

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën

with funding from

Austrian
Development Cooperation

Titulli:
Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën

Citat:
Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Kosovë

Financimi:
Austrian Development Cooperation, Qendra Rajonale e UNDP-së në Bratislavë, Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e rrezikut klimatik në Evropën lindore dhe CIS, Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Kosovë

Udhëzim Administrativ nr. 02/2012
Përmbajtja dhe forma e këtij raporti është në përputhje me nenin 9 të Udhëzimit Administrativ të Republikës së Kosovës nr. 02/2012 për Procedurën, kriteret dhe metodologjinë për përgatitjen dhe aprovimin e dokumenteve dhe planeve strategjike për zbatimin e tyre.

Të drejtat autoriale të mbrojtura© 2014
Në përputhje me nenin 65 (1) të Ligjit të Kosovës për të drejtat e autorit, pjesë të këtij publikimi mund të citohen me kusht që bëhet referencë e qartë në këtë publikim.

Mohim përgjegjësie
Autorët e këtij publikimi kanë ushtruar kujdes të duhur në përgatitjen e këtij publikimi. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet që ky publikim mund të përmbajë gabime apo mund të mos jetë i plotë. Çdo përdorim i përmbajtjes së këtij publikimi është në përgjegjësi vetjake të përdoruesit. Autorët e këtij publikimi dhe organizatat e tyre nuk japin përgjegjësi për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i këtij publikimi.

Përmbledhje ekzekutive 7
Komponentja e I-rë 12
Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët për Kosovën 12
1. Hyrje 13
2. Metodologjia 14
3. Informata të përgjithshme 14
3.1. Konteksti ndërkombëtar 14
3.1.1. Çfarë është Zhvillimi me Emetim të Ulët 14
3.1.2. Pozita ndërkombëtare e Kosovës 14
3.1.3. Konventa Kornizë e OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe Protokolli i Kijotos 16
3.1.4. Veprimet klimatike në Palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I 16
3.1.5. Implikimet e Aderimit në BE 18
3.1.6. Traktati i Komunitetit të Energjisë 20
3.2.1. Gjendja socio-ekonomike 21
3.2.2. Politika për zbutjen e ndryshimeve klimatike 21
3.2.3. Inventari i emërtimeve të gazrave serrë (GS) 23
3.2.4. Energjia 25
3.2.5. Ndërtesat 31
3.2.6. Mineralet dhe industria 32
3.2.7. Transporti 33
3.2.8. Menaxhimi i mbeturinave 34
3.2.9. Bujqësia 35
4. Synimet dhe objektivat 40
5. Alternativat e shqyrtuara: Skenarët e mundshëm të zhvillimit 40
5.1. Modelet globale të parashikimit 40
6. Masat e rekomanduara për reduktim të gazrave serrë 44
7. Hapat e ardhshëm për zbatimin e strategjisë me karbon të ulët 47
7.1. Zhvillimi institucional 47
7.2. Zhvillimi dhe zbatimi i VAKZ-ve 47
7.3. Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të strategjisë 47
7.4. Rishikimi i strategjisë 48
Komponentja e II-të 49
Strategjia Kombëtare e Përshtatjes për Kosovën 49
1. Hyrje 50
1.1 Strategjia Kombëtare e Përshtatjes në lidhje me prioritetet qeveritare 50
1.2 Arsyeshmëria për inicimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes 50
2. Metodologjia 51
2.1. Hyrje 51
2.2. Lista e ministrive dhe institucioneve të përfshira në hartimin e strategjisë 51
2.2.1. Lista e palëve të interesit të përfshira në hartimin e strategjisë 52
2.2.2. Pyetësori i anketës lokale 52
3. Informata të përgjithshme 55
3.1. Përshkrimi i problemit 55
3.2. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë 56
3.2.1. Resurset e ujit 57
3.2.2. Bujqësia, pylltaria, biodiversiteti dhe planifikimi i përdorimit të tokës 60

3.2.3. Shëndeti publik 62
3.3. Qeverisja e përshtatjes klimatik: sfidat për Kosovën 62
3.4. Aktivitetet e qeverisë dhe legjislacioni që ka për synim trajtimin e ndryshimeve klimatike 64
4. Synimet dhe objektivat 69
5. Alternativat e shqyrtuara: Listimi i masave prioritare të përshtatjes për Strategjinë e Kosovës 70
6. Veprimet e rekomanduara 79
6.1. Rritja e kapacitetit të përshtatjes 79
6.2. Pasqyrë e komponentëve të strategjisë dhe formularët e intervenimit 80
6.3. Vlerësimi dhe renditja e intervenimeve 85
6.3.1. Matrica e performancës 90
Matrica e performancës në vijim (tabela 6.3) paraqet rezultatet e vlerësimit. 90
6.4. Korniza e zbatimit 95
7. Hapat vijues për zbatimin e strategjisë 101
7.1. Puna e mëtejme në analiza politike 101
7.1.1. Financimi 101
7.1.2. Ligji 103
7.1.3. Qeverisja e përshtatjes klimatik 103
7.2. Rekomandimet teknike dhe joteknike 105
7.3. Opsionet që publiku i ka për të kontaktuar dhe ngritur brengat e veta 105
Shtojca 1: Përkufizimet kryesore 108
Shtojca 2: Formularët e intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët (përshkrim i VAKZ prioritarë) 114
Shtojca 3: Formularët e intervenimit sipas Strategjisë 124
Shtojca 4: Planifikimi i investimeve dhe implementimi i Strategjisë 179
Shtojca 5: Pasqyrë e strategjisë sektoriale të Strategjisë 182
Shtojca 6: Procesi i zhvillimit të Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët dhe Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes 183
Shtojca 7: Grupi Punues Ndërministror (GPN) dhe ekipi këshillëdhënës përgjegjës për hartimin e CCFS 184
Shtojca 8: Akterët bilateralë 186
Referencat 187

SHKURTESAT

AME	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave
PZHBR	Plani për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural
CA	Marrëveshja e Kopenhagës
CCS	Kapja dhe deponimi i karbonit
KeP	Konferenca e Palëve
DiP	Departamenti i Pyjeve në Ministri
ZRRF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EE	Efiçienca e Energjisë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
EU ETS	Skema e BE-së për tregtimin e emetimeve
EU TAIEX	Instrument për Asistencë Teknike dhe Këmbim të Informatave i menaxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim në Komisionin Evropian
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi, OKB
GAINS	Modeli për Bashkëveprime dhe Sinergji ndaj Gazrave Serrë dhe Ndotjes së Ajrit
FKGJ	Fondi për Klimë të Gjelbër
BPV	Bruto Prodhimi Vendor
GS	Gazrat Serrë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
HC	Hidrocentral
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
ANE	Agjencia Ndërkombëtare për Energji
IHP	Instituti për Hulumtime Pyjore
GPNM	Grupi Punues Ndërministror për Ndryshimet Klimatike
IIASA	Instituti Ndërkombëtar i Analizave të Sistemeve Aplikative
IPA	Instrument për Para-Anëtarësim
AKK	Agjencia Kosovare e Kadastrës
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
PKVEE	Plani Kosovar i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
AKMM	Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
KfW	Kreditanstalt fuer Wiederaufbau
LCP	Impiante të Mëdha me Djegie
LECRDS	Strategjia Zhvillimore për Klimë të Qëndrueshme me Emetim të Ulët
SZHEU	Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët
GLN	Gaz i Lëngëzuar Nafte
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Mt CO2 eq.	Ekuivalent i megaton (milionë tonë) CO2
MRV	Matje, raportim dhe verifikim
VAKZ	Veprimet adekuate kombëtare për zbutje
SKA	Strategjia Kombëtare e Përshtatjes
PKVM	Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis
OJQ	Organizatë Joqeveritare
PKVER	Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme
BRE	Burime të Ripërtëritshme të Energjisë
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
SWD	Dokument Pune i Stafit
TC	Termocentral
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNFCCC	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik
RKSOKB	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
BB	Banka Botërore

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Hartimi i Strategjisë Kornizë për Ndryshime Klimatike është një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedis për periudhën 2011-2015, si dhe është identifikuar si prioritet për procesin e përafrimit të Kosovës me BE-në.

Hartimi i Strategjisë Kornizë për Ndryshime Klimatike është iniciuar në dhjetor 2012 nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) me mbështetje të UNDP-së. Kjo Strategji Kornizë për Ndryshime Klimatike është hap fillestar në procesin e politikave për menaxhim të përshtajtjes. Poashtu, ajo paraqet një mundësi që të gjinden dhe përcaktohen masat për zbutje dhe përshtatje të cilat do të nxisin zhvillim të qëndrueshëm. Prandaj, ajo përbëhet nga dy komponentë: Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët dhe Strategjia Kombëtare e Përshtatjes të cilat janë paraqitur në këtë strategji në dy kapituj.

Përkufizimi i problemit

Kjo Strategji Kornizë për Ndryshime Klimatike është hap fillestar në procesin e politikave për menaxhim të përshtajtjes. Gjithashtu, ajo paraqet një mundësi që t'i shohim masat për zbutje dhe përshtatje të cilat do të nxisin zhvillim të qëndrueshëm. Është me rëndësi që të reagojmë dhe t'i parashikojmë ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Ndikimet aktuale dhe të pritura përfshijnë:

- Emetimet e të gjitha gazrave serrë më 2008 në Kosovë arritën gjithsej në 9.5 Mt CO2 eq. Ato gjatë vitit 2009 janë rritur për gati 11%, pra në 10.5 Mt CO2 eq. Kjo rritje relativisht e lartë është kryesisht pasojë nga djegia e lëndëve fosile.
- Krahasuar me shtetet tjera në Evropë, Kosova ka emetime relativisht të ulëta për kokë banori (5.7 t CO2 ekuivalent për kokë banorë gjatë vitit 2008, derisa emetimet e gazrave serrë për njësi të BPV (0,84 kg CO2 ekuivalent për EUR gjatë vitit 2008) janë më të larta. Emetimet për kokë banori janë vetëm pak mbi gjysmën e mesatares së BE-së (9.93 t) dhe emetimet për njësi të BPV janë gati dyfish më të larta se mesatarja e BE-së (0.4 kg/EUR).
- Këto statistika ilustrojnë sfidat ekonomike dhe sociale për Kosovën të kurthuara me emetime të ulëta por në rritje, ndërsa me BPV edhe më të ulët për kokë banori. Kjo situatë arsyeton aplikimin e parimit të përbashkët për me përgjegjësi të ndryshme të përcaktuar në nenin 3.1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC).
- Ndryshimet klimatike do të rritin ekspozimin në rreziqet nga thatësirat, përmbytjet dhe zjarret në pyje. Ndryshueshmëria e klimës tanimë është rritur në Kosovë;
- Rritja e intensitetit dhe shpeshtësisë së reshjeve ekstreme siç janë shirat e dendur, si dhe thatësirat edhe më të rënda, veçanërisht nga vitet e '80-ta. Përmbytjet e menjëherëshme po bëhen gjithnjë e më të rëndomta në viset malore, gjerësa vërshimet e lumenjve po ndodhin gjithnjë e më shpesh në fusha dhe zona të ulëta;
- Temperaturat më të larta më me gjasë do të shkaktojnë valë të nxehta dhe zjarre në pyje. Që nga viti 2000 e tutje në Kosovë ka pasur gjithnjë e më shumë zjarre në pyje;

- Kosova disa herë është goditur nga thatësirat gjatë dy dekadave të fundit (1993, 2000, 2007, dhe 2008);
- Temperaturat e ngritura, reshjet e pakësuara dhe zvogëlimi i rrjedhave në kombinim me zhvillimet socio-ekonomike dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ujit do ta rrisin ekspozimin në thatësira;
- Që nga viti 2004, 80% e komunave të Kosovës janë përballur me mungesa të ujit për shkak të thatësirave hidrologjike dhe keqpërdorimit të burimeve të ujit; ;
- Degradimi i ekosistemit dhe zvogëlimi i shërbimeve të ekosistemit;
- Shtimi i sëmundjeve dhe paraqitja e sëmundjeve të reja si pasojë e ndotjes dhe ujit

Është me rëndësi të merret parasysh se rreziqet klimatike në një vend si Kosova kanë ndikim shumë më të madh se sa do kishin normalisht, për shkak të shkallës së lartë të cenueshmërisë. Kjo rrjedhë nga disa faktorëve, duke përfshirë:

- Ndërtimet dhe urbanizimi i pakontrolluar nga 1999 deri më tani;
- Cenueshmërinë socio-ekonomike e lartë si pasojë e shkallës së lartë të varfërisë (prek 45% të popullatës) dhe një ekonomie të brishtë e pëcjellur me shërbime të kufizuara në sektorët e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe punësimit;
- Ndërtimet pa leje në zona të rrezikshme si dhe mosrespektimi i standardeve të ndërtimit;
- Mungesa e mirëmbajtjes dhe shkatërrimi gjatë kohës së luftës;
- Sistemet joadekuate të drenazhit dhe kanalizimit;
- Shfrytëzim joadekuat i tokës dhe planifikim joadekuat komunal, të cilat rrisin ekspozimin e popullatës ndaj rreziqeve;
- Menaxhim i paqëndrueshëm i ujit dhe praktikave të paqëndrueshme bujqësore, shpyllëzimi dhe shkatërrimi i shpatinave nga aktivitetet në miniera.

Vizioni i përbashkët, deklarata e misionit dhe objektivat kryesore

Vizioni i Strategjisë Kornizë për Ndryshimet Klimatike

Një Kosovë reziliente e cila në mënyrë efektive zbutë shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe në mënyrë efektive parashikon dhe i përgjigjet ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm.

Deklarata e misionit:

Zvogëlimi i rreziqeve dhe dëmeve nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike me kosto-efektive dhe shfrytëzimi i përfitimeve të mundshme që dalin nga ndryshimet klimatike.

Duke pasur parasysh pasigurinë e lartë për sa i përket nivelit aktual si dhe parashikimit të emetimeve në të ardhmen të gazrave serrë në Kosovë, është vështirë të përcaktohet një objektiv për zbutje me një kuptim të plotë i cili do të definonte caqet e sasisë për redukim të emitimeve. Për të njëjtat arsye dhe për shkak të paqartësisë së zhvillimit të ardhshëm social dhe ekonomik të

vendit, është gjithashtu vështirë të caktohen objektivat afatgjate të strategjisë zhvillimore për emetim të ulët (p.sh. 2050 sipas Udhërrëfyesit të BE-së). Për shkak të kësaj, objektivat për zbutje janë caktuar në kuptim cilësor, si në vijim:

Objektivi i parë i strategjisë për zhvillim me emetim të ulët: Kosova do t'i zhvillojë kapacitetet për t'i përmbushur obligimet e saj të ardhshme në kuadër të Konventës UNFCCC dhe si anëtare e BE-së.

Objektivi i dytë i strategjisë për zhvillim me emetim të ulët: Kosova do të ngadalësojë rritjen e emetimeve të GS përmes

- rritjes së efiçiencës së energjisë në të gjithë sektorët,
- zhvillimit të burimeve të energjisë të ripërtëritshme, dhe
- përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes ka objektivat në vijim:

Objektivi i parë i strategjisë kombëtare për përshtatje: Sjellja e mekanizmave të ri dhe përmirësimi i atyre aktualë për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë, veçanërisht për sektorët me rëndësi ekonomike që janë posaçërisht të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike;

Objektivi i dytë i strategjisë kombëtare për përshtatje: Zgjerimi i kapacitetit[1] të përshtatjes të sistemeve natyrore, në veçanti ekosistemeve të cenueshme, dhe shoqërisë, në veçanti i komuniteteve të cenueshme, siç janë fermerët e varfër, grupet e margjinalizuara dhe gratë, për trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura me jetën dhe mjetet e jetesës së tyre;

Objektivi i tretë i strategjisë kombëtare për përshtatje: Ngritja e kapacitetit të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve qendrorë dhe lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatik dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit lokal dhe kombëtar, si dhe fuqizimi i tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike.

Kursi i dakorduar dhe rekomanduar i veprimit

Gjasat janë shumë të mëdha që Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët do të dërgojë në emetime më të ulëta të gazrave serrë sesa në skenarin pa ndryshime. Ajo do të ndihmojë në:

1. propozimin e zgjidhjeve prioritare për zbutje, të cilat do të sigurojnë mundësi ekonomike;
2. identifikimin e pengesave për zhvillim ekonomik me emetim të ulët të karbonit;
3. forcimin dhe mbështetjen në projektet/investimet ekzistuese, duke tërhequr mbështetje ndërkombëtare shtesë;

[1]Kapaciteti adaptues: aftësia e sistemit për t'u përshtatur ndaj ndryshimit klimatik, për t'i zbutur dëmet potenciale apo për t'i shfrytëzuar përparësitë e mundësive apo për t'u përballur me pasojat (IPCC, 2001).

4. vendimet që do të merren për kontributet/zotimet e ardhshme për reduktim sasior të emetimeve.

Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët paraqet gjithsej 9 **Veprime Adekuate Kombëtare të Zbutjes** të cilat maksimizojnë përfitimet, duke minimizuar pasojat negative.

Duke përdorur një projeksion të thjeshtë të emetimeve të gazarve serrë në varshmëri me kërkesën e parashikuar për energji sipas Planit të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë dhe krahasuar me ndikimin e këtyre masave, na paraqitet një reduktimin i emetimeve prej 7 deri 14% më 2018, krahasuar me skenarin pa ndërmarrjen e këtyre masave . Kjo jep vlerën e parë të përafërt se si do të mund të dukej një cak i emetimit, i cili do të përpunohet më tej pasi të jenë përfunduar inventari dhe parashikimet e emetimeve.

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes përfshin **tetë komponente strategjike** si në vijim:

1. Mbrojtjen nga përmbytjet
2. Thatësirat, rrjedhat e ulëta dhe mungesa e ujit
3. Menaxhimin e pyjeve dhe biodiversitetit
4. Shëndetin publik
5. Menaxhimin dhe shkëmbimin e informatave
6. Ngritjen e kapaciteteve, trajnime dhe ngritjen e vetëdijësimit
7. Financat, mbulimin e kostove dhe menaxhimin i rrezikut
8. Strukturat e bashkëpunimit

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes zbërthen gjithsej 38 **intervenime optimale**, të cilat maksimizojnë përfitimet duke minimizuar pasojat negative. Kjo përfshin masat me kosto efektive për zvogëlimin e rreziqeve, të cilat mund të realizohen pa kompromet uar trajektoret e zhvillimit të qëndrueshëm dhe opsionet e përshtatjes të cilat sigurojnë përfitime pavarësisht kushteve të ardhshme klimatike.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike i referohet përshtatjes në sistemet ekologjike, sociale apo ekonomike si përgjigje ndaj nxitjeve aktuale apo të pritura klimatike si dhe efekteve apo ndikimeve të tyre. Ajo i referohet ndryshimeve në procese, praktika dhe struktura për t'i zbutur dëmet e mundshme apo për të përfituar nga mundësitë që lidhen me ndryshimwt klimatike (Përkufizimi i Konventës UNFCCC: http://unfccc.int). Përshtatja nënkupton parashikimin e efekteve negative të ndryshimeve klimatike dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për parandalimin apo minimizimin e dëmeve që mund t'i shkaktojnë. Veprimet e hershme do të kursejnë nga shpenzimet e mëvonshme për dëme. Strategjitë e përshtatjes janë të nevojshme në çdo nivel të administratës, nga niveli lokal deri te ai ndërkombëtar.

Shembuj të masave të përshtatjes përfshijnë përdorimin më efikas të resurseve të pakta të ujit, përshtatja e standardeve të ndërtimit sipas kushteve të ardhshme klimatike dhe motit ekstrem, ndërtimi i mbrojtjeve nga përmbytjet dhe ngritja e niveleve të digave, zhvillimi i të korrurave që durojnë thatësirat, përzgjedhja e specieve të pemëve dhe praktikave pyjore që janë më pak të

cenueshme ndaj stuhive dhe zjarreve, si dhe vendosja e korridoreve tokësore për të ndihmuar migrimin e specieve. Pjesa 6.2 paraqet një pasqyrë të përgjithshme të komponentëve dhe masave të përshtatjes në kuadër të Strategjisë (d.m.th. intervenimet) që përfshihen në Strategjinë Kombëtare të Përshtatjes së Kosovës.

Përderisa ndryshimet klimatike paraqesin një sfidë shumë të madhe, ato gjithashtu paraqesin një mundësi për inovacion në menaxhimin e resurseve ujore dhe zhvillim të qëndrueshëm në një ekonomi bashkëkohore, posaçërisht përmes rritjes së re (p.sh. energji me erë dhe asaj solare, zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër, prodhimi (i qëndrueshëm) i biokarburanteve, djegie termike, riciklim i ujërave të zeza, si dhe teknologjitë e banimit neutrale në karbon, transport dhe industri neutrale ndaj karbonit, e të tjera).

Përgjithësisht, Strategjia për Kosovën parasheh parashikimin efektiv dhe reagimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh parimet ndërkombëtare për zhvillim të qëndrueshëm. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është jetike për uljen e rrezikut dhe dëmeve nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike me kosto-efektive si dhe për të shfrytëzuar përfitimet e mundshme që dalin nga ndryshimet klimatike. Strategjia do të synojë që të aplikojë mekanizma të ri dhe t'i përmirësojë ata aktualë për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë, të cilat janë me peshë për sektorët e rëndësishëm ekonomikë të cilët janë posaçërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, si dhe për zgjerimin e kapacitetit të përshtatjes të sistemeve natyrale, në veçanti ekosistemeve të cenueshme, dhe shoqërisë, në veçanti komuniteteve të cenueshme, siç janë fermerët e varfër, grupet e margjinalizuara dhe gratë, për trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura në jetët dhe mjetet e jetesës së tyre. Në këtë mënyrë, Strategjia Kombëtare e Përshtatjes ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit lokal dhe rajonal, si dhe fuqizimin e tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike.

Në fund, Strategjia Kombëtare e Përshtatjes synon t'i ndajë dhe pasurojë mësimet e nxjerra, praktikat e mira të përshtatjes, përvojat dhe avokimin për të ndikuar në proceset e politikave dhe të vendimmarrjes në nivel lokal, qendror dhe rajonal.

Komponentja e I-rë

Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët për Kosovën

1. Hyrje

Hartimi i Strategjisë Kornizë për Ndryshime Klimatike (SKNK) është një nga prioritetet të Qeverisë së Kosovës në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit (SKM) dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedis (PKVM) për periudhën 2011-2015, si dhe është identifikuar si prioritet për procesin e përafrimit të Kosovën me BE-në.

Siç është cekur në Dokumentin e Punës të Stafit të Komisionit Evropian SWD (2013) 416 "Raporti final i Progresit për Kosovën - 2013"[2] : "*Kosova nuk e ka një politikë gjithëpërfshirëse dhe as strategji për klimën, dhe nuk ka zhvillime për të raportuar në lidhje me përafrimin me acquis-in mbi klimën. Janë identifikuar gjashtë instalime stacionare me qëllim të zbatimit të ardhshëm të një sistemi të tregtimit të emetimeve dhe është përgatitur një inventar i gazrave serrë (2008-2009). Kosova duhet të ndërmarrë hapa konkretë për përafrim dhe zbatimin e acquis-it me BE-në për klimën, duke filluar nga legjislacioni i mekanizmit monitorues. Në përputhje me Dokumentin e Gjelbër të BE-së mbi ' Një kornizë të vitit 2030 mbi politikat klimatike dhe ato të energjisë'. Kosova është ftuar të fillojë reflektimin mbi kornizën e saj të klimës dhe energjisë për vitin 2030. Duhet të vendoset bashkëpunimi ndër-institucional mes Ministrisë se Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Infrastrukturës për të mundësuar zvogëlimin e emetimit të karbonit. Kosova ka marrë pjesë në mënyrë aktive në punën mbi klimën në kuadër të Rrjetit Rajonal Mjedisor për Anëtarësim. Duhet të bëhen përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin në të gjitha nivelet dhe për të promovuar bashkëpunim midis të gjitha palëve relevante të interesit.*"

Ndonëse Kosova ende nuk është pjesëmarrëse dhe nuk ka nënshkruar *Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshim Klimatik* (UNFCCC) dhe Protokollin e saj të Kijotos, ajo ka përgjegjësi për t'iu përgjigjur kërkesave të Konventës dhe Protokollit, si një nga palët nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Traktati i Komunitetit të Energjisë gjithashtu përcakton caqe të qarta të uljes së përdorimit të energjisë gjersa kërkon rritje të proporcionit të energjive të ripërtëritshme.

Autoriteti përgjegjës për politikat për mjedis dhe klimë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Më 2012, me mbështetje të UNDP, Kosova ka përgatitur inventarin e parë kombëtar të gazrave serrë për periudhën 2008 – 2009. Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka përgjegjësi për politikat e energjisë dhe është në krye të përpjekjeve për përmbushjen e caqeve të BE-së 20-20-20 në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, duke përfshirë Planin e Veprimit për Energji të Ripërtëritshme dhe Planin e Veprimit për Efiçiencë të Energjisë dhe Agjencia Kosovare për Efiçiencë të Energjisë ka planifikuar disa projekte për zvogëlimin e gazrave serrë në ndërtesa dhe sektorë të tjerë.

Qëllimi i Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët është që të mundësohet një kornizë gjithëpërfshirëse e politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike bazuar në nivelin aktual të informatave. Në njërën anë, Strategjia merr parasysh përpjekjet e vazhdueshme të Kosovës, dhe në anën tjetër siguron udhëzim për hapat e ardhshëm që do të merren në kuptim të përmbushjes së kërkesave të BE-së dhe përgjegjësive të ardhshme globale të Kosovës.

[2] http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/brochures/kosovo_2013.pdf

2. Metodologjia

Hartimi i strategjisë bazohet në një proces të planifikimit me pjesëmarrje duke siguruar se janë konsultuar të gjithë akterët qendrorë dhe lokalë. Për këtë qëllim në muajin mars 2013 Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor themeloi Grupin Punues Ndërministror për Ndryshimet Klimatike (GPNM). Grupi punues është mbështetur në përpjekjet e tij nga zyra e UNDP-së në Kosovë, duke siguruar informata të rëndësishme nga ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, si dhe nga Instrumenti i Asistencës Teknike dhe Këmbimit të Informatave i menaxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e Komisionit Evropian (EU TAIEX).

Procesi ka ndjekur Udhëzuesin e UNDP-së "*Përgatitja e Strategjive Zhvillimore me Klimë të Qëndrueshme dhe Emetim të Ulët"* për aq sa ka mundur në kuptim të kohës, informatave dhe resurseve në dispozicion. Për më shumë detaje shih Shtojce 6.

3. Informata të përgjithshme

3.1. Konteksti ndërkombëtar

3.1.1. Çfarë është Zhvillimi me Emetim të Ulët

Ndërkombëtarsiht është pranuar se tranzicioni në një zhvillim me emetim të ulët si për ekonomitë e zhvilluara ashtu edhe për ato në zhvillim është i domosdoshëm për stabilizimin e përqendrimeve të gazrave serrë në pajtim me skenarin e rritjes së temperaturës prej 2^{o} C. Për të arritur reduktimin e emetimeve kërkohet që në mbarë globin të kalohet në mënyrat e zhvillimit me emetim të ulët. Kjo nënkupton shkëputjen e emetimeve të karbonit nga rritja ekonomike përmes një varg masash në të gjithë sektorët ekonomikë, siç janë përmirësimet e efiçiencës së energjisë, përdorimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, menaxhimi i ndryshimit të përdorimit të tokës dhe të tjera.

Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët është dokument strategjik që ndihmon vendet në ndërrimin e rrugës së zhvillimit drejt një ekonomie me karbon të ulët dhe realizimit të zhvillimit të qëndrueshëm, bazuar në prioritetet e tyre soci-ekonomike dhe zhvillimore. Ajo ka një komponentë afatgjate e cila përmbajnë një vizion strategjik si dhe nga një komponentë afatshkurtër dhe afatmesme të cilat paraqesin veprimet specifike për t'i ndërmarrë për të kaluar në rrugën e karbonit të ulët. Përgatitja e Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët bazohet në rrethana specifike në secilin vend, duke përfshirë kapacitetin institucional dhe profesional të tij, përvojat e mëhershme në luftimin e ndryshimeve klimatike dhe kontekstin e përgjithshëm të politikave.

3.1.2. Pozita ndërkombëtare e Kosovës

Kosova është shtet në zhvillim dhe vend me perspektiv për anëtarësim në BE. Rrethanat me rëndësi të cilat janë marrë parasysh në Kosovë, mes tjerash, janë si në vijim:

- Kosova ende nuk është palë e Konventës Kornizë për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC)[3], megjithatë, sipas kategorizimit të saj të vendeve do të konsiderohej si vend në zhvillim (shtetet jo anëtare të Shtojcës I).[4]

[3] RKSOKB 1244 dhe Mendimi i GJND për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës

[4] Sipas Vendimit të UNFCCC 1/CP.17 pritet që marrëveshja e re UNFCCC që pritet të aprovohet deri më do të mbulojë të gjitha shtetet me obligime të zbutjes pas vitit 2020

- Kosova synon anëtarësim në BE, që përfshin ndryshimin sipas legjislacionit të BE-së dhe zbatimin e tij dhe kështu në mënyrë graduale të kalojë nga statusi i vendit në zhvillim në atë të vendit të zhvilluar sipas Konventës UNFCCC.
- Duke qenë një shtet i ri, kapacitet dhe përvojat e saj në trajtimin e ndryshimeve klimatike janë shumë të kufizuara si pasojë e prioriteteve të tjera gjatë viteve të fundit.
- Informatat për emetimet e gazrave serrë dhe në veçanti për projektimin dhe preventimin e tyre janë ende të pamjaftueshme. [5]
- Tanimë, një numër i dokumenteve të veprimit dhe strategjive janë zhvilluar dhe miratuar, mirëpo ato ende mbetet të zbatohen. Në këto rrethana, është i nevojshëm një dokument madhor për t'i ngërthyer së bashku të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike si dhe për t'i caktuar prioritetet e duhura.

Sipas kësaj që u tha më lartë, në këtë periudhë kohore nuk është e realizueshme dhe as e dobishme qasja gjithëpërfshirëse dhe e hollësishme për hartimin e Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët . Sfida kryesore dhe përparësia qëndron të të shkohet drejtë një ekonomie me karbon të ulët duke ulur emetimet e gazrave serre por duke përmbushur edhe objektivat e përmirësimit të shpejtë të gjendjes ekonomike, kohezionit social dhe duke pranuar mbështetje ndërkombëtare. Kjo do të kërkojë tejkalimin nga situata aktuale në trende të qëndrueshme të prodhimit, konsumit dhe mënyrës së jetesës ashtu që Kosova, si anëtare e ardhshme e BE-së, të mund të kontribuojë në konkurrencën dhe kohezionin evropian në periudhë afatgjate.

Si parim parësor i Strategjisë aktuale për Zhvillim me Emetim të Ulët, është përdorur ***Parimi i kujdesit paraprak*** i Konventës UNFCCC (neni 3.3 UNFCCC), i cili përcakton:

> "Palët duhet të marrin masa të kujdesit paraprak për të parashikuar, parandaluar apo minimizuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe zbutur efektet negative të tyre. Nëse ka kërcënime nga dëme serioze apo të përherëshme, mungesa e sigurisë së plotë shkencore nuk duhet të përdoret si arsye për shtyrjen e ndërmarrjes së këtyre masave, duke pasur parasysh se politikat dhe masat për trajtimin e ndryshimeve klimatike duhet të jenë me kosto-efektive në mënyrë që të sigurojnë përfitime globale me kosto sa më të ulëta. Për ta arritur këtë, këto politika dhe masa duhet të marrin parasysh rrethanat e ndryshme socio-ekonomike, të jenë gjithëpërfshirëse, t'i mbulojnë të gjitha burimet, pellgjet dhe rezervuarët relevante të gazrave serrë dhe përshtatjen e tyre, si dhe të përfshijnë të gjithë sektorët ekonomikë. Përpjekjet për t'i trajtuar ndryshimet klimatike mund të realizohen bashkërisht nga Palët e interesuara."

Kjo strategji është hapi fillestar i një procesi të politikave me informata të menaxhimit të përshtatjes. Ajo gjithashtu paraqet një mundësi për të kërkuar për masa adekuate të zbutjes të cilat do të nxisin zhvillim. Strategjia aktuale për Zhvillim me Emetim të Ulët me gjasë do të dërgojë në emetime më të ulëta gazrave serrë sesa në një skenari pa ndryshime. Ajo do të ndihmojë në:

- propozimin e zgjidhjeve prioritare për zbutje, të cilat do të sigurojnë mundësi ekonomike;
- vendimet që do të merren për kontributet/zotimet e ardhshme për reduktim sasior të emetimeve.

[5] Sistemi fillestar i inventarit të GS në Kosovë është siguruar nga projekti "Bartja e Përvojave Çeke: Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Inventarit të Gazrave Serrë në Kosovë" financuar nga UNDP. Për shkak të mungesës së të dhënave të veçanta historike statistikore, modeli i parashikimit të emetimeve globale ende e konsideron Kosovën si grup me Serbinë dhe Malin e Zi.

- identifikimin e pengesave për zhvillim ekonomik me emetim të ulët të karbonit;
- forcimin dhe mbështetjen në projektet/investimet ekzistuese, duke tërhequr mbështetje ndërkombëtare shtesë;

3.1.3. Konventa Kornizë e OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe Protokolli i Kijotos

Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimetn Klimatike (UNFCCC)[6]është miratuar më 9 maj 1992 në Konferencën e OKB-së për Mjedis dhe Zhvillim të Qëndrueshëm[7]në Rio de Zhaneiro si një reagim i bashkësisë ndërkombëtare ndaj fenomenit të ndryshimeve klimatike, të shkaktuar nga rritja e përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë. Objektivi i përgjithshëm i Konventës UNFCCC synon stabilizimin e përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë në një nivel që do të parandalonte ndërhyrjet e rrezikshme antropogjenë (faktori njeri) me sistemin klimatik. Deri më sot, 196 shtete janë Palë të Konventës.

Në Konferencën e tretë të palëve (KeP) në kuadër të Konventës UNFCCC (Kijoto, 1997) u miratua Protokolli i Kijotos (PK)[8], përmes së cilit vendet e industrializuara dhe ekonomitë në tranzicion të përfshira në Shtojcën I të Konventës zotoheshin për uljen e totalit të emetimeve të tyredirekte nga gazrat serrë për së paku 5 për qind kundrejt niveleve të vitit 1990, përgjatë një periudhe kohore pesëvjeçare 2008-2012 (periudha e parë e zotimit)[9]. Në fund të periudhës së parë të zotimit, në Doha më 2012, është miratuar një amendament për të zgjatur Protokollin deri më 2020 (periudha e dytë e zotimit 2013–2020). Në këtë amendament, BE zotohet që të ulë emetimet për 20% gjatë periudhës deri më 2020, krahasuar me vitin bazë.

3.1.4. Veprimet klimatike në Palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I

Në Planin e Veprimit Bali të miratuar në KeP 13 (2007)[10], vendet në zhvillim janë pajtuar për herë të parë që të hartojnë dhe zbatojnë Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje (VAKZ)[11]në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm, me mbështetje dhe mundësim të teknologjisë, financim dhe ngritje të kapaciteteve.

Konferenca e 15-të e Palëve e mbajtur në Kopenhagë në dhjetor 2009 ka marrë parasysh Marrëveshjen e Kopenhagës (MK)[12]–deklaratë kjo politike e cila bie dakord me kufizimin e ndryshimeve klimatike në jo më shumë se 2°C mbi nivelet paraindustriale në kontekst të barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe ripohon aspektet zhvillimore të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë strategjitë për zhvillim me emetim të ulët.

Në Konferencën e 16 të Palëve të mbajtur në Kankun në dhjetor 2010 u miratua Marrëveshja e Kankunit[13], e cila nxitë qeveritë që të përgatisin strategji për zhvillim me karbon të ulët në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm dhe gjithashtu shtetet në zhvillim që të ndërmarrin Veprimet Adekuate Kombëtare për Zbutje (VAKZ) në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm. Marrëveshja e Kankunit *"pranon se trajtimi i ndryshimeve klimatike kërkon një lëvizje të paradigmës drejt ndërtimit të një shoqërie të karbonit të ulët e cila ofron mundësi të konsiderueshme dhe siguron rritje të vazhdueshme dhe zhvillim të qëndrueshëm".*

[6] http://unfccc.int/files/essential_background/background_publications_htmlpdf/application/pdf/conveng.pdf
[7] http://www.un.org/geninfo/bp/enviro.html
[8] http://unfccc.int/resource/docs/convkp/kpeng.pdf
[9] http://unfccc.int/kyoto_protocol/items/3145.php
[10] http://unfccc.int/resource/docs/2007/cop13/eng/06a01.pdf
[11] http://unfccc.int/focus/mitigation/items/7172.php
[12] https://unfccc.int/meetings/copenhagen_dec_2009/items/5262.php
[13] https://unfccc.int/meetings/cancun_nov_2010/items/6005.php

Marrëveshja e Kopenhagës parasheh që edhe shtetet e zhvilluara edhe ato në zhvillim do të realizojnë masa për zbutje. Më tej, ajo parasheh se vendet në zhvillim do të përgaditin Strategji për Zhvillim me Emetim të Ulët si plane për ndarjen e zhvillimit të tyre ekonomik nga rritja e emitimeve. Shtetet në zhvillim gjithashtu do të zbatojnë Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje.

Përveç caktimit të një vizioni të qartë të përgjithshëm dhe synimeve strategjike të tranzicionit drejt zhvillimit të qëndrueshëm me emetim të ulët, Strategjia për Zhvillim më Emetim të Ulët do të duhej të përfshijë një varg masash konkrete të cilat dërgojnë në reduktim të emetimeve të gazarve serrë, përcaktimin e sasisë për ulje të emetimit përkatës për secilën masë dhe kërkesa financiare për zbatimin e tyre. Për palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I, masat mund të shprehen si Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje. Përfundimisht, Strategjia për Zhvillim më Emetim të Ulët duhet të definojë qasjen për zbatim, duke përcaktuar hapat konkrete dhe afatet kohore, si dhe dispozitat për monitorim, matje, raportim dhe verifikim të rezultateve të arritura si dhe në bazë të përvojës gjatë zbatim të përcaktohet edhe një mekanizëm për përmirësim të mëtejmë..

Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje si formë e përshtatshme e veprimit të zbutjes nga shtetet në zhvillim, në parim mund të përfshijë një gamë të gjerë të qasjeve të ndryshme për veprimet e zbutjes me mbështetje ndërkombëtare apo zbatim brenda vendit, siç është zbatimi i politikave, programeve, projekteve individuale apo madje zbatimi i ndryshimeve specifike në ekonomitë kombëtare për uljen e emetimeve të tyre të gazrave serrë. Janë dy lloje kryesore të Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje: (i) Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje të njëanëshme (unilaterale): veprime të zbutjes të ndërmarra nga shtetet në zhvillim me vetë iniciativë; (ii) Veprime të Duhura Kombëtare për Zbutje të mbështetura: veprime të zbutjes në shtetet në zhvillim, të mbështetura me financim, teknologji dhe ngritje të kapaciteteve nga shtetet e Shtojcës I.

Sipas Marrëveshjes së Kopenhagës, Palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I do të zbatojnë veprime të zbutjes. Veprimet e zbutjes të ndërmarra nga Palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I (VAKZ unilaterale) do t'i nënshtrohen procedurave të tyre vendore të matjes, raportimit dhe verifikimit (MRV) dhe për ato do të raportohet çdo dy vite përmes raporteve dyvjeçare të progresit duke u bazuar në udhëzimet që do të miratohen nga Konferenca e Palëve (KeP). Duhet të parashihet koha për konsultime dhe analiza ndërkombëtare sipas udhëzimeve të qarta që do të sigurojnë respektimin e sovranitetit shtetëror.
VAKZ do të futen në një regjistër[14]krahas me mbështetjen e kërkuar të teknologjisë relevante, financiare dhe të ngritjes së kapaciteteve. Ato do t'i nënshtrohen procedurave ndërkombëtare të MRV në pajtim me udhëzimet e miratuara nga Konferenca e Palëve. Udhëzimet për hartimin e VAKZ (mbështetur në përvojat e shteteve) janë përgatitur së fundi nga UNFCCC dhe mund të gjenden në (http://unfccc.int/files/cooperation_support/VAKZ/application/pdf/guidance_for_VAKZ_design_(2013)_final.pdf).

Ndonëse ende nuk është palë e konventës, Kosova i mbështet përpjekjet globale dhe kontribuon për stabilizimin e përqendrimeve në pajtim me skenarin e rritjes së temperaturës prej 2 shkallë dhe ajo duhet ta kalojë në rrugën e zhvillimit me emetim të ulët. Kosova tanimë është zotuar në uljen e emetimeve në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Hapi i parë është që të hartohet një Strategji për Zhvillim me Emetim të Ulët dhe që VAKZ-t të prezantohen pasi të

[14] http://unfccc.int/cooperation_support/nama/items/6945.php

nënshkruhet Konventa, apo ndërkohë tek donatorët e tjerë për mbështetje në zhvillim dhe zbatim.

Konferenca e Palëve[15] e 17-të është mbajtur në Durban, Afrikë të Jugut, në dhjetor 2011. Në konferencë është rënë dakord që BE dhe disa shtete të tjera do të zotohen në një periudhë të dytë kohore për caqet e Kijotos, për periudhën ndërmjet 2012 dhe 2020. Pas kësaj, duhet të hyjë në fuqi një marrëveshje e re globale, e cila do të aplikohet në të gjitha shtetet e botës sipas parimit të përgjegjësisë së përbashkët por të ndarë, që do të përgatitet deri më 2015, dhe do të hyjë në fuqi më 2020. Gjithashtu ka pasur progres në kuptim të krijimit të Fondit për Klimë të Gjelbër(FKGJ)[16] për të cilin është miratuar korniza e menaxhimit. Deri më 2020, Fondi do të shpërndajë një pjesë të shumës prej 100 milionë dollarë në vit për shtetet në zhvillim për veprimet e tyre të zbutjes dhe përshtatjes.

Në Konferencën e Palëve të 18-të në Doha, Katar, është arritur një marrëveshje për vazhdimin e kohëzgjatjes së Protokollit të Kijotos, me periudhën e dytë të zotimit deri më 2020, si dhe për të punuar në Platformën e Durbanit, që nënkupton që "protokolli i ri, instrumenti ligjor apo rezultatet e miratuara me fuqi juridike" do të definohen dhe vihen dakord deri më 2015 ndërsa do të hyjnë në fuqi më 2020. Konferenca ka prodhuar një pako të dokumenteve që bashkërisht titullohen Porta Klimatike e Dohës[17]. Dokumentet si tërësi përfshijnë:

- Një zgjatje tetëvjeçare të Protokollit të Kijotos deri më 2020.
- Kapitalizimi i Fondit të Klimës së Gjelbër është paraparë për mesin e vitit 2014, ndërsa të gjitha strukturat për zbutje, përshtatje, teknologji të zhvillimit dhe transferim, ngritje të kapacitetit dhe MRV janë të sistemuara dhe funksionojnë sipas planifikimit.

Në Konferencën e Palëve të 19-të në Varshavë më 2013 u miratua një vendim përmes së cilit është rënë dakord për një tabelë kohore për të lehtësuar zhvillimin e marrëveshjes së re; një kërkesë për të gjitha vendet "për të iniciuar përgatitjet vendore për kontributet e tyre të synuara kombëtare", dhe një kërkesë për t'i shtjelluar më tutje elementet për tekstin negocues për marrëveshjen 2015, që do të fillojë në mars 2014.

3.1.5. Implikimet e Aderimit në BE

Strategjia përcakton një udhërrëfyes të përgjithshëm të ndryshimeve klimatike për Kosovën për ta mbështetur procesin e aderimit në BE që shpie në regjim të "llojit të Shtojcës I" (shtete të zhvilluara) apo të ngjashëm dikur pas vitit 2020. Deri në atë kohë, Strategjia duhet të bëjë përpjekje që kryesisht përmes mekanizmit të VAKZ-ve bilaterale ta mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të Kosovës, duke maksimizuar shfrytëzimin e mbështetjes ndërkombëtare për financim, ngritje të kapaciteteve dhe transferim të teknologjisë,. Këta mekanizma financiarë do të kenë sukses vetëm nëse objektivat dhe projektet e ndryshimeve klimatike integrohen mirë në politikat dhe strategjitë vendore të zhvillimit ekonomik, si ato që kanë të bëjnë me zbutjen e varfërisë, energjinë, transportin, industrinë, etj. Shqyrtimi i këtyre supozimeve në strategji gjithashtu mund të kërkojë dialog me Komisionin e BE-së brenda kornizave në dispozicion.

Caqet e BE-së për klimë dhe energji[18]janë caktuar nga Liderët e BE-së në mars të vitit 2007, kur kanë zotuar Evropën që të bëhet një ekonomi tejet efikase në kuptim të energjisë, me karbon të

[15] http://unfccc.int/key_steps/durban_outcomes/items/6825.php
[16] http://gcfund.net/home.html
[17] http://unfccc.int/key_steps/doha_climate_gateway/items/7389.php
[18] http://ec.europa.eu/clima/policies/package/

ulët, dhe janë miratuar përmes pakos për Klimë dhe Energji më 2009. Kjo pako është një legjislacion i obligueshëm që synon të sigurojë se Bashkimi Evropian përmbush caqet ambicioze klimatike dhe energjetike të tij për 2020. Këto caqet, që njihen edhe si caqet "20-20-20", përcaktojnë tre objektiva kryesorë për 2020:

- Reduktim prej 20% të emetimeve të gazrave me efekt serrë në BE nga nivelet e vitit 1990;
- Rritja e proporcionit të konsumit të energjisë së prodhuar në BE nga burimet e ripërtëritshme për 20%;
- Përmirësim i efiçiencës së energjisë në BE prej 20%.

Caqet 20-20-20 paraqesin një qasje të integruar në politikat klimatike dhe të energjisë që kanë për synim luftimin e ndryshimeve klimatike, rritjen e sigurisë së energjisë së BE-së dhe fuqizimin e konkurrencës së saj. Ato janë gjithashtu caqe promovuese të Strategjisë Evropa 2020 për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse. Kjo pasqyron njohjen që trajtimi i sfidave klimatike dhe të energjisë kontribuon në krijimin e vendeve të punës, gjenerimin e rritjes së "gjelbër" dhe forcimin e aftësisë konkurruese të Evropës. Është vlerësuar se përmbushja e cakut të energjisë së ripërtëritshme prej 20% mund të ketë ndikim neto të krijimit të rreth 417,000 vendeve të reja pune[19], ndërsa angazhimet e duhura për përmbushjen e përmirësimit të efiçiencës së energjisë prej 20% deri më 2020 parashikohet se do të nxisë rreth 400,000 vende të reja pune. Pakoja klimatike dhe e energjisë nuk e trajton cakun e efiçiencës së energjisë drejtpërsëdrejti. Kjo bëhet përmes Planit të Efiçiencës së Energjisë 2011 dhe Direktivës së Efiçiencës së Energjisë.

Përpjekjet e BE-së për reduktim të emetimeve përbëhen nga dy qasje kryesore:

- Skema e tregtimit të emetimeve të BE-së - **EU ETS**[20], ku caku i reduktimeve të emetimeve prej 21% deri më 2020 është caktuar për tërë BE-në. Ky sistem përfshin emetuesit e mëdhenj: fabrikat, termocentralet dhe stabilimentet e tjera dhe funksionon në parimin "tavan dhe tregti". Kjo do të thotë se "tavan", apo kufizim, në shumën totale të gazrave të caktuar serrë që mund të emetohen nga sistemi. Përbrenda këtij tavani, kompanitë pranojnë lejime të emetimeve të cilat mund t'i shesin apo blejnë nga njëra-tjetra, sipas nevojës. Kufizimi në numrin total të lejimeve në dispozicion siguron se ato kanë vlerë. Fleksibiliteti që sjell tregtia siguron se emetimet shkurtohen aty ku kushton më së paku.
- I ashtuquajturi **"Vendim për Ndarje të Përpjekjeve"**[21]përcakton caqet e obligueshme vjetore të emetimeve të gazrave serrë për Shtetet Anëtare për periudhën 2013–2020. Këto caqe kanë të bëjnë me emetimet nga sektorë që nuk përfshihen në EU ETS –siç janë transporti, ndërtesat, bujqësia dhe mbeturinat. Është pjesë e pakos së politikave dhe masave për ndryshime klimatike dhe energjinë që do të ndihmojë në transformimin e Evropës në një ekonomi të karbonit të ulët dhe do të rrisinë sigurinë e saj të energjisë. Caku i kombinuar për të gjitha shtetet anëtare të BE-së deri më 2020 është 10%, por caqet individuale mund të ndryshojnë nga -20% deri në +20% varësisht nga rrethanat vendore dhe fuqia ekonomike e shteteve. Disa nga Shtetet Anëtare janë të lejuara që të rrisin emetimet e tyre gjersa shtetet më të avancuara duhet të ulin më shumë.

[19] http://ec.europa.eu/clima/policies/package/

[20] **Sistemi i tregtimit të emetimeve të BE-së (EU ETS)** Direktiva për Tregtimin e Emetimeve 2003/87/EC dhe ndryshimet e saj http://ec.europa.eu/clima/publications/docs/factsheet_ets_en.pdf

[21] **Vendimi për Ndarjen e Angazhimeve (ESD)** Nr. 406/2009/EC http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2009:140:0136:0148:EN:PDF

Duke supozuar se sistemi mbetet i njëjtë edhe kur Kosova të ketë hyrë në BE, kufiri i lartë i saj për ETS do të vendoset në bazë të emetimeve historike në sektorin e ETS dhe caku për reduktim të vendeve që nuk janë pjesë e ETS do të vendoset në bazë të kritereve të zbatueshme, duke përfshirë nivelin e zhvillimit të përgjithshëm.

Sipas Direktivës së Energjisë së Ripërtëritshme , Shtetet Anëtare kanë marrë përsipër caqet të detyrueshme kombëtare për rritjen e përqindjes së energjisë së ripërtëritshme në konsumin e tyre të energjisë deri në vitin 2020. Këto caqe, të cilat reflektojnë pikënisjet e ndryshme të Shteteve Anëtare dhe potencialin për rritjen e prodhimit nga burimet e ripërtëritshme, ndryshojnë nga 10% në Maltë deri në 49% në Suedi. Objektivat kombëtare do ta mundësojnë BE-së si tërësi që ta arrijë cakun e saj prej 20% për energji të ripërtëritshme për 2020 - më shumë se dyfishi i nivelit të 2010 prej 9.8% - si dhe një proporcion prej 10% të energjisë së ripërtëritshme në sektorin e transportit. Këto caqe do të ndihmojnë në uljen e emetimeve të gazrave serrë dhe zvogëlimin e varësisë së BE-së në energjinë e importuar.

Një tjetër element i pakos së klimës dhe energjisë është direktiva që përfshin një kornizë ligjore për përdorimin e teknologjive të sigurta në kuptim mjedisor të kapjes dhe deponimit të karbonit . Kapja dhe deponimi i karbonit (CCS) përfshin kapjen e dyoksidit të karbonit të liruar nga proceset industriale dhe deponimin e tij në formacione gjeologjike nëntokësore ku nuk kontribuon në ngrohjen globale. Direktiva mbulon të gjitha formacionet gjeologjike në BE dhe shtron kërkesat të cilat aplikohen për tërë jetëgjatësinë e lokacioneve të deponimit.

3.1.6. Traktati i Komunitetit të Energjisë

Për Kosovën, instrumenti dhe shtytësi kryesor i politikave të energjisë dhe atyre mjedisore në rajon është Komuniteti i Energjisë (TKE) i Bashkimit Evropian dhe nëntë palëve kontraktuese të Evropës Juglindore dhe rajoneve të Detit të Zi (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Maqedoni, Moldavi, Mal i Zi, Serbi dhe Ukrainë), i themeluar më 2005. Neni 3 i Traktatit kërkon nga palët kontraktuese që ta zbatojnë Acquis Communautaire për energji, mjedis, konkurrencë dhe burime të ripërtëritshme. Më saktësisht, ajo përcakton një plan kohor për zbatimin e Direktivave prioritare. Direktiva VNM dhe neni 4(2) i Direktivës për Zogjtë do të zbatoheshin që nga hyrja në fuqi e Traktatit; Direktiva që ka të bëjë me uljen e përmbajtjes së sulfurit në karburante të caktuar të lëngët deri më 31 dhjetor 2011; dhe Direktiva për Impiante të Mëdhenj (LCP) do të zbatohet nga 31 dhjetori 2017.

Shumica e Palëve kontraktuese, duke përfshirë Kosovën[22], janë zotuar në një cak të kursimeve të energjisë prej 9% të konsumit fundor ndërmjet 2009 dhe 2018, përmes Planeve të tyre Kombëtare të Efiçiencës së Energjisë. Më 2012, Këshilli Ministror i Traktatit është pajtuar për caqet e burimeve të ripërtëritshme të energjisë për palët (Kosova do ta rrisë proporcionin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme nga 19,9 në 25%)[23]dhe në tetor 2013 ato kanë rënë dakord që të aplikojnë obligimin për zbatimin e Direktivës së re të BE-së për Emetimet Industriale në kuadër të Traktatit[24].

3.2. Gjendja në Kosovë

[22] http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Kosovo_Energy_Efficiency_Action_Plan_2010-2018.pdf
[23] http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/1766219.PDF
[24] http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/2388178.PDF

3.2.1. Gjendja socio-ekonomike

Kosova është shtet pa dalje në det, me pozicion në qendër të Gadishullit Ballkanik, e kufizuar me Serbinë, Maqedoninë (IRJ), Shqipërinë dhe Malin e Zi. Territori i Kosovës është 10,908 km^2. Kosova ka klimë kontinentale, me vera të nxehta dhe dimra të ftohët. Kosova ka dendësi prej rreth 193 banorë për km^2, me 37 komuna dhe kryeqytet e ka Prishtinën.

Vlerësimet e popullatës për vitin 2012 janë 1,815,606. Përbërja etnike është 90 % shqiptarë, 5 % serbë, 2 % myslimanë sllavë (boshnjakë, goranë), 2 % romë dhe 1 % turq. Kosova aktualisht ka popullatën më të re në Evropë, me moshë mesatare prej 29.5 vite dhe lindshmëri të vlerësuar prej 2.4 fëmijë për një grua. Ka pasur migrim madhor të brendshëm të popullatës së Kosovës, kryesisht nga viset rurale drejt atyre urbane, që nga ndërprerja e konfliktit më 1999, por ende 58% e popullsisë jeton në vise rurale dhe 42% në qendra urbane. Kryeqyteti i Prishtinës është rajoni me shkallën më të lartë të migrimit të brendshëm.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, gjithsej numri i personave të punësuar është 280,000, duke përfshirë 215,000 burra dhe 66,000 gra. Shkalla e papunësisë është 55,5 % për gratë dhe 40,5 % për burrat dhe vakumi gjinor në përfundimin e shkollimi të lartë është 60%. Për më shumë se 900,000 njerëz, mbështetja nga një person tjetër është burimi kryesor i të ardhurave.

Mbi 500,000 persona jetojnë jashtë vendit. Diaspora kosovare është faktor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik të Kosovës. Megjithatë, ky potencial ende nuk është shfrytëzuar sa duhet dhe nuk kanalizohet në aktivitete produktive të cilat do të kishin efekte zinxhirore. Përveç trajtimit të nevojave dhe prioriteteve të Diasporës së Republikës së Kosovës, është duke u hartuar edhe Strategjia për Diasporën e mbështetur me aktet normative në fuqi në Republikën e Kosovës.

Ekonomia e Kosovës është e re dhe dinamike, përdorë euron si valutë zyrtare dhe Bruto Prodhimin Vendor (BPV) në vitin 2012 ishte € 4.723 miliardë, BPV për kokë banori €2.618. Nga 2010 në 2012 BPV është rritur për nga 4 deri 5 për qind në vit. Eksporti i mallrave në vitin 2011 kishte vlerë prej 319 milion euro dhe importet 2,492 Euro. Që nga viti 1999 Kosova është transformuar nga një ekonomi e centralizuar dhe e kontrolluar, në një ekonomi të tregut të lirë. Synimi tani është që të rritet konkurrenca brenda ekonomisë, duke rritur kapacitetet e eksportit për uljen e deficitit tregtar të Kosovës. Përveç që është anëtare e CEFTA-s, në qershor 2009 Kosova u bë anëtare e FMN-së (Fondi Monetar Ndërkombëtar) dhe BB-së (Banka Botërore), dhe aspiron anëtarësim në mekanizma të tjerë të fortë ekonomikë dhe financiarë si BERZH, Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) etj.

3.2.2. Politika për zbutjen e ndryshimeve klimatike

Autoriteti përgjegjës për politikat mjedisore dhe për ndryshimet klimatike është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). MMPH ka nisur konsultimet me Sekretariatin e Konventës UNFCCC dhe ka filluar me përgatitjet e dokumentacionit për ratifikimin e Konventës.

Bazuar në një marrëveshje ndërmjet UNDP-së dhe MMPH-së, nga dhjetori 2012 MMPH bashkë me UNDP bashkërendon mbështetjen e donatorëve për agjendën e ndryshimeve klimatike për Kosovën.

Kosova ende nuk ka regjistër të burimeve dhe emetimeve të gazrave serrë dhe nuk ka identifikuar vitin bazë nga i cili do të vlerësohen emetimet e gazrave serrë. Inventarët e gazrave serrë për 2008 dhe 2009 janë ndër nismat e para në Kosovë që kontribuojnë në përpjekjet

globale për minimizimin e ndikimit të njeriut në ndryshimet klimatike. Ky projekt vazhdon me aktivitete të mëtejshme të ndërtimit të kapaciteteve për monitorimin dhe raportimin e gazrave serrë në periudhën 2013-2014. Kosova ende nuk ka filluar të dorëzojë Komunikata Kombëtare në Sekretariatin e UNFCCC.

Deri në një masë, ndryshimet klimatike janë ndër katër dokumentet e përgjithshme të politikave mjedisore të shtjelluara në vijim.

Strategjia Mjedisore për Kosovën (MMPH) është hartuar për periudhën 2005-2015 me këto fusha prioritare: ndryshimet klimatike, acidimi, biodiversiteti, uji, mjedisi urban dhe menaxhimi i mbeturinave.

Prioritetet për Strategjinë janë:

- Kompletimi i legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, në harmoni me legjislacionin e BE-së;
- Plotësimi gradual i standardeve të BE-së, dhe;
- Zbatimi efikas dhe integrimi efikas i legjislacionit dhe metodologjive mjedisore në të gjithë sektorët;
- Ndërtimi dhe zhvillimi i mëtejmë i institucioneve kompetente, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve;
- Themelimi i Eko-fondit;
- Themelimi dhe funksionimi i rrjetit të monitorimit mjedisor në Kosovë;
- Përdorimi racional i resurseve natyrore;
- Zhvillimi i programeve afatgjate për edukim;
- Fushatat dhe projektet e ndërgjegjësimit publik;
- Mbështetja e konceptit të importimit të teknologjive të pastra në Kosovë;
- Aplikimi i konceptit të efikasitetit të energjisë në të gjithë sektorët e përdorimit të energjisë.

Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010(MMPH) si pjesë e Programit të Qeverisë, është dokumenti i parë i hartuar në Kosovë që ka për synim përmirësimin gradual të situatës mjedisore, në të cilën kornizë do të bazohen të gjitha aktivitetet prioritare të institucioneve përkatëse që lidhen me mjedisin.

Në mënyrë specifike Plani parasheh veprimet vijuese për integrimin e sektorit mjedisor:

1. Kompletimi i legjislacionit dhe harmonizimi me normat e BE-së
2. Hartimi Planit të Veprimit për Bujqësi
3. Riparimi i rrjetit për ujitje
4. Zhvillimi i eko- turizmit
5. Zbatimi i instrumenteve nxitëse për zbatimin e metodave alternative për prodhimtari bujqësore dhe kompostim
6. Sigurimi i lehtësimeve për importin e materialeve për bujqësi dhe plasimi i produkteve ushqimore
7. Ruajtja e metodave tradicionale nëpër ferma

8. Zhvillimi i programeve trajnuese për fermerët që merren me çështjet e praktikave të mira në bujqësi
9. Zhvillimi i treguesve bujqësor-mjedisor të monitorimit
10. Vendosja sistemit për çertifikimin e prodhimeve organike

Strategjia e Kosovës për Mjedisin (SKM) dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedis (PKVM) 2011-2015 (MMPH). Strategjia e shqyrtuar dhe azhurnuar dhe Plani i Veprimit synon që të ofrojë përgjigje për nevojat e tanishme dhe të ardhshme të shoqërisë së Kosovës dhe në mënyrë specifike trajton obligimet e menaxhimit mjedisor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Është dokument që përcakton objektivat dhe prioritetet që duhet të zbatohen përmes Planit Kombëtar të Veprimit në Mjedis (PKVM) 2011-2015. Ai përfshinë gjendjen aktuale, objektivat dhe prioritetet për fushat tematike në vijim:

- Ajri (ndryshimi klimatik, acidimi, mbrojtja e shtresës së ozonit dhe rrezatimi);
- Uji;
- Toka;
- Trashëgimia natyrore;
- Përdorimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore;
- Biodiversiteti;
- Bujqësia;
- Pylltaria;
- Mbeturinat e ngurta;
- Kimikatet;
- Mihjet dhe resurset minerale;
- Energjia;
- Industria;
- Transporti dhe turizmi

3.2.3. Inventari i emërtimeve të gazrave serrë (GS)

Disponueshmëria e informatave për emetimet e gazrave serrë dhe kapacitetin lokal për monitorimin e tyre është e pamjaftueshme. Deri më tani, informatat e vetme për emetimet historike dhe të ardhshme janë zhvilluar në kuadër të studimit të fizibilitetit të sistemit të inventarit të gazrave serrë për Kosovën, përgatitur nga Qendra për Mjedis e Universitetit Charles në Pragë[25].


Sipas rezultateve të këtij projekti, emetimet e gazrave serrë në vitin 2008 arritën gjithsej 9.5 Mt CO2 eq. Në vitin 2009 ato janë rritur për 11% pra në 10.5 Mt CO2 eq.. Kjo rritje relativisht e lartë është shtyrë pothuajse tërësisht nga rritja e djegies së lëndëve fosile. Dioksidi i karbonit përbën rreth 80 % të të gjitha emetimeve, gjersa metani dhe oksidi i azotit rreth 10 %. Të ashtuquajturat gazrat-F, siç janë HFC dhe PFC, janë gati të papërfillshme.

Sektori më i rëndësishëm për tërë inventarin është sektori "1A Aktivitetet e djegies së karburantit" që përbën rreth 80% të të gjitha emetimeve antropogjene në Kosovë. Burimi më i

[25]"Bartja e Përvojave Çeke: Zhvillimi i Sistemit të Menaxhimit të Inventarit të Gazrave Serrë (GS)" financuar nga UNDP


rëndësishëm i emetimeve të gazrave serrë për Kosovën është djegia e lëndëve të ngurta – linjitit vendor. Të ashtuquajturat "Kategoritë kyçe" të tjera (të cilat bashkërisht përbëjnë 95% të gjithsej emetimeve) janë paraqitur në diagramin në vijim (Figura 1).

Figura 1: Identifikimi i kategorive kyçe të inventarit të gazrave serrë në 2009 të Kosovës



- Krahasuar me vendet tjera në Evropë, Kosova ka emetime relativisht të ulëta për kokë banori (5.7 t CO2 ekuivalent për kokë banori në vitin më 2008, gjersa emetimet e gazrave serrë për njësi të BPV (0,84 kg CO2 ekuivalent për EUR më 2008) janë të larta. Emetimet për kokë banori janë pak më shumë se gjysma e mesatares së BE-së (9.93 t) dhe emetimet për njësi të BPV-së janë gati dyfishi i atyre në BE (0.4 kg/EUR). Këto statistika ilustrojnë sfidat ekonomike dhe sociale për Kosovën të kurthuara me emetime të ulëta por në rritje, ndërsa me BPV edhe më të ulët për kokë banori. Kjo situatë arsyeton aplikimin e parimit të përbashkët për me përgjegjësi të ndryshme të përcaktuar në nenin 3.1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC).

Figura 2: Krahasimi ndërkombëtar i emetimeve të gazrave serrë, 2009




3.2.4. Energjia

Sektori i energjisë prodhon rreth 82% të gjitha emetimeve kombëtare të gazrave serrë. Ky sektor mbulon djegien, shfrytëzimin dhe shpërndarjen e lëndëve djegëse fosile në Kosovë. Proceset e djegies në industritë e energjisë në kategorinë 1A japin një kontribut vendimtar në totalin e emetimeve të gazrave serrë, sidomos të dioksidit të karbonit, që prodhohet kur digjen lëndët në bazë karboni. Emetimet nga kjo kategori pothuajse tërësisht bazohen vetëm në djegien e linjitit në termocentralet e Kosovës. Në të ardhmen, nëse Kosova mendon të kërkojë mundësi për uljen e emetimeve të tyre të gazrave serrëS, përmirësimi i efikasitetit të energjisë së këtij stabilimenti të rëndësishëm është skenar me përfitime të dyanshme, edhe për prodhimin e energjisë edhe uljen e emetimit të gazrave serrë.

Emetimet e gazrave serrë në sektorin e transportit janë në rritje e sipër për shkak të numrit gjithnjë e më të madh të veturave dhe konsumit më të madh të karburantit. Me rritjen e të ardhurave të njerëzve dhe me zhvillimin e mëtejmë të sistemit rrugor, kjo kategori gjithsesi do të rritet për nga rëndësia.

Emetimet e fshehura që janë përfshirë në kategorinë 1B vijnë nga eksplorimi, eksploatimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse. Në rastin e Kosovës kjo ka rëndësi të pakët meqë linjiti i nxjerrë në Kosovë është relativisht i ri dhe nuk përmban metan të tillë.

Figura 3: Emetimet e gazrave serrë në sektorin e energjisë



Sektori i energjisë, bashkë me sektorin e mihjeve dhe të bujqësisë, tradicionalisht kanë qenë shtylla themelore të ekonomisë së Kosovës. Kosova ka potenciale të konsiderueshme për prodhim të energjisë elektrike. Rezervat e linjitit në Kosovë, me rreth 12.5 miliardë tonelata, nga të cilat 10.9 të eksploatueshme, konsiderohen si më të mëdhatë në Evropë. Megjithatë, Kosova po përballet me probleme të konsiderueshme në përmbushjen e kërkesës së energjisë elektrike për tërë dekadën, ndonëse që nga viti 1999 janë vërejtur disa përmirësime. Energjia elektrike kryesisht prodhohet nga Termocentralet 'Kosova A' dhe 'Kosova B', ndërsa një sasi më e vogël prodhohet nga hidrocentralet (Ujmani, Lumbardhi, Radaci, Dikanci dhe Burimi), (Tabelat 1 dhe 2).

Tabela 1: Kapacitetet termike të blloqeve të prodhimit në Kosovë[26]

Blloku i TC	Kapaciteti i blloqeve të TC (MW)			Viti i futjes në operim (mosha)
	Të instaluar	Neto	Në dispozicion	
TC Kosova A				
Blloku A1	65	Nuk është operim	0	1962 (51)
Blloku A2	125	Nuk është operim	0	1964 (49)
Blloku A3	200	182	100-130	1970 (43)
Blloku A4	200	182	100-130	1971 (42)
Blloku A5	210	187	100-135	1975 (38)
TC Kosova B				
Blloku B1	339	310	180-260	1983 (30)
Blloku B2	339	310	180-260	1984 (29)
Gjithsej TC-të A+ B	1478	1171		

[26] *Burimi: Raporti vjetor 2011, ZRRE*

Tabela 2: Kapacitetet e hidrocentraleve ekzistuese në Kosovë[27]

Blloqet e prodhimit	Kapaciteti i bllokut (MW)		Futja në operim (rindërtimi)
	Të instaluar	Neto	
HC Ujmani	35.00	32.00	1983
HC Lumbardhi	8.08	8.00	1957 (2006)
HC Dikanci	1.00	0.94	1957 (2010)
HC Radaci	0.90	0.84	1934 (2010)
HC Burimi	0.86	0.80	1948 (2011)
Gjithsej HC-të	45.84	42.58	

Më 2012, energjia elektrike bruto e prodhuar nga termocentralet ekzistuese ishte 5,383.975[28] GWh, gjersa energjia elektrike e prodhuar në hidrocentrale kapte shumën prej 95.579[29] GWh. Kërkesa për energji elektrike është së paku 10% më e lartë sesa energjia elektrike e prodhuar dhe viteve të fundit rritja mesatare relative vjetore e konsumit të energjisë elektrike në Kosovë ka qenë rreth 6-7%. Sipas skenarit bazë (Tabela 3), më 2002 kërkesa për energji elektrike do të rritet për 23,4% krahasuar me vitin 2012.

Tabela 3: Skenari bazë, kërkesa bruto e energjisë elektrike, sipas kategorisë së konsumit (Bilanci i Energjisë 2012-2022).[30]

SKENARI BAZË I KËRKESËS SË ENERGJISË [GWh]	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**	**2021**	**2022**
Konsumatorët e amvisërisë	2.536	2.643	2.706	2.790	2.852	2954	3.053	3.129	32.63	3.355	3.477	3.571	3.676	3.769
Konsumatorët komercialë	701	745	798	789	807	837	873	899	942	972	1012	1042	1084	1123
Gjithsej konsumatorët industrialë	1.210	1.296	1.322	1.237	1.265	1.312	1.370	1.410	1.477	1.525	1.586	1.634	1.699	1.761
Humbjet në KOSTT	175	131	115	128	126	129	132	133	136	138	140	142	144	146
Humbjet teknike në OSSH	799	780	785	797	770	734	749	741	734	726	719	712	705	698
Konsumi bruto i energjisë	5.421	5.594	5.725	5.742	5.820	5.966	6.176	6.312	6.551	6.716	6.934	7.100	7.307	7.496

[27] *Burimi: Raporti vjetor 2011, ZRRE*
[28] *Burimi: draft balanca e realizuar e energjisë elektrike më 2012.*
[29] *Burimi: draft balanca e realizuar e energjisë elektrike më 2012.*
[30] http://mzhe.rks-gov.net/repository/docs/Balanca_afatagjate_2013_-2022_-_eng_finall.pdf


elektrike në
Kosovë

Cilësia e dobët, apo furnizimi me ndërprerje i energjisë elektrike është konsideruar si një nga pengesat kryesore që parandalonte rritjen ekonomike të vendit gjatë dekadës së kaluar. Mungesa e energjisë elektrike është parë si një arsye që investimet e huaja na anashkalonin dhe drejtoheshin në vende të tjera të rajonit dhe bënte që kompanitë vendore të operonin në rrethana shumë të vështira dhe shpeshherë në kufirin e realizueshmërisë ekonomike.

Krahas prodhimit të energjisë elektrike, shpërndarja dhe furnizimi gjithashtu përballen me probleme teknike dhe humbje të energjisë elektrike. Viteve të fundit janë bërë investime të konsiderueshme në sistemin e shpërndarjes dhe kanë ndikuar në uljen e humbjeve, nga 42.80% më 2009 në 38.15% më 2011[31]. Përkundër këtyre investimeve, ende nuk është përmbushur furnizimi cilësor dhe i sigurt i energjisë elektrike për konsumatorët.

Në Kosovë, nga shuma totale e gazrave serrë (rreth 10,5 milionë t CO_2 eq.) të emituar nga aktivitetet antropogjenë më 2009, prodhimi i energjisë elektrike nga shumat e thëngjillit për rreth 6.9 milionë tonCO_2 eq. (duke mos llogaritur gazrat e liruar nga vetëndezja e thëngjillit në miniera – shuma e të cilave nuk është e njohur). Parashikimet e prodhimit të energjisë elektrike tregojnë se deri më 2022, prodhimi i energjisë elektrike nga thëngjilli do të rritet në rreth 33% krahasuar me 2012. Ndonëse pas vitit 2017 do të hyjë në operim termocentrali i ri me efikasitet më të lartë, pritet që emetimet e CO_2 do të vazhdojnë të rriten (Figura 4.).

Figura 4: Emetimet e kaluara dhe të pritura nga termocentralet e Kosovës



[31] *Burimi, 2011 Raporti vjetor, ZRRE*

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat që karakterizojnë vendin, por mbi të gjitha nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik, social dhe teknologjik, mungesën e energjisë elektrike, rritjen e kërkesës për energji elektrike, ulja e emetimeve nën nivelin aktual për shumë vite në vijim nuk mund të jetë pritje reale. Ajo që duket të jetë reale është të arrihet një devijim nga skenari pa ndryshime (rritje e ngadaltë e emetimeve) me masa të ndryshme të zbutjes. Më shumë mund të arrihet me asistencë shtesë të bashkësisë ndërkombëtare.

Strategjia e Energjisë i kushton vëmendje të veçantë pajtueshmërisë me legjislacionin evropian, dispozitave që janë të detyrueshme për Kosovën, meqë kjo e fundit i merrë përsipër këto obligime përmes anëtarësisë së saj në Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Strategjia ka për synim që të nxisë shfrytëzim racional të resurseve të energjisë dhe rritje të efiçiencës së energjisë, si dhe shfrytëzim të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe futjen e teknologjive të reja për zbatimin e standardeve mjedisore të përcaktuara me ligj.

Në periudhën afatmesme, linjiti do të vazhdojë të jetë burim kryesor për prodhim energjisë elektrike në Kosovë. Rezervat e linjitit në Kosovë gjenden në dy pellgje të mëdha, në 'Rrafshin e Dukagjinit' dhe atë të 'Kosovës'. Rezervat gjeologjike të linjitit vlerësohen të jenë deri në 12.5 miliardë tonelata (duke përfshirë të gjitha kategoritë e rezervave). Tabela 4 paraqet një përmbledhje të rezervave të linjitit sipas lokacionit[32].

Tabela 4: Rezervat e linjitit sipas lokacionit

Pellgu	Sipërfaqja [km^2]	Rezervat [milionë tonelata]			
		Të hulumtuara		Të eksploatueshme	
		t	t_{ce}	t	t_{ce}
Kosova	274	10,091	2,957	8,772	2,521
Dukagjini	49	2,244.8	782	2,047.7	464
Të tjera	5.1	106,6	22	73.2	19
Gjithsej		12,442.4	3,761	10,892.9	3,004

Sistemet e ngrohjes qendrore ekzistojnë vetëm në Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë. Këto sisteme përmbushin vetëm 3% të kërkesës për ngrohje. Teknologjitë ekzistuese bazohen në mbetje të naftës dhe naftë. Ky sektor gjithashtu ka vështirësi si pasojë e teknologjisë së vjetër, ndikimeve negative në mjedis dhe nivelit të ulët të faturimit dhe inkasimit të energjisë së furnizuar. Nevoja për zhvillimin e tregut të ngrohjes është përfshirë në rezultatet e Studimit të Tregut të Ngrohjes (ELC, Studimi i Bankës Botërore, 2007). Zhvillimi i një tregu të tillë do të stimulohet nga Qeveria. Ligji për Ndërmarrjet Publike i ka vënë këto ndërmarrje në administrim komunal.

Ligji për Energjinë, 2004/8, neni 10, përcakton kornizën për zbatimin e efiçiencës së energjisë dhe energjisë së ripërtëritshme në Kosovë. Në veçanti, paragrafi (a) i nenit 10 ka të bëjë me përgatitjen e një programi të zbatimit për promovimin e përdorimit efiçient të energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë (erë, solare dhe hidrocentrale të vogla). Masat për efiçiencë të energjisë dhe menaxhimin e kërkesës janë të rëndësishme për uljen e shkallës së lartë të rritjes vjetore të kërkesës për energji që kryesisht është si pasojë e përdorimit të energjisë elektrike për qëllime të ngrohjes.

[32] Institute Inkos – "Studim për vlerësimin e hulumtimeve dhe rezervave gjeologjike të linjitit në Kosovë", Pellgu i Kosovës, Prishtina 2007, faqe 81; dhe pellgu i Dukagjinit, Drenicës dhe të tjera, Prishtina 2007, faqe 56 dhe faqe 24.

Kërkesa e ardhshme për energji supozohet të mbulohet nga prodhimi vendor dhe importet. Në periudhën në vijim, energjia elektrike do të sigurohet nga prodhimi në termocentralet 'Kosova A' dhe 'Kosova B', dhe më pas nga Termocentrali 'Kosova e Re', blloku i parë së cilit do të hyjë në operim më 2018 dhe i dyti më 2019. Gjithashtu, në periudhën afatgjate, parashihet zhvillimi i kapaciteteve të reja nga burime të ripërtëritshme të energjisë (Tabela 5).

Tabela 5: Skenari bazë i prodhimit bruto të energjisë elektrike duke përfshirë konsumin vetjak dhe prodhimin neto (Bilanci Afatgjatë i Energjisë në Kosovë 2013 – 2022).

PRODHIMI BRUTO I ENERGJISË SKENARI KONSERVATOR (MZHE) [GWh]	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
TC KOSOVA A	1.622	1.908	2.203	1.676	2.007	1.974	2.010	2.010	2.010	0	0	0	0	0
TC KOSOVA B	3.638	3.573	3.494	3.769	4.068	4.062	4.062	4.075	3.556	3.556	4.062	4.024	4.003	3.983
TC KOSOVA E RE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2.100	4.200	4.200	4.200
TC I RI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
GJITHSEJ NGA TERMOCENTRALET (1+2+3+4)	5.260	5.481	5.696	5.446	6.075	6.036	6.072	6.085	5.566	3.556	6.162	8.224	8.203	8.183
HC UJMANI	89	115	75	82	82	82	68	82	82	78	78	78	78	78
HC LUMBARDHI	33	36	22	27	27	26	27	26	27	27	27	27	27	27
HC DIKANCE + BURIMI + RADAVCI	0	14	14	23	23	23	23	23	23	23	23	23	23	23
HC ZHURI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HC TË VOGLA	0	0	0	0	0	0	139	178	181	332	351	429	468	472
GJITHSEJ NGA HIDROCENTRALET (6+7+8+9+10)	121	166	112	133	133	131	257	309	314	460	480	558	597	601
CENTRALET NGA BIOMASA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	11	17	19	23	28
CENTRALET ME ERË	0	3	0	0	3	57	57	114	114	172	172	229	229	267
CENTRALET SOLARE	0	0	0	0	0	0	0	0	2	2	2	3	3	0
Gjithsej nga biomasa, era, solare (12+13+14)	0	3	0	0	3	57	57	114	116	185	191	251	254	296

GJITHSEJ TË RIPËRTËRITSHME (11+15)	33	53	37	51	53	106	246	341	348	568	593	731	773	818
GJITHSEJ PRODHIMI BRUTO (5+11+15)	5.381	5.650	5.808	5.578	6.210	6.224	6.386	6.508	5.996	4.201	6.833	9.033	9.055	9.079
GJITHSEJ KONSUMI VETJAK I TC	579	603	611	592	478	638	643	645	591	363	624	831	830	828
GJITHSEJ PRODHIMI NETO (18-19)	4.802	5.047	5.197	4.986	5.732	5.586	5.743	5.863	5.406	3.838	6.209	8.201	8.225	8.251

Kosova synon integrimin sa më shpejtë në BE. Në funksion të kësaj, Kosova është palë nënshkruese e Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) të Evropës Juglindore që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 2006. Në këtë kontekst, Qeveria e Kosovës mbetet shumë e përkushtuar për zhvillimin e sektorit të energjisë në përputhje me kërkesat e TKE-së. TKE kërkon zbatimin e *Acquis Communautaire* nga të gjitha palët kontraktuese sipas një afati kohor që parashikon zbatimin e reformave të kërkuara. Kjo do të kërkojë edhe zbatimin e objektivave të planit të BE-së 20-20-20 për sektorin e energjisë, që kërkon nga vendet anëtare që deri në vitin 2020:

- Të ulen emetimet e gazrave serrë për 20%,
- Të rritet proporcionin i energjisë së ripërtëritshme të konsumit fundor të energjisë në 20%, dhe
- Të përmirësohet efiçienca e energjisë për 20%.

Për këtë qëllim, më 2011 është miratuar **Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKEE) 2010 -2018**[33]dhe më 2013 është hartuar **Plani Kombëtar i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVBR) 2011 – 2020**[34]. Të dy planet përcaktojnë caqe për Kosovën në kuptim të efiçiencës së energjisë dhe pjesës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë deri më 2020:

- **Përmirësimi i efiçiencës së energjisë për 9 %**
- **Rritja e pjesës së burimeve të ripërtëritshme të energjisë në 25 % (synohet 29,47%)**

Kosova është e zotuar që t'i përmbushë këto synime duke vepruar në përputhje me të gjitha direktivat, normat dhe standardet përkatëse të BE-së për energji dhe mjedis, si dhe dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

3.2.5. Ndërtesat

Sipas studimit të BB për Efiçiencë të Energjisë në Ndërtesa Publike të vitit 2013, sektori i ndërtesave përbën 48% të konsumit të energjisë dhe paraqet pjesën më të madhe të konsumit

[33] http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/1280177.PDF
[34] http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/2570177.PDF

fundor të energjisë në Kosovë. Biomasa (45%) dhe energjia elektrike (44%) ishin burimet kryesore të energjisë të përdorura nga Sektori i Amvisërive, gjersa për Sektorin e Shërbimeve energjia elektrike ishte burimi kryesor i energjisë (52%), pasuar nga produktet e naftës (38%).

Gjithsej sipërfaqja e stokut të ndërtesave të Kosovës vlerësohet të jetë 45 milionë m^2. Rreth një e treta e të gjithë stokut të ndërtesave përbehet nga shtëpitë njëkatëshe të banimit dhe vetë sektori i ndërtesave të banimit ka gjithsej sipërfaqe prej më pak se 35 milionë m^2, pasuar nga kategoria e ndërtesave private me gati 8 milionë m^2, gjersa ndërtesat publike kanë gjithsej sipërfaqe prej mbi 2 milionë m^2.

Potenciali i përgjithshëm i kursimeve në sektorin e ndërtesave në Kosovë është gati 11% e tërë energjisë primare të furnizuar dhe 20.07% e konsumit fundor të energjisë për vitin 2010. Gjithsej kursimet e energjisë për tërë stokun e ndërtesave janë gati 45% të gjithsej konsumit të kombinuar të energjisë së ekonomive familjare dhe sektorëve të shërbimeve.

Vlerësimi i tregut i realizuar për këtë studim identifikon një nivel të konsiderueshëm të kursimeve potenciale të energjisë që do të mund të arriheshin në Kosovë përmes aplikimit të masave për efiçiencë të energjisë në stokun e ndërtesave në vend. Realizimi i potencialit të plotë të kursimit të energjisë bazuar në masa me kosto-efektive do të kërkonte një investim total prej €1.367 miliardë dhe me këtë do të krijoheshin kursime vjetore të kostove për investitorët dhe përdoruesit fundorë prej rreth €198 milionë, që nënkupton se kursimet do t'i mbulonin kostot e masave brenda 7 vitesh.

Kontributi më i madh në potencialin e kursimit të energjisë vije nga sektori banesor (72%), pasuar nga sektori privat dhe komercial (20%). Ndonëse gjithsej potenciali për kursime të energjisë në ndërtesa komunale dhe qendrore është i ulët krahasuar me dy sektorët e tjerë (8%), ndërtesat publike aktualisht paraqesin mundësinë më të mirë për arritjen e kursimeve të vërteta të energjisë sepse në shumë raste ato tanimë përmbushin nivelet e kërkuara të komforit. Ky fakt sugjeron se çdo program për efiçiencë të energjisë do të duhej të fillonte me realizimin e masave në ndërtesa publike.

3.2.6. Mineralet dhe industria

Deri në fund të viteve të 1980-ta, industria dhe mihjet merrnin pjesë në bruto prodhimin vendor me rreth 50% dhe kryesisht bazoheshin në resurse natyrore të pasura (thëngjill, xehe, etj.). Kosova ka resurse të shumta të zinkut, plumbit, arit, kadmiumit dhe bismutit, boksiteve, nikelit, etj. Ekzistojnë miniera të ndryshme, gjersa rezervat e zinkut dhe plumbit në Kosovë vlerësohen të jenë rreth 48 milionë tonelata, nga të cilat nikeli deri në 16 milionë tonelata. Rezervat e kromit përbëjnë rreth 89 milionë tonelata dhe rezervat e boksitit deri në 13.2 milionë tonelata.

Pas përfundimit të luftës më 1999, pjesa kryesore e aktiviteteve industriale dhe të mihjes u ndaluan (minierat e xeheve metalore dhe jometalore dhe komplekset përkatëse metalurgjike) për shkak të vonesave në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Sektori privat i aktiviteteve të prodhimit ka filluar të zhvillohet dekadën e fundit, por pa një koncept të shëndoshë.

Për shkak të uljes drastike të prodhimit, niveli i ndotjes nga industria dhe mihjet është zvogëluar, por disa probleme mjedisore nga e kaluara ende janë të pranishme: teknologjia dhe pajisjet e vjetra, sasi të mëdha të mbetjeve minerale dhe metalurgjike nga e kaluara, vazhdojnë të jenë burim i përhershëm i ndotjes në mjedis. Për shkak të mungesës së një kuadri të përfunduar ligjor

dhe zbatimit të tij, sektori privat i prodhimit, ndonëse në faze të zhvillimit, paraqet burim të ndotjes mjedisore.

Më 2011, mihjet dhe gurëthyesit përbënin 1,5 për qind të BPV-së, prodhimi 8,7 për qind dhe ndërtimi 7 për qind. Në të njëjtën kohë, shërbimet tjera përbënin 25 për qind, bujqësia 13 dhe administrata publike (duke përfshirë shëndetësinë dhe arsimin) 16%. Kjo nënkupton që niveli i aktivitetit industrial në Kosovë është i ulët dhe me siguri do të rritet në të ardhmen, gjithashtu duke rritur emetimet e gazrave serrë që kanë të bëjnë me mihjet dhe industrinë.

3.2.7. Transporti

Transporti në Kosovë kryesisht bazohet në transportin rrugor. Rrjeti rrugor ka 7,200 km rrugë të asfaltuara dhe të paasfaltuara me 240.000 automjete. Rrugët kryesore dhe rajonale janë ende në gjendje të keqe, përveç autostradës që lidh Kosovën me Shqipërinë.

Pas përfundimit të luftës është vërejtur një rritje e madhe e numrit të automjeteve. Pjesëmarrja e transportit publik në transportin e përgjithshëm është e ulët. Numri më i madh i automjeteve në Kosovë janë të vjetra, të prodhuara në vitet e 1980-ta dhe fillim të 1990-ta dhe nuk përmbushin kërkesat minimale teknike. 99% e transportit rrugor përdorë naftë dhe benzinë si burime të energjisë, ndërkohë që transporti hekurudhor përdor vetëm naftë. Përveç kësaj, automjetet përdorin karburant të cilësisë së ulët dhe pa katalizatorë. Prandaj, kjo paraqet një burim të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, si dhe gjithashtu mund të shkaktojnë zhurma mbi kufijtë e lejuar. Ndotja e mjedisit shkaktohet edhe përmes derdhjes së pakontrolluar të naftës dhe automjeteve të vjetra.

Hekurudha nuk është tërësisht funksionale pas luftës. Hekurudha e Kosovës përbëhet nga 334,451 km për transport publik dhe 103,4 km për përdorim industrial. Transporti hekurudhor përdorë vetëm naftë si burim të energjisë.

Strategjia e Kosovës për Mjedis parasheh veprimet vijuese që do të ndërmerren në fushën e transportit:

a. Zvogëlimi i emisioneve të gazrave ndotëse nga automjetet;
b. Zvogëlimi i zhurmës nga automjetet;
c. Zhvillimi i infrastrukturës rrugore të pranueshme për mjedisin;
d. Zhvillimi i formave më efikase dhe ekologjikisht më të pastra të transportit;
e. Bashkëpunimi rajonal në lëmin e transportit.

Prioritetet në këtë fushë janë:

i. Kompletimi i kuadrit ligjor të mbrojtjes së mjedisit nga transporti dhe harmonizimi i tij me normat ndërkombëtare dhe të Bashkësisë Evropiane.
ii. Përkrahja e përdorimit të lëndëve djegëse më cilësore.
iii. Shfrytëzimi i alternativave të transportit që shkaktojnë ndotje më të vogël mjedisore (hekurudhat, mjetet transportuese elektrike, etj.).
iv. Kufizimi kohor i përdorimit të automjeteve të vjetruara dhe pa katalizatorë.
v. Zbatimi i normave të lejueshme të zhurmës nga automjetet.
vi. Rehabilitimi i plotë i infrastrukturës ekzistuese rrugore.
vii. Zgjidhja e problemit të automjeteve të vjetra të hedhura.

3.2.8. Menaxhimi i mbeturinave

Rreth 90% e popullatës urbane në Kosovë ka qasje në shërbimet publike për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave, gjersa vendet rurale mbulohen me 10%. Krijimi i mbeturinave në vend, sipas të dhënave të kohëve të fundit, është 1.2 kg/për kokë banori/ditë. Gjithsej sasia e mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2009 ishte pak më shumë se 400,000 tonelata. Kjo është 193 kg për person mesatarisht për Kosovën, krahasuar me 522 kg për person në BE 27 në vitin 2007. Megjithatë, sasia e mbeturinave ndryshon shumë në rajone. Në rajoni e Prishtinës ishte 1.2 kg për person në ditë, në rajonet tjera të Kosovës ishte shumë më pak. Por sasia e mbeturinave është në rritje nga viti në vit, si pasojë e grumbullimit më të mirë si dhe rritjes së standardit jetësor të konsumatorëve. Më 2009 në Prishtinë dhe rajon sasia e mbeturinave të grumbulluara nga komunat gjatë vitit ishte rritur për 10%, sasia e mbeturinave të grumbulluara në rajonet tjera në Kosovë është rritur për 22%, ndërsa gjithsej në Kosovë është rritur për 15% krahasuar me vitin 2007. Taksa për mbeturina është 3 Euro/për familje dhe inkasimi i mbeturinave është rreth 30-40 %. Nga gjithsej 30 deponi komunale, 26 janë të rehabilituara me ndihmën e donatorëve dhe 7 nga ato të rehabilituara janë mbyllur. Me ndihmën e Agjencisë Evropiane për Rindërtim dhe donatorë të tjerë, aktualisht janë në ndërtim e sipër 9 deponi rajonale.

Shumë njerëz të varfër në Kosovë sigurojnë jetesën e tyre nga shitja e metalit skrap apo mbeturinave për riciklim. Këto materiale disa herë përbëjnë shqetësime shëndetësore. Një tjetër praktikë e keqe është ndezja e mbeturinave nga ekonomitë familjare apo në deponi, që po ashtu shkakton emetime të dëmshme në ajër.

Sistemet e veçanta për grumbullim dhe riciklim për menaxhimin e mbeturinave ende nuk janë të aplikuara në Kosovë. Mbeturinat e rrezikshme kryesisht lidhen me komplekse të mëdha industriale dhe “pikat e nxehta” kryesore janë: Trepça, KEK-u dhe Fabrika e Baterive në Gjilan. Problemet kryesore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë: mungesa e politikës dhe shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave (grumbullimi, transporti, përmbajtja e informatave, shërbimet analitike).

Strategjia e Kosovës për Mjedisin parasheh ndërmarrjen e veprimeve në vijim në fushën e menaxhimit të mbeturinave:

a. Krijimi i infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave
b. Zvogëlimi gradual i sasisë së mbeturinave në burim para deponimit dhe shfrytëzimit energjetik apo ripërdorimit.
c. Zvogëlimi gradual i rrezikut nga mbeturinat
d. Rritja graduale e përfshirjes së popullatës në sistemin e trajtimit të mbeturinave.

Prioritetet në këtë fushë janë:

i. Kompletimi i normave ligjore për menaxhimin e mbeturinave bazuar në Direktivat e BE.
ii. Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhim të mbeturinave
iii. Ndërtimi i sistemit qendror të të dhënave dhe të informimit mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturinave.

iv. Hartimi i programeve për ndërtimin e objekteve të infrastrukturës në harmoni me planet hapësinore.
v. Sanimi dhe mbyllja e deponive të vjetra.
vi. Shfrytëzimi i kapaciteteve industriale ekzistuese për trajtimin e mbeturinave të rrezikshme.

3.2.9. Bujqësia

53% apo (530,000 ha) të sipërfaqes së tërësishme të Kosovës përbëhet nga toka bujqësore. Bazuar në informatat e fundit të Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2012 rreth 86% (379,000 ha) të tokës janë të punueshme dhe rreth 14% apo (151,000 ha) llogariten si kullota. Bujqësia dikur përbënte 25% të BPV në vitet e 1980-ta dhe fillim të 1990-ta, ndërsa tani rreth 14.1% të BPV-së. Bujqësia përbën rreth 35% të gjithsej punësimit. Sektori bujqësor gjithashtu përbën 16% të gjithsej vlerës së eksportit dhe mbetet sektor i rëndësishëm ekonomik dhe burim i pasurisë së vendit. Megjithatë, Kosova vazhdon të jetë importues i madh i shumë produkteve bujqësore, që përbënin 24.4% të gjithsej importeve.


Bujqësia e Kosovës mbetet e pazhvilluar me rediment dhe produktivitet të dobët, si rrjedhojë e fermave të madhësisë së vogël, praktikave të vjetruara bujqësore, përdorimit joadekuat të të të dhënave dhe mungesës së qasjes në ekspertizë teknike. Për shkak të presionit dhe kërkesës për produkte bujqësore, d.m.th. produkte ushqimore, ndonëse e vogël dhe e pazhvilluar për momentin bujqësia vazhdon të jetë sektor me ndikim potencialisht të lartë në ndryshimet klimatike me mundësi të rritjes në prodhimin bujqësor.

Sektori i bujqësisë, pylltaria dhe përdorimi i tokës mbulon rreth 13% të gjithsej emetimeve të gazrave serrë në Kosovë. ajo përbëhet nga tri nënsektorë të ndryshëm. Nënsektori i parë ka të bëjë me emetimet nga bagëtitë. Emetimet e metanit nga fermentimi enterik dhe emetimet e oksideve të azotit dhe metanit nga menaxhimi i plehrave janë pjesë e rëndësishme e buxhetit të gazrave serrë të Kosovës. Nga bagëtitë prodhohen rreth 600 mijë tonelata CO2 eq. në vit.

Nënsektori i dytë ka të bëjë me ndryshimet e stokut të karbonit në përdorime të ndryshme të tokës. Ky nënsektor dominohet nga pylltaria që mund të jetë një hinkë e fuqishme e karbonit atmosferik. Megjithatë, për shkak të prerjeve intensive (dhe shpeshherë joligjore) të drunjve, ajo është e parëndësishme në Kosovë në terma relativë (rreth -40 mijë tonelata CO2 eq.). Por në kuptim të karbonit që rrjedh në vit nëpër sektor, është sektori i dytë për nga madhësia në vend (toka pyjore që mbetet pyll ka qarkullim prej rreth 2.750 mijë tonelata CO2). Inventari i mirë i pyjeve dhe menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve të Kosovës do të kontribuonte në masë të madhe në uljen e emetimeve nga vendi si tërësi.

Nënsektori i tretë ka të bëjë me emetimet nga plehërimi i tokës si dhe emetimet nga djegia e biomasës. Kategoritë më të rëndësishme janë emetimet e oksidit të azotit të shoqëruar me menaxhimin e plehrave dhe plehërimin e të korrurave. Gjithsej, ky nënsektor emeton rreth 800 mijë tonelata CO2 eq.

Figura 5: Emetimet e gazrave serrë në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës



3.2.10. Pyjet dhe ruajtja e natyrës

41% e sipërfaqes së tokës së Kosovës është e mbuluar nga pyje (464,800 ha), nga të cilat 60% janë pyje në pronësi të shtetit (278,880 ha) dhe 40% janë pyje private (185,920 ha). Mbulimi pyjor në Kosovë është më i madh sesa në shtetet fqinje (Shqipëria 28%, Maqedonia 39%, Mali i Zi 40% dhe Serbia 31%). Megjithatë, cilësia dhe produktiviteti i pyjeve ekzistuese janë shkak për shqetësim. Në veçanti në terrenet e rrëpirëta malore ka sinjale alarmante të shkretëzimit për shkak të erozionit të rëndë të tokës. Ekzistojnë vetëm 2 lloje të pyjeve:

- Pyjet gjethegjera, të krijuara përmes rigjenerimit natyror e që mbulojë rreth 90% të sipërfaqes pyjore. Llojet kryesore janë bungu (Quercus petraea, Q. cerris, P. robur) dhe ahu (silvatica Fagus).
- Pyje halore ngjajnë natyrshëm, kryesisht në lartësi më të mëdha dhe të vendosura mirë në plantacione pyjore; pyjet natyrore dhe ato halore të mbjella mbulojnë rreth 5% të sipërfaqes totale të pyjeve. Specie të rëndësishme të drunjëve të buta janë Picea abies, Abies alba, Pinus sylvestris dhe Pinus heldreichii. Pinus nigra dhe Pseudotsuga menziesii rriten në plantacione.

Gjatë viteve 2003- 2004, është kryer një inventar shtetëror i pyjeve.

Rreth 379.200 ha janë kategorizuar si tokë pyjore përmes interpretimit të fotografimeve ajrore dhe matjeve në terren. 85.600 ha të tjera janë kategorizuar si toka pyjore përmes interpretimit të fotografive, por nuk ka qenë e mundur matja e tyre në terren për shkak të mospastrimit të minave dhe pengesave të tjera logjistike. Nga gjithsej sipërfaqja e tokave të matura dhe të pamatura pyjore, 278,880 ha janë cilësuar si pyje publike dhe 185.920 ha si pyje private. Kjo sipërfaqe (464.800 ha) është paksa më e madhe (6-8%) sesa vlerësimet e mëhershme. Pyjet gjethegjera, të krijuara përmes mbjelljes natyrore, mbulon më shumë se 90% të sipërfaqes

pyjore. Speciet dominuese gjethegjera janë bungu dhe ahu. Tek pyjet halore, që mbulojnë 7% të gjithsej sipërfaqes pyjore, mbizotërojnë Abies alba, Picea abies dhe Pinus species. Tre për qind të mbetura përbëhen nga një numër speciesh gjethegjera.

Gjithsej vëllimi aktual i tokave pyjore publike vlerësohet të jetë rreth 33.5 milionë m3. Nga ky vëllim, 25.9 milionë m3 janë pemë me diametër >7 cm në lartësi të gjoksit. Në pyjet private, gjithsej vëllimi aktual vlerësohet të jetë rreth 19.5 milionë m3 nga e cila 14.5 milionë m3 janë lisa me diametër >7 cm. Rritja vjetore e pemëve në sipërfaqet e matura dhe me diametër >7 cm në lartësi të gjoksit, llogaritet të jetë 1.165 milionë m3. Meqë pyjet e pamatura në terren (85 600 ha) kryesisht gjenden pranë zonave të minuara dhe zona të tjera pa qasje, duket të jetë e arsyeshme që kjo rritje të mos përfshihen në bazën për prerje të lejuar vjetore. Ka zona të konsiderueshme të tokave pyjore shterpe (20 000 – 30 000 ha). Disa prej këtyre zonave janë të eroduara dhe kanë një shtresë të hollë të tokës sipër. Përkundër humbjes së pjellorisë, një pjesë e konsiderueshme është e përshtatshme për krijimin e plantacioneve. 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private i janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara apo të paligjshme të prerjes.

Në çdo rrethanë, këto shifra janë shumë të larta. Gjendja është më kritike me pyjet halore ku e tërë ekzistenca e sipërfaqeve të mëdha pyjore do të jetë në rrezik nëse nuk ndërmerren veprime të fuqishme dhe të menjëhershme. Rezultatet e inventarit gjithashtu konfirmojnë se pyjet e ulëta, posaçërisht në pyjet publike, janë të ekspozuara ndaj prerjeve të rënda. Rezultatet gjithashtu tregojnë se shumë pyje të reja dhe të moshës së mesme janë në nevojë urgjente të intervenimeve të menaxhimit, nga pastrimi/rrallimi parakomercial deri te r

komercial.

Tabela 6: Objektivat strategjikë në sektorin pyjor

Objektivi strategjik	Synimi
Menaxhimi i pyjeve dhe silvikultura	Prodhimi i farërave, mbjellja, veprimet e rrallimit, ndërtimi i rrugëve dhe mirëmbajtja
Planifikimi i pyjeve	Inventarët e pyjeve (strategjikë), planifikimi i menaxhimit, planifikimi vjetor)
Prerja dhe transportimi	Caqet e prerjes vjetore (publik/privat), shitja e drurit, mekanizmat e kontrollit
Ngritja e kapaciteteve	Edukimi/trajnimi, funksionet e hulumtimit, ngritja e vetëdijes
Mbrojtja e mjedisit pyjor	Kufizimet në menaxhim, zonat e mbrojtura, ruajtja e biodiversitetit, certifikimi
Përdorimi i drurit	Përdorimi optimal i resurseve ekzistuese dhe të ardhshme të drurit
Zhvillimi i sektorit privat	Çështjet e privatizimi, rolet në administrimin/ menaxhimin e pyjeve publike, lehtësirat në financim

Produktet jodrunore	Manaferrat, erëzat, kërpudhat, frutat, bimët mjekësore, etj.


Më 2012, është përgatitur strategjia për mbrojtjen klimatike në sektorin e pyjeve në Kosovë[35] në kuadër të projektit të binjakëzimit të BE-së ndërmjet MBPZHR/APK dhe Pyjeve Federale të Austrisë. Në Strategji janë identifikuar agjentët e shpyllëzimit dhe degradimit të pyjeve. Agjentët e prerjes komerciale që më së shumti nxisin degradimin përfshijnë prerjen e paligjshme të drurit të rrumbullakët nga biomasa e gjallë pyjore për qëllime komerciale të lëndës djegëse siguron një pasqyrë të gjerë të shtytësve të humbjes së resurseve pyjore dhe konfirmon se prerja ilegale për qëllime komerciale është shtytësi kryesor. Gjithashtu është thënë se fshatarët e varfër që jetojnë pranë pyjeve bëjnë prerjen e drurit për qëllime të jetesës, që është në shkallën e 10% të prerjes së paligjshme të drurit dhe është e papërfillshme. Prerja e drurit nga pronarë privatë të pyjeve pas dorëzimit të zvarritur të lejeve për prerje po ashtu konsiderohet prerje e paligjshme, por nuk është në fokus të mëtejmë.

Shpërthimi i gjerë i zjarreve në pyje ndodh për shkak të djegies së pakujdesshme në toka të afërta me të korrura bujqësore apo kullotave nga bujqit dhe blegtorët. Mungesa e ndërgjegjësimit tek shoqëria civile gjithashtu kontribuon në shpërthimin e zjarreve në pyje në tokat e afërta të kampeve dhe vendeve për piknikë.

Planifikimi joadekuat i pyjeve dhe zbatimi joadekuat i menaxhimit si pasojë e bashkëpunimit të pamjaftueshëm ndërmjet APK-së dhe autoriteteve komunale destabilizon investimet e nevojshme në sektorin e pyjeve.


Dy baza për emetimet e karbonit dhe dy skenarë të zbutjes janë marrë parasysh në figurat 6 dhe 7 më poshtë.

Figura 6: Potenciali i përafërt i portofolit të aktiviteteve të zbutjes nëpër kohë (B1, kufiri i ulët) Burimi: Strategjia për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve në Kosovë




[35]Krause, M.; Ruiz, P.; Horst, A.: Strategjia për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve në Kosovë. Raport final. Projekt i Binjakëzimit të BE-së KS09IBEN02 "Mbështetje e mëtejme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve". MAFRD/KFA dhe ÖBf-konsorcium ndërkombëtar. Prishtina, Kosovë.

Figura 7: Potenciali i vlerësuar i portofolit të aktiviteteve të zbutjes nëpër kohë (B2, kufiri i sipërm) Burimi: Strategjia për mbrojtjen e klimës në sektorin e pyjeve në Kosovë



Në të dy skenarët, potenciali më i lartë për uljen e emetimeve është parandalimi i prerjes së paligjshme, siç është treguar në figurën 8 në vijim.

Figura 8: Potenciali i vlerësuar i portofolit të aktiviteteve të zbutjes (B1, kufiri i ulët)



4. Synimet dhe objektivat

Duke pasur parasysh pasigurinë e madhe në lidhje me nivelin aktual dhe parashikimet e ardhshme të emetimeve të gazrave serrë në Kosovë është vështirë të caktohet një objektiv domethënës për zbutje, në kuptim të përcaktimit të caqeve për reduktim të emetimeve. Për të njëjtën arsye, dhe për arsye të pasigurisë së zhvillimit të ardhshëm social dhe ekonomik të vendit, është gjithashtu vështirë të caktohen objektivat afatgjate (p.sh. 2050 sipas Udhërrëfyesit të BE-së). Për shkak të kësaj, objektivat e zbutjes caktohen në kuptim cilësor, si në vijim:

1. **Kosova do të zhvillojë kapacitete për t'i përmbushur obligimet e saj të ardhshme sipas Konventës UNFCCC dhe si anëtare e BE-së.**
2. **Kosova do ta ngadalësojë rritjen e emetimeve të gazrave serrë përmes**
   - **rritjes së efiçiencës së energjisë në të gjithë sektorët,**
   - **zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë, dhe**
   - **përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore**

Nëse mbështetet me financim, teknologji dhe ngritje të kapaciteteve për Veprimet e duhura vendore për zbutje (VAKZ) Kosova mund të arrijë reduktime më të mëdha të emetimeve. Objektivat janë të koordinuara me synimet dhe objektivat e dokumenteve strategjike dhe dokumentet e politikave të Kosovës, siç janë Strategjia e Kosovës për Mjedisin dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin, Strategjia e Energjisë si dhe strategjitë për sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë. Disa nga VAKZ-të tanimë po gjejnë zbatim me resurset e Kosovës dhe me mbështetje të donatorëve, siç janë Plani i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë, Plani i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme dhe Strategjia për Mbrojtjen e Klimës së Pyjeve.

5. Alternativat e shqyrtuara: Skenarët e mundshëm të zhvillimit


5.1. Modelet globale të parashikimit

Modeli GAINS, i përdorur nga Komisioni Evropian në planifikimin e politikave klimatike, si dhe *International Futures* amerikane, Kosovën e shohin si pjesë e një grupi shtetesh, bashkë me Serbinë dhe Malin e Zi, për shkak të mungesës së të dhënave të ndara historike statistikore. Prandaj, për Kosovën janë të mundur vetëm skenarë tejet të përgjithësuar vëzhgues deri në zhvillimin e të dhënave të ndara dhe futjen e tyre në këto modele për vendin.

Modeli GAINS[36] është një varg modelesh të menaxhuar nga IIASA në Laksenburg, Austri, në emër të BE-së. Ai përfshin skenarë dhe të dhëna të ndryshme që rezultojnë nga projekte të ndryshme hulumtuese të BE-së. Në vijim janë paraqitur parashikimet për disa nga këta skenarë për grupin e shteteve.

[36] http://gains.iiasa.ac.at/gains/EUN/index.login?logout=1


Figura 9: Emetimet e kaluara dhe të ardhshme sipas skenarëve të ndryshëm të modelit GAINS. Për shkak se nuk janë llogaritur të gjithë skenarët për të gjitha vitet, disa nga vlerat janë shtuar. Burimi: Gains Europe http://gains.iiasa.ac.at/gains/emissions.EUN/index.menu?page=241



Dy skenarët EGEO krahasojnë opsionet e ndryshme të politikave me karbon të ulët në skenarët bazë. PRIMES 2010 është skenari kryesor i BE-së dhe skenari ANE World Outlook përdor të dhënat nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë në vend të të dhënave të BE-së. Skenarët e ndryshëm prodhojnë rezultate mjaft të ndryshme dhe shërbejnë vetëm për t'i demonstruar zgjidhjet në dispozicion. Përveç *EGEO Renewable*, ato të gjitha parashohin një rritje të ardhshme të emetimeve në rajon.

International Futures është model global dhe disa herë shifrat për shtetet e vogla nuk janë shumë të mira. Por, ato mundësojnë skenarë të ndryshëm në kontekstin global. Shifra në vijim paraqet emetimet e parashikuara për grupin e shteteve deri në vitin 2050. Ndryshe nga GAINS, të gjithë skenarët sipas IF parashohin një rënie mesatare të emetimeve në të ardhmen.

Figura 10: Emetimet e parashikuara sipas skenarit bazë dhe atij 4 të zhvilluar nga UNEP më 2007: Së Pari Tregjet, Së Pari Siguria, Së Pari Politika Dhe Së Pari Qëndrueshmëria. Sistemi i modelit të (IF), versioni 6.69. IFs fillimisht është zhvilluar nga Barry B. Hughes dhe është bazuar në Qendrën për të Ardhmet Ndërkombëtare Frederick S. Pardee, Fakulteti i Studimeve Ndërkombëtare Josef Korbel, Universiteti i Denverit, www.ifs.du.edu.



skenarët e zhvillimit GEO 4 janë zhvilluar nga UNEP më 2007 dhe janë paraqitur në vijim. (http://www.unep.org/geo/geo4/media/fact_sheets/Fact_Sheet_17_The_Future.pdf)

- **Së pari tregjet** angazhohet deklarativisht për zhvillim të qëndrueshëm në kuptim të idealeve të Komisionit Brundtland, Agjenda 21 dhe vendimeve të tjera madhore të politikave. Ekziston një fokus i ngushtë në qëndrueshmërinë e tregjeve në vend të kontekstit të sistemit më të gjerë të mjedisit njerëzor.
- **Së pari politikat** aplikon disa masa që kanë për qëllim promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm, por tensionet ndërmjet politikave mjedisore dhe ekonomike janë të njëanshme karshi konsideratave sociale dhe ekonomike.
- **Së pari siguria** ka në fokus interesat e një pakice: të pasur, kombëtarë dhe rajonalë. Ai vë theksin në zhvillim të qëndrueshëm vetëm në kontekst të maksimizimit të qasjes dhe shfrytëzimit të mjedisit nga të fuqishmit.
- **Së pari qëndrueshmëria** jep peshë të barabartë politikave mjedisore dhe socio-ekonomike, llogaridhënies, dhe thekson transparencën dhe legjitimitetin tek të gjithë akterët. Ai thekson zhvillimin e partneriteteve efektive të sektorit publik dhe privat jo vetëm në kontekst të projekteve por edhe në fushën e qeverisjes, duke siguruar se palët e interesit në tërë diskursin e spektrit të zhvillimit të mjedisit japin input strategjik në politikëbërje dhe zbatim.


Nëse Kosova nënshkruan Konventën Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike dhe Protokollin e saj të Kijotos do të jetë e obliguar të sigurojë monitorim vjetor të emetimeve të saj të gazrave serrë. Në fillim Kosova me siguri nuk do të pjesë e shteteve të Shtojcës I, por do të bëhet pjesë e grupit të ashtuquajtur Palët që nuk janë pjesë e Shtojcës I. Sistemi i raportimit për këto të fundit sipas Konventës UNFCCC është përmes Komunikatave Kombëtare me një afat kohor fleksibil shumëvjeçar, që raporton për inventarët e gazrave serrë dhe informata të tjera. Monitorimi, raportimi dhe shqyrtimi vjetor i emetimeve të gazrave serrë dhe largimeve është një nga obligimet kryesore për Palët e Shtojcës I sipas Konventës dhe Protokollit të Kijotos (vendimet 18/CP.8, 19/CP.8 dhe 14/CP.11). Kosova mund të duhet të fillojë me raportimin vjetor edhe para

se të bëhet anëtare e Shtojcës I, si pjesë e obligimeve të raportimit ndaj Agjencisë Evropiane për Mjedis (AEM).

Bazuar në informatat dhe skenarët ekzistues, nuk është e mundur të caktohen caqe sasiore për emetimet e ardhshme të Kosovës.

Por, duket se janë dy boshte kryesore përgjatë së cilave do të mund të zhvilloheshin skenarët aktual të mundshëm për Strategjinë për Zhvillim më Emetim të Ulët. Boshti i parë ka të bëjë me efiçiencën e energjisë dhe qëndrueshmërinë dhe i dyti me investimet në prodhimin e energjisë elektrike – thëngjilli apo burimet e ripërtëritshme. Skenarët e mundshëm janë paraqitur në Figurën 11 më poshtë.

Figura 11: Skenarët e mundshëm të Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët



Përshkrimi i këtyre skenarëve është si në vijim:

- **Resurset dhe kurthi i varfërisë:** Kosova vazhdon të varet në masë të madhe në thëngjill për prodhimin e saj të energjisë elektrike si dhe ngrohjen e ndërtesave. Termocentralet moderne po ndërtohen me efikasitet gjithnjë më të lartë dhe emetime më të ulëta, por kërkesa e energjisë dhe çmimet e energjisë po rriten. Ekonomitë familjare dhe industria, të cilët nuk mund të përballojnë investime në efiçiencë të energjisë, paguajnë një kosto gjithnjë e më të lartë të energjisë, veçanërisht pasi që sektori i energjisë të ketë hyrë në EU ETS dhe të duhet të paguajë për kuota të emetimeve.
- **Pyjet, lumenjtë dhe peizazhet e shterura:** Kosova do të krijojë mjedis për investitorët e huaj. Potenciali ekziston në hidroenergjetikë, si dhe në kapacitete të mëdha dhe të vogla të erës dhe energjisë solare. Në të njëjtën, kohë zonat e mihjes së thëngjillit janë në rënie

dhe kërkojnë mbështetje shtesë të qeverisë për ristrukturim. Për shkak të efiçiencës së ulët të energjisë kërkesa për energji është në rritje më të shpejtë se sa furnizimi me energji, duke dërguar në mbishfrytëzim të burimeve natyrore si pyjeve, lumenjëve, peizazheve dhe biodiversitetit në përgjithësi. Kjo shkakton probleme shtesë me përshtatjen në ndryshimet klimatike, zvogëlon cilësinë e jetës dhe potencialin turistik të vendit.

- **Rritja përmes tregjeve të energjisë:** Kosova tërheq investimet në sektorin e saj të energjisë nga thëngjilli me teknologji të importuar, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e saj dhe duke ulur emetimet e veçanta. Jetëgjatësia e minierave të thëngjillit është zgjatur për një tjetër brez, duke e bërë të mundur ristrukturimin gradual të ekonomisë së tyre me kosto të ulët. Në të njëjtën kohë, masat e efiçiencës së energjisë në ekonomitë familjare dhe industri mbajnë kërkesën për energji nën nivelin e kostove të furnizimit dhe të energjisë, brenda arsyes. Kosova eksporton energji elektrike tek vendet e tjera të BE-së dhe në këtë mënyrë mund t'i përballojë kuotat e emetimit të nevojshëm në kuadër të EU ETS BE.
- **Rritja përmes teknologjive dhe shërbimeve të reja:** Transformimi i sektorit të energjisë arrihet duke kombinuar investimet në energjinë e ripërtëritshme dhe efiçiencë të energjisë. Kjo krijon mundësi të reja biznesi dhe vende të punës duke zëvendësuar vendet e humbura të punës në rajonet e minierave të thëngjillit. Shfaqen biznese të prodhimit me teknologji të lartë, shërbimeve dhe financimit, të cilat rrisin eksportet e produkteve industriale dhe të shërbimeve. Kërkesa për energji dhe çmimet e energjisë janë të qëndrueshme; ekonomitë familjare dhe industria nuk priten të ekspozohen në rritje të çmimit të karbonit ose paqëndrueshmërisë së tregjeve globale të energjisë.

Është e qartë se dy skenarët te parë do të duhet të shmangen, nëse është e mundur, gjersa zgjidhja e vërtetë qëndron për sa i përket investimeve të ardhshme në prodhimin e energjisë elektrike. Nëse Kosova vendos të investojë në termocentrale me djegie thëngjilli me teknologji bashkëkohore, këtë do të duhej ta bënte para hyrjes në BE. Në këtë mënyrë do të mund të llogaritë në interesimin e investitorëve për shkak të kërkesës së lartë për energji elektrike në rajonin mesdhetar të BE-së. Por Kosova me siguri mund të tërheqë investime të ngjashme në potencialin e saj të burimeve të ripërtëritshme. Këtu, biomasa, hidrocentralet (të vogla dhe të mëdha) dhe era, kanë realizueshmëri komerciale dhe energjia fotovoltaike do të duhej të ishte konkurruese pa subvencione publike para vitit 2020.

Pavarësisht përzgjidhje së bërë në anën e furnizimit të energjisë, investimet janë të arsyeshme në anën e kërkesës – në efiçiencë të energjisë dhe transport të qëndrueshëm. Këtu është i rëndësishëm potenciali kosto-efektiv dhe përfitimet reciproke në kuptim të uljes së varfërisë dhe gjenerimit të rritjes ekonomike.

Synimet e propozuara të zbutjes në Strategji akomodojnë të dy skenarët e mundshëm në kuptim të burimeve të energjisë përderisa qartazi prioritetin e vë në efiçiencën e energjisë.

6. Masat e rekomanduara për reduktim të gazrave serrë

Tabela 7 në vijim tregon masat e planifikuara për reduktim të emetimeve të gazrave serrë sipas sektorëve, të renditura sipas prioritetit të tyre. Prioriteti më i lartë, Veprimet e duhura vendore

për zbutje, i theksuar me ngjyrë të zezë, më vonë paraqitet më në hollësi në Shtojcën 2. VAKZ-të përfshijnë politikat gjithëpërfshirëse, siç janë Plani i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë, Plani i Veprimit për Energji të Ripërtëritshme dhe Strategjia për Mbrojtjen Klimatike të Pyjeve. Të tjerat janë projekte apo nisma të veçanta të cilat ende nuk kanë marrë formën përfundimtare.

Për shkak të nivelit të pamjaftueshëm të informatave për emetimet aktuale, është vështirë të vlerësohet ndikimi i zbutjes së veprimeve individuale. Por disa prej tyre janë përgatitur më në hollësi dhe së paku mund të bëhet një vlerësim i përafërt që ndikimi i pritur mund të jetë një devijim prej 1 deri 2 Mt nga skenari pa ndryshime. Ky ndikim del nga Plani i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (O,7 Mt më 2018 dhe Strategjia për Ndryshimin Klimatik në Pyje (0,3 deri 1,3 Mt më 2020).

Duke përdorur një projeksion të thjeshtë të emetimeve të gazarve serrë në varshmëri me kërkesën e parashikuar për energji sipas Planit të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë dhe krahasuar me ndikimin e këtyre masave, na paraqitet një reduktimin i emetimeve prej 7 deri 14% më 2018, krahasuar me skenarin pa ndërmarrjen e këtyre masave. Kjo jep një përafrim të parë të asaj se si do të duhej të dukej një cak i emetimeve kur të zhvillohen në tërësi inventari dhe parashikimet e emetimeve. Ky skenar i përafërt është paraqitur në figurën 12 në vijim.

Figura 12. Ulja e mundshme e emetimeve bazuar në masat e propozuara të zbutjes krahasuar me vlerësimin e përafërt të skenarit pa ndryshime. Vlerësimi i poshtëm i uljes së emetimeve është 1 Mt CO_2 eq. në vit më 2018 dhe vlerësimi i lartë është 2 CO_2 eq.




Tabela 7. Masat për uljen e emetimeve të gazrave serrë sipas sektorëve dhe nënsektorëve (VAKZ)

Sektori / Nënsektori	Masat e mundshme
Ngritja e kapaciteteve	**Krijimi i një Sistemi Kombëtar të Inventarizimit dhe fuqizimi i raportimit për gazrave serrë (AKMM)** Hartimi dhe zbatimi i politikës kombëtare për ndryshimet klimatike Politika klimatike në sektorë të ndryshëm dhe komunitetet lokale Trajnime për negociatat në kuadër të UNFCCC-së dhe BE-së përkatësisht
Efiçienca e energjisë	**Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë 2010-2018** Aplikimi i standardeve të efiçiencës së energjisë Promovimi dhe ndërgjegjësimi Sistemi i auditimit të energjisë Krijimi i skemave të subvencioneve /huadhënies për masa të efiçiencës së energjisë
Energjia e ripërtëritshme	Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme (PKVER) 2011 - 2020 Zhvillimi i potencialit hidroenergjetik në dispozicion përmes koncesionimit Zhvillimi i potencialit të erës në dispozicion përmes koncesionimit Sigurimi i furnizimit të besueshëm të drurit të zjarrit dhe biomasës për ngrohje Promovimi i përdorimit të biomasës për ngrohjen qendrore dhe kogjenerimin industrial Vendosja e kushteve të favorshme rregullative për prodhimin e energjisë fotovoltaike (pa subvencione) Energji gjeotermike në nivel të cekët për ngrohje Prodhimi i biogazit nga mbeturinat e kafshëve në blegtori
Ngrohja qendrore dhe kogjenerimi industrial	Rindërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ngrohjes qendrore Aplikimi i energjisë së ripërtëritshme dhe efiçiencës së lartë të energjisë (kombinim i ngrohjes dhe energjisë) në prodhimin e energjisë Kogjenerimi në lokacione industriale për nevoja të ngrohjes qendrore dhe nevoja industriale
Termocentralet dhe minierat e thëngjillit	Përmirësimi i efiçiencës së TC-ve ekzistuese **Rritja e efikasitetit të prodhimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të TC Kosova A me Termocentralin Kosova e Re** Parandalimi i vetëndezjes së linjitit
Transporti	**Konceptet e lëvizshmërisë së qëndrueshme në qytete dhe qyteza të Kosovës** Promovimi i transportit publik rrugor (autobus) Rindërtimi i hekurudhave, duke përfshirë sigurimin e shërbimit cilësor të udhëtarëve Përparësi ecjes dhe çiklizmit para automjeteve në zhvillimin urban Stimulime tatimore që shkurajojnë automjetet e vjetra ndotëse, joefikase Zhvillimi i vendbanimeve, rrjetit rrugor dhe lehtësirës intermodale të transportit publik
Menaxhimi i mbeturinave	Grumbullimi i mbeturinave të ndara dhe riciklimi **Përdorimi i mbeturinave të ngurta të parrezikshme (të amvisërive, goma,…) si lëndë alternative djegëse në prodhimin industrial** Kompostimi shtëpiak
Bujqësia	**Metodat e deponimit, përgatitjes dhe aplikimit të plehrave**

	Aplikim adekuat i plehrave artificiale minerale dhe organike Prodhimi organik
Pyjet dhe natyra	**Zbatimi i Strategjisë së Mbrojtjes Klimatike në Sektorin e Pyjeve në Kosovë** Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve duke rritur rezistencën e pyjeve Mbrojtja nga zjarret e pyjeve Shpyllëzimi dhe ripyllëzimi i tokave të zhveshura Promovimi i produkteve drunjore Integrimi i sekuestrimit të karbonit në menaxhimin e pyjeve Pjesë të pyjeve dhe zonave të mbrojtura t'i lihen zhvillimit natyror Caktimi dhe zhvillimi i zonave të mbrojtura

7. Hapat e ardhshëm për zbatimin e strategjisë me karbon të ulët

7.1. Zhvillimi institucional

Nga shqyrtimi i strategjive ekzistuese dhe problemeve me zbatimin e tyre, gjendja institucionale është pengesë dhe shqetësim kryesor për zbatimin efektiv të strategjisë së emetimit të ulët në Kosovë. Strategjia merrë këtë parasysh duke përcaktuar ngritjet e nevojshme të kapaciteteve dhe bashkërendimin e institucioneve.

Kjo do të thotë që prioritet i parë do të jenë veprimet për ngritjen e kapaciteteve. Veprimet e tjera do të sajohen ashtu që të përfshijnë sektorin privat, partneritetet publike private, komunitetet lokale dhe OJQ-të. Gjithashtu, duket se në të ardhmen e afërm do të jenë në dispozicion financa shumë të pakta nga burime publike vendore.. Kjo do të thotë që financimi i veprimeve do të duhet të bazohet kryesisht në sektorin privat (popullata, kompanitë, bankat), donatorët "klasikë" dhe fondet e BE-së në kuadër të zhvillimit të procesit të aderimit në BE.

7.2. Zhvillimi dhe zbatimi i VAKZ-ve

Disa nga VAKZ-t si ato në sektorin e energjisë dhe pylltarisë tanimë janë në proces. Të tjerat duhet të përgatiten dhe të zbatohen. Bazuar në listën e VAKZ-ve dhe përshkrimeve të tyre të shkurtra, hollësitë e VAKZ-ve do të përgatiten në vitin 2014 në bashkëpunim ndërmjet MMPH, UNDP dhe autoriteteve të tjera relevante dhe donatorëve të interesuar. Gjatë përgatitjes së secilit VAKZ, do të përcaktohet buxheti dhe përgjegjësitë institucionale për të siguruar planifikim realist dhe zbatim eventual.

7.3. Monitorimi dhe vlerësimi i efektivitetit të strategjisë

Monitorimi i zbatimit të strategjisë së zhvillimit me emetim të ulët është një mjet i rëndësishëm i përcjelljes së progresit të Kosovës kundrejt synimeve dhe objektivave të strategjisë. Aktualisht, një dobësi madhore e Kosovës janë informatat e besueshme për emetimet e gazrave serrë. Krijimi i një sistemi funksional të monitorimit të emetimeve dhe veprimeve të zbutjes, si dhe vlerësimit të dhe përshtatjes së Strategjisë do të duhej të ishte një nga prioritetet e para të Strategjisë nëse Kosova dëshiron të tërheqë financim të mundshëm për masat e zbutjes. Hapat e parë po realizohen përmes studimeve të partnerëve të huaj, por përpjekjet për ngritje të kapaciteteve në këtë kuptim do të duhet të vazhdojnë.

Një sistem i besueshëm i monitorimit dhe vlerësimit është edhe mekanizëm i rëndësishëm i përputhshmërisë ndërkombëtare që mund të lehtëson pranimin e veprimeve të zbatuara nga Kosova.

Përkundër mungesës së kërkesave dhe procedurave definitive për vlerësimin e gazrave serrë në shtetet në zhvillim, duhet të përcaktohet qartë orientimi i përgjithshëm dhe qëllimi i strategjisë.

Si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova do të duhet të dorëzojë raporte dyvjeçare, që përfshijnë azhurnime për emetimet e tyre kombëtare të gazrave serrë, duke përfshirë inventarët e gazrave serrë dhe raportin e inventarit kombëtar, informata për veprime të zbutjes, nevojën për mbështetje dhe mbështetjen e pranuar.

Hapat që mund të ndërmerren për zbatimin e sistemit efektiv të monitorimit dhe vlerësimit mund të përfshijnë:

- Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemit të inventarit të gazrave serrë;
- Sigurimi i kapaciteteve në nivel kombëtar dhe nivel nën-kombëtar për sa i përket përpilimit të informatave statistikore që kanë të bëjnë me të dhënat nga aktivitete e gazrave serrë, indikatorët specifikë të performancës së veprimeve dhe politikave të zbutjes,
- Marrja e veprimeve për identifikimin dhe zbatimin e një sistemi të indikatorëve specifikë për matjen e progresit në zbatimin e masave të ndryshme sektoriale të zbutjes të identifikuara në strategjinë për zhvillim me emetim të ulët me qëllim që të analizohet performanca e tyre aktuale dhe të identifikohen mundësitë për avancimin e tyre në ardhmen,
- Zhvillimi i qasjeve dhe metodave specifike të Kosovës për vlerësim, faktorëve të emetimeve dhe etapave për vlerësimet e uljes së emetimeve që do të ishin të përshtatshme për kushtet lokale,
- Avancimi i kapaciteteve strategjike të planifikimit dhe vlerësimit të performancës në nivel kombëtar dhe nën-kombëtar për matjen dhe analizimin e efektivitetit të masave për zbutje.
- Mjetet për përshtatjen e strategjisë, sipas nevojës.

Për më tepër, autoritetet, industritë, bizneset, organizatat, agjencitë dhe organet e administratës lokale publike do të duhej të nxiteshin që të mbajnë llogari vjetore të fondeve të shpenzuara për zbatimin e strategjisë së zhvillimit me emetim të ulët dhe masave që e mbështesin atë, për të mundësuar vlerësimin e efektivitet të saj si teknik ashtu dhe ekonomik, si dhe për raportim të saktë tek bashkësia ndërkombëtare.

7.4. Rishikimi i strategjisë

Pasi që sistemi i inventarit të gazrave serrë të jetë operacionale dhe të jenë zhvilluar parashikimet adekuate të emetimeve të ardhshme duhet të rishikohet Strategjia. Planet e hollësishme dhe rezultatet e përkohshme të VAKZ-ve individuale do të duhet të merren parasysh për të caktuar një objektiv realist sasior të emetimit për 2020 dhe mundësisht një objektiv indikativ për 2030. Elementet tjera të Strategjisë gjithashtu duhet të rishikohen dhe të revidohen në pajtim me zhvillimet në periudhën e intervenimit.

Komponentja e II-të

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes për Kosovën

1. Hyrje

1.1 Strategjia Kombëtare e Përshtatjes në lidhje me prioritetet qeveritare

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes ndërlidhet me strategji të ndryshme (sektoriale) dhe plane të veprimit në Kosovë. Një pasqyrë e këtyre strategjive sektoriale është paraqitur në vijim (për më shumë detaje, shih Shtojcën 5).

Për më tepër, Strategjia siguron një pikë të rëndësishme të referencës për strategjinë për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (ZRRF), e cila aktualisht është duke u përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme (MIA) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

Legjislacioni që ndërlidhet me përshtatjen e ndryshimeve klimatike
Strategjia sektoriale/plani/ligji

Plani Hapësinor i Kosovës 2010 - 2020 (MMPH)
Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, 2009 -13 (MMPH)
Zhvillimi i Pyjeve 2010 - 2020
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 - 2020
Strategjia minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025
Strategjia e ngrohjes në Republikën e Kosovës 2011 – 2018
Strategjia e Kosovës për Mjedisin (SKM) 2011-2021
Ligji nr . 04/L-147 për Ujërat e Kosovës
Ligji për veprimtaritë hidrometeorologjike nr. 02 / l-79
Ligji për shëndetin publik nr. 02/L-78
Ligji për ofruesit e shërbimeve të mbeturinave, ujit dhe kanalizimit nr. 03/L-086
Ligji për ujitjen e tokave bujqësore nr. 02/L-9
Ligji për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040
Ligji për mbrojtjen e natyrës nr. 03/L –233
Ligji për vlerësimin e ndikimit mjedisor nr. 03/L-214
Ligji për mbrojtjen mjedisore nr. 03/L-025
Ligji për mbeturinat nr. 04/L-060
Ligji për planifikimin hapësinor nr. 04 - L - 174
Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027.

1.2 Arsyeshmëria për inicimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes

Në përgjithësi është pranuar nga ana e autoriteteve përgjegjëse se Kosova duhet të planifikojë përshtatjen ndaj sfidave dhe mundësive të cilat do t'i sjellin ndryshimet klimatike (shih pjesën 3.1 për më shumë hollësi).

Përgatitja e Strategjisë për Ndryshimet Klimatike është në mesin e prioriteteve në Strategjinë Kombëtare për Mjedis dhe Planin Kombëtar të Veprimit për Mjedisin për periudhën 2011-2015 dhe gjithashtu është identifikuar si prioritet për procesin e përafrimit të Kosovës me BE-në.

Siç është cekur në Dokumentin Punues të Stafit të Komisionit Evropian "Komunikatë e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës", Bruksel, 23 tetor, 2012 { SWD(2012) 339 final/2 }: "*Kosova nuk është palë e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike. Nuk ka strategji për ndryshime klimatike, plan të veprimit, caqe të zbutjes për të gjitha ekonomitë, apo politika dhe masa për ndryshime klimatike".* Përveç kësaj, strategjia e përshtatjes për ndryshime klimatike është e rëndësishme për Kosovën në procesin e përmbushjes të kërkesave të përafrimit me BE-në për sa i përket vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet, në pajtim me Direktivën e BE-së për Përmbytjet.

Në Kosovë, autoriteti përgjegjës për politikat mjedisore dhe për ndryshimet klimatike është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). MMPH ka nisur konsultimet me sekretariatet të disa konventave dhe ka filluar me përgatitjet e dokumentacionit për ratifikimin e Konventave.

Strategjia Kombëtare e Përshtatjes është nismë e MMPH-së, e mbështetur nga UNDP. Strategjia është hartuar në bashkërendim me Strategjinë për Zhvillim me Emetim të Ulët, dhe së bashku përbëjnë Strategjinë Kornizë për Ndryshime Klimatike për Kosovën.

2. Metodologjia

2.1. Hyrje

Dokumenti strategjisë bazohet në procesin e planifikimit, duke përshirë palë qendrore dhe lokale të interesit. Për këtë qëllim Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka themeluar një Grup Punues Ndërministror (GPNM).

Një funksion i rëndësishëm i procesit të planifikimit ishte integrimi i interesave të ndryshme dhe sfidave hapësinore në një Strategji të vetme Kombëtare të Përshtatjes, e cila do të ishte në përputhje me Strategjinë për Zhvillim me Emetim të Ulët, e të cilat janë hartuar në mënyrë paralelet, të dyja nën patronatin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Stategjia Kombëtare e Përshtatjes dhe Strategjia për Zhvillim me Emetim të Ulët, së bashku, formojnë Strategjinë Kornizë për Ndryshime Klimatike për Kosovën.

Shih Shtojcën 6 për një pasqyrë më të hollësishme të procesit pjesëmarrës të planifikimit të Grupit Punues Ndërministror (GPNM).

2.2. Lista e ministrive dhe institucioneve të përfshira në hartimin e strategjisë

Ministritë dhe institucionet vijuese janë përfshirë gjatë procesit të hartimit të strategjisë si anëtarë të Grupit Punues Ndërministror:

- Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

- Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës (DMN), Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Departamenti i Ujërave / Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit / Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës /AKMM/ Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Ministria e Integrimit Evropian (MIE)
- Ministria e Infrastrukturës (MI)
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
- Ministria e Punëve të Brendshme (MIA)

2.2.1. Lista e palëve të interesit të përfshira në hartimin e strategjisë

Kjo pjesë paraqet një pasqyrë të palëve të interesit të cilët janë konsultuar gjatë procesit të hartimit të strategjisë, qoftë përmes pjesëmarrjes së tyre në takime në tryeza të rrumbullakëta, përmes intervistave bilaterale apo përmes pyetësorit të anketës në nivel lokal.

- UNDP Kosovë dhe UNDP RBEC,
- Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë
- Sekretariati i Këshillit Ndërministror për Ujëra, Zyra e Kryeministrit
- Ekipi i FAO në Kosovë
- Qendra Rajonale Mjedisore (REC), Kosovë
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (EMA), Kosovë
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Kosovë
- Instrumenti për Asistencë Teknike dhe Këmbim të Informatave i menaxhuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e Komisionit Evropian
- Programi i Përshtatjes të Ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor / GiZ

2.2.2. Pyetësori i anketës lokale

Pyetësori për masat e përshtatjes në Kosovë që ka shërbyer për ta vlerësuar gjendjen aktuale në trajtimin e rreziqeve të klimës në Kosovë është përgatitur dhe shpërndarë në komuna në nivel lokal dhe aktorëve të tjerë në nivel qendror, duke përfshirë të Grupin Punues Ndërministror për Strategjinë Kombëtare të Përshtatjes.

Pyetësori ka shërbyer si instrument për vlerësimin e parë të masave aktuale dhe të mundshme të përshtatjes në Kosovë. Bazuar në rezultatet e 15 pyetësorëve në nivel lokal dhe raundet e votimit nga 12 anëtarët e Grupit Punues Ndërministror (GPNM) në nivel qendror, është prezantuar një listë prej gjithsej 74 masave të mundshme të përshtatjes me prioritet të lartë ose të mesëm (shih kapitullin 5). Nuk janë përfshirë masat e mundshme të përshtatjes me prioritet të ulët.

Për identifikimin e praktikave më të mira dhe/apo mësimeve të nxjerra, masat e përshtatjes nxjerrin në pah komunat ku rezultatet e zbatimit dhe/ose të planifikimit janë dukshëm më të larta se në komunat e tjera. Për këtë arsye, meqë zbatimi apo planifikimit ka ndodhur ose është në proces në këto vende, ato kërkojnë vëmendje të veçantë për të parë nëse mund të identifikohen dhe ngrihen pengesat dhe mundësitë për përshtatje, mësimet e nxjerra ose praktikat më të mira.

Përzgjedhja e dytë është realizuar në shtator 2013 bazuar në analizën shumëkritereshe (MCA). MCA bazohet në një vlerësim më të hollësishëm (nga Konsulentë Kombëtarë) të masave të mundshme të përshtatjes vetëm me prioritet të lartë dhe të mesëm.

3. Informata të përgjithshme

3.1. Përshkrimi i problemit

Ka dëshmi të shumta se ndryshimi klimatik po ndodhë dhe ndikimit po vërehen tani (Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimin Klimatik (IPCC), 2007, 2013; Raporti Botëror i Zhvillimit të Ujit, 2009; Raporti i Ndikimit Njerëzor, 2009; Asociacioni Ndërkombëtar i Universiteteve Hulumtuese (IARU), 2009; OBSH, OBM, 2012). Për më keq, observimet e kohëve të fundit tregojnë se emetimet e gazrave serrë dhe shumë aspekte të klimës po ndryshojnë në prag të kufijve të sipërm (!) të parashikimeve të IPCC (IARU, 2009). Ndryshimet klimatike po ndodhin më shpejtë se që është menduar (Raporti i Ndikimit Njerëzor, 2009; IARU, 2009). Shumë indikatorë kyçë tanimë po lëvizin përtej trendeve të ndryshueshmërisë natyrore brenda së cilave janë zhvilluar dhe kanë lulëzuar shoqëritë dhe ekonomitë bashkëkohore. Këta indikatorë përfshijnë temperaturën mesatare globale të sipërfaqes, temperaturën globale të oqeaneve, shtrirjen e akullit në Detin Arktik, acidimin e oqeaneve, si dhe ngjarjet ekstreme klimatike (IARU, 2009).

Ndryshimet klimatike mund të ndikojë drejtpërsëdrejti në ciklin hidrologjik dhe, përmes tij, në sasinë dhe cilësinë e resurseve ujore. Rritja e temperaturës sipërfaqësore të ujit dhe ndryshimet në ciklin hidrologjik mund të rezultojnë në ndryshimin e trendeve të reshjeve në rajon. Disa fusha mund të përjetojnë reshje intensive që rezultojnë në përmbytje të rënda, gjersa rajonet e tjera mund të përjetojnë më pak reshje, si dhe thatësira të shpeshta (IPCC, 2013; IARU, 2009; Raporti Botëror i Zhvillimit të Ujit, 2009). Ndryshimet klimatike mund të ulin rrjedhat minimale në lumenj, duke cenuar disponueshmërinë dhe cilësinë e ujit për florën dhe faunën e tij dhe të ujit të pijshëm, prodhimit të energjisë (hidroenergjetikës), ftohjes së termocentraleve dhe transportimit përmes lumenjve, kanaleve dhe liqeneve. Si rrjedhojë e drejtpërdrejtë, shumë sektorë janë tejet të cenueshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, në veçanti bujqësia, peshkataria, industria, navigimi, turizmi, shëndeti njerëzor, siguria publike, biodiversiteti dhe shërbimet mjedisore nga ekosistemet.

Krahas dëmeve mjedisore dhe ekonomike, ndikimi përfundimtar i ndryshimeve klimatike është goditja në resursin tonë më të çmuar – jetën dhe shëndetin e njeriut. Ndikimet shëndetësore janë në mesin e dëmeve më të konsiderueshme nga ndryshimet klimatike – dhe shëndeti mund të jetë forcë shtytëse për angazhim publik për zgjidhje klimatike.

Për këtë arsye, përgjithësisht pranohet nga autoritetet përgjegjëse që Kosova duhet të ketë plan për përshtatje ndaj sfidave dhe mundësive që sjellë një klimë në ndryshim. Institucionet përgjegjëse për ujë, bujqësi, pylltari, navigacion, industri, shëndet publik, planifikim të përdorimit të tokës, dhe çështje të ndërlidhura të mjedisit janë nën presion për t'iu përgjigjur ndikimeve të papara të ndryshimeve klimatike siç janë përmbytjet më të mëdha, thatësirat më të rënda, degradimi i ekosistemeve dhe reduktimi i shërbimeve të ekosistemit, mungesa e furnizimit me ujë, shtimi dhe forma të reja të ndotjes dhe sëmundjeve të lidhura me ujin.

Nëse merret parasysh se në kushtet aktuale ndryshueshmëria e klimës është tashmë e rëndësishme për menaxhimin e suksesshëm të ujit në shumë pjesë të botës, meqë shtyn proceset lokal, kombëtare dhe rajonale të përshtatjes (Palmer et al, 2008;. Hallegatte, 2009),

atëherë ndryshimet klimatike vetëm sa rëndojnë kompleksitetin ekzistues të arritjes së një zhvillimi të drejtë socio-ekonomik që përfshin përdorime të shumta të ujit nga një numër gjithnjë në rritje i përdoruesve në mënyra që janë edhe të drejta edhe të qëndrueshme (Lebel, 2007, 2009). Shpeshherë është i nevojshëm integrimi proaktiv i strategjive të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, zvogëlimit të rrezikut nga fatkeqësitë, dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Megjithatë, tani për tani kemi njohuri të kufizuara për "politikën" e funksionimit të strategjive, p.sh. në lidhje me ndërtimin e besimit, zgjidhjen e konflikteve dhe mënyrën në të cilën interesat e ndryshme peshohen kundrejt njëra-tjetrës.

Shpeshherë, masat teknike më nuk janë të mjaftueshme, dhe autoritetet publike, organizatat joqeveritare dhe kompanitë private janë në kërkim të zgjidhjeve të tjera për të siguruar që burimet e rrezikuara të ujit të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme. Megjithatë, marrëveshjet aktuale institucionale janë shpeshherë të pamjaftueshme për t'i menaxhuar këto sfida të reja në mënyrë adekuate dhe prandaj janë të nevojshme mënyra invoative dhe të përshtatjes për qeverisjen e përshtatjes klimatike.

Në këto rrethana, Kosova përballet me sfida të mëdha për ta bërë sistemin e saj të qeverisjes publike më rezistent dhe fleksibil, për shembull në lidhje me: 1) decentralizimin; 2) proceset pjesëmarrëse në vendimarrje; 3) trajtimin e pasigurive në vendimarrje, veçanërisht në lidhje me të ardhmen e paparashikueshme e ndryshimeve të klimës, për shembull përmes analizave afatgjate të skenarëve, vlerësimeve të rrezikut dhe vlerësimeve të cenueshmërisë; 4) përfshirjen e sektorit privat në menaxhimin e burimeve natyrore, për shembull nëpërmjet partneritetit publik privat; 5) aplikimit të qasjeve të integruara dhe koncepteve të përshtatjes të menaxhimit; 6) riorganizimin dhe fuqizimin e autoriteteve qendrore; 7) aplikimin e mekanizmave të çmimvënies, mbulimit të kostos dhe masave stimuluese; 8) zbatimin e masave kundër korrupsionit.

3.2. Ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë

Strategjia për Përshtatjen e Ndryshimeve klimatike është e rëndësishme për të reaguar dhe parashikuar ndikimet e ndryshimeve klimatike në Kosovë. Këto ndikime aktuale dhe të pritura përfshijnë (Burimet: IPCC, 2007, 2013, UN-Habitat 2009, OSBE 2008, UNDP/WMO 2009):

- Ndryshimet klimatike do të rritin ekspozimin në rreziqet nga thatësirat, përmbytjet dhe zjarret në pyje. Ndryshueshmëria e klimës tanimë është rritur në Kosovë;
- Rritja e intensitetit dhe shpeshtësisë së reshjeve ekstreme siç janë shirat e dendur, si dhe thatësirat edhe më të rënda, veçanërisht nga vitet e '80-ta. Përmbytjet e menjëherëshme po bëhen gjithnjë e më të rëndomta në viset malore, gjerësa vërshimet e lumenjve po ndodhin gjithnjë e më shpesh në fusha dhe zona të ulëta;
- Temperaturat më të larta më me gjasë do të shkaktojnë valë të nxehta dhe zjarre në pyje. Që nga viti 2000 e tutje në Kosovë ka pasur gjithnjë e më shumë zjarre në pyje;
- Kosova disa herë është goditur nga thatësirat gjatë dy dekadave të fundit (1993, 2000, 2007, dhe 2008);
- Temperaturat e ngritura, reshjet e pakësuara dhe zvogëlimi i rrjedhave në kombinim me zhvillimet socio-ekonomike dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ujit do ta rrisin ekspozimin në thatësira;

- Që nga viti 2004, 80% e komunave të Kosovës janë përballur me mungesa të ujit për shkak të thatësirave hidrologjike dhe keqpërdorimit të burimeve të ujit; ;
- Degradimi i ekosistemit dhe zvogëlimi i shërbimeve të ekosistemit;
- Shtimi i sëmundjeve dhe paraqitja e sëmundjeve të reja si pasojë e ndotjes dhe ujit

Është me rëndësi të merret parasysh se rreziqet klimatike në një vend si Kosova kanë ndikim shumë më të madh se sa do kishin normalisht, për shkak të shkallës së lartë të cenueshmërisë. Kjo rrjedhë nga disa faktorëve, duke përfshirë: (burimi: UN-Habitat 2009, OSBE 2008, UNDP/OBM 2009):

- Lulëzimin e paprecedent të ndërtimeve dhe urbanizimit që nga 1999;
- Cenueshmërinë e lartë socio-ekonomike për shkak të pranisë së lartë të varfërisë (prek 45% të popullatës) dhe ekonomisë së brishtë, e pëcjellur me shërbime të kufizuara në sektorët e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe punësimit;
- Ndërtimet pa leje në zona të rrezikshme si dhe mosrespektimi i standardeve të ndërtimit;
- Mungesa e mirëmbajtjes dhe shkatërrimi gjatë kohës së luftës;
- Sistem joadekuate të drenazhit dhe kanalizimit;
- Shfrytëzim joadekuat i tokës dhe planifikimi joadekuat komunal, të cilat rrisin ekspozimin e popullatës ndaj rreziqeve;
- Menaxhim i paqëndrueshëm i ujit dhe praktika të paqëndrueshme bujqësore, shpyllëzimi dhe shkatërrimi i shpatinave nga aktivitetet në miniera .

Pjesët në vijim paraqesin një përkufizim më të hollësishëm të problemit për sektorë të ndryshëm që janë veçanërisht të cenueshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

3.2.1. Resurset e ujit

Kosova ka sasi të pakta dhe të kufizuara të resurseve të ujit të freskët. Mungesat e resurseve të ujit të pijshëm me gjasë do të ndodhin në një të ardhme të afërme në vitet e thata nëse nuk aplikohen menjëherë veprimet e duhura të përshtatjes.

Përveç kësaj, resurset e ujit në dispozicion janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë në tërë territorin, të ndara në katër pellgje lumenjsh /ujëndarës: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës dhe Lepenci. Furnizimi mesatar vjetor i ripërtëritshëm me ujë për person në Kosovë është rreth 1’987 m3/person/vit, dhe kategorizohet si pa trysni (indikatori Falkenmark), që është ndjeshëm më ulët krahasuar me mesataren botërore prej 7’243 m3 (CEDARE AWC, 2006). Për shkak se disponueshmëria e ujit ndryshon nga një pellg lumi në tjetrin, ka nevojë të kryhen hulumtime për mundësitë dhe potencialet për rezervuare shtesë të ujit brenda pellgje të lumenjve. Zhvillimi i vlerësimeve të ndikimit në mjedis, studimeve të fizibilitetit që analizojnë ndryshueshmërinë e opsioneve të bartjes së ujit, duhet t’i paraprijnë zhvillimit të infrastrukturës së duhur përfundimtare të transportimit të ujit nga një pellg lumor në tjetrin.

Pjesa perëndimore dhe jugore e Kosovës, e njohur si Rrafshi i Dukagjinit, është më e pasur me ujëra sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Pjesa veriore dhe lindore e Kosovës, e njohur si Fusha e

Kosovës, ka më pak resurse ujore në dispozicion. Megjithatë, kjo zonë ka përqendrimin më të madh të popullatës dhe më së shumti pika të nxehta të cilat shkaktojnë ndotje ekstreme të ujit.

Kategoritë kryesore të përdorimit të burimeve të ujit të freskët janë: Furnizimi me ujë të pijshëm për ekonomi familjare, furnizimit me ujë për Industrinë dhe Energjetikën (për hidroenergjinë dhe për ftohje të termocentraleve) dhe për qëllime të ujitjes. Bazuar në Raportin Vjetor të Performancës së Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë për vitin 2012, industria e ujit në Kosovë është ende e dobët; duke treguar mangësi në shumicën e treguesve të performancës të tilla si mbulimi i shërbimit që është në nivel prej 78%. Shumë fshatra rurale nuk mbulohen nga skemat rajonale të furnizimit me ujë dhe disa fshatra ende përdorin ujërat nëntokësore nga puset e cekëta të cilësisë së përkeqësuar. Kosova ka rreth 237.800 hektarë tokë bujqësore, nga të cilat vetëm 42.200 hektarë janë të ujitura, ose rreth 17.7 %. Pavarësisht shifrave më lartë, Kosova është më e avancuara në rajon për sa i përket performancës së ndërmarrjeve publike. P.sh. mbulimi prej 78 % nuk do të thotë se pjesa tjetër e popullsisë nuk ka qasje në shërbimet e ujit. Në vend të kësaj, ata mund të kenë sistemet vetjake, ose përdorin puse.

Cilësia e ujit të lumenjve në Kosovë është e dobët për shkak të mungesës së impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, hedhjes së mbeturinave përgjatë/ose pranë brigjeve të lumit, mirëmbajtjes së dobët apo inekzistente të shtretërve të lumenjve. Zakonisht cilësia e lumenjve në rrjedhën e sipërme përfaqëson një habitat të shëndetshëm ujor dhe plotëson standardet mjedisore. Disa nga lumenjtë kryesorë të rrymës së poshtme nga komunat më të mëdha dhe industritë janë të ndotura rëndë sa që uji nuk mund të përdoret për furnizimin me ujë ose për qëllime të ujitjes. Lumenjtë kryesorë në Kosovë bien në kategorinë e ndotjes 2 dhe 3, ndërsa lumi Sitnica është kategorizuar si “lum i vdekur”.

Ndikimi i ndryshimeve klimatike mund ta përkeqësojë edhe më shumë cilësinë e rrjedhave të ujit, në veçanti gjatë muajve të verës kur pritet ndryshim në trendet e reshjeve që do të pasqyrohen në rrjedhën e ulët të lumenjve dhe nga rritja e temperaturave, gjersa burimet e kontaminimit vazhdojnë të jenë të pandryshuara. Ndotja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit do të ndikojnë rëndë në shëndetin e njerëzve; ajo mund të pengojë rritjen ekonomike dhe mund të ndikojë në bollëkun dhe sigurinë e ushqimit.

Një studim i gjerë i mbulimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimit në Kosovë, i realizuar nga CDI dhe financuar nga SCO, tregon mbulueshmëri në nivel vendi prej 66 % gjatë viti 2012. ZRRUM zakonisht raporton për zonën e shërbimit të kompanive të licencuara, që përjashton disa komuna/ fshatra që ende nuk janë integruar në Kompanitë Rajonale të Ujit. Shumica e popullsisë rurale dhe urbane që nuk ka rrjet të kanalizimit në baza individuale përdor gropa apo shkarkim septik të ujërave të zeza, për në lumenjtë e afërt apo përrenjë . Mungesa e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa e trajtimit adekuat të ujërave të zeza është duke shtuar presionin në burimet e ujërave të freskëta. Rrjeti i kanalizimit, në përgjithësi, vlerësohet të jetë në një gjendje shumë të keqe. Në vitin 1999, mbulueshmëria me sisteme kanalizimi ishte 30%. Kjo tregon se shumica e rrjetit është relativisht e re. Disa rrethe në qendrat kryesore urbane ende nuk kanë një rrjet të drenazhit, ndërsa aty ku ai ekziston është në gjendje të përkeqësuar dhe nën parametra, gjë që shkakton përmbytje pas çdo shiu apo stuhie. Shumica e qendrave urbane, të paktën ato më të mëdha, kanë sisteme të veçanta për ujërat nga stuhitë, përveç në disa raste ku lagjet mund të kenë sisteme të kombinuara. Edhe në këtë rast, ka plane për t’i ndarë ato. Përveç komunës së Skenderajt që ka impiant për trajtimin e ujërave të zeza, qendrat tjera urbane dhe fshatrat rurale në Kosovë ende nuk bëjnë trajtimin e ujërave të zeza. Që nga viti 2013, kanë filluar punimet për një impiant të tillë në Prizren. Gjithashtu, studimet e realizueshmërisë janë

përfunduar për Prishtinën, Pejën, Gjakovën dhe Gjilanin. Për dy të fundit, punimet priten të fillojnë vitin e ardhshëm. Studimi i realizueshmërisë për Ferizajin është në fazën e përfundimit gjithashtu. Që nga fundi i vitit 2013, shumica e ujërave të zeza urbane derdhen direkt në lumenj pa ndonjë trajtim paraprak. Përveç ndotjes së burimeve ujore nga shkarkimi i ujërave të zeza nga objektet për banim, shkarkimet e ujërave të ndotura industriale kontribuon në ndotjen e resurseve ujore në Kosovë. Në veçanti, ndotja me metale të rënda dhe toksina të tjera është një shqetësim i madh. Dokumenti i pritur i politikave të ujit, dhe ligji për ujin obligojnë trajtim të detyrueshëm të ujërave të zeza industriale.

Presioni në burimet mjaftë të kufizuara natyrore të ujit po rritet edhe si pasojë e aktiviteteve njerëzore. Rritja e kërkesës për ujë në të gjithë sektorët dhe ndotja përgjatë brigjeve të rrjedhave të ujit po kontribuojnë në shterimin dhe përkeqësimin e burimevetë ujit. .

Temperaturat e larta dhe ulja e trendit të reshjeve të cilat pritet të ndodhin do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në regjimet e rrjedhave të lumenjve, në nivelet e ujërave nëntokësore dhe sasinë e rimbushjes së ujërave nëntokësore, si dhe në avullimin e ujit nga toka. Për më tepër, ndryshimet klimatike do të shtojnë cenueshmërinë ndaj përmbytjeve ekstreme dhe thatërisave me ndikime të paparashikueshme socio-ekonomike në mirëqenien njerëzore dhe kushtet mjedisore.

Rekomandime

Duke pasë parasysh tërë këtë që u tha më sipër, është më se i domosdoshëm një vlerësim për cenueshmërinë e ujit të freskët në mënyrë që identifikohen rreziqet potenciale, dhe njëherit t'iu sigurohet vendimmarrësve një sinjalizim i paralajmërimit të hershëm për nevojën e monitorimit të ndryshimeve të mundshme përgjatë kohës. Kjo është shumë me rëndësi për të zbuluar praninë e rreziqeve sa më herët, për të pasur mundësi që të hartohen dhe zbatohen masat përkatëse për zvogëlimin e ndikimeve negative. Për më tepër, vlerësimi ngritë ndërgjegjësimin publik për rrezikun me të cilin mund të përballet e tërë shoqëria.

- Për t'iu përgjigjur si duhet sfidave të ndryshimeve klimatike, Kosova duhet të hartojë me urgjencë dokumente të reja të politikave dhe/ose të ndryshojë kornizën ekzistuese të politikave për t'i integruar masave e zbutjes dhe përshtatjes të ndryshimeve klimatike brenda kuadrit ligjor dhe strategjisë së përgjithshme të zhvillimit kombëtar. Hartimi i dokumenteve të reja të politikave dhe/ose ndryshimini i kornizës ekzistuese së politikave duhet të bazohet në një hulumtim gjithëpërfshirës shkencor të vlerësimit të ndikimeve të mundshme të ndryshimeve klimatike në burimet e ujit në të katër pellgjet e lumenjve në Kosovë. Rekomonadohet që në strategjinë e ujit dhe planet për menaxhimin e pellgjeve të lumenjve, sipas kuadrit ligjor për menaxhimin e burimeve ujore të integrohen çështjet e në vijim:
- Rregullorja për trajtimin e ujërave të zeza, rikultivimin dhe ripërdorimin e ujit, duke përfshirë këtu edhe pakot stimuluese për rikultivimin dhe ripërdorimin e ujit.
- Rregullorja për menaxhimin e ujërave nëntokësorë, rimbushjen e ujëmbajtësve të ujërave nëntokësorë, kufizimin e detyrueshem të tërheqjes së ujërave nëntokësore dhe monitorimin e ujërave nëntokësorë.
- Programi për menaxhimin e rrezikut, duke përfshirë mbrojtjen nga përmbytjet dhe identifikimin e zonave me rrezik nga përmbytjet.

- Programi për menaxhimin e thatësirave, ndarjes së ujit dhe prioritizimit të kategorive të konsumatorëve në situata të thatësirave.
- Rregullorja për nxitjen e mbledhjes së ujit nga shiu. Programe stimuluese për mbledhjen e ujit nga shiu.

3.2.2. Bujqësia, pylltaria, biodiversiteti dhe planifikimi i përdorimit të tokës

Kosova është në procesin e ristrukturimit të sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë me synim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke u bazuar në standardet mjedisore evropiane, veçanërisht në legjislacion. Qeveria e Kosovës po mbështet një qasje të integruar me synimi që të gjejë një ekuilibër mes zhvillimeve ekonomike, mbrojtjes së mjedisit dhe të përdorimit të tokës.
Kosova ka trashëguar shumë probleme mjedisore të cilat janë akumuluara përgjatë dekadave, dhe po ndikojnë në shfrytëzimin e pakontrolluar të resurseve natyrore, në dendësinë e lartë të popullsisë, ndërtimin e pakontrolluar në toka bujqësore, shfrytëzimin e pakontrolluar dhe prerjen ilegale të pyjeve, aktivitetet ekonomike dhe industriale, duke përfshirë minierat dhe industrinë e përpunimit, e që të gjitha po ndikojnë në mjedis. Përveç të gjithë këtyre faktorëve të cilët ndikojnë në bujqësi, pylltari dhe përdorim të tokës, ndryshimi i klimës e shton ndërlikimin ekzistues drejt realizimit të zhvillimit të drejtë socio-ekonomik.

Korniza ligjore për sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës pothuajse është kompletuar dhe përafruar në një shkallë të madhe me legjislacionin përkatëse të BE-së, ndonëse zbatimi i ligjeve është ende i dobët.

Sipas anketimit për ekonomitë shtëpiake bujqësore në vitin 2012 llogaritet se rreth 378,768 ha janë tokë e përgjithshme dhe 277,364 ha (73 %) janë tokë bujqësore. 41 % e tërë kësaj sipërfaqeje shfrytëzohet si tokë e punueshme dhe 26.0 % për livadhe dhe kullota ndërsa 5 % e tokave bujqësore – përqindje e cila po pëson rënie – janë lënë djerrina. Përdorimi i pemishteve ka shënuar rritje gjatë periudhës 2009-2012 për 10.1%. Gjithashtu, sipërfaqet e përdorura për kultura bujqësore, vreshta dhe serra janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit.

Prodhimi blegtoral ka rëndësi të lartë ekonomike dhe është sektor fitimprurës bujqësor që gjithashtu promovon sektorë të tjerë bujqësorë siç janë prodhimi i bimëve, industria e përpunimit, etj. Vlerësohet se rreth 94,000 ferma bujqësore (52 % të gjithsej numrit të fermave) janë aktive në prodhim blegtoral. Shumica e prodhimit blegtoral bëhet përgjithësisht në ekonomi familjare rurale. Fermat gjysmëkomerciale dhe komerciale kanë prodhim më intensiv blegtoral me raca më cilësore të kafshëve.

Bujqësia dikur përbënte 25% të BPV në vitet e 1980-ta dhe fillim të 1990-ta, ndërsa tani rreth 14.1% të BPV-së (burimi: të dhëna nga ASK nga 2011). Bujqësia përbën rreth 35% të gjithsej punësimit (Pasqyrë e Shtetit, prill 2013, Raport i BB-së). Sektori bujqësor gjithashtu përbën 16% të gjithsej vlerës së eksportit dhe mbetet sektor i rëndësishëm ekonomik dhe krijues i BPV-së.

Për sa i përket pylltarisë, 42,7% të sipërfaqes tokësore të Kosovës është e mbuluar me pyje dhe toka pyjore (464,800 ha), nga të cilat 60% janë pyje në pronësi shtetërore (278,880 ha) dhe 40% janë pyje private (185,920 ha) (Burimi: Strategjia për Zhvillimin e Pyjeve 2010-2020). Mbulimi

pyjor në Kosovë është më i madh sesa në shtetet fqinje (Shqipëri 28%, Maqedoni 39%, Mal i Zi 40% dhe Serbi 31%); megjithatë, cilësia dhe produktiviteti i pyjeve ekzistuese janë shkak për shqetësim. Në veçanti në terrenet e rrëpirëta malore ka sinjale alarmante të shkretëzimit për shkak të erozionit të rëndë të tokës (Burimi: Mbështetje për zbatimin e Politikës dhe Strategjisë së Pyjeve në Kosovë GCP/KOS/005/FIN):

- 32.200 ha konsiderohen si pyje "pa pemë";
- 171.200 ha janë pyje të krijuara përmes mbjelljes natyrore, të kategorizuara si pyje të larta (h > 16 m);
- 115.800 ha kategorizohen si pyje të ulëta (të krijuara nga kërcejtë), që dominojnë pjesën qendrore të Kosovës;
- 21.200 ha quhen pyje të ulëta me standardet (pyje të ulëta me prani të pemëve me lartësi);
- 2.200 ha janë pyje të krijuara përmes pyllëzimit.

Janë rreth 120.000 pronarë të pyjeve private në Kosovë, të cilët menaxhojnë pyjet e tyre në sistemin tradicional dhe zakonisht nuk mbjellin pemë të reja. Ata mbështeten në mbjelljen natyrore për rigjenerimin e pyjeve të tyre, që thuhet se rigjenerohet me bollëk, dhe aplikojnë rimbjellje vetëm në disa raste të jashtëzakonshme. Vlerësohet se e tërë sipërfaqja e rimbjellë në pyje private nuk i tejkalon 30 ha/vit në tërë Kosovën. Madhësia mesatare e një pasurie private të pyjeve është 2 ha, e shpërndarë në disa parcela dhe zakonisht plotësohet nga kullota dhe toka bujqësore. Objektivat e menaxhimit të shumicës së pronarëve të pyjeve janë prodhimi i drunjëve të zjarrit për qëllime të mbijetesës, rritja e stokut, dhe mbrojtja e tokës nga erozioni. Shumë pak pronarë të pyjeve janë të gatshëm të shndërrojnë pyjet e tyre të ulëta në pyje të larta. Shumica e pronarëve të pyjeve private nuk kanë plane të menaxhimit.

Për sa i përket biodiversitetit, Kosova edhe pse me sipërfaqen relativisht të vogël është e pasur me specie bimore. Ekzistojnë 13 lloje të bimëve që rriten vetëm në Kosovë dhe rreth 200 specie që rriten në Ballkan. Numri i përgjithshëm i specieve bimore është më i madh se në disa vende evropiane. Ky diversitet është rezultat i aktiviteteve komplekse të faktorëve fizikë, si toka dhe klima të cilat krijojnë diversitet të habitateve dhe kushte për rritjen e bimëve. Në territorin e Kosovës janë rreth 24 specie të bimëve të rrezikuara si rezultat i aktiviteteve njerëzore. Këto janë kryesisht të përqendruara në zonat malore por edhe në zonat fushore.

Ekzistojnë rreth 46 specie gjitarësh në Kosovë – shumica prej tyre me rëndësi rajonale dhe globale. Disa specie të shpezëve ujore janë humbur si pasojë e shkatërrimit të ligatinave, ndotjes dhe degradimit të lumenjve. Gjuetia ishte shumë intensive gjatë 1990-ve, dhe tani raportohet për një reduktim të gjuetisë së paligjshme. Gjuetia e paligjshme ka rezultuar në rritje të popullatës të kafshëve të rrezikuara. Pjesa më e madhe e pasurisë së biodiversitetit të bimëve tokësore dhe kafshëve është në malet e larta në jug dhe perëndim të Kosovës. Biodiversiteti i ekosistemeve ujore ka rënë ndjeshëm, sidomos për sa i përket specieve të peshkut si rezultat i ndotjes së ujërave dhe degradimit të shtratit të lumenjve (Burimi: Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011 – 2020).

Pjesa më e madhe e tokës në Kosovë, rreth 94% të sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës, është tokë bujqësore dhe pyjore, ndërsa vetëm 5-6% e tokës përdoret për ndërtim. Nga gjithsej tokat bujqësore rreth 90% janë prona private. Në bazë të vlerësimeve të MBPZHR-së, çdo vit rreth 400 ha ndryshojnë destinimin e përdorimit nga toka bujqësore në toka ndërtimore. Një nga

zhvillimet kryesore është ndërtimi i pakontrolluar, si pasojë e mungesës së planeve zhvillimore urbane dhe komunale, si dhe zbatimit të dobët të legjislacionit për mbrojtjen e tokave bujqësore. Faktorët e tjerë përfshijnë: 1) humbja/degradimi i sipërfaqeve bujqësore, b) shpyllëzimi, c) gurthyesit dhe reparacionet, c) deponitë.

3.2.3. Shëndeti publik

Ndikimi në shëndetin njerëzor është një nga ndikimet më domethanëse i ndryshimeve klimatike, por në të njëjtën kohë shëndeti mund të jetë shtytje pozitive për agjendën klimatike dhe një mjet për të angazhuar masën e gjerë për të gjetë zgjidhjet. Është e njohur se përgjegjësia për mbrojtjen e jetëve dhe mirëqenies i takon sektorit të shëndetësisë. Prandaj, investimi në mbrojtjen shëndetësore dhe në përshtatje mund të shpëtojë jetët si dhe të rritë qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike. Pra, mbrojtja dhe avancimi i shëndetësisë është shtyllë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm, dhe reagim ndaj ndryshimeve klimatike. Një qasje më e integruar dhe ndërsektoriale për përmirësimin e rezistencës shëndetësore, nxitjes së rritjes në favor të të varfërve, dhe mbrojtjes së mjedisit, do të duhej të përmirësonte koherencën e politikave dhe të rrisë efikasitetin.

3.3. Qeverisja e përshtatjes klimatik: sfidat për Kosovën

Qeverisja – funksionimi i rregullave, instrumenteve dhe organizimeve që rreshtojnë sjelljen e palëve të interesuara dhe rezultatet aktuale me objektivat e politikave – duhet t'i përgjigjet këtyre problemeve serioze. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike kërkon qasje të përshtatjes në menaxhimin e resurseve (p.sh. ujit, bujqësisë, pylltarisë), me implikime për organizimin institucional, proceset e pjesëmarrjes, aranzhimet për zgjedhje kolektive, si dhe mënyrat e vlerësimit të së ardhmes. Në shumë raste, një qeverisje e re, më efektive është e domosdoshëme për t'iu përgjigjur sfidave të përshkruara. Në pjesën në vijim ofrohet një përmbledhje e sfidave kryesore që kanë të bëjnë me qeverisjen e përshtatjes klimatike në Kosovë.

Qeverisja duhet të përshtatet me rrethanat dhe kapacitetet, të jetë e përshtatur sipas madhësisë dhe natyrës së problemit si dhe ndaj objektivit të synuar. Sfida është më e madhe për shkak të specifikave të zonave të prekura nga ndryshimet klimatike, duke pasur parasysh se secila zonë ka karakteristikat e saja fizike, gjeografike dhe socio-ekonomike. Qeverisja gjithashtu duhet t'i përshtatet gjendjes së zhvillimit dhe problemeve të krijuara nga nga të drejtat dhe sjellja në të kaluarën. Në disa raste, problemi shterimi i resurseve ujore, në raste të tjera praktikat bujqësore janë joefikase, apo të mbjellat janë të cenueshme ndaj thatësirave dhe si pasojë mund të rrezikojnë sigurinë e ushqimit, ndërsa në raste të tjera sfidë mund të jenë problemet lidhur me prerjen e paligjshme të drunjëve, shpyllëzimi, speciet e pemëve dhe praktikat e pylltarisë të cenueshme ndaj stuhive dhe zjarreve. Zakonisht, këto probleme nuk paraqiten të izoluara, por të kombinuara në të njëjtën kohë. të gjitha këto tipare duhet të merren parasysh në vlerësimin e opsioneve të qeverisjes, të cilat duhet të përshtatjen me rrethanat dhe kapacitetin, si dhe të jenë adekuate për problemin në fjalë dhe për objektivat e synuara të veprimeve.

Ndryshimet klimatike ndikojnë në sektorë të ndryshëm dhe si pasojë duhet të integrohen me disa strategji të tjera sektoriale. Megjithatë, ende nuk ka mekanizma për bashkërendimin e strategjive në kërkim për të integruar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Kosova paraqet shumë shembuj të sektorëve me interesa konkurruese, si bujqësia, industria, furnizimi shtëpiak me ujë, shëndetësia dhe rrjedhat minimale për mbajtjen e ekosistemeve. Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të menaxhimit shpeshherë mbetet problematik për shkak të bashkëpunimit të dobët midis ministrive të ndryshme, bashkëpunim të dobët midis kufijve administrativë, si dhe mbrojtjes së interesave vetjake të individëve të rëndësishëm në qeveri, industri apo botën shkencore. Kështu, procesi i formulimit të planeve të veprimit të përshtatjes klimatike duhet të përfshijë jo vetëm përfaqësues të sektorëve të ndryshëm që varen drejtpërdrejti në burimet ujore (si bujqësia ose industria), por edhe sektorëve që në mënyrë indirekte kanë ndikim në burimet ujore (si zhvillimi urban dhe planifikimin rural). Një sfidë e madhe për qeverisjen e përshtatjes klimatik është bashkëpunimi ndërsektorial. Nëse do të ketë sukses, bashkëpunimi mes fushave të politikës dhe sektorëve ofron mundësi të jashtëzakonshme në drejtim të efikasitetit të kostove.

Delegimi në strukturat e pushtetit lokal mund të prodhojë rezultate të mira dhe duhet të aplikohet një kornizë për nxitjen e subsidiaritetit, në pajtim me disa direktiva të BE-së. Në parim, subsidiariteti (do të thotë, delegimi i menaxhimit në nivelin më të ulët) është atraktiv sepse është më së afërmi vendimmarrësve në terren: bujqve, ekonomive familjare, kompanive dhe përdoruesve të ujit në përgjithësi. Në disa raste, qasjet e menaxhimit kolektiv në nivel lokal kanë dëshmuar rezultate të mira, shpeshherë në partneritet ndërmjet palëve të interesit dhe agjencive apo projekteve lokale publike. Në Kosovë, kompanitë rajonale të ujësjellësit dhe komunat bashkërisht përfaqësohen në Bordin e Drejtorëve.

Informatat, ndarja e njohurive dhe komunikimi janë të pamjaftueshme për të mbështetur menaxhimin apo për të nxitur qeverisje të mirë. Edhe aty ku ka informata, asimetria e tyre shpeshherë pengon këmbimin ndërmjet palëve të ndryshme të interesit. Për shembull, informatat zakonisht nuk janë në format që mund të qaset lehtësisht nga vendimmarrësit apo masa e gjerë. Në rastet ku janë në dispozicion informatat relevante, shpeshherë ka këmbim joefektiv të atyre informatave ndërmjet palëve. Ndonëse informatat bazike për hidrogjeologjinë apo resurset ujore përgjithësisht janë në dispozicion, ajo janë shpesh të pamjaftueshme për planifikim dhe menaxhim të hollësishëm. Për shembull, në Kosovë nuk ka monitorim të ujërave nëntokësore, prandaj dhe nuk ka të dhëna në dispozicion për cilësinë he sasinë.

Përmirësimi i qasjes së "planifikimit pjesëmarrës" që integron tw dhwnat nga masa e gjerë dhe palëve të interesit në vendimmarrje. Dëshmitë empirike sugjerojnë se pjesëmarrja dhe menaxhimi lokal kolektiv mund të jenë qasje efektive në qeverisjen e mirë. Pjesëmarrja duket të jetë efektive në përmirësimin e rezultateve sepse rritë pronësinë e palëve të interesit dhe sepse palët e interesit shpeshherë kanë qasje në informata dhe mund të sajojnë zgjidhje më të mira apo plotësuese ndaj atyre të siguruara nga lartë poshtë. Ndoshta aspekti më i rëndësishëm i pjesëmarrjes është se mund t'i bashkërendisë objektivat e qeverisë me ato të banorëve lokalë. Kjo u jep palëve lokale të interesit stimulim për menaxhimin më të mirë të resurseve natyrore dhe mjedisit, dhe mund t'i fuqizojë ata duke iu ofruar më shumë ndikim mbi rezultatet gjatë procesit të zbatimit.

Ka rrezik që qasjet pjesëmarrëse mund t'i pasqyrojnë pabarazitë ekzistuese. Palët më të fuqishme të interesit mund të dominojnë në diskutimet pjesëmarrëse apo të mos marrin pjesë fare. Një aspekt tjetër në këtë asimetri të pushtetit është se shumica e njerëzve nuk janë

'pronarë' të çdo toke dhe/ose uji, por megjithatë janë palë të interesit. Mënyrat për të përfshirë dhe fuqizuar këta njerëz janë shpeshherë të vështira për t'u negociuar, sidomos kur ka pengesa sociale apo kulturore. Një sfidë po aq e vështirë është se si të sigurohet pjesëmarrja e atyre që nuk janë përfitues të drejtpërdrejt të resurseve, por që mund të jenë ndotës, ose janë të cenueshëm ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Prandaj, Strategjia e Kosovës rekomandon që të përfshihet një përfaqësim i gjerë i palëve të interesit gjatë zbatimit të strategjisë, duke përfshirë personat që edhe drejtpërdrejtë edhe tërthorazi përfitojnë nga strategjia e propozuar.

Përvoja jep disa anë të mira dhe këqija: të ndërtohet në kapitalin ekzistues shoqëror, të promovohet barazia dhe përfshirja, të fillohet në fushat me potencial të mirë, të shkohet hap pas hapi, dhe të nxjerren mësime dhe të përshtatemi. Siç duket kostot janë më të ulëta dhe rezultatet më të mira nëse qasja pjesëmarrëse ndërtohet në kapitalin ekzistues shoqëror, dhe për të marrë maksimumin intervenimet duhet të përshtaten. Parimet e kapitalit dhe drejtësisë shoqërore kërkojnë që të dëgjohen edhe zërat e atyre që janë më pak të fuqishëm. Kjo mund të përkrahet nga agjencitë publike. Intervenimet mund të fillojnë në zonat me potencial për sukses dhe aty ku kostot e intervenimit janë më të ulëta, me pritje se do të përsëriten vetvetiu.

Përshtatja e strukturës së masave stimuluese është mekanizëm i mundshëm për të mbështetur përshtatjen klimatike në nivel lokal, por përshtatjet janë politikisht të vështira dhe mund të kenë pasoja negative apo të pamenduara. **Stimulimet pozitive dhe negative** janë përcaktues shumë të fuqishëm të sjelljes dhe, në rastin e përshtatjes klimatike, qeveritë zakonisht janë në gjendje t'i përshtatin lehtësisht. Prandaj, ato janë mekanizma atraktivë, posaçërisht në një fushë me kapacitet të kufizuar administrativ. Opsionet përfshijnë përshtatjen e çmimeve të të dhënave si energjia apo çmimet e prodhimit si produktet bujqësore; duke ofruar subvencione për të nxitur sjellje specifike; apo futjen e ndalesave në kultura bujqësore apo në metoda të ujitjes, për shembull. Megjithatë, të gjitha këto qasja kanë mangësi të mëdha. Përshtatja e çmimeve shpeshherë prodhon pasoja të pamenduara dhe mund të ketë dëme politike. Subvencionet janë të shtrenjta dhe hapin mundësi për korrupsion. Ndalesat shpeshherë janë në kundërshtim me efikasitetin ekonomik.

3.4. Aktivitetet e qeverisë dhe legjislacioni që ka për synim trajtimin e ndryshimeve klimatike

Kjo pjesë ofron një përmbledhje të aktiviteteve dhe ligjeve kryesore ekzistuese dhe të planifikuara (financuara) të qeverisë që kanë për synim trajtimin e ndryshimeve klimatike.

Në nivel ndërkombëtar:

Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2011 i UNDP jep dëshmi tronditëse se jemi duke e arritur një nivel të sipërm të kapacitetit tonë për emetimin e gazrave serrë pa pasoja të rënda. Është vlerësuar se stabilizimi i përqendrimeve të gazrave serrë në atmosferë në një nivel që parandalon ndryshim katastrofik klimatik do të kërkojë reduktim të emetimeve të gazrave serrë për 50% deri më 2050, krahasuar me nivelet e 1990.

Trajtimi i ndryshimeve klimatike kërkon dy lloje të reagimeve. Së pari, dhe më së rëndësishmi, duhet të ulim emetimet tona të gazrave serrë (GS) (d.m.th. të ndërmarrim veprime të **zbutjes**) dhe së dyti duhet të marrim veprime të **përshtatjes** për t'i trajtuar ndikimet e pashmangshme. Legjislacioni për të cilin kohëve të fundit BE-ja ka rënë dakord për ndryshimin klimatik kërkon

masa konkrete për përmbushjen e zotimit të BE-së për zvogëlimin e emetimeve në 20% krahasuar me nivelet e 1990 deri më 2020, dhe lë mundësinë që të ndryshohet për të siguruar një zvogëlim prej 30% nëse ka pajtim si pjesë e një marrëveshjeje ndërkombëtare në të cilën shtetet tjera të zhvilluara pajtohen në zvogëlime të krahasueshme dhe kontribute të duhura nga shtetet në zhvillim që janë ekonomikisht më të avancuara, bazuar në përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre. Megjithatë, edhe nëse bota ka sukses në kufizimin dhe pastaj uljen e emetimeve të gazrave serrë, planetit tonë do t'i duhet kohë për t'u rimëkëmbur nga gazrat serrë që tanimë janë në atmosferë. Prandaj, do të përballemi me ndikimin e ndryshmeve klimatike së paku edhe për 50 vitet e ardhshme. Prandaj duhet të ndërmarrim hapa për përshtatje.

Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik (UNFCCC), Protokolli i Kijotos (PK) në kuadër të Konventave dhe vendimet e tyre pasuese, si dhe politika e BE-së për këtë fushë, mbështesin shtetet në zhvillim dhe shtetet me ekonomi në tranzicion në përpjekjet e tyre për të vazhduar me rritje ekonomike me sa më pak pengesa konkurruese, gjersa në të njëjtën kohë të ulet rritja e emetimeve dhe të përshtaten ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Në Planin e Veprimit të Balit (2007), shtetet në zhvillim janë pajtuar për herë të parë që të hartojnë dhe zbatojnë Veprime të duhura kombëtare për zbutje (VAKZ) në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm, mbështetur dhe mundësuar me teknologji, financim dhe ngritje të kapaciteteve. Konferenca e 15 e Palëve" (KeP) e mbajtur në Kopenhagë në dhjetor 2009, ka nxjerrë Marrëveshjen e Kopenhagës (MK) – një deklaratë politike e cila pajtohet me kufizimin e ndryshimeve klimatike në jo më shumë se 2°C mbi nivelet paraindustriale në kontekst të ekuitetit dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe riafirmon aspektet zhvillimore të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë strategjitë e zhvillimit me emetim të ulët. Konferencat në Kankun dhe në Durban kanë siguruar më shumë hollësi në këtë kuptim.

Janë marrë shumë hapa në zhvillimin e regjimit të përshtatjes në kuadër të UNFCCC, si dhe shumë aktivitete janë mandatuar për zbatimin e Konventës. Dy pika të rëndësishme të arritjes për Kosovën janë cekur në vijim, por të cilat duhet njohur në kontekst të shumë hapave të tjerë të rëndësishëm që janë ndërmarrë në procesin paraprak për realizimin e këtyre pikave të arritjes.

- **Programi i Punës Najrobi (NWP)**: Më 2006, në KeP 12 në Najrobi, Organi Subsidiar për Këshilla Shkencore dhe Teknologjike (SBSTA) është mandatuar që të realizojë një projekt pesëvjeçar për të trajtuar ndikimet, cenueshmërinë dhe përshtatjen në lidhje me ndryshimin klimatik – Programi i Punës Najrobi. Aktivitetet në kuadër të NWP janë në vazhdim e sipër.
- **Korniza e Përshtatjes Kankun (CAF):** Më 2010, në KeP 16 në Kankun, është përcaktuar Korniza e Përshtatjes Kankun (CAF). Aktivitetet në kuadër të CAF kanë të bëjnë me pesë klasterët në vijim: Zbatimi, duke përfshirë një proces për t'i mundësuar palët e LDS që të formulojnë dhe zbatojnë plane kombëtare të përshtatjes (PNV), dhe programin e punës për t'i marrë parasysh qasjet për trajtimin e humbjeve dhe dëmeve; mbështetja; institucionet, duke përfshirë themelimin e një Komisioni të Përshtatjes në nivel global, si dhe aranzhimet rajonale dhe kombëtare; parimet; dhe angazhimi i palëve të interesit. Aktivitetet në kuadër të CAF janë në vazhdim e sipër për të mundësuar operacionalizim të plotë.

Procesi i Planit nacional të përshtatjes (PNA) është krijuar në kuadër të Kornizës së Përshtatjes Kankun (CAF). Ai mundëson Palët që të formulojnë dhe zbatojnë plane kombëtare të veprimit

(PNA) si masë për identifikimin e nevojave afatmesme dhe afatgjate të përshtatjes dhe hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve për trajtimin e këtyre nevojave.

Krahas mandatave nga UNFCCC, tani ka menate të fuqishme politike nga organet ndërkombëtare për shëndetësi, përmes rezolutës së Asamblesë Botërore të Shëndetësisë 2008 (WHA61.19[37]) për ndryshimet klimatike dhe shëndetin, dhe zotimeve ekuivalente në nivel rajonal evropian (Korniza Rajonale Evropiane për Veprim është mirëpritur në Deklaratën e Parmës për Mjedis dhe Shëndetësi 2010[38]). Këto mandate politike gjithashtu mbështeten me avancime në udhëzimet teknike dhe projektet e përshtatjes shëndetësor.

Palët kanë miratuar Kornizën e Përshtatjes Kankun (CAF) si pjesë të Marrëveshjes së Kankunit në Konferencën për Ndryshimin Klimatik në Kankun, Meksikë (KeP 16/CMP 6). Në marrëveshje, palët kanë konfirmuar se **përshtatja duhet të trajtohet me të njëjtin nivel të prioritetit sikurse edhe zbutja**. CAF është rezultat i tri viteve të negociatave për përshtatjen në kuadër të AWG-LCA që ka vijuar miratimin e Planit të Veprimit Bali në Konferencën për Ndryshimin Klimatik Bali 2007 në Bali, Indonezi (KeP 13/ CMP 3).

Objektivi i **Kornizës së Përshtatjes Kankun** (paragrafët 11-35) është që të shtohen veprimet për zbutje, duke përfshirë përmes bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shqyrtimit koherent të çështjeve që kanë të bëjnë me përshtatjen në kuadër të Konventës. Përfundimisht, veprimet e shtuara kërkojnë uljen e cenueshmërisë dhe ngritjen e qëndrueshmërisë së palëve shtetërore në zhvillim, duke marrë parasysh nevojat urgjente dhe të menjëhershme të këtyre shteteve në zhvillim të cilat janë veçanërisht të cenueshme. Në Konferencën për Ndryshimet Klimatike në Durban në nëntor/dhjetor 2011, Palët kanë arritur avancim të ndjeshëm në zbatimin e Kornizës.

Në nivel të BE-së:

Në prill të vitit 2009 Komisioni Evropian ka prezantuar një dokument politikash të njohur si Libri i Bardhë i cili paraqet kornizën për masat dhe politikat e përshtatjes për zvogëlimin e cenueshmërisë së BE-së ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Kjo kornizë përqendrohet në fushat kyçe në vijim:

- Ndërtimi i një baze më të fuqishme të njohurisë meqë të dhënat e sigurta janë jetike në hartimin e politikave klimatike
- Marrja parasysh e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në politikat kyçe të BE-së
- Financimi i masave të politikave të ndryshimeve klimatike
- Mbështetja e përpjekjeve të gjera ndërkombëtare për përshtatje duke ndihmuar për shembull shtetet jo anëtare të BE-së në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe kapacitetit të tyre për t'u përshtatur me ndryshimin klimatik.

Nga 21 maj deri 20 gusht 2012, BE ka realizuar një proces konsultimesh për Përgatitjen e Strategjisë së Përshtatjes të BE-së. Ky konsultim mëtonte grumbullimin e opinioneve nga palë të interesit dhe ekspertë në fushën e përshtatjes në ndryshimin klimatik me synim të marrjes së informatave shtesë për përgatitjen e Strategjisë së Përshtatjes të BE-së.

[37] http://www.who.int/globalchange/A61_R19_en.pdf
[38] http://www.euro.who.int/en/what-we-do/health-topics/environment-and-health/Climate - change/publications/2010/protecting-health-in-an-environment-challenged-by-climate-change-european-regional-framework-for-action

Strategjia e Përshtatjes të BE-së është miratuar më 16 prill 2013 (http://ec.europa.eu/clima/policies/adaptation/what/index_en.ht)

Për të lehtësuar zbatimin e shtyllës së parë të Librit të Bardhë, në mars 2012 ueb-platforma Climate-ADAPT (Platforma Evropiane për Përshtatje Klimatik) është vënë në dispozicion publik. kjo platformë iu mundëson përdoruesve informata në fushat në vijim:

- Ndryshimi i pritur klimatik në Evropë;
- Cenueshmëria aktuale dhe e ardhshme e rajoneve dhe sektorëve;
- Strategjitë kombëtare dhe transnacionale të përshtatjes;
- Rastet studimore të përshtatjes dhe opsionet e mundshme të përshtatjes;
- Integrimi në nivel evropian;
- Mjetet që mbështesin planifikimin e përshtatjes;
- Profilet e projekteve hulumtuese që lidhen me përshtatjen, dokumentet udhëzuese (p.sh. për menaxhimin e pasigurisë), raportet, burimet shtesë të informatave, vegëzat dhe lajmërimet e ngjarjeve.

Pakoja e strategjisë së përshtatjes të BE-së[39]:

- 30/07/2013 - SWD (2013) 299 - Parimet dhe rekomandimet për integrimin e konsideratave të përshtatjes të ndryshimeve klimatike në kuadër të programeve operacionale të Fondit Evropian të Detarisë dhe Peshkatarisë 2014-2020 (179 kB)
- 18/06/2013 – Konkluzat e Këshillit për Strategjinë e Përshtatjes të BE-së
- 16/04/2013 - COM (2013) 216 – Strategjia e BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0216:FIN:EN:PDF
- 16/04/2013 - SWD (2013) 131 – Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit http://ec.europa.eu/smart-regulation/impact/ia_carried_out/docs/ia_2013/swd_2013_0131_en.pdf
- 16/04/2013 - SWD (2013) 132 – Vlerësimi i Ndikimit Pjesa 1 (716 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 132 - Vlerësimi i Ndikimit Pjesa 2 (2.27 Mb)
- 16/04/2013 - COM (2013) 213 – Libri i Gjelbër për sigurimin e fatkeqësive natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2013:0213:FIN:EN:PDF
- 16/04/2013 - SWD (2013) 133 – Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, çështjet bregdetare dhe detare (448 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 136 - Përshtatja ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe bimëve (354 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 137 – Përshtatja i infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike (494 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 138 – Ndryshimet klimatike, degradimi mjedisor dhe shtegtimi migrimi (286 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 135 – Udhëzime teknike për integrimin e përshtatjes të ndryshimeve klimatike në programet dhe investimet e Politikës së Kohezionit (228 kB)

[39] http://ec.europa.eu/clima/policies/adaptation/what/documentation_en.htm

- 16/04/2013 - SWD (2013) 139 - Parimet dhe rekomandimet për integrimin e konsideratave të përshtatjes të ndryshimeve klimatike në kuadër të programeve të zhvillimit rural 2014-2020 (204 kB)
- 16/04/2013 - SWD (2013) 134 – Udhëzimet për hartimin e strategjive të përshtatjes (697 kB)

Në nivel kombëtar:

Si rezultat i çështjeve që kanë të bëjnë me statusin e saj, Kosova ende nuk është pranuar nga Institucionet e Kombeve të Bashkuara. Rrjedhimisht, ajo nuk mund të jetë palë në konventat ndërkombëtare dhe mund të merr pjesë në negociata vetëm si vëzhguese. Megjithatë, përputhshmëria me ligjet ndërkombëtare, duke përfshirë Marrëveshjet Shumëkombëshe të Mjedisit vazhdon të jetë shumë e rëndësishme për të ardhmen e Kosovës në strategjinë e saj vendore si dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të saj.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar një sërë ligjesh të rëndësishme të përafruara me acquis communautaire dhe prandaj legjislacioni i Kosovës në masë të madhe veçse është në përputhje me BE-në.

Siç është cekur në Dokumentin e Punës së Stafit të Komisionit "Komunikatë e Komisionit për Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës", Bruksel, 23 tetor, 2012 { SWD(2012) 339 final/2 }: "Kosova nuk është palë e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimin Klimatik. Nuk ka strategji për ndryshim klimatik, plan të veprimit, caqe të zbutjes për të gjitha ekonomitë, apo politika dhe masa për ndryshimin klimatik". Deklarata në këtë dokument thekson nevojën që Kosova të bëjë përpjekje serioze për të siguruar veprime konkrete në këtë drejtim.

Autoriteti përgjegjës për politikat për mjedis dhe klimë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjersa Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit monitoron gjendjen e mjedisit.

Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka nisur konsultimet me sekretariatet të disa konventave dhe ka filluar me përgatitjet e dokumentacionit për ratifikimin e Konventave. Në muajin prill 2009, Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka organizuar një Konferencë Ndërkombëtare për Ndryshimet Klimatike, ku janë paraqitur përvojat e vendeve të ndryshme që janë palë të UNFCCC (Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin Klimatik).

Vlerësimi pas fatkeqësive[40]

Departamenti për Menaxhimin e Emergjencave (DME) në kuadër të Ministrisë së Brendshme është zyrtarisht përgjegjës për koordinimin dhe/ose realizimin e vlerësimeve të dëmeve. Megjithatë, nuk ka asnjë metodë të parapërcaktuar /aranzhuar dhe procedura për grumbullimin e informatave, ruajtjen dhe përditësimin periodik të të dhënave historike të fatkeqësive në Kosovë. Grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave për çdo katastrofë bëhet në baza aty për aty (*ad hok)*. Për shembull, pas zjarreve të pyjeve të vitit 2007, një Komision Ndërministror ka caktuar Ministrinë e Bujqësisë që të kryej grumbullimin dhe vlerësimin e të dhënave. Kjo është bërë sipas praktikave të kësaj ministrie. Përfundimisht, të gjitha të dhënat janë bartur në Qendrën e Situatave (QKS) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ku ato janë ruajtur dhe arkivuar. Analiza dhe raporti post-veprimit janë kryer më vonë.

[40] UNDP/OBM, 2011. Vlerësimi i Nevojave për Përfitim nga IPA (sipas përkufizimit të RKSOKB 1244/99)

Vlerësimi i rrezikut[41]

AME ka për detyrë koordinimin dhe përgatitjen e vlerësimeve të rrezikut për fatkeqësitë natyrore dhe ato të shkaktuara nga njeriu. Në vitin 2009 është bërë Vlerësimi i Rrezikut për Kosovën duke mbuluar të gjitha rreziqet e mundshme për popullatën e Kosovës dhe që mëtonte të përcaktojë nivelin e pritshëm të dëmeve. Vlerësimi kryesisht përqendrohet në rreziqet dhe dobësitë strukturore, meqë AME dhe organizatat e tjera kanë pak ekspertizë në analizimin e cenueshmërisë socio-ekonomike dhe vlerësimin e kapaciteteve. Përveç hartave të rrezikshme, të dhëna e tjera relevante në dispozicion përfshijnë hartat rrugore, hekurudhore dhe të infrastrukturës së energjisë elektrike, si dhe të shpërndarjes së popullsisë. Megjithatë, deri më tani, nuk ka në dispozicion të dhëna të cenueshmërisë së ndryshimeve klimatike për Kosovën (Burimi: Portali i Njohurisë së Ndryshimeve klimatike, Grupi i Bankës Botërore, 2013)

Në nivel të komunitetit, komunat posedojnë pak apo fare kapacitet të vlerësimit. Kryqi i Kuq i Kosovës është duke punuar me komunat për fuqizimin e kësaj fushe dhe po kërkon të sigurojë financim për të kryer vlerësime të cenueshmërisë dhe kapacitetit.

Menaxhimi i informatave[42]

AME është zyrtarisht përgjegjës për mirëmbajtjen e një baze të të dhënave të menaxhimit të emergjencave, që përfshin grumbullimin, ruajtjen dhe azhurnimin e informatave. Për këtë qëllim, DEM ka përgatitu një draft metodologji, e cila ende nuk është aprovuar nga Qeveria. Megjithatë, siç është theksuar më lartë në situata të reagimit, shumica e agjencive i përcjellin informatat e tyre Qendrës së Situatave. Nuk është e qartë se në çfarë mënyre i pranon këto informata AME.

Ministria Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor gjithashtu mban një bazë të të dhënave në mbështetje të Planit Hapësinor të Kosovës. Krahas analizave të të dhënave gjeografike, demografike, të varfërisë, tokës dhe mjedisit, ajo përfshin raportet e sektorëve dhe të dhënat për sistemin e arsimit, banimin, bujqësinë, pyjet, zonat rurale, sektorin e energjisë, sektorin e shëndetësisë, infrastrukturën e transportit, hidrologjinë, tregtinë, industrinë, kulturën, teknologjinë e informatave dhe turizmin në Kosovë. Të gjitha këto informata menaxhohen nën mbikëqyrjen e Departamentit të Planifikimit Hapësinor. Duket se nuk ka koordinim apo lidhje ndërmjet kësaj baze të të dhënave dhe atyre të AME-së dhe Qendrës së Situatave.

4. Synimet dhe objektivat

Deklarata e misionit për Strategjinë Kombëtare të Përshtatjes është

- Të zvogëlohen rreziku dhe dëmet nga ndikimet aktual dhe të ardhshme të ndikimit klimatik me kosto-efektive dhe të shfrytëzohen përfitimet e mundshme që dalin nga Ndryshimet klimatike

Bazuar në deklaratën më sipër Strategjia ka objektivat vijues:

[41] *Po aty*

[42] UNDP/OBM, 2011. Vlerësimi i Nevojave për Përfitim nga IPA (sipas përkufizimit të RKSOKB 1244/99)

- **Objektivi i parë i strategjisë kombëtare për përshtatje**: Sjellja e mekanizmave të ri dhe përmirësimi i atyre aktualë për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë, veçanërisht për sektorët me rëndësi ekonomike që janë posaçërisht të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike;;

- **Objektivi i parë i strategjisë kombëtare për përshtatje:** Zgjerimi i kapacitetit[43] të përshtatjes të sistemeve natyrore, në veçanti ekosistemeve të cenueshme, dhe shoqërisë, në veçanti i komuniteteve të cenueshme, siç janë fermerët e varfër, grupet e shoqërisë, në veçanti i komuniteteve të cenueshme, siç janë fermerët e varfër, grupet e margjinalizuara dhe gratë, për trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura me jetën dhe mjetet e jetesës së tyre;;

- **Objektivi i tretë i strategjisë kombëtare për përshtatje:** Ngritja e kapacitetit të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjes në proceset e zhvillimit lokal dhe kombëtar, si dhe fuqizimi i tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike.

5. Alternativat e shqyrtuara: Listimi i masave prioritare të përshtatjes për Strategjinë e Kosovës

Lista në vijim paraqet gjithsej 74 masa të mundshme të përshtatjes me prioritet të lartë apo të mesëm. Masat e mundshme të përshtatjes me prioritet të ulët nuk janë përfshirë. Prandaj, kjo listë siguron hapin e parë dhe shumë të rëndësishëm në **përzgjedhjen e masave të mundshme të përshtatjes për Strategjinë** e Kosovës.

Përveç kësaj, ajo nënvizon komunat ku rezultatet për zbatim dhe/apo planifikim janë ndjeshëm më të larta se në komunat e tjera, në mënyrë që të të identifikohen **praktikat më të mira dhe/apo mësimet e nxjerra.**

Lista prioritare është bazuar në rezultatet e 15 pyetësorëve në nivel lokal[44] dhe raundet e votimit të 12 anëtarëve të Grupit Punues Ndërministror (GPNM) në nivel kombëtar[45]. Prandaj, lista në vijim paraqet prioritetet edhe për nivel qendror edhe lokal, ndonëse gjendja aktuale e zbatimit dhe/apo planifikimit specifikohet vetëm për nivelin lokal.

Prioritetet vijuese janë paraqitur në radhitje **lartë-poshtë,** që lidhet me domosdoshmërinë e cekur nga palët e interesit në nivel qendror dhe atë lokal. Masat me rezultat mesatar më të lartë se 4 (në shkallë nga 1 deri në 5) janë cekur si tejet të nevojshme, prandaj dhe kanë prioritet më të lartë. Masat me notë mesatare ndërmjet 2.5 – 4.0 (në shkallë 1 -5) janë cilësuar si me

[43]Kapaciteti adaptues: aftësia e sistemit për t'u përshtatur ndaj ndryshimit klimatik, për t'i zbutur dëmet potenciale apo për t'i shfrytëzuar përparësitë e mundësive apo për t'u përballur me pasojat (IPCC, 2001).
[44] Pyetësori i anketës lokale është kryer nga 6 qershor deri 10 korrik 2013
[45]Votimi është bërë gjatë Takimit të Dytë në Tryezë të Rrumbullakët më 27 qershor 2013 në Prishtinë nga Grupi Punues Ndërministror për hartimin e SKA

prioritet mesatar, gjersa notat mesatare nën 2.5 janë cilësuar me prioritet të ulët. Ato me prioritet të ulët nuk janë përfshirë në këtë listë.

Për të mbështetur identifikimin e praktikave më të mira potenciale dhe/apo mësimet e nxjerra, masat e përshtatjes të paraqitura në vijim **nënvizojnë komunat** ku notat vlerësuese për zbatimin dhe/apo planifikimin janë ndjeshëm më të larta se në komunat e tjera. Prandaj, meqë zbatimi apo planifikimi është kryer apo është në vazhdim e sipër në këto vende, ato kërkojnë vëmendje specifike për të parë nëse mund të identifikohen dhe mundësisht të trajtohen pengesat dhe/apo mundësitë për përshtatje, mësimet e nxjerra apo praktikat më të mira.

Mbrojtja nga përmbytjet

Prioritet i lartë (>4):

1) Kufizimi i zhvillimit të vendbanimeve/ndërtimeve në zonat e ndjeshme ndaj rrezikut> shih Komunën e Podujevës, Shtimes, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Pejës dhe Gjakovës

2) Thellimi i shtratit veror > shih planifikimin dhe zbatimin në komunat e Podujevës dhe Rahovecit

3) Avancimi dhe/apo ngritja e digave për të parandaluar përmbytjet > shih planifikimin e avancuar në Komunën e Podujevës, dhe një pjesë të zbatimit të planifikimit në Komunat e Istogut dhe Mamushës

4) Rregullimi apo largimi i pengesave hidraulike në shtretër të lumenjve (p.sh. ndërtesa, pemë, infrastrukturë, mbeturina, etj.) > shih zbatimin në komunat e Obiliqit dhe Kaçanikut

5) Ndërtimi i zonave të mbajtjes (gjithashtu të quajtura zona të përmbytjeve për të ulur rrjedhat e përmbytjeve) > shih zbatimin e plotë në Komunën e Klinës, planifikimin e avancuar në Komunën e Rahovecit, dhe një shkallë të planifikimit dhe zbatimit në Komunën e Istogut

6) Avancimi i sistemeve të drenazhit > shih një shkallë të zbatimit dhe planifikimit në Komunën e Istogut dhe zbatimin e plotë në Komunën e Klinës

7) Standardet për zhvillim të ndërtimit (p.sh. sipërfaqet e depërtueshme, gjelbërimi i kulmeve, etj.) > shih Rahovecin

8) Restaurimi i fushave të përmbytura (që përfshin uljen/thellimin e fushave të përmbytura) > shih Komunën e Podujevës dhe Istogut

9) Zonat e shpyllëzuara për zvogëlimin e rrjedhës së përmbytjeve > shih zbatimin në komunën e Obiliqit dhe Kaçanikut.

Prioritet i mesëm (<4):

10) Zëvendësimi i digave për të zgjeruar kapacitetin e shtratit të lumenjve > shih zbatimin në Komunën e Rahovec

11) Ndryshimi i shfrytëzimit të tokës (për të mundësuar mbajtje natyrale të ujërave të përmbytjeve) > shih zbatimin në Rahovec dhe planifikimin në Kaçanik

12) Zgjerimi i rezervuarëve për të rritur kapacitetin mbrojtës > shih planifikimin e avancuar në komunat e Rahovecit dhe Kaçanikut

13) Anashkalimet e lumenjve (gjithashtu përdoren si 'lumenj të gjelbër' kur nuk ka shkarkim të pikut) > shih planifikimin e avancuar në Komunën e Rahovec.

Thatësirat / rrjedhat e ulëta / mungesa e ujit

Prioritet i lartë (>4):

14) Masat e planifikimit të peizazhit për të përmirësuar bilancin ujor (p.sh. Ndryshimi i shfrytëzimit të tokës, shpyllëzimi, zvogëlim i mbylljes së zonave) > shih zbatimin mesatar dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit it, Komunën e Klinës, dhe planifikimin në Komunën e Podujevës

15) Reduktimi i rrjedhjeve > shih zbatimin në Komunën e Rahovecit dhe Klinës, planifikimin e avancuar në Komunën e Shtimes, Rahovecit dhe Klinës, dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Istogut dhe Podujevës

16) Riciklimi dhe ripërdorimi i ujit, p.sh. përdorimi i ujit gri, ujërave të zeza dhe industriale të trajtuara> shih zbatimin në Komunën e Rahovecit dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Shtime dhe planifikimin mesatar në Komunën e Podujevës

17) Konservimi i pikës së përdorimit në ekonomi familjare dhe industri> shih zbatimin në Komunën e Rahovecit dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Shtime dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

18) Transferimet ujore (për më shumë shpjegime shih shtojcën 3)> shih zbatimin fillestar në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës

19) Sigurimi i rrjedhave minimale në periudha të thata > shih zbatimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut, planifikimin e avancuar në Komunën e Kaçanikut dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës dhe Istogut

20) Përshtatja e kulturave bujqësore: Zgjedhja e farave dhe kulturave tejet rezistente (kultura me përdorim më efikas të ujit) > shih për zbatimin dhe planifikimin e mëtejmë në Komunën e Klinës, zbatimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës dhe Istogut

21) Teknologjitë për kursimin e ujit në ujitje > shih për planifikimin mesatar të avancuar dhe zbatimin në Komunën e Istogut

22) Grumbullimi i ujërave nga reshjet > nuk ka zbatim apo planifikim në asnjë komunë

23) Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave nëntokësorë (duke përfshirë masat e rimbushjes) > shih zbatimin dhe planifikimin e mëtejmë në Komunën e Obiliqit dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Kaçanik

24) Rritja e vëllimeve të rezervuarëve > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit dhe Rahovecit, zbatimi në Komunën e Klinës dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Kaçanikut dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës

25) Kufizimi i përdorimit të ujit > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit dhe Kaçanikut.

Prioritet i mesëm (<4):

26) Rotacioni i kulturave bujqësore (për rigjenerim të tokës) > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Klinës dhe Komunën e Obiliqit , zbatimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut, planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit dhe Mamushës dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës.

Menaxhimi i pyjeve dhe biodiversitetit

Prioritet i lartë (>4):

27) Fuqizimi i politikave për mbrojtjen e pyjeve > shih për zbatimin e avancuar dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Obiliqit it, Klinës dhe Kaçanikut, planifikimin dhe zbatimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut, si dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

28) Edukimi i qytetarëve për përfitimet nga pyjet dhe ndikimet e dëmshme të shpyllëzimit > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në komunat e Obiliqit it, Klinës dhe Kaçanikut, planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

29) Trajtimi i rreptë i rasteve të prerjeve ilegale të drunjëve/shpyllëzimit > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në komunat e Obiliqit it, Klinës dhe Kaçanikut, planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit it, planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

30) Mbjellja e pemëve/pyllëzimi (shih edhe masën 9 dhe 14) > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në komunat e Klinës dhe Kaçanikut, zbatimin fillestar në

Komunën e Istogut, planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit dhe planifikimin fillestar në komunat e Podujevës dhe Istogut

31) Largimi i drunjëve të zjarrit për të ulur cenueshmërinë ndaj zjarreve të pyllit> shih planifikimin e avancuar dhe zbatimin në komunat e Obiliqit dhe Kaçanikut, dhe planifikimin fillestar në komunat e Podujevës dhe Istogut

32) Korridoret ekologjike për të ndihmuar migrimin e specieve > shih zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istogut dhe zbatimin e avancuar dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Obiliqit

33) Inkorporimi i objektivave lokalë të biodiversitetit në planifikimin, aplikimin dhe menaxhimin e masave të gjelbra të infrastrukturës >??>

Prioritet i mesëm (<4):

34) Zgjedhja e specieve të pemëve dhe praktikave pyjore më pak të cenueshme ndaj stuhive dhe zjarreve > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit it, zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar dhe të avancuar në Komunën e Podujevës

35) Krijimi i variacionit mikroklimatik dhe rezistent ekologjikisht të peizazheve përmes topologjisë së ndryshuar për t'i ndihmuar speciet që të reagojnë ndaj ndryshimeve në temperaturë dhe të rriten gjasat që ato specie do të arrijnë të shtegtojnë në nivel lokal në habitate të reja të favorshme >??>

<u>Shëndeti publik</u>

Prioritet i mesëm (<4):

36) Programet e shëndetit publik për vdekjet e lidhura me nxehtësinë (p.sh. sistemet e paralajmërimit të nxehtësisë) > shih planifikimin e avancuar dhe zbatimin në Komunën e Kaçanikut, zbatimin fillestar në Komunën e Istogut dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

37) Programe të ndërgjegjësimit për ndryshimet klimatike dhe shëndetin tek praktikuesit e shëndetit publik dhe mjekësorë > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Obiliqit dhe zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istogut

38) Programet e shëndeti publik që kanë të bëjnë me ndryshimet e trendeve të sëmundjeve infektive > shih zbatimin në Komunën e Obiliqit dhe Klinës, si dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit , dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istogut dhe Podujevës

39) Sistemet e përcjelljes së sëmundjeve infektive që mund të zbulojnë 'nënshkrime' potenciale të sëmundjeve që mund të jenë pasojë nga ndryshimet klimatike në Kosovë

> shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit , dhe zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istog

40) Tërheqja e vëmendjes së profesionistëve mjekësorë dhe pacientëve të tyre për potencialin për ndryshime në trendet e ekspozimit ndaj aeroalergjenëve që përkeqësojnë sëmundjet alergjike si astma dhe riniti alergjik ("alergjia nga bari") > shih planifikimin e avancuar dhe zbatimin në Komunën e Obiliqit , dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës, si dhe zbatimin fillestar në Komunën e Istog

41) Sistemet ekzistuese të përcjelljes së shëndetit publik janë mjaft gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm për t'i zbuluar ndikimet potenciale të ndryshimeve klimatike ndaj shëndetit > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit, zbatimin mesatar të avancuar dhe një pjesë të planifikimit mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës dhe Istogut

42) Program për ndërgjegjësimin publik lidhur me pasojat e ekspozimit ndaj nxehtësisë > shih zbatimin fillestar dhe planifikimin e mëtejmë mesatar në Komunën e Obiliqit.

Menaxhimi dhe këmbimi i informatave

Prioritet i lartë (>4):

43) Shqetësimet nuk fshihen por komunikohen (në raportet finale, verbalisht) > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Obiliqit dhe Kaçanikut, dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

44) Miratimi i një plani M&E gjatë përgatitjes së projektit që përfshin krijimin e indikatorëve të procesit, indikatorëve të uljes së stresit dhe indikatorëve të gjendjes mjedisore > shih planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës.

Prioritet i mesëm (<4):

45) Qeveritë shpërndajnë në mënyrë aktive informata dhe të dhëna për publikun: në internet, por edhe përmes fletushkave, mediave, etj. >> shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Kaçanikut dhe planifikimin fillestar dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut

46) Organe të ndryshme qeveritare janë të përfshira në përcaktimin e kushteve të punës për projektet e përshtatjes në sektorët përkatës dhe mbikëqyrjen e hulumtimit, apo të paktën të konsultuara (intervista, anketa, etj.) > nuk ka zbatim apo planifikim

47) Monitorim afatgjatë të ujërave sipërfaqësore (cilësia dhe sasia) > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit , zbatimin mesatar të avancuar dhe planifikimin fillestar në Komunën e Obiliqit dhe Podujevës

48) Multidisiplinariteti: Disiplina të ndryshme përfshihen në përkufizimin dhe realizimin e hulumtimit për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike: p.sh. krahas shkencave

teknike dhe të inxhinierisë gjithashtu edhe për ekologji dhe shkenca sociale > shih planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

49) Sistemet për mbështetjen e vendimeve, p.sh. sistemet informative hidrometeorologjike janë sipas standardeve> shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit , planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

50) Monitorimi afatgjatë i ujërave nëntokësore (cilësia dhe sasia)> shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit , dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

51) Modernizimi i sektorit të hidrometeorologjisë (d.m.th. fuqizimi i sistemit të parashikimit dhe lajmërimit të hershëm apo të lajmërimit të fatkeqësive) > nuk ka zbatim apo planifikim

52) Qeveritë shkëmbejnë informata dhe të dhëna me qeveritë tjera > shih zbatimin në Komunat e Klinës dhe Kaçanikut, si dhe në Komunën e Kaçanikut planifikimin mesatar të avancuar

Ngritja e kapaciteteve, trajnimet, ndërgjegjësimi

Prioritet i mesëm (<4):

53) Programet e ndërgjegjësimit për ndryshimin klimatik > shih zbatimin në Komunën e Istogut dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Rahovec

54) Fushatë ndërgjegjësimi për rreziqet e ndërtimit, jetesës dhe punës në zona të cenueshme > nuk ka zbatim apo planifikim

55) Fushatë ndërgjegjësimi për qytetarët, kompanitë, fabrikat për kursimin e ujit . > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Klinës dhe Rahovecit, zbatimin mesatar të avancuar në Komunën e Istogut dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

56) Trajnim për menaxhimin efikas të ujitjes për bujqit > shih zbatimin dhe planifikimin e mëtejmë të avancuar në Komunën e Obiliqit dhe zbatimin fillestar në Komunën e Istogut

57) Trajnime për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për profesionistët e avancuar në bujqësi, pylltari, planifikim të përdorimit të tokës, shëndetit publik, etj. > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Obiliqit dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

Financat dhe rikthimi i kostove

Prioritet i lartë (>4):

58) Resurset financiare për programe/projekte të përshtatjes janë të lloj llojshme duke përdorur një gamë të gjerë instrumentesh private dhe publike të financimit > shih zbatimin mesatar të avancuar dhe planifikimin fillestar në Komunën e Istog

Prioritet i mesëm (<4):

59) Kostot mbulohen nga 'përdoruesit' nga instrumente publike dhe private financiare (ngarkesa, çmime, sigurim, etj..) > nuk ka zbatim apo planifikim

60) Autoritetet mund të marrin kredi dhe t'i zhvlerësojnë asetet e tyre, për të lehtësuar përdorimin efikas të resurseve dhe zëvendësimin e aseteve > shih planifikimin e avancuar në Komunën e Rahovec

61) Pjesëmarrje e gjerë e sektorit privat në menaxhimin e resurseve të ujit dhe atyre natyrore > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Obiliqit dhe Rahovec, zbatimi në Komunën e Istogut dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

<u>Strukturat e bashkëpunimi</u>

Prioritet i lartë (>4):

62) Qeveritë në rrjedhën e poshtme (lokale apo kombëtare) përfshihen në vendimmarrje nga qeveritë e rrjedhës së sipërme > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Vitia, Obiliqit dhe Klinës, dhe zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

Prioritet i mesëm (<4):

63) Dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me qasjen në informata, pjesëmarrjen në vendimmarrje (p.sh. kërkesat për konsultime para vendimmarrjes) dhe qasja ne gjykata > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Klina, zbatimin fillestar në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës

64) Aktorët joqeveritarë në të vërtetë kontribuojnë në vendosjen e agjendës, analizën e problemeve, zhvillimin e zgjidhjeve dhe marrjen e vendimeve ("bashkëprodhimi") > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Obiliqit dhe Klinës, zbatimin në Komunën e Istogut dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Mamushës, dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

65) Strukturat e bashkëpunimit përfshijnë organet qeveritare nga nivele të ndryshme hierarkike; përgjithësisht shumë kontakte > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Klina, zbatimin mesatar të avancuar dhe planifikimin në Komunat e Istogut dhe Podujevës

66) Strukturat e bashkëpunimit përfshijnë aktorë joqeveritarë (p.sh. OJQ mjedisore, grupe përdoruesish, grupe të qytetarëve apo sektorin privat) > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunat e Vitia, Obiliqit dhe Klinës, dhe zbatimin dhe planifikimin fillestar në Komunën e Podujevës

67) Qeveritë sektoriale në mënyrë aktive përfshijnë sektorë të tjerë të qeverisë (kombëtare dhe lokale) (p.sh. bujqësia, natyra, mjedisi, turizmi, pylltaria, shëndetësia, navigimi, planifikimi hapësinor) > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunat e Obiliqit dhe Klinës, zbatimin fillestar dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës

68) Qeveritë e nivelit lokal janë të përfshira në vendimmarrje nga qeveri të nivelit të lartë > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Obiliqit dhe Klinës, zbatimin fillestar në Komunën e Istogut dhe Podujevës, si dhe planifikimi i avancuar në Komunën e Vitisë

69) Konfliktet trajtohen me konstruktivitet, duke rezultuar në marrëveshje përfshirëse në të cilat zotohen palët > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunën e Klina

70) Ekzistojnë struktura ndërkombëtare/ndërkufitare të bashkëpunimit (p.sh. komisione të pellgjeve të lumenjve); përgjithësisht shumë kontakte> shih planifikimin fillestar në Komunën e Istogut dhe Podujevës

<u>Menaxhimi i rrezikut</u>

Prioritet i lartë (>4):

71) Janë në dispozicion mekanizma të sigurimit të të korrurave > shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunat e Vitia, Obiliq, Klinës dhe Kaçanikut, zbatimin mesatar të avancuar dhe planifikimin në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës

Prioritet i mesëm (<4):

72) Ka në dispozicion sigurime kundrejt dëmeve në banim dhe prona >> shih zbatimin në Komunën e Klinës

73) Perceptimi i rrezikut nga gjykimi i ekspertit zyrtar dhe perceptimi i rrezikut nga palët e interesit >> shih zbatimin dhe planifikimin e avancuar në Komunat e Vitisë dhe Rahovecit dhe zbatimin fillestar në Komunën e Podujevës dhe Istogut, dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës

74) Palët qeveritare dhe joqeveritare janë të përfshira në vendimet për rreziqet e pranueshme të ndryshimeve klimatike > shih zbatimin dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunat e Vitisë dhe Klinës, zbatimin fillestar në Komunën e Istogut dhe planifikimin mesatar të avancuar në Komunën e Podujevës

6. Veprimet e rekomanduara

Strategjia për Kosovën parasheh parashikim efektiv dhe reagimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike, duke marrë parasysh parimet e pranuara ndërkombëtarisht për zhvillim të qëndrueshëm. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është vendimtare për uljen e rrezikut dhe dëmeve nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike me një kosto-efektive dhe me shfrytëzimin e përfitimeve të mundshme që dalin nga ndryshimet klimatike. Strategjia do të synojë sjelljen e mekanizmave të ri dhe përmirësimin e atyre aktualë për reduktim të rrezikut nga fatkeqësitë, të cilat në veçanti kanë peshë për sektorët me rëndësi ekonomike që janë posaçërisht të cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe të avancojë kapacitetin i përshtatjes së komuniteteve të cenueshme, në veçanti të bujqve të varfër, grupeve të margjinalizuara dhe grave në trajtimin e ndikimeve klimatike dhe rreziqeve të ndërlidhura me jetën e tyre dhe mjeteve për jetesë. ndryshimeve klimatike. Në këtë mënyrë, Strategjia ka për qëllim ngritjen e kapacitetit të partnerëve, akterëve dhe hisedarëve lokalë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen në proceset e zhvillimit lokal dhe rajonal, si dhe fuqizimin e tyre për trajtimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike. Në fund, Strategjia mëton t'i shpërndajë dhe ngritë mësimet e nxjerra, praktikat e mira, përvojat dhe avokimin për të pasur ndikim në politikat dhe proceset vendimmarrëse në nivel lokal, qendror dhe rajonal.

6.1. Rritja e kapacitetit të përshtatjes

Një nga objektivat kryesore të Strategjia për Kosovën është rritja e kapacitetit të përshtatjes të sistemeve natyrore dhe shoqërore, duke u bazuar në kuptimin e shëndoshë të asaj që përcakton rezistencën dhe cenueshmërinë e këtyre sistemeve. Problemi që duhet të trajtohet është rritja e mundësisë së tërë sistemit për të reaguar ndaj ndryshimit në vend se të reagohet ndaj ndikimeve të padëshirueshme të ndryshimit.

Thënë shkurt, kapaciteti i përshtatjes është tregues i kapacitetit që duhet trajtuar ndryshimin dhe shqetësimin, dhe pasqyron të mësuarit me anë të shkëmbimit të njohurive dhe duke iu përgjigjur informatave kthyese. Rritja e aftësisë së sistemeve për t'u përshtatur, apo të ndërtuar kapacitetet e tyre të përshtatjes, është një element i rëndësishëm që duhet marrë parasysh për t'u përgatitur dhe për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike: prandaj sistemet me kapacitete të larta të përshtatjes mund ta ruajnë integritetin e tyre në një gamë më të gjerë kushtesh sesa sistemet me kapacitetet të ulëta të përshtatjes. Në sistemet shoqërore, kapaciteti i përshtatjes i referohet aftësisë për të mësuar nga gabimet dhe për të gjenruar përvojat nga trajtimet e ndryshimeve, e që kjo varet j në masë të madhe nga aftësia e individëve dhe rrjeteve të tyre shoqërore për inovacion.

Për më tepër, është theksuar se vetëm gjenerimi i përvojës nuk është i mjaftueshëm për ndërtimin e kapacitetit të përshtatjes në sistemet socio-ekologjike në mënyrë të atillë që të përmbushur sfidën e navigimit të dinamikave të natyrës. Prandaj, të mësuarit se si të mbahen sistemet socio-ekologjike në një botë të ndryshimit të vazhdueshëm ka nevojë për një kontekst

institucional dhe shoqëror brenda të cilit do të zhvillohet dhe veprohet. Njohuria dhe aftësia për të vepruar në informata të reja janë elemente të vazhdueshme në procese shoqërore.

Duke u mbështetur në informatat e mësipërme, Strategjia për Kosovën përfshin disa komponentë të strategjisë të synuar në rritjen e kapacitetit të përshtatjes:

1. Përmirësimi i menaxhimit dhe këmbimit të informatave, d.m.th. prodhimi i njohurisë së përbashkët/pjesëmarrëse, zotim për trajtimin e shqetësimeve, komunikimi i përgjithshëm ndërmjet palëve të interesit, burimet e hapura dhe të përbashkëta të informatave dhe fleksibiliteti dhe gatishmëria për eksperimentim.

2. Ngritja e kapaciteteve, trajnimet dhe ndërgjegjësimi, duke përfshirë programet e ndërgjegjësimit publik dhe trajnimet për profesionistë.

3. Masat financiare dhe ekonomike dhe përmirësimi i menaxhimit të rrezikut.

4. Përmirësimi i strukturave të bashkëpunimit, d.m.th. përfshirja e palëve joqeveritare, qeverive të sektorëve të ndryshëm (duke mbështetur integrimin horizontal) dhe qeverive nga nivele të ndryshme hierarkike (duke mbështetur integrimin vertikal).

6.2. Pasqyrë e komponentëve të strategjisë dhe formularët e intervenimit

Ky kapitull paraqet orientimin e veprimeve që konsiderohet të jetë mënyra më efektive e përmbushjes së objektivave, duke pasur parasysh shtrëngimet buxhetore dhe çështjet lidhur me zbatimin.

				250,000	500,000	500,000	500,000						1,750,000

11) Sigurimi i rrjedhave minimale në periudha të thata	**2,500,000**	Afatmesëm 2020 – 2025						120,000 60,000 60,000			120,000	480,000	600,000
12) Përshtatja i të mbjellave	**500,000**	Afatmesëm 2015 - 2018		50,000 25,000 25,000	66,500 66,500	66,500 66,500	66,500				50,000	225,000	225,000
13) Teknologjitë e kursimit të ujit në ujitje	**42,000,000**	Afatmesëm 2014 -2020	7,000,000	3,500,000 3,500,000	3,500,000 3,500,000	3,500,000 3,500,000	3,500,000 3,500,000	3,500,000 3,500,000			7,000,000	17,500,000	17,500,000
14) Shfrytëzimi i ujërave nga të reshurat	**40,000-60,000**	Afatshkurtër 2017 –2020				4,000 2,000	2,000 20,000	2,000 20,000			4,000	6,000	40,000
15) Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave tokësore	**4,500,000 - 5,000,000**	Afatmesëm 2014-2018	500,000 250,000 500,000	500,000 500,000	250,000 500,000	250,000 500,000	250,000 500,000				500,000	1,500,000	2,500,000
Komponenti Strategjik 3. Menaxhimi i pyjeve dhe biodiversitetit													
16) Fuqizimi i politikave për planifikimin pyjor	**900,000**	Afatshkurtër 2013-2015	90,000 90,000	315,000 315,000							90,000	405,000	405,000
17) Mbjellja e druve/ripyllëzimi, gjithashtu si masë për trajtimin e mungesës së ujit apo përmbytjeve	**2,700,000**	Afatshkurtër 2013-2015	270,000 540,000	945,000 945,000							270,000	1,485,000	945,000
18) Korridoret ekologjike që ndihmojnë në migrimin e specieve	**1,500,000 - 2,000,000**	Afatshkurtër 2011-2015	175,000 725,000	450,000 450,000							175,000	1,175,000	450,000
19) Përfshirja e objektivave lokale të biodiversitetit në planifikim, realizim dhe menaxhim të masave të gjelbra infrastrukturore	**700,000 - 1,000,000** **100,000**	Afatmesëm 2012 - 2015 2012 – 2013	90,000 180,000 180,000	300,000 300,000							90,000	480,000	480,000
20) Krijimi i	**200,000 -**	Afatshkurtër	40,000								40,000		

variacioneve mikroklimatike dhe peizazheve të qëndrueshme ekologjikisht	**500,000**	2013-2015	20,000 20,000	180,000 180,000								200,000 200,000	
Komponenti Strategjik 4: Shëndeti publik													
21) Për publikun: programet e shëndetit publik (shih shtojcën 1)	**1,700,000**	Afatmesëm 2014 – 2018	170,000 85,000 85,000	 170,000 170,000	 170,000 170,000	 170,000 170,000	 170,000 170,000				170,000	 765,000	 765,000
22) Për punonjësit mjekësorë: program vetëdijesimi për ndryshimet klimatike dhe shëndetin për punonjësit mjekësorë dhe shëndetësorë	**750,000**	Afatshkurtër 2014 – 2015	75,000 37,500 37,500	 300,000 300,000							75,000	 337,500	 337,500
23) Për autoritetet: Fuqizimi i sistemeve të vëzhgimit të shëndetit publik, drejt sigurimit të sistemeve mjaftueshëm gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme për të zbuluar efektet potenciale të ndryshimeve klimatike në shëndet	**600,000**	Afatshkurtër 2014 – 2016	60,000 60,000 60,000	 105,000 105,000	 105,000 105,000						60,000	 270,000	 270,000
Komponenti Strategjik: 5. Menaxhimi dhe këmbimi i informatave													
24) Fuqizimi i sistemeve të prodhimit të informatave bashkërisht/me pjesëmarrje (shih detajet në Shtojcën 1).	**900,000**	Afatshkurtër 2014 – 2015	90,000 180,000 180,000	 225,000 225,000							90,000	 405,000	 405,000
25) Modernizimi i sektorit	**20,000,000 - 30,000,000**	Afatmesëm 2014 – 2018	3,000,000 2,000,000	 2,000,000	 2,000,000	 2,000,000	 2,000,000				3,000,000	 10,000,00	

hidrometeorologjik												0	
			2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000	2,000,000						10,000,000
26) Përmirësimi i komunikimit (shih detajet në Shtojcën 1)	**700,000**	Afatgjatë 2014 - 2015 (faza nismëtare) 2014 - 2024 (mirëmbajtja)	70,000								700,000		
				200,000								200,000	
			35,000	200,000	35,000	35,000	35,000	35,000					430,000
27) Përmirësimi i këmbimit dhe shfrytëzimit të informatave	**750,000**	Afatshkurtër 2014 – 2015	75,000								75,000		
			150,000	187,500								337,500	
			150,000	187,500									337,500
Komponenti Strategjik: 6. Ndërtimi i kapaciteteve, trajnimi, ngritja e vetëdijes													
28) Vetëdijesimi i publikut	**800,000**	Afatshkurtër 2014 – 2016	80,000								80,000		
			40,000	160,000	160,000							360,000	
			40,000	160,000	160,000								360,000
29) Trajnimi për profesionistë	**900,000**	Afatshkurtër 2014 - 2017	90,000								90,000		
			45,000	120,000	120,000	120,000						405,000	
			45,000	120,000	120,000	120,000							405,000
Komponenti Strategjik: 7. Financat, mbulimi i kostove dhe menaxhimi i riskut													
30) Masat financiare dhe ekonomike	**1,700,000**	Afatmesëm 2014 – 2018	170,000								170,000		
			85,000	170,000	170,000	170,000	170,000					765,000	
			85,000	170,000	170,000	170,000	170,000						765,000
31) Përmirësimi i menaxhimit të riskut	**600,000**	Afatmesëm 2014 – 2018	60,000								60,000		
			30,000	60,000	60,000	60,000	60,000					270,000	
			30,000	60,000	60,000	60,000	60,000						270,000
Komponenti Strategjik: 8. Strukturat e bashkëpunimit													
32) Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së palëve me interes dhe krijimi i kushteve për të	**600,000**	Afatshkurtër 2014 – 2016	60,000								60,000		
			30,000	120,000	120,000							270,000	
			30,000	120,000	120,000								270,000
33) Përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial	**800,000**	2014 – 2025	80,000								80,000		
			40,000	32,000	32,000	32,000	32,000	32,000	32,000			360,000	
			40,000	32,000	32,000	32,000	32,000	32,000	32,000				360,000

			550,000								550,000		
34) Përmirësimi i bashkëpunimit mes niveleve të administratës	**5,500,000**	Afatgjatë 2014 – 2025	275,000 275,000	220,000 220,000	220,000 220,000	220,000 220,000	220,000 220,000	220,000 220,000	220,000 220,000			2,475,000	2,475,000
35) Përmirësimi i bashkëpunimit mes kufijve administrativë	**500,000**	Afatshkurtër 2014 – 2015	500,000								500,000		
36) Plani i menaxhimit dhe masat e rehabilitimit për kanalin Ibër-Lepenc	**15,000,000 - 17,000,000**	Afatshkurtër 2015-2018		1,700,000 1,000,000 1,000,000	2,000,000 2,000,000	2,000,000 2,000,000	2,000,000 2,000,000				1,700,000	7,000,000	7,000,000
37) Dizajni dhe ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave acidike nga Miniera e Novobërdës	**850,000 - 1,000,000**	Afatshkurtër 2015-2016		85,000 170,000 170,000	225,000 225,000						100,000	395,000	395,000
38) Dizajnimi dhe implementimi i rikultivimit të sipërfaqeve të drenimit dhe trajtimi i drenazhit acidik nga minierat	**12,000,000 - 15,000,000**	Afatgjatë 2015 – 2025		1,500,000 750,000 750,000	700,000 700,000	700,000 700,000	700,000 700,000	700,000 700,000	700,000 700,000		1,500,000	6,000,000	6,000,000
										Kostot e gjithmbarshme e përgatitjes/dizajnimit			**34,520,500**
										Kostot e gjithmbarshme të ndërtimit		**106,745,750**	
										Kostot e gjithmbarshme operative			**134,676,250**
										GJITHSEJ			**275,942,500**

7. Hapat vijues për zbatimin e strategjisë

Ky kapitull përfshin rekomandimet për zbatimin e Strategjisë së Kosovës. Pjesa e parë paraqet rekomandimet për punë shtesë në kuptim të analizimit, përfshirë strukturat financiare, aranzhimeve qeveritare dhe kërkesave legjislative. Përveç kësaj, në kapitullin 7.2 paraqiten një sërë rekomandimesh teknike. Ky kapitull do të përmbyllet me opsionet të cilat publiku i ka në dispozicion për të kontaktuar dhe ngritur brengat e veta (7.3). Shtojca 4 adreson sfidën se si të kryhen përgatitjet për financim dhe zbatim. Në të paraqitet edhe një pasqyrë e shkurtër e planifikimit dhe financimit të investimeve, si dhe përgatitjes dhe zbatimit të projekteve.

7.1. Puna e mëtejme në analiza politike

Në këtë kapitull rekomandohet punë e mëtejme në kuptim të analizave të politikave (përfshirë edhe dokumentet konceptuale), të cilat planifikohet të realizohen për të arritur deri tek rekomandime më të detajuara.

7.1.1. Financimi

Partneritetet publike-private

Një nga sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë së Kosovës është gjetja e mënyrave për të financuar planet për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe operacionet, infrastrukturën dhe projektet gjegjëse. Në disa dekadat e fundit janë vënë në dispozicion forma të reja të skemave dhe strukturave të financimit, të cilat tanimë janë vënë në përdorim. Këto forma, mënyra dhe struktura moderne të financimit shpesh njihen si partneritete publike-private (ose PPP). Brenda kontekstit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, PPP-të mund t'i mundësojnë sektorit publik ndarjen e kostove të investimit përgjatë një periudhe më të gjatë, jo sikur financimi tradicional, ku sigurimi i kapitalit kërkohet nga sektori publik, ndërsa përfitimet vijnë shumë më vonë dhe janë në masë të gjerë të pasigurta. Për shembull, në Kosovë potenciali i shfrytëzimit të partneriteteve publike-private për t'i mbrojtur nga efektet klimatike zonat industriale dhe veprimtarinë bujqësore duhet të studiohet edhe më tej.

Në disa projekte për përshtatje mund këshillohet krijimi i partneriteteve publike-private për realizimin e projekteve, pasi që të njëjtat do të shtonin efikasitetin dhe do të realizonin projektin me kosto më të ulët. Ato gjithashtu do të mund t'i siguronin taksapaguesve shpenzim të matur të parave të tyre, duke e ndarë riskun në mënyrë optimale dhe duke e menaxhuar atë, por edhe do të shtonin efikasitetin si rezultat i integrimit të dizajnit dhe ndërtimit të infrastrukturës publike me financimin, operimin dhe mirëmbajtjen/azhurnimin.

PPP-të gjithashtu do të krijojnë vlerë të shtuar duke siguruar sinergji mes autoriteteve publike dhe kompanive të sektorit privat, në veçanti përmes integrimit dhe bartjes së shkathtësive,

njohurive dhe ekspertizës mes sektorit publik dhe privat. Ato poashtu shtojnë konkurrencën dhe zhvillojnë kapacitetet ndërtuese (duke përfshirë pjesëmarrjen e firmave të huaja, veçanërisht në partneritete dhe shoqëri aksionare). Për më tepër, ofrimi i shërbimeve cilësore publike do të mund të përmirësohet nga regjimet e menaxhimit/rregullimit që bazohen në stimulime, ndërsa që kjo formë mund të ulë nivelin e shpenzimeve të buxheteve publike përderisa i sjell përfitime të gjithë përdoruesve të shërbimeve publike.

Shkurtimisht, duhet të shqyrtohen disa aspekte që ndërlidhen me PPP-të:

- PPP-të mundësojnë gjenerim të investimet private
- PPP-të mundësojnë mobilizim të sektorit privat
- PPP-të duhet të kenë afarizëm pozitiv (profite)
- PPP-të krijojnë disiplinë në treg nëse bëhet ndarja adekuate e rreziqeve (rreziqet komerciale do duhej të barten nga partneri privat)
- PPP-të kërkojnë përgjegjësi dhe përkushtim të qartë si nga pala publike ashtu edhe ajo private
- PPP-të nuk mund të përfaqësojnë vetëm interesin publik
- PPP-të duhet të kenë skema efektive për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Shumëllojshmëria ekonomike

Kosova gjithashtu mund të hulumtojë për mundësi tërësisht të reja ekonomike në fushën e energjisë së ripërtëritshme, për shembull në energjinë solare, burimet e erës, me apo pa çiftëzim me prodhimin e ushqimit, përfshirë metodat e bazuara në komunitet (dhe të decentralizuar), përmes të cilave do të bëhet përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.

Pagesa për shërbimet e ekosistemit

Shërbimet e ekosistemit, siç janë sekuestrimi i karbonit, mbrojtja nga vërshimet dhe mbrojtja nga erozioni i tokës janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me ndryshimet klimatike dhe ekosistemet e shëndetshme, dhe përbëjnë një mbrojtje esenciale ndaj disa nga ndikimet më ekstreme. Andaj janë të domosdoshme qasje gjithëpërfshirëse dhe të integruarz ndaj ruajtjes dhe përmirësimit të ekosistemeve, mallrave dhe shërbimet që ato i ofrojnë.

Për shembull, në fushën e pylltarisë në Kosovë është me rëndësi të sigurohet më shumë përvojë dhe të zhvillohet legjislacioni në lidhje me pagesat për shërbime ekologjike pyjore (PFES). Kjo përvojë trego se puna me kapacitetet e natyrës për të absorbuar apo kontrolluar ndikimet në fushat urbane dhe rurale mund të përbëjë mënyrë efikase të përshtatjes, duke ikur nga fokusi në

infrastrukturën fizike. Infrastruktura e gjelbër[46] mund të luajë rol kyç në përshtatje, duke ofruar burimet esenciale për qëllime sociale dhe ekonomike nën kushtet klimatike ekstreme. Shembuj të kësaj përfshijnë përmirësimin e kapacitetit të depozitimit të karbonit dhe ujit në tokë, si dhe ruajtja e ujit në sistemet natyrore, përmes të cilave lehtësohet efekti i thatësirave dhe parandalimi i vërshimeve, erozionit të tokës dhe shkretimit. Prandaj, është me rëndësi që të hulumtohen politikat dhe masat potenciale për përmirësimin e kapacitetit të ruajtjes së ujit në Kosovë, si dhe në përgjithësi potenciali për pagesat për shërbime të ekosistemit.

7.1.2. Ligji

Ndryshimi dhe zbatimi i ligjeve për ruajtjen e pyjeve

Një nga kërcënimet më të theksuara për menaxhimin e qëndrueshëm të ujërave (duke i rezistuar klimës) që është përmendur nga palët me interes është prerja e pakontrolluar e zonave pyjore për materiale ndërtimore, dru për djegie dhe thëngjill. Ky problem shkon përkrah me eksploatimin, shitjen dhe shfrytëzimin e lëndëve të drurit dhe produkteve tjera pyjore me origjinë të panjohur. Njëkohësisht, palët me interes gjithashtu kanë përmendur vështirësi në trajtimin e këtij problemi, në veçanti duke qenë se këto veprime kryesisht kryhen nga persona të varfër të cilët duhet të sigurojnë mbijetesën disi. Prandaj, rrallë ndodhë që njerëzit të gjobiten apo ndiqen penalisht për prerje ilegale të drunjëve, pasi që shumica e kryerësve të veprave të tilla janë të varfër dhe organet e rendit hezitojnë dhe nuk ndëshkojnë të varfrit. Pasi që ky është instrumenti i vetëm praktik të cilin e ofron ligji aktual, parandalimi i prerjes ilegale është mjaft joefektiv. Një alternativë e mundshme është që prerja ilegale e drunjëve të trajtohet përmes pagesës për shërbimet e ekosistemit (shih kapitullin e mësipërm).

7.1.3. Qeverisja e përshtatjes klimatik

Përputhja e interesave dhe harmonizimi i politikave sektoriale

Korrigjimi i mospërputhjes apo konfliktit mes politikave sektoriale është një nga sfidat më të mëdha të qeverisjes së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Zakonisht, përfitimet politike dhe stimulimet ekonomik kanë shumë ndikim në sektorët që përdorin ujë, e në veçanti prekin interesat e furnizimit të ujit për bujqësi, amvisëri dhe industri. Nevojiten studime të mëtejme për të parë se cilët mekanizma qeverisës mund të sigurojnë se politikat sektoriale dhe planifikimi i integruar do të sigurojnë promovim të burimeve të mira natyrore dhe menaxhimit mjedisor.

Krijimi i mekanizmave koordinues ndërsektorial

Gjatë procesit të planifikimit janë propozuar disa qasje për promovimin e koordinimit ndërsektorial: (i) besimin e një roli koordinues një ministrie neutrale, zakonisht Ministrisë së

[46] Infrastruktura e gjelbër është rrjeti i ndërlidhur i fushave natyrore duke përfshirë tokë bujqësore, siç janë livadhet, ligatinat, pyjet që ruajnë komunitetet autoktone, që rregullojnë rrjedhat e stuhive, temperaturat, rrezikun nga përmbytjet, dhe cilësia e ekosisitemit dhe ajrit

Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor apo Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, që do të ketë për qëllim përputhjen e interesave të sektorëve të ndryshëm; dhe (ii) analistët institucionalë gjithashtu kanë propozuar qeverisje shumështresore si mekanizëm për lehtësimin e harmonizimit ndërsektorial, si dhe lidhjeve vertikale mes nivelit qendror dhe atij lokal. Rekomandohet që një ministrie neutrale t'i besohet roli i përputhjes së interesave të sektorëve të ndryshëm. Model i kësaj do të mund të ishte përvoja me Grupin Punues për Ujërat në Kosovë, i cili tani është shndërruar në Këshillin Ndërministror të Ujërave që udhëhiqet nga ZKM dhe përbëhet nga ministrat e MZHE, MMPH, MAPL dhe MIE.

Ujërat tokësore duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të MIBU

Në rastet kur planet për menaxhimin e integruar të burimeve ujore janë miratuar, qoftë në nivel të master planeve kombëtare apo në nivel lokal për shtretër të lumenjve duhet të ndahen burime të veçanta njerëzore dhe financiare për ujërat nëntokësore.. Natyrisht, disa aktivitete realizohen bashkërisht për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, andaj do duhej shmangur krijimi i 'mbretërive' të ndara. Edhe ndër-fertilizimi është i dobishëm. Për shembull, menaxhimi i ujërave nëntokësore mund të përfitojë nga përvojat e fituara me ujërat tokësore, në kuptim të qasjes ndaj pjesëmarrjes dhe aranzhimeve kolektive, të cilat janë shpesh shumë më të zhvilluara për menaxhimin e ujërave sipërfaqësore. Megjithatë, ujërat nëntokësore duhet trajtuar me kapacitete të specializuara në kuptim të njohurive dhe monitorimit të burimeve, andaj arritja deri tek informatat përkatëse për ato kërkon më shumë mund se sa në rastin e ujërave sipërfaqësore. Para të gjithave, Kosova duhet të zhvillojë rrjetin e monitorimit të ujërave nëntokësore, pasi që nuk ka as informata themelore lidhur me disponueshmërinë e ujërave nëntokësore, sasinë apo cilësinë e tyre. Të vetmet informata në dispozicion janë ato që i përmbajnë hartat hidrogjeologjike të KFOR-it.

Qasja e hapur në të dhëna dhe informata dhe shkëmbimi i tyre

Një çështje e rëndësishme sa i përket përmirësimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit në sektorin e ujërave është këmbimi i lirshëm i informatave dhe të dhënave përkatëse mbi hidrologjinë, hidraulikën dhe meteorologjinë. Nënkuptohet se grumbullimi i të dhënave dhe informatave të tilla kushton dhe se monitorimi në terren kërkon investime kapital. Sidoqoftë, do të jetë i domosdoshëm një mekanizëm për shkëmbim më të mirë dhe më të lirshëm të të dhënave mes institucioneve të ndryshme, në mënyrë që të mund të përmirësohet qeverisja e përshtatjes dhe të mos pengohet zhvillimi shoqëror dhe ekonomik. Mbase qeveria kombëtare do duhej të udhëheqë procesin e krijimit të një sistemi të pranueshëm që do të përshtatet nga trupa tjerë qeveritare si dhe institucione hulumtuese, etj. Për shembull, në fund të vitit 2013 projekti i Strategjisë së Ujërave në Kosovë është duke zhvilluar një sistem të informatave ujore, i cili është në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Ujërat.

Në vijim janë dhënë **rekomandime të ndryshme** lidhur me qeverisjen e përshtatjes klimatike:

- Të sigurohet se vendimmarrja lidhur me problemet lokale dhe projektet lokale do t'i mbetet nivelit përkatës të qeverisë (parimi i subsidiaritetit).
- Të përmirësohet vendimmarrja me pjesëmarrje dhe ndërtimi i konsensusit.
- Të sigurohet barazia shoqërore mes akterëve dhe banorëve gjatë marrjes së vendimeve lidhur me dizajnin/llojin e strategjisë dhe implementimin e projekteve.

7.2. Rekomandimet teknike dhe joteknike

Përveç rekomandimeve lidhur me financimin, ligjet dhe qeverisjen, të cilat u ofruan në kapitujt paraprak, rekomandimet vijuese mund të jepen lidhur me masat apo projektet potenciale të cilat mund të zbatohen për të fuqizuar strategjinë e përshtatjes. Mesazhi kyç që duhet të merret parasysh është që duhet të bëhen përpjekje për tu fokusuar në një lokacion unik në Kosovë dhe në të njëjtin të realizohen hapat në vijim:

- Të bëhet një vlerësim i shërbimeve të ekosistemit të cilat mund të ofrohen duke marrë parasysh lokacionin specifik dhe kushtet sa i përket burimeve ujore në Kosovë dhe mjeteve të marketingut që nevojiten për të kapitalizuar shërbimet e tilla.
- Të hulumtohet potenciali për depozitimin e ujit në ekosistem, si dhe i ruajtjes së ujit të freskët për stinën e thatë.
- Të hulumtohen masat më jostrukturore të cilat do ta përmirësojnë MIBU dhe gjendjen socioekonomike (llojllojshmërinë e mbjellave, tranzicionin drejt mbjelleve të cilat sigurojnë më shumë mjete të gatshme, etj.).
- Të hulumtohen mundësitë e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme: nga uji, nga dielli dhe nga era.
- Të kalohet në teknologji të gjelbër dhe jetesë të gjelbër: të përmirësohet shfrytëzimi i burimeve natyrore (3R: rishfrytëzimi, reduktimi dhe riciklimi).
- Të zhvillohet menaxhimi inovativ i katastrofave, duke marrë parasysh cenueshmërinë dhe rezistueshmërinë e popullatës lokale.
- Të vendosen dhe zbatohen rregullore për menaxhimin e ujërave të zeza, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit në Kosovë.

7.3. Opsionet që publiku i ka për të kontaktuar dhe ngritur brengat e veta

Politikëbërësit pajtohen se pjesëmarrja e publikut është e rëndësishme. Deklarata e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (1992) thotë se çështjet mjedisore më së mirë trajtohen kur në këtë

trajtim marrin pjesë të gjithë qytetarët që preken nga to. Pas kësaj, konventa e Aarhusit, e miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (1998) bën thirrje për qasje në informata, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi sa u përket çështjeve mjedisore. Në Evropë, në vitin 2000 është miratuar Direktiva Kornizë e BE-së për Ujërat (WFD) e cila kërkon përfshirjen e publikut në përgatitjen dhe zbatimin e politikave. Pjesëmarrja publike kërkohet kryesisht me nenin 14 të WFD.

Si pasqyrim i këtyre që u përmendën më sipër, WFD kërkon pjesëmarrjen e publikut në menaxhimin e ujërave: "suksesi i kësaj Direktive varet nga bashkëpunimi i ngushtë dhe veprimi koherent në nivel të komunitetit, shtetit anëtar, dhe në nivel lokal, si dhe nga informimi, konsultimi dhe përfshirja e publikut, përfshirë përdoruesit" (Bashkimi Evropian, 2000/60/EC). Kjo Direktivë i referohet përfshirjes së 'opinionit publik' dhe 'palëve të interesuara' (të cilave u referohet edhe si 'palë me interes' apo 'hisedarë'). 'Opinioni publik' mund të përkufizohet si 'një apo më shumë persona fizikë apo juridikë dhe, në pajtim me legjislacionin apo praktikat kombëtare, shoqatat, organizatat, apo grupet e të njëjtëve'. Termi 'palë e interesuar' i referohet 'të gjithë personave, grupeve, apo organizatave që kanë interes apo 'hise' në një çështje të caktuar, qoftë për shkak se janë të prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë apo për shkak se mund të kenë ndikim në të..." (Grupi Hartues, 2002, faqe 18).

Në WFD përmenden tri forma të pjesëmarrjes së publikut: furnizimi i informatave, konsultimi dhe pjesëmarrja aktive. Dy format e para duhet të sigurohen nga shtetet anëtare, ndërsa kjo e fundit duhet të inkurajohet (Grupi Hartues, 2002).

Pjesëmarrja publike kërkon veprime të bashkërenduara

Pjesëmarrja publike i referohet një sërë procedurave që përfshijnë publikun/hisedarët gjatë përgatitjes së planit, vendimmarrjes dhe zbatimit të vendimeve, për shembull në shqyrtimin e opsioneve të preferuara politike.

Konsultimet janë forma e parë reale e pjesëmarrjes së publikut. Këtu kemi të bëjmë me një marrëdhënie të dyanshme në të cilën publiku dhe palët e interesuara mund të shfaqin reagimet e tyre mbi propozimet e sajuara nga autoritetet. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ato do të merren parasysh gjatë vendimmarrjes apo se ekziston obligimi që planet të miratohen në bazë të konsultimeve të bëra.

Këtu mund të dallohen dy nënkategori. Në të parën bie konsultimi pas përgatitjes së planit. Kjo është perspektiva tradicionale mbi pjesëmarrjen e publikut. E dyta përfshin konsultimin para dhe gjatë përgatitjes së planeve, ashtu siç kërkohet me direktivat e BE-së. Në këtë rast, informatat, idetë dhe brengat e publikut dhe palëve me interes merren parasysh gjatë përgatitjes së planit. Autoritetet i hartojnë planet, por palët me interes dhe publiku ofrojnë qëndrimet e tyre në vendime (Grupi Hartues, 2002).

Nga këndvështrimi i zbatimit në Kosovë është me rëndësi të përmendet se brenda MF veç ekziston një njësi për PPP-të. Gjithashtu, grupi punues për ujërat ka nxjerrë dy vendime për të

vlerësuar opsionet për PPP në sektorin e ujërave. Ky mandat pritet të finalizohet së shpejti (TeR janë finalizuar). Gjithashtu, Projekti i KE mbi strategjinë e ujërave ka një komponent për PSP.

Shtojca 1: Përkufizimet kryesore

Ky fjalor ofron përkufizimet e zakonshme të termeve të përdorura më shpesh në këtë raport, si dhe nga komuniteti i angazhuar në ndryshimet klimatike në përgjithësi. I njëjti është nxjerrë nga Platforma Evropiane për Përshtatje Klimatike. Platforma përmbledh termet më relevante nga raportet e ndryshme, përfshirë raportet e vlerësimit të katërt të IPCC të përpiluara nga grupet e ndryshme punuese (grupet punuese I, II dhe III) dhe raportet e UN ISIDR.

Ndryshimet e menjëhershme klimatike
Jolinearitet i sistemit klimatik mund të sjellë ndryshime të menjëhershme klimatike, të cilat nganjëherë quhen ndryshime të shpejta klimatike, ngjarje të papritura apo dhe befasi. Termi i menjëhershëm i referohet afateve kohore më të shpejta se sa koha tipike që i nevojitet forcës së caktuar. Megjithatë, jo të gjitha ndryshimet e menjëhershme klimatike janë të sforcuara nga jashtë. Nganjëherë ngjarjet e papritura të mundshme që janë propozuar përfshijnë riorganizimin dramatik të qarkullimit termohalin ("Termohalin" i referohet rrjedhjes së ujit të oqeanit të shkaktuar nga ndryshimet në dendësinë. Kjo mund të ndodhë se oqeani ngrohet ose ftohet në sipërfaqe nga rrezatimi dhe kontakti me atmosferën, ose me shtimin e ujit të freskët (shi, borë, dhe derdhja e lumenjëve) ose kripës (nga formimi i akullit në det), shkrirjen e shpejtë të masave të mëdha të akullnajave të përhershme apo respirimin e tokës që rezulton ndryshim të shpejtë të ciklit të karbonit. Ngjarje tjera mund të jenë edhe ato që janë vërtetë të papritura, e që rezultojnë nga sforcimi i shpejtë i sistemit jolinear i cili ndryshon me shpejtësi.

Përshtatja
Përshtatja është përshtatje e sistemeve natyrore apo njerëzore si reagim ndaj nxitjeve aktuale apo të pritura klimatike apo efekteve të tyre, me të cilat zbuten efektet e dëmshme apo shfrytëzohen mundësitë e dobishme. Mund të dallohen lloje të ndryshme të përshtatjes, përfshirë përshtatjen pararake, autonome dhe të planifikuar.

Kapaciteti i përshtatjes (në lidhje me ndikimet e ndryshimeve klimatike)
Kapaciteti i përshtatjes përshkruan aftësinë e një sistemi për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike (përfshirë variabilitetin dhe ekstremet klimatike) për të zbutur dëmet potenciale, shfrytëzuar mundësitë apo për t'u përballë me pasoja.

Informatat bazike/referente
Informatat bazike (apo referente) paraqesin gjendjen kundrejt së cilës matet ndryshimi. Ato shfaqen në formë të 'informatave bazike aktuale' në ç'rast paraqesin gjendjen aktuale të vrojtueshme. Ato mund të jenë edhe 'informata bazike të ardhshme', të cilat janë informata mbi gjendjen e projektuar por që nuk marrin parasysh faktorin shtytës të interesit. Interpretimet e ndryshme të gjendjes referente mund të rezultojnë me informata bazike të ndryshme.

Klima
Në kuptim të ngushtë klima zakonisht përkufizohet si 'moti mesatar', apo edhe më saktë si përshkrim statistikor i sasive relevante mesatare dhe të ndryshueshme brenda një periudhe kohore, nga disa muaj e deri tek mijëra e miliona vjet. Këto sasi janë më së shpeshti variabla sipërfaqësore si temperatura, reshja dhe era. Klima në kuptim më të gjerë nënkupton gjendjen e sistemit klimatik, përfshirë përshkrimin statistikor të tij. Periudha kohore e përdorur më së shpeshti nga Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM) është 30 vite.

Ndryshimet klimatike
Ndryshimet klimatike i referohen të gjitha ndryshimeve të klimës përgjatë kohës, qoftë për shkak të ndryshimeve natyrore apo si rezultat i aktivitetit njerëzor. Ky përdorim i këtij termi dallon nga ai i përshkruar në Konventën Kornizë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshime Klimatike (UNFCCC), e cila e përkufizon 'ndryshimin klimatik' si: 'ndryshim i klimës i cili i atribuohet drejtpërsëdrejti apo tërthorazi veprimtarisë njerëzore që ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe e cila vjen si shtesë ndaj ndryshimeve të rëndomta klimatike të vrojtuara përgjatë një periudhe të caktuar kohore.'

Skenari (i ndryshimit) klimatik
Përfaqësim i mundshëm dhe shpesh i thjeshtësuar i klimës në të ardhmen, në bazë të një seti konsistent të marrëdhënieve dhe supozimeve klimatologjike të sforcimit radial, zakonisht i konstruktuar për përdorim të thjeshtë si e dhënë hyrëse për modelet e ndryshimeve klimatike. 'Skenari i ndryshimeve klimatike' është dallimi mes skenarit klimatik dhe klimës aktuale.

Ndjeshmëria klimatike
Në raportet e IPCC-së, ndjeshmëria e ekuilibrit klimatik i referohet ndryshimit të ekuilibrit në temperaturën mesatare globale të temperaturës, pas çiftëzimit të koncentrimit ekuivalent atmosferik të dioksid karbonit. Për shkak të kufizimeve në kalkulim, ndjeshmëria e ekuilibrit klimatik në modele klimatike kryesisht parashihet përmes përdorimit të modelit të qarkullimit të përgjithshëm atmosferik dhe modelit të oqeanit me shtresa mikse, për shkak se ndjeshmëria e ekuilibrit klimatik përcaktohet nga proceset atmosferike. Modelet efikase mund të shfrytëzohen për të arritur ekuilibër me oqeane dinamike. Ndjeshmëria efektive klimatike është masë e ndërlidhur e cila anashkalon kërkesat e ekuilibrit. Ajo vlerësohet nga rezultati i modelit për evoluimin e kushteve joekuilibruese. Kjo është masë e fuqisë së informatave prapavepruese klimatike në një moment të caktuar kohor dhe mund të ndryshojë si rrjedhojë e sforcimeve dhe gjendjes së klimës. Parametri i ndjeshmërisë klimatike (njësitë: °C (W m–2)–1) i referohen ndryshimeve të ekuilibrit në temperaturën mesatare vjetore globale në sipërfaqe, pas ndryshimit të ndonjë njësie në sforcim radial. Reagimi i menjëhershëm klimatik është ndryshimi i temperaturës globale në sipërfaqe, e nxjerrë si mesatare e një periudhe 20-vjeçare, e përqendruar rreth kohës së çiftëzimit të dioksid karbonit atmosferik, do të thotë, në vitin 70 në një eksperiment me shtim të dioksid të karbonit prej 1% viti-1, çiftëzuar me modelin klimatik. Kjo është masë për fuqinë dhe shpejtësinë e reagimit të temperaturës së sipërfaqes ndaj sforcimeve nga gazrat serrë.

Sistemi klimatik
Sistemi përkufizohet nga dinamikat dhe ndërveprimet e pesë komponentëve kryesorë: atmosferës, hidrosferës, kriosferës, sipërfaqes së tokës dhe biosferës. Dinamikat e sistemit klimatik shtyhen nga sforcime të jashtme dhe të brendshme, siç janë erupsionet vullkanike, ndryshimet solare, apo modifikimet e nxitura nga faktori njeri në balancën radiale planetare, për shembull, përmes emetimit antropogjen të gazrave serrë dhe/apo ndryshimit të destinimit të tokave.

Variabiliteti klimatik
I referohet variacioneve të gjendjes mesatare dhe statistikave tjera (siç janë deviacionet standarde, shfaqja e ekstremeve, etj.) të klimës në të gjitha shkallët hapësinore dhe kohore, përtej atyre që shkaktohen nga evenimente individuale të motit. Variacionet mund të shfaqen

për shkak të proceseve natyrore të brendshme brenda sistemit klimatik (variacion i brendshëm), apo variacioneve në sforcime natyrore apo antropogjene të jashtme (variacion i jashtëm).

Analiza e kostove dhe përfitimeve
Matja monetare e të gjitha ndikimeve negative dhe pozitive që ndërlidhen me një veprim të caktuar. Kostot dhe përfitimet krahasohen në kuptim të dallimit dhe/ose proporcionit të një indikatori i cili paraqet se si një investim apo politikë e caktuar shpaguhet, nga këndvështrimi i shoqërisë.

Katastrofë
Trazime në funksionimin e komunitetit apo shoqërisë, të cilat shkaktojnë humbje apo ndikime të theksuara njerëzore, materiale, ekonomike apo mjedisore, e me të cilat komuniteti apo shoqëria e prekur nuk ka mundësi të përballet me resurse vetanake. Koment: Katastrofat shpesh përshkruhen si rezultat i kombinimit të: ekspozimit ndaj një rreziku; brishtësisë së pranishme; dhe kapacitetit apo masave të pamjaftueshme për të zvogëluar apo për tu përballë me pasojat negative. Ndikimet nga katastrofat përfshijnë humbjen e jetëve, lëndimet, sëmundjet dhe ndikimet tjera negative në mirëqenien fizike, mendore dhe shoqërore të njerëzve, përcjellë me dëmtim të pronave, shkatërrim të pasurisë, humbje të shërbimeve, trazira shoqërore dhe ekonomike dhe degradim mjedisor. Ka mënyra të ndryshme të përkufizimit të katastrofave. Shih, për shembull, listën e përgatitur për komunitetin e zvogëlimit të ndikimit të katastrofave.

Rreziku nga katastrofat
Humbjet potenciale nga katastrofat të jetëve, statusit shëndetësor, kushteve të jetesës, pasurisë dhe shërbimeve, të cilat mund t'i ngjajnë një komuniteti apo shoqërie të caktuar brenda një periudhe të caktuar kohore në të ardhmen. Përkufizimi i katastrofës pasqyron konceptin e katastrofave si rezultat i kushteve vazhdimisht të pranishme të rrezikut. Rreziku nga katastrofat ngërthen lloje të ndryshme të humbjeve potenciale të cilat shpesh vështirë kuantifikohen. Megjithatë, bazuar në njohjen paraprake të rreziqeve kryesore dhe trendeve të zhvillimit të popullatës dhe zhvillimit socio-ekonomik, rreziqet nga katastrofat mund të parapërcaktohen së paku në aspekt të gjerë.

Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat
Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat nënkupton një proces sistematik të përdorimit të udhëzimeve administrative, organizatave dhe shkathtësive dhe kapaciteteve operative për zbatimin e strategjive, politikave dhe kapaciteteve për përballje me katastrofat, me qëllim të zbutjes së ndikimeve negative të rreziqeve dhe mundësive për shfaqje të katastrofës. Ky term përbën zgjerim të termit më të gjerë 'menaxhimi i rrezikut', ndërsa me të adresohet një rrezik i caktuar potencial. Menaxhimi i rrezikut nga katastrofat ka për qëllim parandalimin, zbutjen apo bartjen e efekteve negative të rreziqeve, përmes aktiviteteve dhe masave parapërgatitore, parandaluese dhe lehtësuese.

Zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat
Koncepti dhe praktika e zvogëlimit të rrezikut nga katastrofat përmes përpjekjeve sistematike për analizimin dhe menaxhimin e faktorëve shkaktarë të katastrofave, përfshirë përmes zvogëlimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, uljes së nivelit të brishtësisë së popullatës dhe pronave, menaxhimit të mençur të tokave dhe mjedisit dhe përgatitjes së shtuar për tu përballë me ndikime negative.

Skenarët e emetimit

Skenari i emetimit është paraqitje e mundshme e trendeve të ardhme të emetimit të substancave të cilat kanë rrezatim potencialisht aktiv (p.sh. gazrat serrë, aerosolet), në bazë të parashikimeve të qëndrueshme lidhur me forcat shtytëse (siç janë zhvillimi demografik dhe socioekonomik, ndryshimet teknologjike) dhe marrëdhënieve mes tyre. Skenarët e përqendrimit, të cilat nxirren nga skenarët e emetimit, shpesh shfrytëzohen si bazë për modelin klimatik të kalkulimit të projeksioneve klimatike. Në IPCC (1992) u paraqitën një sërë skenarësh të emetimit të cilët u shfrytëzuan si bazë për projeksionet klimatike në IPCC (1996). Këta skenarë të emetimit janë të njohur si skenarët IS92. Raporti Special i IPCC për Skenarët e Emetimit (Nakienovi dhe Swart, 2000) paraqet skenarë të rinj të emetimit, të ashtuquajturit skenarë SRES, të cilët u publikuan dhe disa prej të cilëve u përdorën mes tjerash si bazë për projektimet klimatike të paraqitura në TAR-IPCC (2001) dhe 4AR-IPCC (2007).

Ngjarje e motit ekstrem
Ngjarja e motit ekstrem është ngjarje e rrallë që shfaqet në një vend dhe kohë të caktuar. Përkufizimi i të termit të rrallë dallon, por ngjarja e motit ekstrem zakonisht është më e rrallë se sa percentili i 10-të apo 90-të i probabilitetit të vrojtuar të funksionit të densitetit. Sipas përkufizimit, karakteristikat e asaj që konsiderohet mot ekstrem mund të ndryshojnë nga vendi në vend në aspekt absolut. Ngjarjet e motit ekstrem nuk mund t'i atribuohen drejtpërdrejt vetëm ndryshimeve klimatike antropogjen, pasi që gjithmonë ekzistojnë gjasat që ngjarja të jetë shfaqur në mënyrë të natyrshme. Kur një trend i motit ekstrem shfaqet për një periudhë më të gjatë, për shembull gjatë një stine, ai mund të klasifikohet si ngjarje e motit ekstrem, në veçanti nëse rezulton me një mesatare apo total që në vete është ekstreme (p.sh. thatësi apo reshje të mëdha gjatë një stine të caktuar).

Ngrohja globale
Ngrohja globale i referohet shtimit gradual, të vrojtuar apo projektuar, të temperaturës sipërfaqësore globale, si një nga rrjedhojat e rrezatimit të shkaktuar nga emetimet antropogjene.

Efekti serrë
Gazrat serrë janë efektive në absorbimin e rrezatimit termik infra të kuq të emetuar nga sipërfaqja e Tokës dhe retë, për shkak të përbërjes së gazrave të njëjtë. Rrezatimi atmosferik emetohet në të gjitha anët, do të thotë edhe poshtë në drejtim të sipërfaqes së Tokës. Andaj, gazrat serrë mbajnë nxehtësinë brenda sistemit të sipërfaqes-troposferës. Kjo quhet efekti serrë. Rrezatimi termik infra i kuq në troposferë fuqimisht çiftëzohet me temperaturën nga atmosfera në lartësinë në të cilën emetohet. Në troposferë, temperatura gradualisht zvogëlohet me rritjen e lartësisë. Efektivisht, rrezatimi infra i kuq i emituar në hapësirë e ka origjinën në lartësinë e temperaturës prej mesatarisht -19 °C, duke u balancuar me neto rrezatimin solar, ndërsa në sipërfaqen e Tokës ai mbahet në temperatura shumë më të larta (mesatarisht +14 °C). Ngritja e përqendrimit të gazrave serrë rezulton me rritjen e perdes infra të kuqe në atmosferë, e rrjedhimisht edhe me rrezatim efektiv në hapësirë nga një lartësi më e madhe dhe një temperaturë më e ulët. Kjo shkakton rrezatim të sforcuar që shpie tek rritja e efektit serrë - i ashtuquajturi efekti i shtuar serrë.

Gazrat serrë (GS)
Gazrat serrë janë ato përbërje gazoze të atmosferës, natyrore dhe antropogjene, të cilat absorbojnë dhe emetojnë rrezatim në breza valorë specifikë brenda spektrit të rrezatimit infra të kuq të emetuar nga sipërfaqja e Tokës, atmosfera dhe retë. Ky tipar shkakton efektin serrë. Avulli i ujit (H_2O), dyoksidi i karbonit (CO_2), oksidi i nitratit (N_2O), metani (CH_4) dhe ozoni (O_3) janë gazrat primarë serrë në atmosferën e Tokës. Për më tepër, në atmosferë ekzistojnë një numër i

gazrave serrë që janë tërësisht të gjeneruar nga faktori njeri, siç janë halikarbonet dhe substancat tjera që përmbajnë klor dhe bromin, e të cilat trajtohen nga protokolli i Montrealit. Përkrah CO2, N2O dhe CH4, Protokolli i Kjotos trajton gazrat serrë të heksafluorit të sulfurit (SF6), karboneve të fluorit të lëngshëm (HFC) dhe perfluorkarbonet (PFC).

Rreziku
Fenomen, substancë, aktivitet njerëzor apo gjendje që mund të rezultojë me humbje të jetës, lëndim apo ndikim tjetër shëndetësor, humbje të pronave, humbje të mjeteve të jetesës apo shërbimeve, trazira sociale dhe ekonomike apo dëmtim të mjedisit.

Gjasat
Gjasat përshkruhen si ngjarje, rezultat apo rrjedhojë që mund të parashihet me probabilitet.

Keqpërshtatja
Veprimi apo investimi që shton brishtësinë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe nuk e zvogëlon atë. p.sh. marrë parasysh ngritje e nivelit të detit, do të ishte keqpërshtatje nëse në brigjet e ulëta bregdetare ndërtohet infrastrukturë e re (UKCIP).

Masat
Masat të përshtatjes janë teknologji, procese dhe aktivitete të drejtuara nga shtimi i kapacitetit për tu përshtatur (ndërtuar kapacitete të përshtatjes) dhe nga minimizimi, përshtatja dhe shfrytëzimi i përparësive që i ofron Ndryshimet klimatike (realizimi i përshtatjes).

Masa zbutëse
Intervenim antropogjen me qëllim të zvogëlimit të sforcimit antropogjen mbi sistemin klimatik; të njëjtat përfshijnë strategji dhe masa për zvogëlimin e burimeve dhe emetimeve të gazrave serrë dhe në shtimin e sifoneve të gazrave serrë. Shembuj të masave zbutëse janë teknologjitë e energjisë së ripërtëritshme, proceset e minimizimit të mbeturinave dhe praktikat e komunikimit përmes transportit publik, etj.

Rrezik natyror
Proces apo fenomen natyror që mund të shkaktojë humbje të jetës, lëndim apo ndikim tjetër shëndetësor, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetës dhe shërbimeve, trazira shoqërore dhe ekonomike, apo dëmtim mjedisor.

Parandalimi
Parandalimi është shmangie e drejtpërdrejtë e ndikimeve negative të rreziqeve dhe katastrofave të ndërlidhura me to. Parandalimi (d.m.th. parandalimi i katastrofave) shpreh konceptin dhe qëllimin e shmangies së plotë të ndikimeve potenciale negative përmes veprimeve paraprake. Shembuj të veprimeve të tilla janë pendat apo argjinaturat të cilat eliminojnë rrezikun nga vërshimet, rregulloret për shfrytëzimi e tokave që nuk lejojnë zhvillimin e vendbanimeve në zona me rrezik të lartë dhe dizajnet inxhinierike sizmike të cilat sigurojnë mbijetesë dhe funksionim të një ndërtese kyçe në rast të tërmetit. Shpesh ndodh që të mos jetë e mundshme shmangia e tërësishme e humbjeve dhe në rast të tillë kjo zëvendësohet me ndërmarrjen e masave zbutëse. Pjesërisht për shkak të kësaj termet parandalim dhe zbutje ndodh të shfrytëzohen për të njëjtin qëllim.

Projeksioni

Evolucioni potencial i një cilësie apo sasie, shpesh i kalkuluar me ndihmë të modeleve. Projeksionet dallohen nga parashikimet, duke theksuar se projeksionet përfshijnë supozime, për shembull sa i përket zhvillimeve teknologjike dhe socio-ekonomike, të cilat mund të mos realizohen. Andaj ato mund të jenë në substancë të pasigurta.

Rezistueshmëria

Rezistueshmëria përshkruan aftësinë e një sistemi shoqëror apo ekologjik për t'i absorbuar trazirat, duke ruajtur në të njëjtën kohë strukturën themelore dhe mënyrat e veta të veprimit, kapacitetin për vetëorganizim dhe kapacitetin për t'iu përshtatur ndryshimit apo pengesës.

Risku

Risku është kombinim i probabilitetit të një ngjarjeje dhe pasojave negative të saj. Ky përkufizim është i përafërt me përkufizimin e Udhëzimit 73 të ISO/IEC. Fjala 'risk' ka dy konotacione të ndryshme: në përdorim popullor theksi zakonisht vëhet në konceptin e gjasave apo mundësisë, për shembull 'risku nga një aksident'; ndërsa në mjedise teknike, theksi vëhet zakonisht në pasojat, në kuptim të 'humbjeve potenciale' nga një shkaktar i caktuar, në një vend apo kohë të caktuar. Mund të theksohet se njerëzit zakonisht nuk kanë të njëjtat perceptime sa i përket rëndësisë dhe shkaqeve të riskut të natyrave të ndryshme.

Skenari

Përshkrim i mundshëm dhe shpesh i thjeshtësuar i asaj se si e ardhmja mund të duket, në bazë të një sërë supozimesh koherente dhe konsistente lidhur me forcat shtytëse dhe marrëdhëniet kryesore mes tyre. Skenarët mund të rrjedhin nga projeksionet, por shpesh bazohen në informata shtesë nga burimet tjera, nganjëherë të kombinuara me narracione.

Skenarët socio-ekonomikë

Skenarët lidhur me gjendjen e ardhshme të popullatës, bruto prodhimit vendor dhe faktorëve tjerë socio-ekonomikë që janë relevantë për të kuptuar ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Pragu

Pragu është niveli i një procesi sistematik në të cilin shfaqet ndonjë ndryshim i papritur apo i shpejtë. Pika apo niveli në të cilin shfaqen tipare të reja në një sistem ekologjik, ekonomik apo tjetër, të cilët i bëjnë të pavlefshme parashikimet e bazuara në marrëdhënie matematikore e të cilat janë të aplikueshme në nivele më të ulëta.

Pasiguria

Shprehje e masës deri në të cilën një vlerë (p.sh. gjendja e ardhshme e sistemit klimatik) mbetet e panjohur. Pasiguria mund të rezultojë nga mungesa e informatave apo nga mosmarrëveshjet lidhur me atë që është e ditur apo madje edhe mbi atë që mund të dihet. Pasiguria mund të ketë shumë burime të ndryshme, nga gabimet sasiore të të dhënave deri tek konceptet apo terminologjia e përkufizuar në mënyrë të dykuptimtë, apo tek projeksionet e pasigurta sa i përket sjelljes njerëzore. Andaj, pasiguria mund të paraqitet me masa kuantitative, për shembull, si varg i vlerave të kalkuluara përmes modeleve të ndryshme, apo si deklarata kualitative, të cilat për shembull pasqyrojnë gjykimin e një ekipi ekspertësh.

Brishtësia

Brishtësia është shkalla deri në të cilën një sistem i caktuar preket nga (apo nuk është gjendje të përballet me) efektet negative të ndryshimeve klimatike, përfshirë variacionet dhe ekstremet klimatike. Brishtësia është funksion i karakterit, përmasës dhe normës së ndryshimeve klimatike

dhe variacionit ndaj të cilit ekspozohet një sistem i caktuar, ndjeshmërisë së tij dhe kapaciteteve të përshtatjes të të njëjtit.

Shtojca 2: Formularët e intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët (përshkrim i VAKZ prioritarë)

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr.1		
Themelimi i një sistemi kombëtar të regjistrimit të gazrave serrë dhe fuqizimi i raportimit mbi to (AMMK)		
Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit): Veprim i mundshëm	**Lokacioni:** Në tërë Kosovën	**Lloji i intervenimit:** Ngritja e kapaciteteve Instrumentet rregullative
Objektivat: - Ngritja e kapaciteteve lokale për grumbullim dhe raportim e të dhënave, - Zhvillimi i regjistrit të gazrave serrë për përdorim të mëtejmë në të ardhmen nën UNFCCC, duke përfshirë vitin bazë		
Përshkrim i veprimeve: Krijimi i 'sistemit kombëtar të regjistrimit' dhe 'sistemit për politika, masa dhe projeksione' në bazë të nenit 3 (2) dhe (15) të Rregullores së BE-së Nr. 525/2013 mbi mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e emetimeve të gazrave serrë dhe për raportimin dhe informatat tjera relevante mbi ndryshimet klimatike në nivel të shteteve dhe Bashkimit. Kjo nënkupton se brenda shteteve anëtare duhet të themelohet një sistem institucional, ligjor dhe procedural për parashikimin e emetimeve antropogjene dhe për largimin e sifoneve të gazrave serrë të cilat nuk kontrollohen përmes Protokollit të Montrealit, si dhe për raportimin dhe arkivimin e informatave nga regjistri në pajtim me Vendimin 19/CMP.1 dhe vendimet tjera relevante të organeve të UNFCCC apo Protokollit të Kjotos; Duhet të themelohet sistemi i aranzhimeve institucionale, ligjore dhe procedurale për raportimin e politikave, masave dhe projeksioneve të emetimeve antropogjene nga burimet e ndryshme dhe për largimin e sifoneve të gazrave serrë të cilat nuk kontrollohen përmes Protokollit të Montrealit, ndërsa Sistemi Kombëtar i Regjistrit të Emetimeve të gazrave serrë duhet gjithashtu të: - Adresojë raportimin mbi projeksionet, politikat dhe masat dhe të sigurojë konsistencë me instrumentet tjera ligjore që trajtojnë ndotësit e ajrit. - Kjo paraqet një mënyrë më efikase, përkundër barrës që ndërlidhet me të, ngase do të sigurojë pajtueshmëri më të mira afatgjate, thjeshtësim dhe kosto më të ulëta. - Propozimi poashtu përfshin dispozita më të mira për sigurim të cilësisë/kontroll të cilësisë dhe integrim me formatet dhe udhëzimet e raportimit, për të ngritur cilësinë dhe kompletimin e të dhënave të siguruara si dhe për të thjeshtësuar kërkesat aktuale të raportimit pa shtuar barrën administrative. Ky sistem do të krijohet brenda MMPH dhe AMMK.		
Rezultatet e pritura/ndikimet: Raportimi vjetor mbi emetimet e gazarave serrë tek AEE dhe rrjedhimisht tek UNFCCC		
Përgjegjësitë: - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë		

Përfitimet e pritura: Baza për caktimin e objektivave të zvogëlimit të emetimit të gazrave serrë dhe formulimi i politikave klimatike në të ardhmen		
Kostoja e përgatitjes: 100 000 EUR	**Kostoja e investimit:** 1,5 milion EUR	**Periudha e investimit:** 2014 - 2020
Burimet e pritura të financimit: - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë - Donatorë të jashtëm: BE, TAIEX, IPA		

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 2

Implementimi i Planit të Veprimit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë 2010-2018

Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit): Rreth 0,7 Mt	**Lokacioni:** Në tërë Kosovën	**Lloji i intervenimit:** Rregullativ Instrumente ligjore dhe planifikuese Mekanizëm financues

Objektivi:

Kursimi i 81,89 ktoe energji deri në vitin 2018, apo 9% krahasuar me konsumin mesatar gjatë periudhës vjetore 2003 - 2007, në pajtim me Direktivën 2006/31/EC

Përshkrim i veprimeve:

Plani i veprimit përfshin masa për sektorët në vijim:

Sektori	Kostoja e parashikuar EUR	Kontributi në kursimin e energjisë 2010 – 2012 %
Amvisëritë	10 385 000	40
Shërbimet	7 239 125	30
Industria	Përfshirë në buxhetin për amvisëritë	25
Transporti	Përfshirë në buxhetin për amvisëritë	4,5
Bujqësia	Përfshirë në buxhetin për amvisëritë	0,5
Gjithsej	17 624 125	100

Në sektorin e amvisërive përfshihen masat rregullative, të ndërtimit të kapaciteteve, komunikimit dhe financimit të listuara më poshtë:

- Termorenovimi,
- Vendosja e GLN për gatim dhe ngrohje,
- Promovimi i kogjenerimit efikas të ngrohjes dhe rrymës,
- Promovimi i ngrohjes qendrore dhe të qytetit,
- Promovimi i bojlerëve të rinj dhe efikas,
- Panelet solare për ngrohje të ujit,
- Shfrytëzimi i pajisjeve efiçiente në amvisëri.

Për sektorin e shërbimeve planifikohen intervenime në fushat vijuese:

- Përmirësimi i pagimit të energjisë elektrike,
- Vendosja e sistemeve të ngrohjes dhe gatimit me naftë dhe GLN,
- Përmirësimi i izolimit termal në ndërtesa private dhe publike
- Panelet solare për ngrohje të ujit,

- Vendosja e skemës së gjenerimit të kombinuar të ngrohjes dhe rrymës nga TPP Kosova B,
- Krijimi i sistemeve të vegjël të gjenerimit qendror të kombinuar të ngrohjes dhe rrymës,
- Auditimet energjetike në ndërtesa publike dhe private
- Përmirësimi i pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe menaxhimit të energjisë.

Në industri pritet që përfitime në efiçiencë të energjisë të arrihen përmes investimeve në këtë sektor. Përveç kësaj janë planifikuar edhe masat në vijim:

- Promovimi i EE në NVM
- Auditimet e energjisë

Transporti dhe bujqësia do të trajtohen kryesisht përmes ndërgjegjësimit dhe studimit të masave të mundshme të efiçiencës së energjisë.

Rezultatet e pritura/ndikimet:
- Realizimi i programeve për ngritje të kapaciteteve
- Miratimi dhe implementimi i udhëzimeve administrative dhe rregulloreve tjera
- Krijimi i sistemeve të auditimit të energjisë
- Vendosja e instrumenteve financiare, siç janë kreditë

Përgjegjësitë:
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Autoritetet komunale
- Bankat

Përfitimet e pritura:
- Zvogëlimi i varfërisë energjetike
- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit të energjisë elektrike
- Zvogëlimi i ndotjes së ajrit

Kostoja e përgatitjes:	**Kostoja e investimit:**	**Periudha e investimit:**
E përfunduar	17,6 milion EUR	2010 - 2018

Burimet e pritura të financimit:
- Buxheti i qeverisë
- Buxheti i autoriteteve lokale
- Donatorët e huaj: BE, KfW, BB, BERZH, GIZ
- Bankat: Pro-Credit, Raiffeisen,
- Sektori i bizneseve (vendor dhe i huaj)
- Amvisëritë

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 3

Implementimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (PKVBRE) 2011 - 2020

Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit):	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
n.a.	Në tërë Kosovën	- Rregullativ - Financiar

Objektivat:

PKVBREE përkufizon caqet për tre sektorë: gjenerimin e energjisë elektrike, transportin dhe sektorin e ngrohjes dhe ftohjes.

- 25.64 % të BRE në konsumin final të energjisë elektrike
- 10% të BRE në konsumin final të energjisë në transport
- 45.65% të BRE në konsumin final bruto për ngrohje dhe ftohje

Përshkrim i veprimeve:

Arritja e caqeve vjetore të energjisë nga BRE pritet të arrihet përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja për gjenerimin e energjisë që shfrytëzojnë teknologji të ndryshme BRE, edhe atë në të tre sektorët: energji elektrike, energji termike për ngrohje dhe ftohje, dhe transport. Janë paraparë edhe kapacitetet vijuese të gjenerimit të cilat do të përkrahin arritjen e cakut të energjisë nga BRE deri në vitin 2020:

- 25.64 % të BRE në konsumin bruto të energjisë elektrike do të arrihet përmes ndërtimit të kapaciteteve vijuese të gjenerimit:

Në sektorin e energjisë elektrike, gjenerimi nga BRE shtohet si rrjedhojë e zhvillimit të hidrocentraleve të vogla dhe të mëdha: 240 MW nga hidrocentralet e vogla; 305 MW nga HC Zhurni, 150 MW nga era, 14 MW nga biomasa, dhe 10 MW nga centralet fotovoltaike. Sektori i energjisë elektrike kontribuon për të arritur cakun e përgjithshëm të BRE me 10.1%.

- 10 % të BRE në konsumin final në transport do të arrihet përmes shfrytëzimit të biokarburantëve, siç përcaktohet me UA për shfrytëzimin e biokarburantëve në transport.

Caku sektorial i BRE në transport kalkulohet në pajtim me nenin 3(4) të Direktivës 2009/28/EC dhe është 10%. Megjithatë, norma reale e konsumit të gjithmbarshëm të energjisë në transport (e cila është e më e lartë se sa vlera e kalkuluar sipas nenit 3(4) për shkak të shfrytëzimit të kerozinës, naftës për aviacion dhe vajrave në transport), është e caktuar në normë prej 9.24%. Kontributi i këtij sektori në arritjen e cakut të përgjithshëm është 2.1%.

- 45.65 % të BRE në konsumin final për ngrohje dhe ftohje do të arrihet përmes zhvillimit të kapaciteteve të reja të gjenerimit, si në vijim:

70MWth nga energjia solare, 10MWth nga pompat termike.

Sektori i ngrohjes dhe ftohjes do të kontribuojnë në arritjen e cakut të përgjithshëm të BRE për vitin 2020 me 17.2 për qind. Kontributi më i madh vjen nga shfrytëzimi tradicional i biomasës (drurit për ngrohje), i cili do vazhdojë të përbëjë burimin më të rëndësishëm të ngrohjes në Kosovë.

Rezultatet e pritura/ndikimet:

- Korniza rregullative në pajtim me direktivat relevante të BE-së për promovimin dhe joshjen e investimeve për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme.
- Potencialet për energji të ripërtëritshme në bazë të hulumtimeve të avancuara dhe metodologjive të matjes për të gjitha burimet e lartpërmendura.

Përgjegjësitë:

- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Autoritetet komunale
- Agjencia e Pyjeve e Kosovës
- KOSTT
- KEDS

Përfitimet e pritura:

- Ngritja e kapaciteteve në fushën e energjisë së ripërtëritshme
- Zhvillimi i bizneseve dhe vendeve të punës në sektorin e energjisë së ripërtëritshme
- Qasja ndaj politikave energjetike dhe mjedisore të BE-së

- Më pak import i karburanteve fosile

Kostoja e përgatitjes:	**Kostoja e investimit:**	**Periudha e investimit:**
Nuk është e aplikueshme	Nuk është e aplikueshme	2011 - 2020

Burimet e pritura të financimit:
Kosova planifikon të arrijë cakun e gjithmbarshëm përmes burimeve vendore; pra nuk parashihet shfrytëzimi i mekanizmave të bashkëpunimit.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 4

Ngritja e efiçiencës së prodhimit të energjisë elektrike përmes zëvendësimit të TC Kosova A me TC Kosova e Re

Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit):	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Do të ketë zvogëlim specifik të CO2 (rreth 37%), mirëpo për shkak të prodhimit më të madh nga TC i ri (për rreth 50%), emetimi i CO2 do të shtohet për rreth 22%.	Obiliq	Projekt infrastrukturor

Objektivat:
Zvogëlimi i intensitetit të karbonit duke përmirësuar efiçiencën e konvertimit dhe kogjenerimin.

Përshkrim i veprimeve:
Sipas dokumenteve strategjike, Kosova planifikon të ndërtojë kapacitete të reja për prodhimin e energjisë elektrike nga thëngjilli (2x300MW).

Ndërtimi i kapaciteteve të reja duhet të analizohet në kontekst të zëvendësimit të kapaciteteve të TC Kosova A (njësitë A3, A4, A5 të ndërtuara gjatë viteve 1970-1975) me kapacitete të reja, me teknologji më efiçiente dhe më të avancuar, që mundëson kogjenerimin. Ky projekt është përfshirë edhe në listën e Projekteve me Interes për Komunitetin e Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave i KTE në tetor 2013.

Rezultatet e pritura/ndikimet:
- Emetimet e CO2 nga TC Kosova A janë mes 1.4-1.5 ton/MWh, ndërsa pritet që TC i ri të emetojë 0.92 ton/MWh, ose për 37% më pak se TC Kosova A.
- Përmes aplikimit të teknologjisë së kogjenerimit (prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe asaj termike), do të jetë e mundshme që të zvogëlohet dukshëm shfrytëzimi i energjisë elektrike për ngrohje në Prishtinë. Rreth 1800GWh/vit energji elektrike konsumohet vetëm për ngrohje!

Përgjegjësitë:
- Qeveria e Kosovës
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik/Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Përfitimet e pritura:
- Siguri më e lartë sa i përket prodhimit të energjisë elektrike,
- Furnizim i sigurt,
- Shfrytëzim racional i resurseve minerare,
- Emetim më i ulët i hirit fluturues dhe gazrave tjera të dëmshme,
- Qëndrueshmëri më e lartë e zhvillimit ekonomik.

Kostoja e përgatitjes: Është pjesë e kostos së studimeve për ndërtimin e TC të ri.	**Kostoja e investimit:** 1,2 – 1,5 miliardë EUR Kapaciteti i planifikuar: 2x300 MW	**Periudha e investimit:** 2014 - 2019
Burimet e pritura të financimit: - Buxheti i qeverisë - Donatorët ndërkombëtarë - Sektori i biznesit (vendor, ndërkombëtar)		

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr.5		
Parandalimi i vetëndezjes së linjitit në minierat e thëngjillit në Kosovë		
Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit): Nuk ka të thëna mbi sasinë e emetimeve të gazrave nga vetëndezja e linjitit, por supozohet se ky fenomen ka ndikim të theksuar në emetimin e CO2 dhe NH4. Përmes masave të propozuara, ky emetim mund të ulet për 90%.	**Lokacioni:** Mihjet sipërfaqësore të linjitit	**Lloji i intervenimit:** Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe sigurimi i pajisjeve të domosdoshme shtesë.
Objektivat: Parandalimi i emetimit të CO2 dhe NH4 nga vetëndezja e linjitit.		
Përshkrim i veprimeve: Në kontekst të aspekteve të menaxhimit mjedisor dhe operativ, në miniera do të krijohen ekipe speciale për trajnime për të luftuar zjarret dhe për të parandaluar vetëndezjen. Për këtë qëllim do të blihen pajisje shtesë.		
Rezultatet e pritura/ndikimet: Ndërprerja dhe parandalimi i vetëndezjes së linjitit dhe rrjedhimisht parandalimi i emetimit të CO2 dhe NH4.		
Përgjegjësitë: - Implementimi: KEK, respektivisht Divizioni për Prodhim të Thëngjillit - Mbikëqyrja: MMPH, respektivisht inspektorati mjedisor		
Përfitimet e pritura: - Përmirësimi i cilësisë së ajrit, që ka rëndësi të veçantë për punonjësit, por edhe për banorët e vendbanimeve përreth. - Shtimi i stabilitetit të rrëpirave dhe sigurisë. - Shmangia e humbjeve të një sasie të caktuar të thëngjillit nga vetëndezja.		
Kostoja e përgatitjes: Kostoja e trajnimit: 50.000 – 100.000 (€)	**Kostoja e investimit:** Falë donacionit nga KE, në vitin 2005/2006 janë blerë pajisjet për luftimin e zjarreve në miniera.	**Periudha e investimit:** Investime të vazhdueshme nën kuadrin e menaxhimit mjedisor.
Burimet e pritura të financimit: Korporata Energjetike e Kosovës - Divizioni për Prodhimin e Thëngjillit		

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 6

Shfrytëzimi i mbeturinave të ngurta të parrezikshme (mbeturinat komunale, gomat, ...) si karburant alternativ në prodhime industriale

Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit):	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Mbetet të përcaktohet	Në tërë Kosovën Industria e çimentos	- Korniza politike - Studimi i fizibilitetit - Investimi

Objektivat:

Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm në aspekt financiar dhe mjedisor për shfrytëzimin e mbeturinave të ngurta të cilat janë të parrezikshme si burim i energjisë së ripërtëritshme në industrinë e çimentos, dhe menaxhimi i mbeturinave që do t'i përgjigjet nevojave aktuale dhe të ardhme të ekonomisë së Kosovës.

Përshkrim i veprimeve:

Mbeturinat e ngurta komunale (MNK) përbëjnë burim të rëndësishëm të emetimit të metanit në momentin kur depozitohen. Kjo mund të shmanget duke shfrytëzuar norma më të larta të riciklimit dhe kompostimit, apo duke i shfrytëzuar mbeturinat si burim të energjisë. Tharëset e çimentoreve, për shkak të kohës së gjatë të mbajtjes, paraqesin metodën më të pranueshme në aspekt mjedisor dhe ekonomik për përdorimin e mbeturinave. Industria e çimentos në Kosovë do të mund të shfrytëzonte të gjitha mbeturinat komunale dhe mbeturinat tjera të parrezikshme, siç janë gomat e automjeteve, si burim të energjisë pa bërë ndonjë investim të madh. Ky veprim përfshinë:

- Zhvillimin e një plani strategjik për menaxhimin e mbeturinave
- Zhvillimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave
- Optimizimin e sistemeve të grumbullimit të mbeturinave komunale
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave
- Studimin e fizibilitetit për bashkë-përpunimin e mbeturinave në industri dhe përmes djegies

Rezultatet e pritura/ndikimet:

Zvogëlimi i emetimet si rrjedhojë e zëvendësimit të karburanteve fosile (mazutit) me burime të ripërtëritshme të energjisë (mbeturina)

Vëllim i reduktuar i mbeturinave komunale dhe kërkesë më e ulët për hapësira për deponi.

Përgjegjësitë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave
- Sektori i industrisë (industria e çimentos...)
- Partneritetet publike-private

Përfitimet e pritura:

- Zvogëlim i konsumit të energjisë dhe importeve të karburanteve fosile në industrinë e çimentos.
- Shmangia e investimeve në deponi.
- Kursimi i resurseve dhe ulja e sasisë të emetimeve dhe mbeturinave.
- Përmirësimi i konkurrueshmërisë së industrisë së çimentos.

Kostoja e përgatitjes:	**Kostoja e investimit:**	**Periudha e investimit:**
Studimet e fizibilitetit dhe përgatitja e një plani për impiantin prodhues nga mbeturinat komunale AF (RDF)	Kostoja e gjithmbarshme e përdorimit të mbeturinave komunale për prodhim të çimentos: 1.621.050 €	2014-2017

Burimet e pritura të financimit: - Buxheti i qeverisë - Buxheti i autoriteteve lokale - Donatorët e huaj - Sektori i industrisë		
Konceptet e qëndrueshme të mobilitetit në qytete dhe qyteza të Kosovës		
Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit): Veprim i mundshëm	**Lokacioni:** - Prishtina dhe qytetet tjera kryesore	**Lloji i intervenimit**: - Ngritje e kapacitetit - Instrumentet ligjore dhe planifikuese - Pilot-projekte infrastrukturore
Objektivat: Fillimi i planifikimit të mobilitetit të qëndrueshëm dhe promovimi i tij në qendrat më të populluara të Kosovës		
Përshkrim i veprimeve: Ngritja e nivelit të kapaciteteve lokale dhe kombëtare për planifikim të mobilitetit. Zhvillimi dhe realizimi i koncepteve të qëndrueshme të transportit për Prishtinën dhe qytetet tjera, në përputhje me programin EU CIVITAS, në bazë të përvojave pozitive me themelimin e zonave të këmbësorëve. Promovimi i ecjes, çiklizmit dhe transportit publik.		
Rezultatet e pritura/ndikimet: Realizimi i së paku një pilot-veprimi për qytet apo qytezë.		
Përgjegjësitë: - Komunat - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Ministria e Transportit		
Përfitimet e pritura: - Zvogëlimi i ndotjes së ajrit në qytete, ulja e numrit të vdekjeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ndotja, në pajtim me Direktivën e BE-së për Cilësinë e Ajrit. - Shtimi i cilësisë së jetës dhe atraktivitetit në zonat urbane - Përmirësimi i sigurisë në trafik		
Kostoja e përgatitjes: 100 000 EUR	**Kostoja e investimit**: 2 milion EUR	**Periudha e investimit:** 2014 - 2020
Burimet e pritura të financimit: - Buxheti i autoriteteve lokale - Donatorët e huaj: BE		

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 7		
Metodat e depozitimit, përgatitjes dhe aplikimit të plehut organik		
Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit): Duhet të përcaktohet	**Lokacioni:** - Në tërë Kosovën (fermat ekzistuese dhe të reja të	**Lloji i intervenimit:** - Mekanizëm financues - Projekt infrastrukturor

	bagëtive)	- Studim i fizibilitetit

Objektivi:

- Realizimi i depozitimit modern të plehut organik në ferma të bagëtive.
- Përmirësimi i menaxhimit të plehut organik që i kontribuon zvogëlimit të emetimeve të NOx dhe metanit
- Mundësimi i gllabërimit të biogazit në ferma

Përshkrim i veprimeve:

Trajtimi i plehut organik të bagëtive, depozitimi dhe menaxhimi i tij janë pjesë shumë e rëndësishme e çdo veprimtarie në blegtori. Përfitimet nga depozitimi i plehut organik janë mes tjerash përmirësimi/mbrojtja e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, përmirësimi i menaxhimit të vlerave ushqyese, dhe eliminimi i shpërndarjes së tyre.

Përbërja ushqyese e plehut organik dallon dhe varet nga një sërë faktorësh. Një nga faktorët kryesorë është depozitimi dhe puna me pleh organik. Për shkak të kësaj, dizajnimi dhe menaxhimi i mirëfilltë i depozitimit të plehut organik janë veprimtari kryesore e çdo sistemi prodhues blegtor. Strukturat për depozitimin e tij kanë rol të rëndësishëm për zvogëlimin e rrjedhjes së mineraleve nga ahuret dhe depozitat e plehut organik në ujëra sipërfaqësore apo nëntokësore, si dhe zvogëlimi i nivelit të avullimit të amoniakut. Trajnimi/ngritja e kapaciteteve mbi përdorimin e plehut organik dhe llumit janë aset i vlefshëm për çdo punim të tokës bujqësore në rast se bëhet si duhet (me kohë, me sasi dhe cilësi adekuate). Depozitimi adekuat i plehut organik përbën parakusht për gllabërimin dhe shfrytëzimin e biogazit në ferma. Veprimtaria përkatëse përfshin:

- Krijimin e një depozite moderne të plehut organik në nivel të fermës së bagëtive.
- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve për përdorim të mirëfilltë të stabilimenteve dhe pajisjeve për trajtimin e plehut organik.
- Studimi i fizibilitetit mbi potencialin për përdorimin e plehut organik në prodhimin e biogazit.
- Pilot-sistemet për gllabërimin e biogazit.

Rezultatet e pritura/ndikimet:

- Shtimi i numrit të depozitave moderne të reja të plehut organik - monitorimi i tyre.
- Shtimi i numrit të sistemeve të gllabërimit të biogazit, që i kontribuon zvogëlimit të emetimit të metanit.
- Ulja e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga rrjedhjet e mineraleve të plehut organik - zvogëlimi i numrit të pikave të ndotura
- Depozitimi i plehut organik lejon përdorimin e tij me në pajtim me kërkesat e mbjellave - cilësia dhe sasia e plehut organik
- Shtimi i mundësive për të vendosur dhe kontrolluar një sistem të përdorimit të balancuar të plehut artificial në tokë.

Përgjegjësitë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Shërbimet këshillëdhënëse,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Komunat,
- Amvisëritë.

Përfitimet e pritura:

- Mbrojtja e mjedisit dhe natyrës
- Ruajtja dhe përdorimi adekuat i plehut të kafshëve, që do të zvogëlojë dukshëm efektet në mjedis (në veçanti emetimin e amoniakut, gazrave serrë dhe erës).
- Përzgjedhja e teknologjisë për përdorimin e plehut të kafshëve është me rëndësi të veçant për të

kufizuar ndikimet mjedisore dhe zvogëluar sasinë e plehut të kafshëve.
- Zhvillimi ekonomik

Kostoja e përgatitjes:	**Kostoja e investimit:**	**Periudha e investimit:**
Studimi i fizibilitetit - përdorimi i plehut organik për prodhimin e biogazit - 200,000 euro	Kostoja e investimit për ndërtimin e depozitave të plehut organik për mesatarisht 15 lopë qumështore është rreth 4.000 euro Total 3 000 000 euro	2014 -2020

Burimet e pritura të financimit:
- Buxheti qeveritar - supozim
- IPA programi për zhvillim rural
- Donatorët e huaj
- Amvisëritë

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët Nr. 8

Implementimi i Strategjisë për Mbrojtjen Klimatike në Sektorin e Pylltarisë në Kosovë

Potenciali i parashikuar për zvogëlim të emetimit (Mt CO2 eq/vit):	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Potenciali i plotë: 2,4 - 3,2 Mt Caku për reduktim për 20%: 0,3 - 1,3 Mt	Në tërë Kosovën	- Ngritja e kapaciteteve - Instrumente ligjore dhe planifikuese - Zbatim - Financim

Objektivi

Të sigurohet rritje afatgjatë e produktivitetit në rritjen e stokut dhe pyjeve, ruajtjen e burimeve pyjore përmes parandalimit të prerjes ilegale të drunjëve, pyllëzimit, ripyllëzimit, ruajtjes së tokës dhe promovimit të shfrytëzimit efikas të burimeve pyjore.

Përshkrim i veprimeve:

Duhet të identifikohen veprime për zbutjen e situatës në fushat në vijim:
- Parandalimi i prerjes ilegale të drunjëve
- Pyllëzimi (rikthimi i zabeleve të degraduara për shfrytëzim të bioenergjisë, dhe konvertimin e tyre në pyje të mesme e të larta, krasitja parakomerciale me kohë, normat e shtuara të rigjenerimit, speciet mikse për përmirësimin e stabilitetit dhe llojllojshmërisë së të hyrave)
  - Kalimi nga prodhimi i drunjëve për djegie nga të gjitha llojet e pyjeve me funksione mjedisore në pyje që shërbejnë për bioenergji, preferohet në zabele më afër infrastrukturës, në toka të mira (ALS high) me konvertim afatgjatë në zabele me standarde të caktuara për prodhimin e lëndëve.
  - Shtimi i normës së sekuestrimit të karbonit në pyje komerciale për prodhim të lëndëve, me trajtim pyllëzimi drejt prodhimeve afatgjata nga druri
  - Përmirësimi i depozitimit të karbonit në toka në pyje konservuese/mbrojtëse përmes restaurimit të këtyre pyjeve
- Mbrojtja e pyjeve (largimi i mbetjeve drusore pas dëmtimeve, praktikat e mira në korrjen e pyjeve (jo në lartësi të dbh), monitorimi dhe luftimi më efektiv i brejtësve dhe sëmundjeve, monitorimi dhe luftimi më efektiv i zjarreve)
- Promovimi i aktiviteteve në AR

- Shmangia e shpyllëzimit
- Jashtë sektorit të pyjeve:
  - Përmirësimi i efiçiencës së përdorimit të drunjëve për djegie (të mos digjen drunjët e njomë)
  - Përmirësimi i efiçiencës së përdorimit të tokës që mbetet tokë për dru për lëndë, zvogëlimi i importeve)

Rezultatet e pritura/ndikimet:

- Zvogëlim i emetimeve mes 0,3 dhe 1.3 Mt CO2 në vit deri në vitin 2020
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore
- Shtimi i vëllimit aktual të pyjeve
- Më pak prerje ilegale e druve
- Zvogëlimi i sipërfaqeve të prekura nga zjarret në pyje

Përgjegjësitë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,
- Agjencia Kosovare e Pyjeve,
- Policia e Kosovës,
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave,
- Shërbimet këshillëdhënëse,
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Komunat dhe amvisëritë.

Përfitimet e pritura:

Të listohen përfitimet e pritura përveç zvogëlimit të emetimeve, në fusha siç janë përshtatja, zhvillimi ekonomik, zbutja e varfërisë, vendet e punës, siguria sociale, barazia gjinore, mbrojtja e mjedisit, konservimi i natyrës

- Përmirësimi i mbrojtjes së mjedisit
- Përmirësimi i konservimit të natyrës
- Shtimi i disponueshmërisë së drunjëve dhe produkteve tjera të pyjeve
- Përmirësimi i ekonomisë rurale

Kostoja e përgatitjes:	**Kostoja e investimit:**	**Periudha e investimit:**
Nuk ka	2 ,700 ,000 euro	2013 -2015

Burimet e pritura të financimit:

- Buxheti qeveritar
- Sektori privat
- Donatorët ndërkombëtarë, përfshirë: fondi i biokarbonit i Bankës Botërore (BIOFC), Fondi Gjerman për Mbrojtjen Klimatike, Programi i Granteve të Vogla të GEF: Ndryshimet klimatike

Shtojca 3: Formularët e intervenimit sipas Strategjisë

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 01

Emri: Kufizimi i vendbanimeve/ndërtimit në zona të rrezikshme	Lokacioni: Zonat që rrezikohen nga erozioni dhe vërshimet në Kosovë	Lloji i intervenimit: 1. Përgatitja e Planeve Zhvillimore Urbane 2. Hartimi dhe zbatimi i ligjeve 3. Intervenim fizik

Objektivi:
Kufizimi i ndërtimit të vendbanimeve në zona që cenohen nga vërshimi dhe erozioni.

Arsyeshmëria
Burimet natyrore, private dhe sociale, të krijuara dhe planifikuara në zona të ndryshme të Kosovës kërcënohen nga erozioni dhe vërshimet. Erozioni dhe vërshimet manifestohen nga degradimi dhe vërshimet e tokave bujqësore, pyjeve, rrjeteve të rrugëve dhe hekurudhës dhe stabilimenteve të ndërtuara dhe vendbanimeve.
Në bazë të të dhënave ekzistuese pothuajse tërë territori i Kosovës është i rrezikuar nga erozioni, ngase rreth 55% të tërë territorit bën pjesë në kategoritë I, II dhe III, ndërsa 45% të mbetura në kategoritë IV dhe V, të cilat janë më pak të rrezikuara nga erozioni.
Sa u përket vërshimeve, ato ndodhin në shtretër të lumenjve. Në bazë të të dhënave nga hulumtimet, rreth 491km në gjatësi të lumenjve rrezikohen nga vërshimet, ndërsa vetëm 140km, apo 28%, të tyre nuk janë në rrezik nga vërshimi.
Për shkak të situatës së parregulluar sa u përket shtretërve të lumenjve, sipas të dhënave aktuale rreth 34,000 ha rrezikohen nga vërshimet e mundshme.

Intervenimi:
Nga të dhënat e paraqitura tek arsyeshmëria e objektivit të këtij formulari të intervenimit, shihet qartë se një pjesë e madhe e territorit të Kosovës kërcënohet nga erozione të kategorive të ndryshme si dhe nga vërshimet, posaçërisht zonat që janë në afërsi të shtretërve të lumenjve.
Intervenimi është i domosdoshëm në mënyrë që të parandalohet zhvillimit të vendbanimeve të reja dhe të mbrohen vendbanimet aktuale nga erozioni dhe vërshimi.
Aktualisht duhet të fokusohet në dy drejtime, duke përfshirë politika adekuate dhe implementim të pilot-projekteve.

- Kompletimi i të gjitha planeve zhvillimore urbane, në mënyrë që zonat urbane të shfrytëzohet në mënyrë më racionale dhe funksionale, si dhe të ndërpritet ndërtimi i pakontrolluar dhe zhvillimi i vendbanimeve. (2020).
- Projektligji për tokën ndërtimore: Ligji për tokën ndërtimore do të rregullojë të drejtat dhe obligimet që ndërlidhen me tokën ndërtimore dhe do të rregullojë lëshimin e lejeve për shfrytëzim të tokës ndërtimore. Ky ligj do të ndihmojë në parandalimin e ndërtimeve ilegale dhe të rregullojë tokat të cilat parashihen për ndërtim. (2015).
- Krijimi i bazës së të dhënave mbi rrjedhat e lumenjve.
- Rishikimi i hartave të zonave të cenuara në afërsi të shtretërve të lumenjve
- Sistemi i alarmimit dhe parashikimi i vërshimeve
- Në nivel kombëtar duhet të shtohet numri i stafit profesional që parasheh, monitoron dhe alarmon.
- Zhvillimi i planeve emergjente për reagim ndaj vërshimeve nga institucionet relevante për menaxhim të krizave.

Finalizimi i të gjitha planeve zhvillimore urbane dhe zbatimit i politikave adekuate, si dhe disa masa/intervenime teknike mund të ndihmojnë në zbutjen e ndikimit të erozicionit dhe vërshimit.

- Masat teknike në brigjet e lumenjve apo shtretërit e tyre; të shmangen barrierat natyrore apo ato të krijuara nga faktori njeri.

- Intervenimet teknike (pendat me materiale natyrore por edhe me materiale të forta)
- Ndalimi me ligj i përdorimit të tokave bujqësore pranë shtretërve të lumenjve të cilat preken nga vërshimet
- Parandalimi i të gjitha aktiviteteve ndërtimore në afërsi të brigjeve të lumenjve, përveç objekteve me karakter ekonomik (urave, pendave, drenazhimit, etj). Ndërtimi dhe ruajtja e shiritave bregorë përkrah kanaleve të lumenjve nga ndërtimi, si dhe sigurimi i një brezi të caktuar për të bërë të mundur mirëmbajtjen e lumit.
- Mbrojtja e shtretërve të lumenjve nga nxjerrja e pakontrolluar e zhavorrit.
- Ndalja e hedhjes së mbeturinave të ngurta të lumenj.
- Mbjellja/rritja e drunjëve në mënyrën më të mirë të mundshme, për të parandaluar largimin e tokave, në veçanti drunjtë me rrënjë të mëdha e të forta të cilat mbajnë tokat të paprekura.
- Të mos lërohen, apo të lërohen vetëm kur është e domosdoshme
- Ndërtimi i mureve mbajtëse
- Shfrytëzimi i praktikave bujqësore që mund të prodhojnë mbjella të mira pa lërim.
- Pyllëzimi i pyjeve dhe tokave pyjore.

Të përgjithshme
- Bashkëpunimi mes institucioneve qeveritare
- Krijimi i një sistemi adekuat të monitorimit
- Përkrahje financiare

Rezultatet/ndikimet:
Implementimi i planeve urbane dhe i Ligjit për tokën ndërtimore:
- Do të zvogëlojë zgjerimin e pakontrolluar të vendbanimeve
- Do të zvogëlojë/ndalojë ndërtimin në zona të rrezikuara.

Intervenimi teknik:
- Zvogëlon dëmet nga vërshimet, një numër më i vogël i vërshimeve, më pak dëme në nivel të vendbanimeve, më pak dëme në bujqësi (mbjellet kultivohen në afërsi të lumenjve)
- Zvogëlon erozionin, humbjen e tokave (të shfrytëzuara në bujqësi)
- Zvogëlon dëmet për peizazhin, biodiversitetin, etj.

Përgjegjësitë:
Qeveria, MMPH, MBPZHR/APK/Shërbimet Këshillëdhënëse dhe komunat

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
- 10,000 - 4,560,000	Afati: 2015/Ligji për ndërtimin Afati: 2020/Plani urban për zhvillim Afati: Intervenimi teknik

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 02		
Emri: **Ngritja e kapacitetit të rrjedhës së lumit, me fokus në krijimin e zonave natyrore të ruajtjes në vend se të bëhen investime të mëdha infrastrukturore.**	**Lokacioni: Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit:** **Masa strukturore dhe jostrukturore**

Objektivat:

Në shumë rajone të botës vërshimet janë rrezik i madh natyror. Modelet e simulimit klimatik parashikojnë ndryshim të trendit të reshjeve, që do të thotë se frekuenca dhe intensiteti i shirave do të dallojë me kalimin e kohës.

Frekuenca e vërshimeve është drejtpërdrejt e ndikuar nga ndryshimet e reshjeve nga viti në vit dhe nga ndryshimet në kuptim të reshjeve afatshkurtra (siç është intensiteti i reshjeve në rrebesh). Sipas Ligjit për ujërat, komunat dhe autoritetet e shtretërve të lumenjve janë institucionet me përgjegjësi kryesore në rast të vërshimeve, dhe obligohen që të mbajnë dhe rregullojnë infrastrukturën e domosdoshme për të mbrojtur nga vërshimet. Zhvillimi dhe implementimi i programeve për mbrojtje nga vërshimet është përgjegjësi e komunave dhe autoriteteve të shtretërve të lumenjve. Ngjashëm me vendet tjera të Ballkanit, Kosova është e cenuar nga katastrofat ekstreme natyrore, megjithatë, risku i ndërlidhur me vërshimet, rrëshqitjen e dheut dhe erozionin nuk konsiderohet i madh. Në bazë të informatave të marra nga institucionet relevante, në vijim janë paraqitur arsyet kryesore që shkaktojnë vërshime.

Gjatë intervistave me autoritetet komunale/zyrtarët e ministrive, u tha se arsyet kryesore për vërshime janë:

Mungesa e programeve dhe projekteve të përhershme për mirëmbajtjen dhe pastrimin e shtretërve të lumenjve nga copërat, toka e eroduar dhe mbeturinat tjera të hedhura në lumenj.

Tej-eksploatimi i materialeve inerte nga lumenjtë dhe ndryshimi i shtegut të lumit.

Shpyllëzimi dhe humbja e vegjetacionit.

Ndërtimi ilegal pranë lumenjve dhe ngushtimi i shtretërve të lumenjve.

Dëmtimi i mureve mbrojtëse pranë lumenjve dhe mungesa e hendekëve dhe digave përgjatë lumenjve/rrjedhave.

Në qendrat urbane, vërshimet kryesisht shkaktohen nga mungesa e rrjetit të ujërave atmosferike, nëndimensionimi i tyre dhe mosmirëmbajtja adekuate e kolektorëve kryesorë.

Prandaj, zhvillimi i strategjisë kombëtare për adresimin e vërshimeve, përfshirë përcaktimin e të gjitha zonave të rrezikuara, si dhe zhvillimi i programeve kombëtare për mirëmbajtje të lumenjve janë edhe të domosdoshme edhe urgjente.

Intervenimi:


Institucionet përgjegjëse për vërshime, komunat dhe qeveria qendrore, do të zhvillojnë sistemet për menaxhimin e vërshimeve, të cilat do duhej të përbëhen nga masat strukturore dhe jostrukturore.

Nën intervenimet jostrukturore propozohen aktivitetet vijuese:

Vlerësimi i rrezikut që ndërlidhet me vërshimet, përcaktimi i të gjitha pronave që cenohen nga vërshimet dhe zhvillimi i planeve përkatëse për menaxhimin e riskut nga vërshimet, përfshirë planet për mbrojtje dhe shpëtim.

Zhvillimi i modeleve hidraulike të vërshimeve nën skenarë të ndryshëm ekstremë, për vërshime që mund të ndodhin në përmasa kohore prej 20, 50 dhe 100 vitesh, analizave të frekuencës së vërshimeve, rrjedhat nga

vërshimet dhe vijëzimeve të kufijve të zonave të vërshuara.
Forcimi i kapaciteteve lokale për të krijuar sistem të paralajmërimit të hershëm/paralajmërimit të katastrofave. Zhvillimi i menaxhimit të riskut nga vërshimet - në tërë Kosovën Zhvillimi i planit kombëtar të veprimit dhe programit për ndërtimin e digave të reja dhe rehabilitimin e digave ekzistuese në shtretërit e lumenjve, përfshirë planin e mirëmbajtjes së rregullt të lumenjve. Intervenimet strukturore duhet të dizajnohen në bazë të kushteve specifike të shtretërve të lumenjve, të cilët përbëjnë kërcënim të madh për jetët e njerëzve, pronat dhe tokat bujqësore. Për masave në fillim duhet të bëhet VNM, në mënyrë që të vlerësohet nëse të njëjtat mund të konsiderohen si opsione. Intervenimet duhet të implementojnë një apo më shumë masa nga masat e listuara në vijim: Ulja e fushave të vërshimit: ulja e një zone të fushës së vërshuar shton hapësirën për lumin në rast të periudha të nivelit të lartë. Thellimi i shtratit të verës: thellimi i shtratit të lumit ofron më shumë hapësirë për rrjedhën e lumit Zhvendosja e digës: zhvendosja e digës në drejtim të tokës zgjeron hapësirën e fushës së vërshimit dhe i ofron lumit më shumë hapësirë. Përshtatja apo largimi i pengesave hidraulike: largimi apo modifikimi i pengesave në shtratin e lumit kurdo që kjo është e mundur e rritë normën e rrjedhës së ujit në lum (p.sh. sedimentet, materialet erozive, lumenjtë, bërlloku, etj.). Largimi i pendës nga hapësira kënetore: hendeku në brigjet e lumit zhvendoset në drejtim të tokës. Hapësira kënetore zgjerohet dhe lumi mund ta vërshojë këtë zonë me rastin e ngritjes së nivelit të ujit. Ndërtimi i digave të reja dhe përforcimi i digave ekzistuese: ngritja e digave të reja dhe përforcimi i digave ekzistuese në zonat të cilat rrezikohen nga vërshimi dhe në zonat ku nuk ka më hapësirë për zgjerimin e shtratit të lumit. Ndërtimi i kanaleve të drenazhit për rrjedhjen e ujit të akumuluar nga vërshimet, kurdo që kjo është e nevojshme. Ndërtimi i kanaleve kaluese për të lidhur lumenjtë, të ashtuquajturit breza të gjelbër të lumit, të cilët mund ta bartin ujin apo ta drejtojnë ujin drejt lumit tjetër.



Rezultatet/ndikimet:
Implementimi i masave të mësipërme ka për qëllim zvogëlimin e kërcënimeve nga vërshimet në masën maksimale të mundshme.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
Këshilli Ndërministror i Ujërave (KNU);
Ministria e Punëve të Brendshme;
Ministria e Forcës së Sigurisë;
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
Komunat.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimeve të lartpërmendura parashihet si në vijim: Masat afatshkurtra: Intervenimet jostrukturore-hulumtimet, studimet e fizibilitetit, planet për menaxhimin e vërshimeve, modelimi i vërshimeve: Kostoja e përafërt: rreth 1.2-1.7 milionë euro. Masat afatmesme dhe afatgjata: Intervenimet strukturore varen nga shkalla dhe madhësia e intervenimit, në bazë të planit për menaxhimin e riskut nga vërshimi dhe programin e veprimit. Kostoja e përafërt: 10-20 milionë euro	Masat afatshkurtra: 2015 –2017. Masat afatmesme dhe afatgjata: 2016 –2030.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 03		
Emri: **Ndërtimi i zonave për grumbullimin dhe mbajtjen e ujërave nga stuhitë**	**Lokacioni: Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt joinfrastrukturor dhe infrastrukturor**
Objektivat: Bazenet (pellgjet) për mbajtjen e ujërave nga stuhitë përbëjnë një metodë konvencionale për grumbullimin dhe ruajtjen e ujërave nga stuhitë dhe për lëshimin e ngadaltë të ujit në mënyrë që të mos përmbyten zonat në rrjedhën e poshtme. Lëshimi i ujit bëhet në norma të rregulluara, të ngjashme me ato që shfaqen në kushte të natyrshme. Bazenet mbajtëse janë zakonisht stabilimente më të mëdha rajonale, të cilat mund të mbulojnë sipërfaqe deri në disa qindra hektarë. Kur mbushen me ujë, bazenet mbajtëse i ngjajnë liqeneve. Kohëve të fundit, bazenet dizajnohen asisoj që të kenë vazhdimisht një nivel të ujit në pjesën e poshtme të bazenit, ndërsa depozita e vërshimit ndodhet mbi sipërfaqen normale të liqenit. Duke e gllabëruar dhe mbajtur ujin gjatë stuhive, bazenet mbajtëse kontrollojnë edhe sasinë edhe cilësinë e ujit nga stuhitë. Pasi që gllabërohet në bazen, në ujë veprojnë proceset fizike, biologjike dhe kimike të cilat i largojnë ndotësit. Procesi i sedimentimit i largon copëzat, materiet organike dhe metalet, ndërsa metalet dhe vlerat ushqyese largohen përmes proceseve biologjike. Përveç kontrollimit të vërshimeve dhe largimit të ndotësve, shumë pellgje dizajnohen asisoj që të shfrytëzohen si zona rekreative, habitate të botës së egër, etj.		
Intervenimi: Ndërtimi i bazeneve për mbajtjen e ujërave nga stuhitë paraqet zgjidhjen adekuate për kontrollimin e vërshimeve. Një tjetër përfitim nga ndërtimi i bazeneve mbajtëse është zvogëlimi i përqendrimit të ndotësve, të cilët gjenden në norma më të larta në ujërat e stuhive. Përzgjedhja e lokacionit dhe kapacitetit të bazeneve mbajtëse duhet të bazohet në vlerësimin e riskut për zonat e cenuara nga vërshimi, kalkulimet e bëra me modelet e vërshimeve hidraulike, vlerësimin e rrjedhës së vërshimit dhe përqendrimin e vlerave kontaminuese. Dizajni i bazenit mbajtës duhet të ngërthejë të gjitha masat relevante të sigurisë; të shqyrtojë terrenin lokal dhe kufizimet që ai imponon. Një tjetër aspekt që duhet pasur parasysh gjatë dizajnimit të bazenit për mbajtjen e ujërave nga stuhitë është qasja në lokacion, që nevojitet për të operuar dhe mirëmbajtur bazenin.		
Rezultatet/ndikimet: Bazenet mbajtëse ndërtohen në zona ku vërshimet paraqesin rrezik të përhershëmk për jetët e njerëzve dhe pronat, si dhe për të shmangur erozionin.		
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtyre intervenimeve janë: - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; - Këshilli Ndërministror i Ujërave (KNU); - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; - Komunat; - Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit;		
Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të një (1) pilot-projekti të bazenit mbajtës, përfshirë studimin e fizibilitetit, dizajnin kryesor, punët civile dhe mekanike dhe në peizazh, dhe punët tjera të ndërlidhura me të: 1.5 – 3.0 milionë euro.	**Periudha e investimit:** Investim afatmesëm: 2025-2030.	

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 04:		
Emri: **Standardet e ndërtimit**	**Lokacioni:** **Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit: Korniza politike + projekt infrastrukturor (pilot projekt)**

Objektivat:

Në vitet e fundit vërehet një trend në rritje i zhvillimit të standardeve të ndërtimit të cilët i kushtojnë shumë kujdes mjedisit dhe që janë miqësor për mjedisin. Faktori më i rëndësishëm shtytës për dizajnet dhe ndërtimet e tilla janë çatitë e gjelbra, të cilat vonojnë rrjedhjen e ujit nga reshjet në sistemin e ujërave të stuhive apo të cilat në përgjithësi shfrytëzohen si struktura për mbajtjen e ujërave nga të reshurat. Varësisht nga sistemi i çative të gjelbra dhe thellësia e mediumit në rritje, rrjedhja e menjëhershme e ujit mund të ulet për 50-90%.

Intervenimi:

Masat e planifikuara brenda këtij intervenimi janë të ndara në projekte joinfrastrukturore dhe infrastrukturore, të cilat janë përmbledhur në vijim:

<u>Intervenimi joinfrastrukturor (afatshkurtër):</u>

- Zhvillimi i standardeve të reja të ndërtimit që promovojnë konceptet e gjelbra të ndërtimit, në veçanti konceptin e çative të gjelbra > rekomandohet që çatitë e gjelbra të integrohen në legjislacion/ligje dhe të mos vendoset si masë e veçantë.
- Zhvillimi i udhëzimeve për ndërtimin e çative të gjelbra
- Promovimi i konceptit të ndërtesave të gjelbra, me fokus të veçantë në çatitë e gjelbra (realizimi i fushatave vetëdijesuese)
- Skemat stimuluese për individë/institucione që duan të ndërtojnë çati të gjelbra me qëllim të zvogëlimit të sasisë së ujit nga stuhitë që derdhet dhe mbrojtjes së mjedisit

<u>Intervenimi infrastrukturor (afatshkurtër deri afatmesëm):</u>

- Implementimi i pilot projekteve të 'ndërtesave të gjelbra' dhe 'çative të gjelbra' (në ndërtesa të qeverisë, komunave, shkolla, spitale, etj.) dhe replikimi i tyre në sektorin e banimit duke aplikuar skema stimuluese.

Vërejtje: aktualisht sistemi më i plotë i standardeve për dizajnimin e çative të gjelbra është Stabilimenti Hulumtues Gjerman për Zhvillimin dhe Ndërtimin e Peizazheve.

Rezultatet/ndikimet:

Përveç përfitimit nga vonimi i rrjedhjes së ujit nga reshjet, përfitime tjera mjedisore nga çatitë e gjelbra janë edhe ato në vijim:

- Izolimi më i mirë termal i ndërtesave dhe ruajtja e nxehtësisë
- Sigurimi i hapësirës së re për habitatet e botës së egër
- Përmirësimi i ruajtjes së biodiversitetit, më shumë hapësira për kopsht.
- Ulja e nivelit të grimcave ajrore, pluhurit dhe smogut
- Ulja e nivelit të zhurmës.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (departamenti i banimit dhe ndërtimit do të realizojë të gjitha veprimet ligjore dhe procedurale për hartimin e standardeve të ndërtimit dhe hartimin e udhëzimeve për çatitë e gjelbra); dhe Këshilli Ndërministror i Ujërave

Kostoja e investimit: Afatshkurtër: - Hartimi i standardeve të ndërtimit dhe udhëzimeve për ndërtesat e gjelbra dhe çatitë e gjelbra nuk kanë kosto. - Kostoja e fushatës vetëdijesuese dhe promovuese për çatitë e gjelbra kalkulohet të jetë 15,000 euro. Afatmesëm: - Kostoja e implementimit të një pilot-projekti të një ndërtese me çati të gjelbër, përveç kostos së ndërtimit të pjesës standarde të ndërtesës, parashihet të jetë 0.15-0.2 milionë euro (varësisht nga madhësia e ndërtesës).	Periudha e investimit: Afatshkurtër: 2014 - 2016. Afatmesëm: 2016 - 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 05		
Emri: **Zgjerimi i rezervuarëve për të shtuar kapacitetin amortizues**	**Lokacioni:** **Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit: Kornizë politike + projekt infrastrukturor**
Objektivat: Liqene konsiderohen trupat me ujë të ëmbël që rrethohen nga toka. Ekzistojnë liqene natyrore të cilat formohen me procese natyrore, dhe liqene artificiale të cilat ndërtohen nga njeriu e njihen si rezervuarë. Liqenet dhe/ose rezervuarët paraqesin infrastrukturë strategjike të secilit vend dhe shfrytëzohen për qëllime të ndryshme, përfshirë: - Për furnizim me ujë të pijes, për ujitje dhe industri; - Kultivim të peshkut, në kuptimin komercial; - Rekreacion, sporte ujore, atraksione turistike dhe peshkim; - Si zona për mbrojtje të natyrës; - Për shkarkimin e ujërave të zeza. Rezervuarët e mëdhenj janë element kyç në menaxhimin e resurseve ujore për furnizim publik të ujit dhe për zhvillimin ekonomik në shumë vende, siç është rasti i Kosovës. Kosova posedon gjashtë (6) rezervuarë me kapacitet të gjithmbarshëm të depozitimit prej 539.53 x 10^6 m^3. Krahasimi i të dhënave vjetore mbi rrjedhën mesatare në pellgjet e lumenjve në Kosovë (3'608x10^6 m^3) dhe kapacitetit të gjithmbarshëm të gjashtë liqeneve akumuluese (563.69 x10^6 m^3), shpie tek përfundimi se akumulimet e ujit grumbullojnë rreth 15% të ujit. Këta rezervuarë shërbejnë parimisht për furnizim të ujit (ujit të pijes), ujitje, industri dhe rekreacion. Objektivi i këtij intervenimi është që të krijohen praktika adekuate menaxhuese dhe masa mbrojtëse për rezervuarët, në mënyrë që të kontrollohet veprimtaria njerëzore në rezervuarë apo edhe në rrjedhat që akumulojnë në të, të kontrollohet rrjedha në zonën mbajtëse të rezervuarëve, të monitorohet cilësia e ujit, siguria e pendës dhe të kontrollohet hyrja e sedimenteve që mund të rezultojë me zvogëlim të theksuar të kapacitetit dhe dobishmërisë së tyre.		
Intervenimi: Jo sikur lumenjtë, të cilët e transportojnë sedimentin përgjatë tërë rrjedhës së ujit, rezervuarët mbajnë një pjesë të madhe të sedimentacionit që hyn në të, gjë që mund të rezultojë me zvogëlim të dukshëm të kapaciteteve të tyre. Sedimentet më të mëdha zakonisht depozitohen në afërsi të lokacionit prurës, ndërsa ato më të imëta transportohen për distanca më të largëta. Kjo përbën brengë për operacionet dhe mirëmbajtjen e rezervuarëve. Zvogëlimi i sedimentacionit në rezervuarë është problematik. Nëse		

rezervuari ka një sifon dalës në fund, heqja e sedimentit (që kërkon pothuajse zbrazjen e rezervuarit) mund të heqë një pjesë, por kjo nuk është gjithmonë e mundshme për shkak të vëllimeve të mëdha të ujit hyrës dhe dalës.

Për shkak të tendencës së tyre për të mbajtur sedimentet dhe materiet organike, rezervuarët akumulojnë ndotës siç janë metalet e rënda, pesticidet dhe përmbajtje tjetër organike në disa pjesë. Kjo ndotje mund të përbëjë problem serioz për disa përdorime të caktuara, posaçërisht për furnizimin e ujit.

Siguria e pendës është brengë kryesore edhe gjatë ndërtimit edhe gjatë operimit. Çarja e pendës mund të shkaktohet nga vërshimet, dështimet strukturore apo lëvizjet sizmike. Në shumicën e shteteve ekziston një komitet kombëtar përgjegjës për sigurinë e pendave, shqyrtimin e aplikacioneve për ndërtim të pendave në kuptimin e sigurisë dhe për bashkërendimin dhe kryerjen e inspektimeve të rregullta në penda të mëdha.

Prandaj, brenda këtij intervenimi, të gjitha brengat e lartpërmendura duhet të adresohen me shpejtësi, përfshirë:

- Dizajnimin e planeve dhe programeve për të mbajtur vegjetacionin në shirita amortizues, kontrolluar erozionin e brigjeve duke mbajtur vegjetacion natyror nëpër korridore, shfrytëzuar masa strikte mbrojtëse nëpër tërë rrjedhën. Shiritat amortizues me vegjetacion ruajnë dheun dhe pengojnë largimin e tij, duke larguar kësisoj sedimentin dhe fosforin (elementin që shkakton eutrofikimin).
- Zgjerimin e rezervuarëve për të shtuar kapacitetin e amortizimit, duke larguar sedimentin nga dyshemeja e rezervuarit.
- Zhvillimin e programeve për monitorimin e cilësisë së ujit në rezervuar, përfshirë masat dhe aktivitetet për të trajtuar probleme si eutrofikimi, ndotja kimike dhe sedimentimi.
- Themelimin e komitetit kombëtar për sigurinë e pendave, shqyrtimin e ndërtimit të pendave dhe kryerjen e inspektimeve të rregullta në penda të mëdha.

Rezultatet/ndikimet:
Ndikimet negative në rezervuarë të prekur nga proceset e erozionit, aspektet e cilësisë së ujit dhe sigurisë së pendave janë adresuar. Përveç kësaj, kapaciteti amortizues i rezervuarit është shtuar.

Përgjegjësitë:
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Këshilli Ndërministror i Ujërave;
- Ministria Zhvillimit Ekonomik;
- KRU-të.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Afatshkurtër: 10-15 milionë euro	Afatshkurtër: 2014 - 2025.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 06

Emri:	**Lokacioni: Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit:**
Masat e planifikimit të peizazhit për të përmirësuar balancin e ujit (p.sh. ndryshimi i destinimit të tokës, ripyllëzimi, mosmbulimi i sipërfaqes)		**4. Pyllëzimi, ripyllëzimi** **5. Peizazhi, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi** **6. Ndërgjegjësimi**

Objektivi:
Të zvogëlohet sasia e ujit të humbur dhe të përmirësohet balanci i ujit përmes masave për përmirësim të peizazhit, siç janë pyllëzimi, ripyllëzimi, mosmbulimi i sipërfaqes së dheut, mbrojtja e peizazhit natyror, përdorimi i balancuar i ujit në bujqësi, vetëdijesimi, etj.

Arsyeshmëria
Ndryshimet klimatike si dhe zhvillimi i mëtejme ekonomik dhe ngritja e standardit të jetesës përcillen me kërkesë të shtuar për ujë. Në këtë drejtim, është me rëndësi që uji të përdoret racionalisht dhe të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme për kursimin e tij.
Sipas parashikimeve të MBPZHR, çdo vit rreth 400 hektarë tokë bujqësore e ndërrojnë destinimin për tu bërë tokë ndërtimore.
Ekziston supozimi jozyrtar se çdo vit prehen rreth 100,000 m^3 dru. Rreth 30,000 ha janë pyll i shkretë dhe kanë një shtresë të hollë dheu, ndërsa një pjesë e këtyre pyjeve mund të pyllëzohet.
Rreth 40% të tokave pyjore publike dhe 29% të tokave pyjore private preken nga eksploatimi i pakontrolluar apo ilegal. Në krahasim me standardet e aplikueshme, këto shifra janë mjaft të larta ngase prerja ilegale e drunjëve shkakton edhe dëmtim/shkatërrim të peizazheve natyrore. Aktivitetet e shfrytëzimit të pakontrolluar të zhavorit kanë ndikim negativ në peizazhe dhe në biodiversitet ngase shkatërrojnë peizazhet natyrore.

Intervenimi:
Për të parandaluar këtë situatë kërkohet përmirësim i balancit të ujit dhe mbrojtje e peizazhit, përmes disa intervenimeve.
Në këtë fazë duhet të fokusohet në drejtime të caktuara, siç janë politikat adekuate dhe implementimi i projekteve.
- Përgatitja e planit hapësinor për zonat e mbrojtura natyrore, fillimisht për parqet kombëtare e më pas edhe për zonat e mbrojtura;
- Themelimi i sistemit të kontrollit për mbrojtjen e diversitetit dhe peizazhit.
- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndryshimi i destinimit.
- Mbrojtja e pyjeve nga prerja ilegale
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi
- Edukimi i njerëzve mbi përfitimet nga pyjet
- Menaxhimi i mirë i shfrytëzimit të pyjeve
- Përkrahja politike për rojet e pyllit
- Fuqizimi i mbrojtjes së pyjeve
- Mbrojtja e peizazhit

Të përgjithshme
- Bashkëpunimi mes institucioneve qeveritare
- Themelimi i një sistemi adekuat të monitorimit
- Përkrahja financiare

Rezultatet/ndikimet:
- Humbje më e vogël e ujit dhe përmirësim i balancit të ujit.
- Mbrojtja e peizazheve natyrale
- Mosmbulimi i sipërfaqeve
- Shtimi i sipërfaqes pyjore
- Zvogëlimi i prerjes ilegale
- Shtimi i vetëdijes mbi përfitimet nga pyjet, etj.

Përgjegjësitë:
Qeveria, MMPH, MBPZHR, AKP/Shërbimet Këshillëdhënëse/MASHT, si dhe komunat.

Kostoja e investimit:	Periudha e investimit:
- 2, 700, 000 - pyllëzimi dhe menaxhimi i pyjeve - 80, 000 vetëdijesimi	2013-2015 2013 -2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 07		
Emri: **Zvogëlimi i rrjedhjeve në rrjetin shpërndarës të ujit të pijes**	**Lokacioni:** **Për të gjitha shtatë Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU)**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt infrastrukturor**

Objektivat:

Furnizimi i ujit të pijes dhe shërbimet e kanalizimit në Kosovë sigurohen nga shtatë kompani të licencuara rajonale të ujësjellësit (KRU) brenda zonave të tyre të caktuara. Përveç KRU Bifurkacioni (Ferizaj), e cila është NP lokale dhe i jep përgjegjësi Komunës së Ferizajt, gjashtë KRU-të tjera, Prishtina, Mitrovica, Hidroregjioni Jugor (Prizren), Hidrodrini (Pejë), Radoniqi (Gjakovë) dhe Hidromorava (Gjilan) janë NP qendrore dhe përgjegjëse para Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Sipas Raportit Vjetor të Performansës të Ofruesve të Shërbimeve të Ujit në Kosovë për vitin 2012, industria e ujit në Kosovë është ende e dobët; me mangësi të dëshmuara në shumicën e treguesve të performansës.

Mbulimi me shërbime (që përkufizohet si përqindje e popullatës brenda sipërfaqes së caktuar që gëzon furnizim të ujit) raportohet të jetë 78%. Pjesa e mbetur e popullatës (22%) furnizohen me ujë (të cilësisë së panjohur) përmes puseve të tyre të cekëta apo ujërave tjerë sipërfaqësorë apo nëntokësorë.

Ujërat që nuk sjellin të hyra (që përkufizohen si: dallimi mes sasisë së ujit që prodhohet dhe sasisë së ujit që faturohet, d.m.th. uji që nuk i sjell të hyra kompanisë) janë në nivel të lartë, me përqindje prej 58%.

Inkasimi i të hyrave për sektorin e ujërave dhe kanalizimit raportohet të jetë 70%, përqindje kjo që nuk u mundëson KRU-ve kryerjen e investimeve kapitale. Investimet në infrastrukturën ujore dhe kanalizim varen shumë nga donatorët e huaj.

Duhet theksuar se shumë fshatra nuk janë të mbuluara nga skemat rajonale të furnizimit me ujë. Fshatrat ende vazhdojnë të shfrytëzojnë ujëra të cilësisë së ulët nga puset e cekëta.

Intervenimi:

Intervenimet përbëhen nga rehabilitimi/zëvendësimi i segmenteve të dëmtuara të rrjetit, zbulimi i rrjedhjeve dhe riparimi i tyre, instalimi i orëve të ujit në nivel distrikti dhe konsumatori, në mënyrë që të mund të dihet bilanci i ujit në segmente të caktuara. Masat në fjalë duhet të implementohen lagje pas lagjeje. Pas rehabilitimit të një lagjeje, rezultatet përfundimtare duhet të vlerësohen dhe të krahasohen me 'gjendjen fillestare', ndërsa leksionet përkatëse duhet të nxirren dhe të replikohen gjatë ndërmarrjes së masave në lagje tjera.

Masat e rëndomta të ruajtjes së ujit, përkrah projekteve të drejtpërdrejta infrastrukturore, duhet të plotësohen me masa si: arsimimi i konsumatorëve lidhur me përdorimin e ujit dhe riparimet efikase, peizazhim efikas, masa stimuluese ekonomike dhe programe për restriksione në shfrytëzim të ujit.

Rezultatet/ndikimet:

Ndikimi i parë i drejtpërdrejtë i implementimit të masave është zvogëlimi i humbjeve të ujit, i cili pasqyrohet në kosto më të ulët operative për KRU-të. Këto përfitime përfshijnë kursimin e energjisë dhe

kimikateve të përdorura për trajtim të ujit, moszgjerimin apo shtyrjen e zgjerimit të kapaciteteve përpunuese të ujit dhe kostot më të ulëta dhe ndikimin në menaxhimin e ujërave të zeza.
Konsumi i energjisë për operimin e impianteve të trajtimit dhe stacioneve të pompimit përbën një nga shpenzimet kryesore operative të prodhimit të ujit. Prandaj, zbritja e kostove të energjisë do të përkthehet si emetim më i ulët i gazrave serrë.
'Uji i kursyer' nga intervenimet e mësipërme mund të shfrytëzohet për të zgjeruar më tej shërbimin dhe për të mbuluar rajonet që nuk gëzojnë furnizim të ujit nga KRU-të.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- 7 KRU-të e Kosovës
- Komunat brenda të cilave këto 7 KRU i ofrojnë shërbimet e veta
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave
- Këshilli Ndërministror i Ujërave
- Donatorët aktivë në sektorin e ujërave në Kosovë

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur është parashikuar të jetë rreth 90-100 milionë euro (rreth 10-15 milionë për çdo vit për secilën KRU)	Intervenimi afatgjatë: 2014-2025 (do të zvogëlojë normën e rrjedhjes nga 58% në 25% brenda 10 vitesh). Supozim: zvogëlim i normës së rrjedhjes prej 2.5-3.0% për vit).

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 08

Emri:	**Lokacioni: Në tërë Kosovën Pilot projektet e përzgjedhura nga MMPH**	**Lloji i intervenimit:**
Reklamacioni, ripërdorimi dhe riciklimi i ujit		**Projekt infrastrukturor**

Objektivat:
Implementimi i projekteve për ripërdorimin dhe riciklimin e ujit bazohet kryesisht në mungesën e projektuar të ujit nëpër vende. Burimet e ujit pritet të vëhen nën presion gjatë viteve dhe dekadave në vijim, si rezultat i shtimit të popullatës dhe shpërndarjes së pabarabartë të popullatës dhe ujit. Trajtimi i ujërave të zeza, për t'i bërë ato të përdorshme për destinime tjera përveç pijes, duke i plotësuar të gjitha kriteret e cilësisë së ujit, është një punë atraktive e cila praktikohet çdo kund në botë. Përdorimi më i rëndësishëm i ujërave të ricikluar, është në sektorin e ujitjes, ujitjes së peizazheve (parqe, kopshte shkollash), procese industriale (ujë për ftohje, ujë për përpunim, në ndërtim të rëndë), për rimbushje të ujërave nëntokësore, përdorime tjera mjedisore për shërbime të ekosistemeve, përdorim urban jo për pije (mbrojtje nga zjarri, tualete), autolarje, etj.
Arsyeja për ripërdorimin e ujit
Uji është burim i kufizuar; shoqëria njerëzore nuk ka më luksin që ujin ta shfrytëzojë vetëm një herë. Cilësia e ujit të ricikluar është adekuate për shumë përdorime (jo për pije), siç janë ujitja dhe ftohja industriale, apo pastrimi. Ripërdorimi i ujit mundëson shfrytëzim më efikas të energjisë dhe burimeve, duke ia përshtatur trajtimin kërkesave për t'i shërbyer përdoruesit fundorë.
Faktorët që shtyjnë drejt ripërdorimit të ujit
Uji i ricikluar është në dispozicion në afërsi të mjediseve urbane, ku burimet e ujit nevojiten më së tepërti,

ofron një burim të besueshëm të ujit (edhe gjatë viteve me thatësi), pasi që prodhimi i ujërave të zeza është pothuajse konstant.

Intervenimi:

Sot ekzistojnë procese dhe teknologji të dëshmuara për trajtimin e ujërave të zeza të cilat mund të ofrojnë ujë të cilësisë që plotëson standardet më relevante për përdorime të ndryshme (jo për pirje). Gjatë konstruktimit të trajtimit të ujërave të zeza faktori më i rëndësishëm që duhet të mbahet në mend është përdorimi dhe qëllimi i përdorimit të atij uji.

Intervenimi do duhej të përfshijë veprimet në vijim:

- Përcaktimin dhe përzgjedhjen e lokacioneve industriale, institucionale dhe/ose të banimit apo komplekset që janë adekuate për implementimin e pilot projekteve për reklamacion të ujit dhe/ose reciklim të ujit.
- Sajimin e studimeve të fizibilitetit dhe dizajneve kryesor për implementimin e reklamacionit të ujit, apo të ashtuquajturat stabilimente të trajtimit të ujërave të zeza në rrjedhat e sipërme në impiantet industriale ose ndërtesat institucionale/banesore (me shumë zyra apo banesa) dhe/ose projektet e reciklimit nëpër stabilimente industriale.
- Ndërtimin e impianteve të vogla për trajtimin e ujërave të zeza, përfshirë bazenet mbajtëse, pajisjet e transportit (pompat, gypat, etj.) për të transportuar ujin nga pika e përdorimit (ujitja e fushave, pastrimi i brendshëm dhe/ose i jashtëm, tualetet, auto larjet, etj.).
- Shfrytëzimin e teknologjive përkatëse të riciklimit për disa stabilimente të përzgjedhura industriale, si pilot projekte.
- Përsëritjen e projekteve të mësipërme në stabilimente apo ndërtesa tjera industriale.
- Fushatat vetëdijesuese mbi ripërdorimin e ujit të ricikluar apo teknologjive ricikluese.

Rezultatet/ndikimet:

Përdorimi i ujit të ricikluar dhe/ose teknologjive të riciklimit do të kishte përparësitë/ndikimet në vijim:

- Do të zvogëlonte presionin për burime të ujit të freskët.
- Do të shtonte vetëdijen mes institucioneve, industrive dhe pranë sektorit të banimit për ndërmarrjen e masave të tilla dhe për ruajtjen e ujit.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik (për shërbimet ujore që kanë të bëjnë me KRU-të)
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- KNU
- Komunat
- Sektori industrial
- Donatorët aktivë në sektorin e ujërave në Kosovë

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të projekteve/sistemeve për reklamacion dhe ripërdorim të ujit dhe teknologji të riciklimit të ujit duhet të studiohet edhe më tej, në mënyrë që të përcaktohet lokacioni, lloji i sistemit që më së miri i përshtatet specifikave të vendit, pikat e përdorimit të ujit të trajtuar (të zi).	Afatmesme: 2016-2017.

Megjithatë, implementimi i një pilot projekti apo sistemi për reklamacionin dhe ripërdorimin e ujit apo teknologjive ricikluese (të madhësisë së vogël apo të mesme) qoftë në ndonjë ndërtesë institucionale apo në ndonjë lokacion industrial, do të kushtonte rreth 0.35-0.50 milion euro, përfshirë sistemin e trajtimit të ujërave të zeza dhe pajisjet e transportit të ujit deri në pikën e përdorimit (parkun e ujitjes, kopshtin e shkollës, parkun industrial, etj.)	

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 09		
Emri: **Konservimi në pikën e përdorimit**	**Lokacioni: Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit:** **Programe arsimore dhe vetëdijesuese**
Objektivat: Uji është burim i shtershëm dhe njerëzit duhet ta kuptojnë vlerësim e tij si një nga burimet më të rëndësishme, por edhe më të pakta. Konkurrenca për ujë paraqet rrezik për ekonominë, komunitetet dhe shërbimet e ekosistemeve. Nëse kësaj i shtohen ndikimet e ndryshimeve klimatike të cilat bëjnë që temperatura mesatare në glob të rritet, uji pritet të jetë edhe më pak në dispozicion në shumë zona, andaj është shumë me rëndësi që të gjenden zgjidhje për t'i mbrojtur dhe menaxhuar më mirë burimet ujore. Marrë parasysh mënyrën joefikase të përdorimit të ujit, konservimi i ujit në pikën e përdorimit është me shumë rëndësi për zvogëlimin e sasisë së ujit që përdoret për çfarëdo qëllimi. Duke ndryshuar sjelljet njerëzore apo qasjen ndaj shfrytëzimit të ujit, përmes programeve edukuese dhe vetëdijesuese, do të shfrytëzohet një potencial i madh për konservim të një sasie enorme të ujit të freskët, që do të pasqyrohet në fatura më të ulëta të ujit. Konservimi i ujit mund të aplikohet në të gjithë sektorët: amvisërorë (përdorimi i ujit për pije dhe sanitari), bujqësi, industri dhe energji. Në Kosovë përdoruesit më të mëdhenj të ujit janë sektorët e amvisërive, bujqësisë dhe energjisë. Uji i nxjerrë për qëllime të ftohjes në gjenerim të energjisë pothuajse i tëri kthehet në lum, paksa më i nxehtë se sa temperatura fillestare e tij. Në kontrast me këtë, pjesa më e madhe e nxjerrë për bujqësi konsumohet. Kjo do të thotë se këto ujëra nuk kthehen në lum pasi që shfrytëzohen për ujitje, andaj ose avullohet ose shfrytëzohet nga të mbjellat. Uji i shfrytëzuar për qëllime amvisërore konsumohet (për pirje dhe gatim të ushqimit) apo ndotet rëndë, kështu që nëse kthehet në lum nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera pa trajtim paraprak. Andaj, ky intervenim ka për qëllim konservimin e ujit në pikën e përdorimit të tij.		
Intervenimi: Implementimi i programeve arsimore dhe vetëdijesuese për kursimin e ujit që aplikohet për qëllime të përditshme do të fokusohet në krijimin e një kulture për kursim të ujit: informatat, edukimi dhe trajnimi do të ngritin nivelin e vetëdijes tek bizneset dhe konsumatorët. Programet arsimore dhe vetëdijesuese do të ilustrohen me shembuj nga jeta e përditshme dhe do tu komunikohen njerëzve përmes Buletineve Mjedisore, mediave të shkruara dhe elektronike, fletushkave, ndërveprimit të drejtpërdrejtë me nxënës dhe studentë. Vetëdijesimi do të përqendrohet në mundësitë për ruajtjen e ujit, të cilat janë listuar në tekst më poshtë, duke shfrytëzuar këshilla joshëse për audiencën dhe duke demonstruar praktikisht mundësitë e shfrytëzimit më racional të ujit. *Mundësitë e kursimit së ujit në tualet:* - Rreth një e treta e ujit që përdoret në amvisëri shkon në banjo. Prandaj, në banjo mund të arrihen		

kursime të mëdha, p.sh. duke e shfrytëzuar lëshimin e një sasie më të vogël të ujit në tualet kurdo që është e mundshme, apo duke e zvogëluar kapacitetin e depozitës së ujit duke e vënë një shishe të zbrazët brenda saj.

- Bëni dush në vend se të laheni, vendosni rubinet që kursen ujë.
- Kontrolloni valvulet, rubinetet dhe gypat dhe në rast të rrjedhjes ndërroni ato.
- Mos leni ujin lëshuar kur lani dhëmbët, rruheni apo lani fytyrën.

Mundësitë e kursimit të ujit në kuzhinë:

- Shpëlani enët, pemët dhe perimet në lavaman të mbushur dhe jo nën ujë të rrjedhshëm.
- Lëshoni enëlarësen vetëm kur të jetë e mbushur plot, shqyrtoni zëvendësimin e enëlarëses të vjetër me një që është më efiçiente dhe që do t'ju kursejë ujë dhe energji.
- Mbani një shishe me ujë të ftohur në frigorifer, në mënyrë që të mos detyroheni të mbani ujin e lëshuar deri sa të ftohet.
- Shqyrtoni mundësinë e instalimit të një ngrohësi momental të ujit në lavamanin tuaj të kuzhinës, në mënyrë që të mos leni ujin të rrjedhë deri sa të ngrohet.

Mundësitë e kursimit të ujit për larjen e rrobave

- Lani rrobat vetëm kur të mbushet makina, shqyrtoni zëvendësimin e rrobalarëses së vjetër me një më efiçiente që do t'ju kursejë ujë dhe energji
- Lani rrobat individuale në dorë.

Mundësitë e kursimit të ujit në kopsht:

- Grumbulloni ujin e të reshurave për kopsht dhe pastrim të veturës. Kjo mund t'jua kursej deri në 50% të ujit që shfrytëzohet në ekonomitë familjare.
- Ujitni kopshtin vetëm gjatë periudhave të freskëta të ditës për të minimizuar avullimin
- Shfrytëzoni pemë me origjinë nga vendi, të cilat përshtaten me reshjet normale, tokën, dhe klimën përkatëse e të cilave u nevojitet më pak ujë.
- Bimët më të mëdha kërkojnë më shumë ujë.
- Mbulimi i bazës së bimëve paraqet mënyrë të mirë për të zvogëluar humbjen e ujit. Kjo ruan lagështinë e tokës, duke zvogëluar nevojën për ujitje. Mbulesa do të pasurojë dheun ekzistues dhe do të parandalojë largimin e shiut apo elementeve tjera.
- Bimët e reja kanë nevojë për shumë më pak ujë nëse mbillen në fillim të vjeshtës apo pranverës, kur moti është më i freskët. Në verë, ato do të kenë rrënjë të thella dhe të shëndosha dhe do kenë nevojë për më pak ujitje.
- Instaloni spërkatës që janë më efiçient. Mikroujitja, ujitja me pikje dhe me gypa lagës janë shembuj të metodave efiçiente të ujitjes.
- Bleni një ndërprerës automatik për zorrën tuaj në mënyrë që të mos rrjedhë uji tërë kohën mes përdorimeve

Mundësi tjera për promovimin e kursimit të ujit janë:

- Shmangia e blerjes së lodrave rekreative që kërkojnë rrjedhje të vazhdueshme të ujit
- Inkurajimi i punëdhënësit që ta promovojë kursimin e ujit në vend të punës. Sugjerimi që kursimi i ujit të vendoset në doracakun e punës dhe programin e trajnimit të punonjësve
- Punoni me biznese që praktikojnë dhe promovojnë kursimin e ujit
- Raportoni të gjitha humbjet e mëdha të ujit (gypat e shpuar, hidrantët e hapur, spërkatësit e dëmtuar, etj.) tek pronari apo kompania e ujësjellësit.
- Inkurajoni sistemin arsimor dhe qeverinë lokale që të ndihmojë në promovimin e etikës së kursimit

të ujit tek fëmijët dhe të rriturit - Përkrahni projektet që do të rezultojnë me shtim të përdorimit të ujit të ricikluar për ujitje dhe destinime të ngjashme - Promovoni kursimin e ujit në buletine të komunitetit, tabela informative, etj. - Përpiquni të bëni çdo ditë diçka që do të rezultojë me kursim të ujit. Mos u brengosni nëse kursimet janë minimale, ngase "çdo pikë është e vlefshme".
Rezultatet/ndikimet: Shtimi i vetëdijes lidhur me përdorimin e ujit në mënyrë më racionale duke edukuar të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; - Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; - KRU-të; - Komunat; - Sektori industrial;

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
- Kostoja është mes 0.4-0.5 milionë euro.	2014-2020

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 10		
Emri: **Bartja e ujit**	**Lokacioni:** **Përzgjedhja e masave prioritare do të aranzhohet me MMPH**	**Lloji i intervenimit: Korniza politike + studimi i fizibilitetit + projekt infrastrukturor**
Objektivat: Bartja e ujit nënkupton zhvillimin e skemave adekuate të bartjes për ta zhvendosur/transportuar ujin nga një bazen në një bazen tjetër ku ka më pak ujë në dispozicion apo ku do të mund të shfrytëzohej më mirë për nevoja e zhvillimit njerëzor. Kosova ka sasi relativisht të kufizuara të burimeve të ujit të freskët. Për më tepër, popullata dhe burimet e ujit në dispozicion janë joproporcionalisht të shpërndara në territor. Pjesët perëndimore dhe jugore të Kosovës janë të pasura me ujë, ndërsa pjesët veriore dhe lindore kanë më pak burime të ujit. Për të plotësuar kërkesën për ujë e cila është në rritje në rajone me më pak burime uji, infrastruktura për bartjen e ujit do duhej të planifikohet dhe implementohet me kujdes. Burimet e ujërave sipërfaqësore në Kosovë nuk janë të shfrytëzuara në mënyrë efikase për shkak të kapacitetit të ulët të liqeneve akumuluese. Aktualisht ekzistojnë vetëm 6 liqene akumuluese në të cilat depozitohen 15% të rrjedhave mesatare vjetore të ujit. *Arsyetimi për bartjen e ujit* Duke marrë parasysh se disponueshmëria e ujit dallon nga një bazen në tjetrin, ekziston nevoja për të krijuar infrastrukturë adekuate për ta transportuar ujin mes pellgjeve të lumenjve. Krijimi i infrastrukturës për transportim të ujit do të shtonte fleksibilitetin e furnizimit të ujit në rajone që nuk kanë burime të mjaftueshme të ujit, gjë që paraqet faktor kufizues për zhvillimin social dhe ekonomik të tyre.		

Faktorët që shtyjnë drejt jetësimit të infrastrukturës për bartjen e ujit (korniza ligjore dhe fizike)
Ofrimi i mundësive të barabarta për zhvillim socioekonomik të rajoneve që ndodhen në afërsi të pellgjeve të lumenjve, sigurimi i burimeve adekuate ujore për pjesën veriore dhe lindore të vendit, për të mbuluar kërkesën për ujë që konsiderohet e rëndësisë jetike për Kosovën (ujë për pije, bujqësi, industri, stabilimente për gjenerimin e energjisë, etj.) dhe shtimi i fleksibilitetit të bartjes së ujit mes rajoneve (pellgjeve të lumenjve) dhe kategorive të ndryshme të përdoruesve të tij.

Intervenimi:
Implementimi i projekteve për bartjen e ujit do të realizohet në dy faza. Faza e parë do të përqendrohet në hartimin dhe miratimin e tërë legjislacionit të duhur për bartjen e ujit, përfshirë hulumtimet dhe studimet e fizibilitetit. Faza e dytë do të përqendrohet në implemetimin e projekteve infrastrukturore për bartjen e ujit, në pajtim me prioritetet e përcaktuara në studimet e fizibilitetit dhe hulumtimet tjera të kryera.

Masat afatshkurtra dhe afatmesme:

i) Zhvillimi i kornizës adekuate politike/ligjore për bartjen e ujit.

ii) Zhvillimi i hulumtimeve dhe studimeve që ndërlidhen me balancin e ujit në bazene, përkufizimin e nevojave për ujë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda çdo bazeni, përgatitja e projeksioneve për nevojën për ujë, ndarja e ujit dhe përcaktimi i prioriteteve për furnizimin e ujit tek konsumatorët, adresimin e situatave të thatësisë dhe kufizimin e përdorimit të ujit.

iii) Përgatitja e raporteve të vlerësimit të ndikimit mjedisor, vlerësimeve për ndryshimin e destinimit të tokave, vlerësimit të habitateve dhe pengesave sociale që ndërlidhen me implementimin e infrastrukturës për bartjen e ujit (kanaleve bartëse, liqeneve akumuluese, etj.).

iv) Zhvillimi i studimeve të fizibilitetit dhe analizave hulumtuese mbi realizueshmërinë e opsioneve të bartjes së ujit mes pellgjeve të lumenjve:

- Nga veriu në juglindje: vazhdimësi e ish-projektit të Bankës Botërore për Ibër Lepencin (që nga të 80-tat) që lidh pellgun e Ibrit me atë të Lepencit, përfshirë infrastrukturën e transportit dhe liqenit akumulues në lumin Lepenc.
- Nga juglindja në lindje: që lidhë Lepencin me pellgun e lumit Morava e Binçës, përfshirë infrastrukturën për bartjen e ujit dhe liqenin akumulues
- Nga perëndimi në veri: për të lidhur Drinin e Bardhë me pellgun e Ibrit dhe pellgjet e lumenjve në juglindje.

Masat afatgjata:

v) Përgatitja e dizajnit kryesor për implementimin e infrastrukturës së bartjes së ujit mes pellgjeve të lumenjve.

vi) Implementimi/ndërtimi i infrastrukturës për bartjen e ujit: liqenet akumuluese, kanalet bartëse për transportimin e ujit nga një pellg i lumit tek tjetri.

Rezultatet/ndikimet:

Implementimi i skemave adekuate të bartjes së ujit do t'i ndihmonte pellgjeve pranuese në tejkalimin e mungesave të ujit dhe do të ofronte furnizim shtesë të ujit për këto rajone, gjë që do të ndihmonte zhvillimin social dhe ekonomik të tyre. Përveç kësaj, kjo do përmirësojë fleksibilitetin e bartjes së ujit mes burimesh si dhe furnizimin e ujit tek popullata, industria, centralet e prodhimit të energjisë në rast të situatave emergjente. Ajo gjithashtu i kontribuon rrjedhjes së lehtë për të mundësuar 'rrjedhën minimale mjedisore'.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Këshilli Ndërministror i Ujërave;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (do të realizojë aktivitetet e domosdoshme ligjore

dhe procedurale për bartjen e ujit);

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik;
- Ministria e Financave;
- Komunat;
- KRU-të;
- Donatorët aktivë në sektorin e ujërave në Kosovë.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Afatshkurtër: Kostoja e implementimit të fazës së parë parashikohet të jetë mes 4.0 dhe 5.0 milionë euro. Afatgjatë: Kostoja për implementimin e këtij intervenimi kërkon studime të mëtejme. Në këtë moment është vështirë të parashihet kostoja.	Masat afatshkurtra deri afatmesme: 2014 - 2018. Afatgjatë: 2017 - 2030.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 11

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Sigurimi i rrjedhave minimale gjatë periudhave të thata	**Në tërë Kosovën**	**Zhvillim i politikave dhe punime hulumtuese shkencore**

Objektivat:

Historikisht, burimet e ujit janë menaxhuar vetëm për të plotësuar nevojat e zhvillimit jashtë rrjedhës. Uji që nuk është nxjerrë nga rrjedha për qëllime të zhvillimit ekonomik kryesisht është konsideruar i shpenzuar kot. Ndryshimi i vlerave sociale sa i përket cilësisë së ujit, mjedisit dhe shërbimeve të ekosistemit ka pasur ndikim në menaxhimin e burimeve të ujit. Kjo qasje është pasqyruar në evolucionin e qëndrimit fillestar.

Menaxhimi i rrjedhës minimale fokusohet parimisht në nevojën që një sasi minimale e ujit të mbetet në rrjedhë për të siguruar kësisoj disa përfitime. Rrjedhjet mjedisore kanë rol të rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme dhe konkurrencën e cila zhvillohet mes kërkesave të ndryshme për ujë. Ndryshimi i vlerave shoqërore ka bërë që kujdes më i madh t'i kushtohet burimeve ujore, me qëllim të plotësimit të nevojave për ujë cilësor, peshq dhe habitat të botës së egër, si dhe për shërbimet tjera të ekosistemit.

Intervenimi:

Hartimi dhe miratimi i politikave përkatëse për të adresuar rrjedhat mjedisore, është i rëndësishëm, veçanërisht gjatë periudhave të thata. Ky intervenim përfshin hartimin e politikave dhe punimeve hulumtuese, si në vijim:

- Zhvillimin e metodologjive që prodhojnë rekomandime të besueshme sa i përket rrjedhave, edhe atë brenda kornizave përkatëse kohore, duke konsideruar: nevojat për ujë të pijes, nevojat për ujitje, rrjedhën e nevojshme për ta ruajtur cilësinë e ujit, dhe rrjedhën e nevojshme për të ruajtur ekologjinë lumore.
- Zhvillimin e një procesi përfshirës që bazohet në konsensus e jo në procese konkurruese, e në të cilin në çdo hap përfshihen hulumtues shkencorë nga disiplina të ndryshme, planifikues, inxhinierë, dhe vendimmarrës.
- Dhënia e rekomandimeve për rrjedhën minimale e cila siguron ruajtjen e shërbimeve mjedisore dhe të ekosistemeve për lumenjtë.
- Kuptimi i rëndësisë së rrjedhave të ulëta (apo mosrrjedhjes) si kontribues në ruajtjen e

strukturave natyrore të ekosistemeve lumore. - Zhvillimi i hulumtimeve dhe vlerësimeve lidhur me integritetin dhe ndjeshmërinë e habitatit. - Përcaktimi i regjimeve hidrologjike në lumenj; vlerësimi dhe modelimi i rrjedhës së lumit, modelimi i cilësisë së ujit duke konsideruar skenarë të ndryshëm.
Rezultatet/ndikimet: Rrjedha mjedisore e lumenjve është përcaktuar në bazë të hulumtimeve shkencore, duke shqyrtuar kërkesën për ujë të pijes, për ujitje, rrjedhën e nevojshme për të ruajtur cilësinë e ujit dhe rrjedhën e nevojshme për ruajtur ekologjinë lumore.
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Autoritetet e Pellgjeve të Lumenjve; - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; - Komunat.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të mësipërm parashikohet të jetë rreth 2.5 milionë euro	2020 – 2025

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 12		
Emri: **Përshtatja e të mbjellurave, përfshirë a) Farat e të mbjellurave tejet të rezistueshme; b) përzgjedhjen e të mbjellurave (të mbjellurat që shfrytëzojnë ujin në mënyrë më efikase), c) Rotacioni i të mbjellurave (për ripërtëritje të dheut)**	**Lokacioni: Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Zhvillim i ave programeve vetëdijesuese të cilat promovojnë përdorimin e 'teknologjive efikase në ujitje'**
Objektivi: Përshtatja e bujqësisë së Kosovës me ndryshimet klimatike rajonale dhe botërore. *Arsyeshmëria* Ndryshimet klimatike që aktualisht po vërehen në tërë botën dhe në rajon kanë prekur edhe Kosovën. Thatësi ka pasur edhe historikisht në Kosovë, ndërsa tani ka dëshmi që ndryshimet klimatike janë duke krijuar afinitet të shtuar ndaj thatësisë në Mesdheun juglindor. Në shtetet e Evropës juglindore me të cilat kufizohet Kosova ka pasur zvogëlim të nivelit të reshjeve vjetore gjatë 45 vitet e fundit, edhe atë në sasi prej 150mm për çdo 10 vite, apo 15mm për çdo vit. Këto rënie enorme do të ndikojnë në të gjitha aspektet e ciklit hidrologjik gjatë viteve në vijim. Nivelet e ujërave nëntokësore do të bien në mënyrë progresive, sikur edhe rrjedhat e lumenjve dhe niveli i lagështisë së dheut. Si përkrahje në këtë drejtim, respektivisht me qëllim të përshtatjes, bujqit e Kosovës duhet t'i përshtasin të mbjellurat e tyre dhe sistemet e mbjelljes me kushtet mbizotëruese më shpejt se kurdo herë më parë. Farat/varietetet e rezistueshme që mund të tolerojnë nxehtësinë, vërshimet, thatësinë dhe problemet tjera do të jenë shumë me rëndësi për të siguruar furnizim të ushqimit kundrejt presioneve të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.		

Të mbjellurat që shfrytëzojnë në mënyrë më efikase ujin dhe ndryshimi i të mbjellurave mund të shihen si metoda të përshtatjes.
Intervenimi: Duke marrë parasysh gjendjen aktuale dhe ndryshimet klimatike të cilat po ndodhin në rajon dhe në Kosovë, është e qartë se bujqësia dhe pylltaria në Kosovë duhet t'i përshtatet këtyre ndryshimeve klimatike. Për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike duhet të ndërmerren disa intervenime. Në këtë fazë, fokusi duhet të jetë në drejtime të ndryshme, në hulumtime, dokumente për politikat, si dhe në përdorimin e farave të mbjellurave të rezistueshme, të mbjellurave që kërkojnë më pak ujë dhe me ndryshimin e të mbjellurave. - Studimi i fizibilitetit lidhur me të mbjellurave dhe farat e rezistueshme - Përgatitja e draft Planit Kombëtar për Menaxhimin e Thatësisë (PKMTH) - Zhvillimi i një institucioni adekuat për monitorimin e thatësisë; - Vlerësimi i cenueshmërisë së thatësisë; - Programet e Ngritjes së vetëdijes së bujqve mbi: - Mbjelljen e varieteteve që i përshtaten thatësisë; - Varieteteve me sipërfaqe të kufizuar të gjetheve, që minimizojnë djersitjen; - Sisteme me rrënjë të thella profilike që ngritin shfrytëzimin e lagështisë; - Varietete me maturim të shpejtë që janë të rëndësishme në mënyrë që e të mbjellurat të mund të zhvillohet para pjesëve më të thata të vitit dhe para shpenzimit të të gjitha burimeve të lagështisë. - Kontrollimi i brejtësve, kontrolli i barishteve dhe lërimi më i paktë.
Rezultatet/ndikimet: Implementimi i përshtatjes të të mbjellurave sjell këto përparësitë: - Vlerësimi i cenueshmërisë do të ndihmojë në minimizimin e ndikimeve të thatësisë, falë planifikimit të mirë; - Të kuptuarit adekuat nga fermerët të përdorimit të mbjellurave dhe farave tejet të rezistueshme; - Studimet hulumtuese që do t'u ndihmojnë bujqve në përdorimin e farave dhe të mbjellurave më të rezistueshme dhe që shfrytëzojnë më pak ujë, e që përputhen me kushtet në Kosovë. - Zvogëlimi i humbjeve të rendimentit të mbjelluarve.
Përgjegjësitë: Fakulteti i Bujqësisë, hulumtuesit, KAI, MMPH, MBPZHR, APK, KFI, Shërbimet Këshillëdhënëse dhe bujqit.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
500 000 euro	2015 - 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 13		
Emri: **Teknologjitë e kursimit të ujit në ujitje**	**Lokacioni:** **Në tërë Kosovën - implementimi i pilot projektit**	**Lloji i intervenimit:** **Zhvillimi i politikave & dokumente hulumtuese, programe për vetëdijësim që**

		promovojnë përdorimin e "teknologjive efiçiente në ujitje".

Objektivat:

Në tërë botën ujitja e tokës bujqësore paraqet një nga përdorimet më të shumta të ujit, duke shfrytëzuar më shumë 70% të tërë sasisë së ujit të nxjerrë në botë. Në bazë të të dhënave statistikore, skemat zyrtare të ujitjes në Kosovë janë në gjendje shumë të dobët dhe mbulojnë vetëm 17.4% të tërë tokës bujqësore në Kosovë. Si i tillë, sektori bujqësor nuk është tërësisht i zhvilluar dhe kërkon investime tjera.

Para konfliktit të vitit 1999, 70,000 ha tokë ishin të ujitjshme, përmes shfrytëzimit të sistemit tradicional dhe të spërkatjes. Kjo sipërfaqe ka rënë në 23,000 pas vitit 1999, për shkak të konfliktit si dhe mungesës së infrastrukturës adekuat të ujitjes. Përafërsisht rreth 33,000 ha mund të ujiten përmes spërkatjes dhe 26,000 tjera përmes ujitjes sipërfaqësore.

Skemat ekzistuese të ujitjes janë tejet joefiçiente sa u përket furnizimit me ujë, kanaleve të bartjes dhe sistemit të gypave, të cilët janë përkeqësuar. Humbja e ujit në kanalin Ibër-Lepenci, sipas raporteve të Hidrosistemit Ibër Lepenc, supozohet të jetë rreth 50%.

Arsyetimi për vendosjen e teknologjive për kursimin e ujit në ujitje

Sektori bujqësor paraqet një shtyllë të rëndësishme për zhvillimi social dhe ekonomik të Kosovës, si një nga sektorët kryesorë sa i përket gjenerimit të punësimit. Shtimi në këtë ekuacion i skemave të stimulimit të bujqve, të cilat i jep Qeveria, dëshmon se sektori i bujqësisë po bëhet edhe më i rëndësishëm. Në reagimin ndaj kërkesës në rritje për ujë në sektorin e bujqësisë në njërën anë dhe ndaj mungesës së ujit në anën tjetër, 'teknologjitë e kursimit të ujit në ujitje' janë tejet të rëndësishme.

Faktorët shtytës për vendosjen e teknologjive për kursimin e ujit në ujitje

Përmirësimi i teknologjisë së ujitjes dhe avancimi i praktikave të menaxhimit të fermave i ofrojnë bujqësisë mundësinë që ta shfrytëzojnë ujin në mënyrë më efikase. Implementimi i programeve institucionale të menaxhimit të ujit dhe praktikave të kursimit të ujit pa sakrifikuar rendimentin e të mbjellurave, dhe promovimi i 'teknologjive që kursejnë ujë në ujitje' do t'i kontribuojnë kursimit të ujit që shfrytëzohet për qëllime tjera mjedisore.

Intervenimi:

Aktualisht, shumica e sistemeve të ujitjes në Kosovë bazohen në gravitet, që i bën ata tejet joefikasë sa i përket furnizimit dhe kursimit të ujit. Andaj kalimi nga skemat gravitetcionale në skema me presion më efikas, siç janë sistemet e pijes apo spërkatjes, përbën një mundësi të mirë për të kursyer sasi të konsiderueshme të burimeve të ujit të freskët që shfrytëzohen për ujitje. Implementimi i teknologjive efiçiente të ujitjes mund të mos mjaftojë, andaj intervenimi në këtë moment duhet të përqendrohet në dy drejtime, që përfshijnë politikat adekuate dhe implementimin e pilot projekteve.

- Zhvillimi i politikave adekuate për ujitje dhe ndarje të ujit për bujqësi, në bazë të hulumtimeve shkencore, duke pasur parasysh kushtet specifike të pellgut të lumit dhe kërkesat specifike për ujë të bimëve/të mbjelluraver bujqësore që do mbjellën.
- Zhvillimi i programeve institucionale për menaxhimin e ujërave dhe nismave që i inkurajojnë bujqit që të përshtasin dhe zbatojnë 'sisteme efiçiente të ujitjes' dhe të promovojnë teknologjitë e reja të ujitjes.
- Kufizimi, deri në masën e lejuar, i ujërave nëntokësore për qëllime të ujitjes.
- Implementimi i masave stimuluese për bujqit dhe ndarja e fondeve për implementimin e pilot projekteve mbi 'teknologjitë efiçiente për kursimin e ujit në ujitje' përfshirë sensorët 'e mençur' për matjen e lagështisë në ujë.
- Krijimi i orarit të ujitjes dhe sistemit të monitorimit.
- Kultivimi i varieteteve të reja të të mbjelluarve që i rezistojnë më shumë thatësisë.

Rezultatet/ndikimet:

Implementimi i skemave efiçiente të ujitjes sjell përparësitë vijuese:

- Skemat e reja të ujitjes i mundësojnë bujkut zvogëlimin e sasisë së ujit që përdoret në një fushë të caktuar; përmirësimin e uniformitetit të shpërndarjes së ujit, gjë që mund të rezultojë me ngritje të rendimentit.
- Efiçienca e lartë e aplikimit të ujit, prej rreth 85%, parandalon humbjet nga avullimi apo rrjedhja e pakontrolluar e ujit.
- Aplikimi i saktë dhe me kohë i plehut dhe pesticideve rezulton me efiçiencë më të madhe dhe mund të rezultojë me nevojën për sasi më të vogla të tyre.
- Kursimi i ujit nga ngritja e efikasitetit në ujitje në një fushë mund replikohet për tu shfrytëzuar në ujitjen e fushave tjera.
- Ngritja e efikasitetit të ujitjes dhe shtimi i kursimit të ujit gjithashtu do të zvogëlojë shpenzimet për ujë në fermë.
- Ulja e sasisë së ujit të nxjerrë për qëllime të ujitjes.
- Programet e kursimit të ujit brenda fermave, së bashku me mekanizmat institucionalë për menaxhimin e ujërave, mund të inkurajojnë rialokimin e ujit të kursyer për të plotësuar nevojat e fermës për rrjedhje mjedisore dhe kërkesat tjera për qëllime bujqësore dhe jobujqësore.

Raporti i Departamentit të Bujqësisë të SHBA-ve: Kursimi i Ujit në Ujitje në Bujqësi: Trendet dhe Sfidat nga Shtimi i Kërkesës (USDA, 2012) konfirmon se aplikimi i teknologjive efikase të ujitjes rezulton me përmirësimet si në vijim:

- Shtimi i rendimentit të të mbjellurave mes 58-67%
- Ulja e kostove të energjisë për 43-56%
- Sasi më të vogla të ujit të shfrytëzuar 54-60%
- Zvogëlim të humbjes së plehut/pesticideve 16-18%
- Zbritje të normës së erozionit të tokës 25-29%

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Autoritetet e Pellgjeve të Lumenjve;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Shërbimet Këshillëdhënëse;
- Shoqatat e bujqve;
- Komunat.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e investimit për intervenimin e lartpërmendur kërkon studime të mëtejme në fushat që mund të mbulohen me ujitje, në përcaktimin tokave bujqësore, kërkesën për ujë për mbjelljet e ndryshme, etj. Kostoja e implementimit të sistemit të ujitjes me pikje për një hektar të ujitur supozohet të jetë 1.500 - 2.500 Euro/ha. Kostoja e rehabilitimit të kanaleve të ujitjes, përveç kanalit Ibër-Lepenci i cili adresohet në ISH 40, dhe shtimi i normës së mbulimit të tokës së ujitur nga skemat zyrtare, vështirë mund të vlerësohen aktualisht. Studime të mëtejme të këtij aktiviteti janë të domosdoshme.	2015 – 2020.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 14		
Emri: **Grumbullimi i ujit të shiut**	**Lokacioni:** **Tërë Kosova, amvisëritë, industritë, institucionet, etj.**	**Lloji i intervenimit:** **Zhvillimi i politikave, programeve të vetëdijesimit dhe stimulimit të grumbullimit të ujit të shiut**

Objektivat:

Burimet e ujit të freskët janë të kufizuara, prandaj shpikja e programeve zhvillimore të ndryshme dhe teknikave përkatëse për promovimin e kursimit të ujit mund të ndihmojë në shtimin e vetëdijes së popullatës për kursimin dhe shfrytëzimin racional të ujit dhe për implementimin e sistemeve për grumbullimin e ujit të shiut.

Uji i shiut është falas, e vetmja kosto që ndërlidhet me grumbullimin e tij është blerja dhe instalimi i një sistemi për grumbullimin dhe depozitimin e tij. Pas grumbullimit, uji i shiut mund të shfrytëzohet për qëllime të ndryshme, siç janë ujitja (në parqe e kopshte), pastrime të jashtme e madje edhe për rimbushje të akuifereve (shtretëve) nëntokësore, etj. Zëvendësimi i ujit të përpunuar të shfrytëzuar për këto qëllime me ujë të shiut lehtëson paksa presionin mbi burimet e ujit dhe ekosistemet e ndjeshme. Hulumtuesit e ndryshëm sugjerojnë që grumbullimi i ujit të shiut mund ta zbret konsumin e gjithmbarshëm për mes 20-40%. Uji i depozituar i shiut përbën një burim të gatshëm të ujit, veçanërisht gjatë verave të gjata e të thata në rajone që kanë mungesë uji.

Intervenimi:

Grumbullimi i ujit të shiut paraqet një sistem të thjeshtë që përbëhet nga grumbullimi dhe depozitimi i ujit të shiut nga pullazet dhe ruajtja e tij në një rezervuar depozitues (qoftë nga betoni qoftë nga plastika). Shfrytëzimi i teknikave për grumbullimin e ujit të shiut kërkon realizimin e fushatave intensive edukative dhe vetëdijesuese, me theks në përfitimet mjedisore të grumbullimit të ujit. Implementimi i masave stimuluese për amvisëritë, industritë, institucionet dhe ndarja e fondeve për implementim të pilot sistemeve të grumbullimit të ujit të shiut do të ishin të dobishme për të paraqitur potencialin e grumbullimit të ujit të shiut dhe ndikimet që ky grumbullim i ka në kursimin e ujit dhe faturat e gjithmbarshme të ujit.

Rezultatet/ndikimet:

Përfitimet nga grumbullimi i ujit të shiut mund të listohen si në vijim:

- Zvogëlon kërkesën e përgjithshme për ujë të trajtuar (nga furnizuesi i ujit komunal), gjë që do përkthehet si kosto më e ulët e pompimit dhe emetime më të ulëta të gazrave serrë.
- Zvogëlon potencialin për vërshime, erozion dhe rrjedhje drejt kanalizimit
- Zvogëlon kontaminimin e ujërave sipërfaqësore me sedimente të origjinave të ndryshme, plehra dhe pesticide nga ujërat ë rrjedhje
- Mund të shfrytëzohet për rimbushje të burimeve nëntokësore


Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Këshilli Ndërministror i Ujërave;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Komunat;
- Institucionet qeveritare dhe komunale.

Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të një pilot-projekti mesatar për grumbullimin e ujërave nga shiu në institucionet publike, siç janë shkollat, ndërtesat qeveritare/komunale, etj. përfshirë kostot për infrastrukturën e grumbullimit, infrastrukturën e depozitimit dhe pajisjet e transportit deri në pikën e përdorimit, parashikohet të jenë mes 40,000 dhe 60,000 euro.	**Periudha e investimit** (intervenimi afatshkurtër deri afatmesëm): 2017 –2020.

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 15		
Emri: **Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore**	**Lokacioni: Në tërë Kosovën**	**Lloji i intervenimit:** **Dokument i politikave, studime të fizibilitetit dhe projekt infrastrukturor**
Objektivat: Ujërat nëntokësore janë resurs strategjik për shkak të cilësisë së lartë dhe disponueshmërisë përgjatë tërë vitit. Megjithatë, menaxhimi i ujërave nëntokësore shpesh nuk ka qëndrueshmëri, gjë që rezulton me zbritje të nivelit të ujit në dispozicion, ndërsa si rrjedhojë e mungesës së praktikave adekuate të menaxhimit, dëmtohet edhe cilësia e ujit. Siç ilustrohet në figurën e mëposhtme, menaxhimi i burimeve të ujërave nëntokësore ka të bëjë me balancimin e dimensionit social dhe ekonomik të menaxhimit të kërkesës pranë dimensionit hidrologjik të menaxhimit të ofertës.		



Menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore trajton balancimin e eksploatimit të një burimi kompleks të ujërave nëntokësore (sa i përket sasisë, cilësisë dhe ndërveprimit me ujëra sipërfaqësore) me kërkesë në rritje për ujë tek përdoruesit (gjë që mund të konsiderohet kërcënim për disponueshmërinë dhe cilësinë e tij).

Vërejtje: Projekti i binjakëzimit i BE-së në MMPH do të ketë për detyrë përgatitjen e një vlerësimi lidhur me gjendjen e rrjetit të monitorimit të burimeve ujore, nevojat për themelimin e rrjetit të monitorimit, vlerësimin e burimeve ujore, vlerësimin e kontaminimit të burimeve ujore dhe inspektimin e burimeve ujore.

Intervenimi:

Masat që do të realizohen përmes këtij intervenimi janë listuar më poshtë:

- Zhvillimi i legjislacionit dhe dispozitave rregullative mbi ujërat nëntokësore nga rregullat zakonore sa i përket planifikimit të integruar të mbajtjes, me qëllimin përfundimtar që të rregullohet zhvillimi i ujërave nëntokësore dhe të kufizohen veprimtaritë që mund të kompromentojnë disponueshmërinë dhe cilësinë e ujërave nëntokësore. Legjislacioni gjithëpërfshirës për ujërat ofron përparësi të konsiderueshme, pasi që përbën bazën ligjore për menaxhim efektiv dhe të qëndrueshëm të ujërave nëntokësore, përmes:

✓ Sigurimit të kuantifikimit, planifikimit, alokimit dhe kursimit të resurseve të ujërave nëntokësore

✓ Një sistemi të licencave për rrjedhje të ujërave të zeza, duke ndihmuar në mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja

✓ Sigurimit të monitorimit të ujërave nëntokësore (sasia dhe cilësia) për menaxhimin e reagimit ndaj rreziqeve për akuiferet ✓ Sigurimi i rimbushjes/plotësimit të akuifereve ✓ Sigurimi i vlerësimit të cenueshmërisë dhe formulimi i strategjive për zbutjen e situatës ✓ Dizajnimi dhe implementimi i politikave kombëtare dhe për pellgje lumenjsh ✓ Përkufizimi i të drejtave dhe obligimeve të përdoruesve të ujërave nëntokësore ✓ Rregullimi i shfrytëzimit emergjent të ujërave nëntokësore gjatë thatësirave ✓ Themelimi dhe kufizimi i zonave për mbrojtjen e ujërave nëntokësore, përfshirë implementimin e masave përkatëse ✓ Kërkimi i regjistrimit dhe kualifikimit të hapësve të puseve ✓ Intervenimi i mundshëm administrativ në situata kritike (shterje apo ndotje të akuifereve) ✓ Sigurimi i ndërveprimit bashkëpunues mes administratorëve të ujit dhe përdoruesve të ujit ✓ Pjesëmarrja e hisedarëve në menaxhimin e ujërave nëntokësore ✓ Krijimi i ndërveprimit institucional në menaxhimin e burimeve nëntokësore ujore me pjesëmarrje të gjerë, varësisht nga lokacioni gjeografik, përmasat e akuiferit, etj. ✓ Instrumentet ekonomike për menaxhimin e ujërave nëntokësore përfshirë masat stimuluese për përmirësimin e qëndrueshmërisë. ✓ Themelimi i një sistemi për monitorimin e ujërave nëntokësore në tërë territorin e Kosovës.
Rezultatet/ndikimet: - Burimet nëntokësore menaxhohen dhe shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje të plotë me parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Këshilli Ndërministror i Ujërave - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Komunat - Donatorët aktivë në sektorin e ujërave në Kosovë

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të këtij intervenimi, përfshirë kostot për krijimin e rrjetit të monitorimit të burimeve të ujërave nëntokësore është rreth 4.5-5.0 milionë euro.	2014-2018.

Formulari i intervenimit Nr. 16		
Emri: **Fuqizimi i politikave për mbrojtjen e pyjeve, përfshirë a) trajtimi strikt i rasteve të prerjes ilegale, b) edukimi i njerëzve mbi përfitimet nga pylli dhe efektet e dëmshme të shpyllëzimit, c) largimi i drunjëve për djegie**	**Lokacioni: Kosovë - zonat pyjore**	**Lloji i intervenimit:** **Zhvillimi dhe implementimi i politikave, programeve vetëdijesuese dhe**

për të zvogëluar kërcënimin nga zjarret në pyje, d) përzgjedhja e specieve të drunjëve dhe praktikave pyjore që më pak rrezikohen nga stuhitë dhe zjarret, e) gjithashtu në lidhje me intervenimet e përmendura nën strukturat e menaxhimit të informatave dhe bashkëpunimit		**edukative, ngritje e kapacitetit për menaxhimin e pyjeve dhe bashkëpunimin më të ngushtë mes institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve**

Objektivat:

Të rrallohet prerja ilegale e pyjeve përmes trajtimit strikt të rasteve në gjykatë dhe programeve të edukimit dhe vetëdijesimit të popullatës lokale lidhur me rëndësinë dhe dobitë e mbrojtjes së pyjeve.

Arsyeshmëria

41% e sipërfaqes së Kosovës është e mbuluar me pyje (464,800 ha), nga të cilat 60% janë pronë shtetërore (278,880 ha) dhe 40% janë pyje private (185,920 ha).
Gjatë regjistrimit është supozuar se rreth 40% të pyjeve publike dhe 29% të pyjeve private preken nga veprimtaria e prerjes ilegale të pyjeve.
Shumë pyje të reja dhe të moshës së mesme kanë nevojë për intervenim urgjent, si dhe për pastrim dhe hollim.
Në vitin 2010 kishte 'vetëm' 1,203 aktakuza penale, ndërsa në vitin 2011 numri u shtua në 7,871 aktakuza, në vitin 2012 u shënua një rënie e vogël në krahasim me vitin paraprak duke qenë se 7,586 raste u dërguan pranë gjykatave themelore përkatëse.
Në bazë të hulumtimeve të bëra, kërkesa për dru për djegie si burim i energjisë është më e lartë se sa sasitë e tij në dispozicion në pyje. Andaj Kosova duhet të përballet me mungesën e drunjëve për djegie, për të qenë në gjendje që të garantojë menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve dhe zhvillim ekonomik të vendit.
Për të garantuar zhvillim stabil, këto probleme duhet të zgjidhen përmes menaxhimit të pyjeve dhe zvogëlimit të konsumit të drunjëve për qëllime energjetike.
Në bazë të informatave, konsumi vjetor i drunjëve për djegie në Kosovë arrin në 2,350,000 m3. Për shembull në vitin 2008 në Kosovë janë konsumuar 2.5 milionë m3 dru (87% në sektorin e amvisërive), e nëse ky trend vazhdohet atëherë mund të arrihet tek përfundimi se në vitin 2028 Kosova do të mbetet pa pyje.
Burimi: Konsumi i Energjisë në Sektorin e Amvisërive në Kosovë - Zhvillimet e Ardhme, 2011

Intervenimi:

Për të ndalur këtë tendencë të shfrytëzimit të pakontrolluar dhe shkatërrimit të pyjeve, janë të domosdoshme intervenime ndërsektoriale:

1. Për të krijuar një grup punues ndërqeveritar, të përbërë nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve;
2. Për të themeluar një dhomë të veçantë në gjykatë apo për të caktuar gjyqtarë të posaçëm për të trajtuar rastet e dëmtimit të pyjeve me prioritet.
3. Për të ndërmarrë një fushatë mediatike që ka për qëllim ngritjen e vetëdijes mbi mbrojtjen e pyjeve, duke pasur për synim të veçantë njerëzit që jetojnë në vise malore (veprime që përfshijnë edukimin, shpërndarjen e fletëpalosjeve të ndryshme, reklamat në TV, radio dhe shtyp);
4. Për të ngritur kapacitetit në menaxhimin e pyjeve

5.	Për të fuqizuar sistemin e monitorimit

Rezultatet/ndikimet:

- Më pak prerje ilegale e drunjëve
- Përdorim më i vogël i drunjëve për djegie/ngrohje
- Menaxhim më i mirë i burimeve pyjore
- Ngritja e vetëdijes lidhur me përfitimet tjera nga pyjet.

Përgjegjësitë:
Qeveria, MBPZHR, AKP, MASHT, MMPH, gjykatat, policia, komunat, pronarët privatë të pyjeve dhe shoqëria civile.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
500 000 euro	2013-2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 17

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Mbjellja e drunjëve, ripyllëzimi, dhe trajtimi i mangësisë së ujit dhe vërshimeve	**Në tërë Kosovën – pyjet e djerra**	**Pyllëzimi dhe ripyllëzimi**

Objektivat:
Të mbrohen mallrat (pronat, të mirat natyrore, tokat bujqësore, etj.) nga vërshimet dhe të shtohet efikasiteti i përdorimit të ujit (amvisëri, industri, bujqësi, etj.) për të tejkaluar mungesën e ujit.

Arsyeshmëria

Ndryshimet klimatike janë duke theksuar çdo herë e më shumë rolin e pyjeve në rregullimin e rrjedhave të ujit dhe ndikimin e tyre në disponueshmërinë e burimeve ujore.
Prandaj, marrëdhënia mes pyjeve dhe ujit është çështje kritike të cilës duhet t'i jepet prioritet i lartë.
Dihet mirë se shfrytëzimi i pakontrolluar apo largimi i mbulesës së drunjëve mund të përshpejtojë rrjedhjen e ujit dhe shton rrezikun nga vërshimet gjatë stinës së shirave, por gjithashtu mund të zvogëlojë rrjedhën në lumenj apo madje edhe të shkaktojë tharjen e shtretërve të lumnjëve gjatë stinës së thatë. Megjithatë, rëndësia e mbulesës pyjore në rregullimin e rrjedhave hidrologjike shpesh është mbivlerësuar.
Marrë parasysh gjendjen aktuale të pyjeve në Kosovë, është tejet e rëndësishme që si prioritet të vëhet mbrojtja e pyjeve nga prerja ilegale, jo vetëm për të zvogëluar rrjedhjen e ujit por edhe për tu mbojtur nga erozioni.

Kosova potencialisht rrezikohet nga tri lloje kryesore të vërshimit: vërshimet e mëdha të ultësirave, vërshimet e shpejta në zonat e larta dhe vërshimet katastrofale nga rrënimi i pendave.
Në Kosovë, vërshimet ndodhin pranë pellgjeve të lumenjve. Në bazë të të dhënave nga hulumtimet, rreth 491km të lumenjve janë në rrezik nga vërshimet, ndërsa deri tani vetëm 140km, apo 28% të gjatësisë së lumenjëve të rrezikuar nga vërshimet janë rregulluar.
Ka pasur shumë periudha të vërshimeve të shkurtra në Kosovë dhe mesatarisht në vend një vërshim më i

madh ndodhë një herë në gjashtë vite.
Për shkak të situatës me pellgjet e parregulluara të lumenjëve, sipas të dhënave aktuale rreth 34,000 ha rrezikohen nga vërshimet e mundshme.
Shumë rajone të Kosovës përballen me mungesë të ujit dhe cilësi të ulët të ujit të pijes.

Dendësia relativisht e lartë e popullatës, bujqësia që ujitet në mënyrë tradicionale, verat e nxehta dhe të thata janë faktorë shtesë që rëndojnë mungesën e ujit në Kosovë.
Megjithatë, furnizimi mesatar vjetor për kokë banori në Kosovë është rreth 1'987 m^3, dhe klasifikohet si i mjaftueshëm. UNEP përdorë klasifikimin vijues:

Pamjaftueshëm	> 1'000 m^3/person/vit
Stres	1'000 – 1'700 m^3/person/vit
Mjaftueshëm	> 1'700 m^3/person/vit

Intervenimi:
Për të tejkaluar situatat e mundshme të vërshimeve apo mungesës së ujit si rrjedhojë e ndikimeve nga ndryshimet klimatike.

Intervenimi
- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të degraduara
- Mbjellja/rritja e drunjëve për të parandaluar lëvizjen e dheut, veçanërisht mbjellja e atyre me rrënjë të thella që mbajnë dheun kompakt.
- Moslërimi/lërimi vetëm kur është i domosdoshëm
- Shfrytëzimi i praktikave bujqësore që mund të prodhojnë mbjella të mira pa nevojë për lërim.

Të përgjithshme
- Bashkëpunimi mes institucioneve qeveritare
- Krijimi i një sistemi adekuat të monitorimit
- Përkrahja financiare
- Përgatitja e analizave statistikore mbi frekuencën e vërshimeve
- Monitorimi dhe raportimi mujor i parashikimit rajonal të vërshimeve (IHMK)
- Monitorimi i buletineve mujore dhe parashikimeve për katër pellgje lumore, shpallja e paralajmërimeve për vërshime dhe grumbullimi i Komitetit për Menaxhimin e Vërshimeve

Rezultatet/ndikimet:
Implementimi i pyllëzimit dhe mbjelljes së drunjëve ka ndikimet në vijim:
- Pyllëzimi mbron tokën dhe zvogëlon normën e erozionit dhe bartjes së sedimenteve në lumenj;
- Pyllëzimi zvogëlon rrjedhat e ujit dhe erozionin;
- Pyjet natyrore të mbajtura mirë mund të mbrojnë edhe ujin e pijes

Zvogëlimi i dëmeve nga vërshimet, më pak vërshime, më pak dëme në nivel të vendbanimeve, më pak dëme në bujqësi (të mbjellat e kultivuara pranë lumenjve)

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:
MBPZHR, AKP, MMPH, IHMK, OJQ-të, donatorët/komunat

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
2 700 000 euro	2013-2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 18		
Emri: **Korridoret ekologjike për të ndihmuar migrimin e specieve**	**Lokacioni: Kosovë** **- Bjeshkët e Nemuna (Alpet shqiptare);** **- Shala e Bajgorës;** **- Anamorava;** **- Malet e Sharrit; dhe** **- Rajoni i Drenicës**	**Lloji i intervenimit:** - **Zhvillim i institucionit për mbrojtje të biodiversitetit** - **Ndërtim i kapaciteteve njerëzore të këtij institucioni** - **Krijimi i korridoreve të gjata me breza të pandërprerë vegjetacioni** - **Korridore të vegjël me gurë; një seri e habitateve të vogla jo të lidhura.** - **Korridore peizazhi;**

Objektivat:
Të ndihmohen speciet që të lëvizin nga një habitat në tjetrin në zgjerim të habitateve, në kërkim për ushqim, në lëvizjen e kafshëve të vogla për të ndihmuar në mbrojtjen e biodiversitetit.

Arsyeshmëria

Korridoret ekologjike propozohen si mjet për të zbutur disa efekte negative ekologjike të fragmentimit të habitatit. Korridoret ekologjike, të planifikuara dhe dizajnuara me kujdes, mund të ndihmojnë në zbutjen e efekteve negative të fragmentimit të habitateve.
Shumë zona natyrore janë me shumë rëndësi për habitetet kryesore. Biodiversiteti paraqet vlerë unike; Kosova është e pasur me specie të ndryshme të bimëve dhe kafshëve, duke marrë parasysh sipërfaqen relativisht të vogël të saj.
Në Kosovë ekzistojnë 13 specie bimëve të cilat janë të identifikuara që të cilat rriten vetëm në Kosovë dhe rreth 200 të tjera të cilat rriten vetëm në Ballkan. Ky diversitet është rezultat i aktiviteteve komplekse fizike, pasi që dheu dhe klima krijojnë diversitetin e habitateve dhe kushtet për rritjen e bimëve. Në territorin e Kosovës ekzistojnë rreth 24 specie të bimëve të rrezikuara si rezultat i veprimtarisë njerëzore dhe natyrore. Këto janë kryesisht të përqendruara në viset malore por edhe në lugina.
Nga sipërfaqja e gjithmbarshme e Kosovës, prej 10.908.00,00ha, sipërfaqja e shpallur si Zonë e Mbrojtura Natyrore mbulon 119.933,40 ha, apo rreth 11% të saj.

Intervenimi:
Për të mbrojtur dhe krijuar kushte më të mira për biodiversitet të tillë, është e nevojshme të ndërmerren masa përkatëse për inventarizimin, konservimin dhe krijimin e kushteve më të mira për të gjitha speciet që zhvillohen në të.
Së pari intervenimet institucionale
- Funksionalizimi dhe punësimi i stafit profesional për Institutin e Kosovës për Mbrojtje të Natyrës
- Institucionalizimi i grumbullimit, mbajtjes dhe përpunimit të të dhënave mbi biodiversitetin;

Së dyti, intervenimet objektive
- Kërkimi i mirëmbajtjes apo restaurimit të vegjetacionit lokal, dhe menaxhimi afatgjatë.
- Sigurimi i përkrahjes adekuate për restaurimin dhe menaxhimin e korridorit.
- Mbjellja e drunjëve, shkurreve dhe bimëve tjera për të siguruar ushqim dhe mbulesë, si dhe mundësi për krijim të foleve për shpezët.
- Krijimi i korridoreve, brezave të pandërprerë të vegjetacionit, siç janë gardhet mbrojtëse, brezat e

pyjeve dhe vegjetacioni që rritet në brigjet e lumenjëve dhe rrjedhave;
- Krijimi i korridoreve me gurë për kalim; një seri të habitateve të vogla jo të lidhura të cilat shfrytëzohen për të gjetur strehë, ushqim apo për pushim;
- Krijimi i korridoreve të peizazhit; këto përbëhen nga elemente të ndryshme dhe të pandërprera të peizazheve të cilat ofrojnë mbulesë të mjaftueshme për rrugëtim të sigurt nga një zonë kyçe në tjetrën.

Rezultatet/ndikimet:
- Funksionalizimi i Institutit për Mbrojtje të Natyrës dhe punësimi i stafit profesional në Institutin për Mbrojtjen e Natyrës
- Monitorimi i rregullt dhe të dhënat mbi biodiversitetin
- Kushtet e sigurisë për lëvizjen e banorëve të habitateve nga një vend në tjetrin
- Më shumë mundësi për të mbajtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit të specieve
- Më pak ndikim të ndryshimeve klimatike në biodiversitet, etj.

Përgjegjësitë:
MMPH, Fakulteti i Shkencave Natyrore, MBPZHR, AKP, OJQ-të mjedisore

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
1 500 000 - 2 000 000	2011-2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 19

Emri:	**Lokacioni: Pilot-projekt në Kosovë**	**Lloji i intervenimit:**
Inkorporimi i objektivave lokale të biodiversitetit në planifikim, realizim dhe menaxhim të masave të infrastrukturës së gjelbër		**- Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale dhe programeve të vetëdijesimit që promovojnë masat e infrastrukturës së gjelbër** **- Pilot projekti** **- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe peizazhit**

Objektivi

Në kuptim të përshtatjes, infrastruktura e gjelbër shton rezistueshmërinë e ekosistemit. Infrastruktura e gjelbër mund të ruajë dhe të krijojë tipare të peizazhit që garantojnë se ekosistemet do vazhdojnë të ofrojnë shërbime siç janë uji i pastër, dheu produktiv dhe zonat atraktive rekreative.
Një nga mënyrat më efektive për të ndërtuar infrastrukturë të gjelbër është që të përvetësohet një qasje e integruar ndaj planifikimit hapësinor, për të përmirësuar ndërveprimin hapësinor në zona më të gjera gjeografike, pra nga qasja lokale në një qasje më të gjerë.

MMPH ka "Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitet 2011-2020" me katër objektiva strategjike të cilat mund të ndihmojnë në realizimin dhe menaxhimin e masave të mundshme të infrastrukturës së gjelbër.
Objektivi strategjik 1: Të zhvillohet korniza ligjore dhe institucionale në pajtim me standardet e BE-së dhe e njëjta të zbatohet në mënyrë efektive
Objektivi strategjik 4: Të promovohet edukimi dhe komunikimi efektiv lidhur me biodiversitetin
Objektivi strategjik 2: Të konservohet, ruhet dhe përmirësohet gjendja e specieve të bimëve dhe kafshëve, habitateve natyrore dhe peizazheve të paraqitura në balancë natyrore
Objektivi strategjik 3: Të sigurohet mbrojtje e integruar e natyrës përmes bashkëpunimit me sektorë tjerë,

shfrytëzimit të qëndrueshëm të biodiversitetit dhe ndarjes së barabartë të përfitimeve.

Arsyeshmëria

Infrastruktura e gjelbër është shpesh më pak e kushtueshme dhe më e durueshme se sa alternativat që i ofron inxhinieria civile e rëndomtë. Parqet dhe hapësirat e gjelbra mund të zbusin efektet negative të valëve të nxehtësisë gjatë verës.
"Kontributi i infrastrukturës së gjelbër në zhvillimin e qëndrueshëm në zonat urbane është veçanërisht i rëndësishëm. Ne jetojmë në një planet urban, ku më shumë se gjysma e popullatës së botës jeton në qytete, ndërsa që pritet që kjo shifër të arrijë 70% deri në vitin 2050. Qytetet duhet të fillojnë me përgatitje nëse dëshirojnë të jetojnë në një të nesërme të qëndrueshme," ka deklaruar Van Ham.

Intervenimi:
Ndërmarrja e masave për infrastrukturë të gjelbër do të ketë efekt pozitiv në ndaljen e humbjes së biodiversitetit dhe degradimit të ekosistemeve.

- Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale në pajtim me standardet e BE-së dhe implementimi efektiv i saj;
- Ngritja e vetëdijes përmes promovimit të edukimit dhe komunikimit efektiv mbi biodiversitetin
- Përshtatja i rrugëve të gjelbra për ecje dhe çiklizëm; (Eko shtegu në parkun e Gërmisë)
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore dhe peizazhit

Rezultatet/ndikimet:
- Zhvillimi i kornizës ligjore
- Informimi më i mirë lidhur me përfitimet nga biodiversiteti si dhe nga realizimi i infrastrukturës së gjelbër
- Më shumë shtigje të gjelbra dhe masa infrastrukturore të gjelbra për ecje, çiklizëm dhe rekreacion
- Mbrojtje më e mirë e trashëgimisë kulturore dhe peizazhit

Përgjegjësitë:
MMPH, komunat, MBPZHR, APK, MTI, komunitetet, OJQ-të lokale, etj.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
700 000 -1 000 000 Euro 100 000 Euro Eko Shtegu i Parkut të Gërmisë	2012 - 2015 2012 – 2013

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 20		
Emri: **Krijimi i variacioneve mikroklimatike dhe peizazheve të rezistueshme ekologjikisht përmes topologjive të ndryshme, për tu ndihmuar specieve në reagimin e tyre ndaj ndryshimeve të temperaturës dhe për t'i rritur gjasat e migrimit të specieve në nivel lokal tek një habitat më i favorshëm**	**Lokacioni:** **- Bjeshkët e Nemuna (Alpet shqiptare);** **- Shala e Bajgorës;** **- Anamorava;** **- Malet e Sharrit; dhe** **- Rajoni i Drenicës**	**Lloji i intervenimit:** **- Analizë e mangësive të sistemeve të zonave të mbrojtura sa i përket mbulimit reprezentativ të habitateve dhe specieve** **- Krijimi i korridoreve të reja dhe ruajtja e korridoreve ekzistuese,** **- Krijimi i rrjetit të këtyre korridoreve**

Objektivat:
Të krijohen kushte më të mira mikroklimatike dhe peizazhe më të rezistueshme për tu mundësuar specieve migrimin në habitate më të favorshme.

Arsyeshmëria

Ndryshimet klimatike janë duke ndodhur dhe ndikime të ndryshme po shfaqen çdo ditë.
Disa ndryshime klimatike janë të pashmangshme, përfshirë ekspozimin e shtuar ndaj temperaturave më të larta, valëve të nxehtësisë, vërshimeve dhe thatësisë, ashtu që biodiversiteti (kafshët dhe bimët) duhet të jetë i gatshëm për t'u përballë me ndikimet klimatike dhe për t'iu rezistuar atyre.
Për t'u përballë me sfidën e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike është me rëndësi që të ndërmerren disa masa që ndihmojnë në mbrojtjen e diversitetit të habitateve.

Intervenimi:
- Analiza e mangësive të sistemit të zonave të mbrojtura, në kuptim të mbulimit reprezentativ të habitateve dhe specieve;
- Zhvillimi i një sistemi qendror informativ për biodiversitetin
- Krijimi i korridoreve të ndryshme (përmes mbjelljes së drunjëve) në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i valëve të nxehtësisë dhe të ruhet lagështia në habitat.
- Pendat natyrale

Rezultatet/ndikimet:
- Ruajtja e popullatës përkatëse (bimë dhe kafshë)
- Ruajtja e potencialit reproduktiv (bimë dhe kafshë)

Përgjegjësitë:
MMPH, MBPZHR, komunat, OJQ-të mjedisore lokale, etj.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
200,000 -500,000 euro	2013-2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 21

Emri:	**Lokacioni: Kosovë**	**Lloji i intervenimit:**
Programet e shëndetit publik		**Projekt burimor dhe strategjik**

Objektivat:
Për sektorin e shëndetësisë është thelbësore që të ndërmerren masa për të ngritur nivelin e gatishmërisë, përfshirë:
(a) fuqizimin e kujdesit shëndetësor primar;
(b) fuqizimin e sigurisë shëndetësore;
(c) fuqizimin e monitorimit, mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të hershëm;
(d) vlerësimin e kapaciteteve, ndikimeve dhe zhvillimeve

Intervenimi:

- Realizimi i një vlerësimi të ndikimit në cenueshmërinë e shëndetit. Rezultati i vlerësimit do duhej të ofrojë të dhëna themelore mbi cenueshmërinë, ndikimet, politikat dhe programet e përshtatjes të cilat ekzistojnë aktualisht dhe të identifikojë veprimet e domosdoshme për vlerësimet e ardhshme. Hapa themelorë të vlerësimit janë:

1. Kuadri dhe fushëveprimi i vlerësimit;
2. Vlerësimi i cenueshmërisë: përshkrimi i rreziqeve që ndryshimet klimatike të fundit paraqesin për shëndetin njerëzor, si dhe i politikave dhe programeve të shëndetit publik për t'i trajtuar këto rreziqe;
3. Vlerësimi i ndikimit: të projektohen rreziqet dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike për shëndetin në të ardhmen;
4. Vlerësimi i përshtatjes: të identifikohen dhe të përcaktohet prioriteti politikave dhe programeve të cilat adresojnë rreziqe të caktuara për shëndetin.
5. Të krijohet një proces i monitorimit dhe menaxhimit të vazhdueshëm të rreziqeve që ndryshimet klimatike i paraqesin për shëndetin njerëzor.

- Zhvillimi i planit të veprimit për shëndet gjatë nxehtësisë dhe ngritja e vetëdijes mbi ekspozimin në nxehtësi.
- Fuqizimi i sistemit të mbikëqyrjes, i cili do të jetë gjithëpërfshirës dhe i ndjeshëm për t'i identifikuar efektet potenciale të ndryshimeve klimatike në shëndet.
- Fuqizimi i sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve infektive.
- Lansimi i fushatave vetëdijesuese mbi ndryshimet klimatike dhe shëndetin për punonjësit shëndetësorë dhe mjekësorë.

Rezultatet/ndikimet:

Ndikimi kryesor do të ishte zhvillimi i politikave efektive shëndetësore dhe ndarja e burimeve të shëndetit publik, me qëllim të përmirësimit të shëndetit publik dhe minimizimit të rreziqeve për shëndetin nga ndryshimet klimatike.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Ministria e Shëndetësisë/Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik
- Qeveria qendrore - ministritë
- Qeveria lokale - komunat
- Organizatat joqeveritare
- Donatorët aktivë në Kosovë dhe palët tjera me interes, etj.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur është paraparë të jetë 1.7 milion euro.	2014 – 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 22		
Emri: **Programi i vetëdijesimit për punëtorët mjekësorë**	**Lokacioni: Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt burimor dhe strategjik**

Objektivat:

Adresimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në shëndeti njerëzor është veçanërisht sfidues për shkak të mjedisit që na rrethon dhe vendimeve që njerëzit marrin e që kanë ndikim në shëndet. Për sektorin e shëndetësisë është thelbësore që të ndërmerren hapa për të vlerësuar dhe ndërtuar kapacitetet e veta, përfshirë ato njerëzore. Prandaj nevojitet një program vetëdijesimi për punëtorët mjekësorë lidhur me ndryshimet klimatike dhe shëndetin, p.sh. duke i paralajmëruar punëtorët e profesionit mbi ndryshimet potenciale sa i përket ekspozimit ndaj aeroalergjentëve apo vektorëve.

Intervenimi:

- Përgatitja për situata emergjente dhe reagimi në rast të tyre, nga ngritja e kapacitetit në Ministrinë e Shëndetësisë e deri tek përgatitja e planeve emergjente të spitaleve dhe protokolleve për ekzaminim të shpejtë për raste të nxitura nga ndryshimet klimatike.
- Integrimi i masave të përshtatjes brenda qasjes gjithëpërfshirëse ndaj përforcimit të sistemeve shëndetësore, me qëllim të mbrojtjes së popullatës nga ndryshimet klimatike.
- Shfrytëzimi i vlerësimeve të ndikimit në shëndet gjatë vlerësimit të kostove sociale dhe ekonomike të kërcënimeve përkatëse dhe gjatë përcaktimit të prioritetit për veprime dhe investime.
- Krijimi i sistemit për grumbullimin e informatave me kohë, kryerja e hulumtimeve dhe azhurnimi i rregullt i vlerësimeve, përfshirë rreziqet aktuale dhe të ardhme për shëndetin që rezultojnë nga ndryshimet klimatike; identifikimi i grupeve dhe nënregjioneve të cenueshme; kapacitetet aktuale në nivel kombëtar dhe më të ulët për të adresuar rreziqet për shëndetin dhe mjedisin; përcaktimin e kostos dhe identifikimin e mundësive, përfshirë koston e mosveprimit për shëndetin; si dhe trendet e efektivitetit të përshtatjes.
- Mjetet për të përkrahur shfrytëzimin e shkencës në të kuptuarit e rreziqeve nga sëmundjet dhe e zhvillimit të komunikimit efektiv lidhur me rreziqet përkatëse, me qëllim të informimit të popullatës së cenueshme.
- Në veçanti, vlerësimi i infrastrukturës ekzistuese për kontrollimin patogjen/vektorial, të sëmundjeve që barten me ujë, morbiditetit dhe mortalitetit të ndërlidhur me motin, sëmundjet dhe vlerat ushqyese që barten me ushqim, sëmundjet dhe çrregullimet neurologjike, çrregullimet e shëndetit mendor të ndërlidhura me stresin, etj.

Rezultatet/ndikimet:

Ngritja e vetëdijes për të përkrahur angazhim më të gjerë të sektorit të shëndetësisë në programet e përshtatjes. Këmbimi i informatave dhe arritja e konsensusit janë të rëndësishëm për mobilizimin e përkrahjes publike, dhe vetëdijesimi është hapi i parë drejt ndërmarrjes së veprimeve të bazuara në informata të mirëfillta, ndërsa në shoqëritë demokratike, ai shpie drejt zhvillimit të qëndrueshëm.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Ministria e Shëndetësisë/Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik
- Qeveria qendrore - ministritë
- Qeveria lokale - komunat
- Organizatat joqeveritare
- Donatorët aktivë në Kosovë dhe palët tjera me interes, etj.

Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.75 milionë euro.	**Periudha e investimit:** 2014 – 2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 23		
Emri: **Sistemet e mbikëqyrjes së shëndetit publik**	**Lokacioni: Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt burimor dhe strategjik**
Objektivat: Të shmangen ndikimet potenciale të klimës në shëndet, përmes një kombinimi të fuqizimit të funksioneve kryesore shëndetësore dhe menaxhimit më të mirë të rreziqeve që paraqiten nga ndryshimet klimatike. Për autoritetet: fuqizimi i sistemeve të mbikëqyrjes së shëndetit publik, drejt zbulimit gjithëpërfshirës të efekteve potenciale të ndryshimeve klimatike në shëndet.		
Intervenimi: ➢ Fuqizimi i kapacitetit të përshtatjes së sistemit shëndetësor: shumë nga ndikimet e pritura të ndryshimeve klimatike mbi shëndetin janë të shmangshme apo të kontrollueshme, në rast se aplikohen intervenime të mirënjohura dhe të testuara në sistemin e shëndetit publik dhe shërbimeve shëndetësore, siç janë edukimi i publikut, hulumtimi i sëmundjeve dhe posaçërisht sëmundjeve të ngjitëse, përgatitja për katastrofa, kontrolli i mushkonjave, higjiena dhe inspektimi i ushqimit, suplementimi i vlerave ushqyese, vaksinat, kujdesi primar dhe sekondar i shëndetit mendor, dhe trajnimi. Përmirësimet/zhvillimi i planeve të veprimit dhe mbajtja e resurseve të kontrollit dhe kapacitetit të personelit duhet të përmirësohet për të siguruar reagim të suksesshëm. ➢ Avancimi/zhvillimi i sistemeve të reagimit në rast të epidemive infektuese		
Rezultatet/ndikimet: Ndikimi i katastrofave aktuale dhe të ardhme natyrore mund të zbutet nga sektori shëndetësor, në rast se definohen mekanizmat që adresojnë origjinën e shkaqeve të cenueshmërisë dhe planifikohen reagime efektive për rastet e tilla. Këto i ndihmojnë sektorit shëndetësor në përmirësimin e klimës së menaxhimit 'të rreziqeve dhe bëjnë shërbimet klimatike pjesë esenciale të shërbimeve të shëndetit publik. Fuqizimi i sistemeve shëndetësore do duhej të përbëjë një nga sfidat më prioritare të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.		
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Ministria e Shëndetësisë/Institutit Kombëtar i Shëndetit Publik - Qeveria qendrore - ministritë - Qeveria lokale - komunat - Organizatat joqeveritare - Donatorët aktivë në Kosovë dhe palët tjera me interes.		
Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.6 milion euro.		**Periudha e investimit:** 2014 – 2016

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 24		
Emri: **Avancimi i përgatitjes së përbashkët/me pjesëmarrje të të dhënave**	**Lokacioni: Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt burimor dhe strategjik**
Objektivat: Hulumtimi, së bashku me mjetet tjera të sofistikuara për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave, do të ofrojnë njohuri esenciale për autoritetet qendrore dhe lokale, bizneset e ndryshme dhe komunitetet teksa planifikojnë zhvillimin e mëtejmë të tyre. Hulumtime në fushën e klimës, produktivitetit të tokës, lumenjëve dhe burimeve tjera ujore, sistemeve ekologjike, trendeve demografike dhe socioekonomike, etj. Prandaj avancimi i përgatitjes së përbashkët/me pjesëmarrje të informatave është i domosdoshëm, duke përfshirë: a) Organet e ndryshme qeveritare dhe organizatat joqeveritare janë të përfshira në krijimin e kushteve dhe mbikëqyrjen e kërkimit, apo së paku konsultohen (përmes intervistave, anketave, etj.) b) Multidisiplinariteti: në përkufizimin dhe ekzekutimin e hulumtimit përfshihen disiplina të ndryshme: përveç shkencave inxhinierike dhe teknike, të nevojshme janë edhe ekologjia dhe shkencat sociale. c) Hulumtuesit lejojnë që hulumtimi i tyre të sfidohet nga palët tjera me interes të cilat mund të paraqesin supozimet e tyre, d) Rezultatet e hulumtimit nuk paraqiten në mënyrë autoritative por në mënyrë të thjeshtësuar, për të stimuluar reflektim nga palët me interes lidhur me atë që është e mundshme dhe atë që të njëjtat dëshirojnë, e) Pasiguritë nuk anashkalohen por komunikohen (në raportet përfundimtare, gojarisht), f) Hulumtuesit janë të gatshëm të flasin me palët me interes lidhur me pasiguritë.		
Intervenimi: Në programet dhe nismat kombëtare për hulumtim zhvillimi i një modeli të procedurave do të mund të konsiderohej si intervenim nëse kjo bëhet me qëllim të krijimit të mjeteve për zbutje dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Ky model i procedurave do të përgatitej nga ekspertë të ndryshëm, organe qevertare dhe palët me interes të cilat do t'i kontribuojnë avancimit të përgatitjes së informatave në mënyrë të përbashkët/me pjesëmarrje. Modeli i procedurave do të jetë i hapur për përdorim dhe qasje nga palët me interes, duke qenë i vendosur në internet dhe i mirëmbajtur nga qeveria.		
Rezultatet/ndikimet: Rezultati i këtij invervenimi do të shtojë produktivitetin e hulumtimeve specifike, për të arritur performansën më të mirë të tyre, me përfshirjen e të gjitha strukturave, personave dhe mjeteve relevante.		
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Qeveria qendrore - ministritë - Qeveria lokale - komunat - Organizatat joqeveritare - Donatorët aktivë në Kosovë dhe palët tjera me interes, etj.		
Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.9 milion euro.		**Periudha e investimit:** 2014 – 2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 25		
Emri: **Modernizimi i sektorit të hidrometerologjisë, përfshirë a) avancimin e sistemit të parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm të katastrofave, b) monitorimin afatgjatë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (cilësia dhe sasia)**	**Lokacioni:** **Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës në Prishtinë;** **Stacionet meteorologjike në Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt infrastrukturor**

Vërejtje e rëndësishme: Harmonizimi me ekipin e Strategjisë së Ujërave dhe/ose Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mjedisin, në mënyrë që të parandalohen dyfishimet dhe të zbriten shpenzimet.

Objektivat:

Kosova është e ekspozuar ndaj rreziqeve natyrore siç janë vërshimet, thatësirat, reshjet e mëdha të shiut apo borës, stuhitë e erës, valët e nxehtësisë, rrëshqitjet e dheut, orteqet, zjarret e pyjeve, si dhe disa epidemi të cilat drejtpërsëdrejti apo tërthorazi ndërlidhen me hidrologjinë, meteorologjinë dhe kushtet klimatike.

Qëllimi i këtij intervenimi është të modernizohet sektori i hidrometerologjisë, përfshirë avancimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm dhe parashikimit, dhe monitorimin afatgjatë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Është shumë me rëndësi që të gjenerohen parashikime dhe paralajmërime më të sakta, më në kohë dhe më të besueshme, në lidhje me motin, klimën, ujin dhe elementet tjera mjedisore. Gjithashtu, përmirësimi i mënyrës së plasimit të informatave dhe shërbimeve mbi motin, klimën, ujin dhe mjedisin tek publiku dhe autoritetet dhe përdoruesit tjerë. Është me rëndësi të madhe që publiku dhe autoritetet qeveritare të trajnohen mbi rreziqet e ndërlidhura me motin, klimën dhe ujin, për më tepër duke këshilluar grupet e përdoruesve se si të shfrytëzojnë më mirë informatat mbi motin, klimën dhe ujin për qëllime të përfitimit ekonomik dhe social.

Prandaj, është thelbësore të modernizohet sektori i hidrometeorologjisë, përfshirë a) avancimin e sistemit të parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm të katastrofave, b) monitorimin afatgjatë të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore (sasia dhe cilësia).

Intervenimi:

Modernizimi i infrastrukturës hidrologjike dhe meteorologjike për grumbullimin e të dhënave hidrometeorologjike mund të bëhet përmes veprimeve në vijim:

- Modernizimi i rrjetit aktual të monitorimit të burimeve ujore (nëntokësore dhe sipërfaqësore) dhe rrjetit për parametrat tjerë klimatikë (stacionet për monitorimin e temperaturës, reshjeve, avullimit, kondensimit, rrezatimit solar, etj.) dhe krijimi i rrjetit në rastet kur një i tillë nuk ekziston për të mbuluar tërë territorin e Kosovës, përfshirë furnizimin, dorëzimin, instalimin dhe konfigurimin e tërë infrastrukturës së domosdoshme, pajisjeve, instrumenteve, etj. Shtimi i besueshmërisë dhe disponueshmërisë së të dhënave meteorologjike, automatizimi i proceseve të matjes në disa lokacione të caktuara dhe transmetimi i të dhënave në kohë reale tek zyra qendrore e Institutit Hidrometeorologjik;
- Përmirësimi i operimit dhe mirëmbajtjes së të gjitha instrumenteve të instaluara;
- Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të institucioneve lokale për të grumbulluar të dhënat e regjistruara, analizuar ato, shfrytëzuar motelet softuerike për simulim dhe projektim të ndikimit të ndryshimeve klimatike mbi resurset ujore dhe shërbimet e ekosistemit, ndarjen e informatave mes

institucioneve të ndryshme brenda Kosovës dhe në nivel rajonal.

- Ngritja e kapaciteteve për të kryer vlerësime të integruara mjedisore dhe vlerësime të teknologjive me nivel të ulët karboni;
- Mundësimi i qasjes në të dhënat dhe informatat më cilësore mbi ndikimet klimatike.
- Dhënia e sinjalit të paralajmërimit të hershëm për vendimmarrësit lidhur me nevojën për të monitoruar ndryshimet meteorologjike dhe hidrologjike, gjatë marrjes së vendimeve lidhur me ndarjen e financave për të zbutur ndikimet e ndryshimeve klimatike apo për të realizuar përshtatjet e domosdoshme, përfshirë bashkërendimin me institucione financiare ndërkombëtare.
- Identifikimi, vlerësimi dhe monitorimi i rreziqeve nga katastrofat dhe avancimi i paralajmërimit të hershëm;
- Komunikimi dhe shpërndarja më e mirë e paralajmërimeve dhe shfrytëzimi i teknikave të reja për alarmimin e publikut;
- Krijimi i strukturave adekuate për të operuar dhe mirëmbajtur rrjetet në tërë vendin.

Rezultatet/ndikimet:

Një nga ndikimet e para është integrimi i aktiviteteve të ndërlidhura me motin, ujin dhe klimën me aktivitetet përkatëse në rajon. I dyti, gatishmëria dhe vetëdija për tu përballë me brengat globale dhe rajonale, përfshirë ndikimin e motit, klimës dhe ujërave, parandalimin dhe zbutjen e ndikimit të katastrofave, ndryshimet klimatike dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Ndikime tjera janë vetëdijesimi mbi përfitimet nga shërbimet që ndërlidhen me motin, ujin dhe klimën për të gjithë sektorët e shoqërisë, përfshirë vendimmarrësit. Për më tepër, të rëndësishme janë edhe lidhjet me organizata relevante të rajonit, autoritete tjera shtetërore, sektorin privat, botën akademike, përdoruesit e shërbimeve, etj.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
- Stacionet meteorologjike në Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj
- Agjencia Për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë (AMMK)
- Komunat në zonat e stacioneve meteorologjike
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave dhe
- Donatorët aktivë në Kosovë.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 20-30 milionë euro.	2014 – 2020

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 26

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Përmirësimi i komunikimit	**Kosovë**	**Projekt zhvillimor**

Objektivat:

Qeveria e Kosovës, ngjashëm me qeveritë e vendeve tjera, ka krijuar ueb-faqe qeveritare për të shpërndarë një pjesë të informatave që i grumbullon. Andaj, përmirësimi i komunikimit është i

domosdoshëm (shkëmbimi i të dhënave dhe informatave të prodhuara), përfshirë:
a) Shkëmbimin e të të dhënave me qeveritë tjera,
b) Hapjen e burimeve të të dhënave me të cilat plotësohen boshllëqet dhe mundësohet integrimi, p.sh. një bazë e hapur e të dhënave lidhur me monitorimin afatgjatë të ujërave sipërfaqësore (cilësia dhe sasia),
c) Shpërndarjen aktive të informatave dhe të dhënave nga qeveria për publikun: në internet, por edhe përmes prodhimit të fletushkave, përmes mediave, etj.

Intervenimi:

- Shtimi i numrit të të dhënave në dispozicion për publikun, përmes portaleve kombëtare, rajonale, lokale apo tematike, të përkrahura me zotime të politikave për qeverisje të hapur dhe të dhëna të hapura.
- Koncepti për një projekt bashkëpunues me qeveri lokale për të krijuar dhe organizuar Kulturën e të Dhënave të Hapura dhe Qeverisë së Hapur. Një listë me mbi 200 katalogje lokale, rajonale dhe kombëtare të të dhënave të hapura mund të gjendet në faqen e projektit datacatalogs.org, që mëton të jetë një listë gjithëpërfshirëse e katalogjeve të të dhënave nga anembanë bota.
- Konceptimi i një baze të hapur të të dhënave lidhur me monitorimin afatgjatë të ujërave sipërfaqësore (cilësisë dhe sasisë) dhe ndërlidhja me departamente të ngjashme në vendet e rajonit.
- Fushatat vetëdijesuese, hulumtimet dhe veglat tjera për grumbullim dhe analizim të të dhënave.

Rezultatet/ndikimet:
Përmes zgjerimit dhe përmirësimit të qasjes në teknologji të informimit dhe komunikimit (TIK), dhe inkurajimi i shfrytëzimit më të shpeshtë të TIK me qëllim të stimulimit të rritjes ekonomike, përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, dhe promovimit të qeverisjes së mirë dhe llogaridhënies sociale.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:
- Qeveria e Kosovës
- Autoritetet qendrore - ministritë
- Autoritetet lokale - komunat
- Donatorët aktivë në Kosovë, etj.
-

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.7 milion euro.	2014 - 2015 (faza fillestare) 2014 - 2024 (mirëmbajtja)

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 27

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Përmirësimi i përdorimit të informatave	**Kosovë**	**Projekt përmirësues**

Objektivat:
Përdorimi i informatave është bartja e informatave nëpër një seri shtigjesh që lidhin grupet dhe individët me role dhe tipare të ndryshme. Ne mund ta shqyrtojmë sistemin e përdorimit të informatave dhe t'i identifikojmë barrierat e tij. Por, për të eliminuar këto barriera ne duhet të adresojmë procesin e përdorimit të informatave apo mënyrën se si ne i komunikojmë ato.
Prandaj, është i nevojshëm përmirësimi i përdorimit të informatave, përfshirë
a) Përdorimin e informatave të reja në debate publike (të pashtrembëruara),
b) Sistemet e përkrahjes së vendimeve, p.sh. sistemet e informatave hidrometeorologjike të jenë të standardit të caktuar,
c) Miratimin e një plani për M&E gjatë përgatitjes së projektit, që përfshin përcaktimin e indikatorëve të procesit, indikatorëve për zvogëlim të stresit dhe indikatorëve të statusit mjedisor.

Intervenimi:

- Komponentë specifikë të teknologjisë informative dhe zhvillimi i produkteve të teknologjisë informative
- Krijimi i resurseve tjera informative, dhe avancimi i ofruesve të informatave duke i trajnuar ata për të shmangur gabimet
- Ngritja e kapaciteteve për të zvogëluar numrin e gabimeve edhe më tej
- Mirëmbajtja dhe azhurnimi i shpeshtë i sistemeve të informatave hidrometeorologjike
- Programet dhe rrjetet e vogla inovative dhe hulumtuese
- Zhvillimi i teknologjive inovative

Rezultatet/ndikimet:
Në vitet në vijim teknologjia informative do të luajë rol parësor në ridizajnimin e përmirësimeve të qëndrueshme të shërbimeve, njohurive, komunikimit, rezultateve, cilësisë dhe efikasitetit. Progres i theksuar do të arrihet me ndryshimin e faktorëve teknikë, sociologjik, kulturor, edukativ, financiar dhe të tjerë..

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Qeveria e Kosovës
- Autoritetet qendrore - ministritë
- Autoritetet lokale - komunat
- Donatorët aktivë në Kosovë, etj.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.75 milion euro.	2014 – 2015

Formulari i intervenimit Nr. 28

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Programet e vetëdijesimit mbi ndryshimet klimatike	**Kosovë**	**Projekt socioekonomik**

Objektivat:
Pasi që shumë organizata qeveritare dhe joqeveritare veç janë duke punuar në mënyrë aktive në ngritjen e vetëdijes lidhur me ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre, qeveria e Kosovës duhet të punojë në të njëjtin drejtim, dhe t'i inkurajojë autoritetet lokale, edukatorët, mediat që të luajnë rol në vetëdijesimin e publikut mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike.

Programet e vetëdijesimit të publikut mbi ndryshimet klimatike dhe mbi mënyrat e trajtimit të tyre, përfshirë a) fushatën vetëdijesuese mbi rrezikun e ndërtimit, jetesës dhe punës në zonat e rrezikuara, b) fushatën vetëdijesuese mbi kursimin e ujit për qytetarët, kompanitë, fabrikat, etj.

Intervenimi:

- Mjetet për ngritjen e vetëdijes përfshijnë ngritjen e kapaciteteve, përmes edukimit, trajnimit dhe përgatitjes së materialeve për ndryshime klimatike, shpjegimin se çfarë nënkuptojnë ndryshimet klimatike dhe si do të ndikojnë ato në jetën e njerëzve, ndryshimet që do t'i sjellin në ekonomi, shëndet dhe si mund të punojmë bashkërisht për një të ardhme më të mirë.
- Këto mjete duhet të përshtaten në mënyrë që të mund të përdoren nga njerëzit e rëndomtë, komunitetet, shoqëria civile, planprogramet shkollore, politikëbërësit, etj.
- Punëtoritë dhe seminaret do të organizohen në nivel kombëtar dhe lokal, duke filluar me procesin e edukimit dhe trajnimit të zyrtarëve, profesionistëve dhe mësimdhënësve shkollorë, të cilët do t'i përcjellin më tej dijen dhe përvojat e fituara.
- Mediumet komunikuese, siç janë televizioni, radio, pamfletet, gazetat, etj. do të aktivizohen në këto fushata.

Rezultatet/ndikimet:

Ekzistojnë shumë përfitime nga ngritja e vetëdijes mbi ndikimet e mundshme të ndryshimeve klimatike. Filluar nga inkurajimi i planifikimit më të mirë; përgatitjes së skenarëve të cenueshmërisë dhe përmbledhjes së veprimeve që mund të shtojnë rezistueshmërinë ndaj faktorëve stresues apo ndikimeve në komunitete specifike; të kuptuarit më të mirë se si ndryshimet klimatike do të prekin komunitetet, ekonominë, bujqësinë apo mënyrën e jetesës së tyre. Për të adresuar çështjet që ndërlidhen me përshtatjen është esenciale që të vlerësohet niveli i vetëdijes të popullatës lidhur me ndryshimet klimatike.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Qeveria e Kosovës
- Autoritetet qendrore - ministritë.
- Autoritetet lokale - komunat.
- Donatorët aktivë në Kosovë.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.8 milion euro.	2014 – 2016

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 29

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Trajnimi për profesionistët	**Kosovë**	**Projekt edukativ**

Objektivat:

Krijimi i qendrave të ujitjes me programe që paraqesin përmirësimin në menaxhim të ujërave në nivelin e distrikteve dhe atë planifikimin e ujërave në nivelin rajonal duke trajnuar profesionistë, përmes:
a) Trajnimin mbi menaxhimin efikas të ujitjes për bujq,
b) Trajnimin mbi përshtatjet ndaj ndryshimeve klimatike për profesionistë të shquar të fushës së ujërave, bujqësisë, pylltarisë, planifikimit të destinimit të tokave, shëndetësisë publike, etj.
Punëtoritë trajnuese do të fokusohen në efikasitet të ujitjes, duke shtjelluar temat: dheu, pajisjet për

paracaktimin e ujitjes, vlerësimi i ujitjes me pije, interpretimi i të dhënave të motit, menaxhimi i salinitetit në hortikultura të ujitura, etj.

Intervenimi:

- Shërbime edukative dhe asistencë teknike për distriktet e ujitjes
- Asistencë teknike, dizajnim dhe trajnim në implementimin e Sistemit të Informatave Gjeografik (SIG) dhe integrimin e sistemeve të bazave të të dhënave, përfshirë optimizimin e rrjetit shpërndarës së ujit dhe sistemet e ujitjes në fusha
- Hulumtimet aplikative të sistemeve të menaxhimit të bazuara në Sistemin e Informatave Gjeografik dhe metodat e shpejta të vlerësimit të projekteve prioritare për rehabilitim, në bazë të potencialit për kursim të ujit
- Sistemi i Informatave Gjeografike për nevoja të përcaktimit të distrikteve të ujitjes dhe menaxhimit të tyre
- Matjet dhe vendosja e orëve të ujit në distrikte të ujitjes
- Trajnimet e specializuara individuale dhe grupore
- Programet e menaxhimit të ujitjes

Rezultatet/ndikimet:

Analizimi i gjendjes së furnizimit të ujit në distrikt dhe aftësia e tyre për të shpërndarë sasi të kënaqshme të ujit dhe për ta drejtuar atë tek ferma, për të mundësuar ujitje efikase brenda fermës. Vlerësimi i humbjeve të ujit në distrikte përmes testeve të derdhjes dhe humbjeve, matjes së derdhjeve, etj., për të përcaktuar prioritetet dhe projektet përkatëse të propozuara për rehabilitim dhe trajtim të stabilimenteve me qëllim të kursimit të ujit. Vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës së distriktit për të identifikuar komponentët e rrjetit shpërndarës të ujit dhe strukturave përkatëse që duhet riparuar. Përcaktimi i vendndodhjes në Sistemit të Informatave Gjeografik dhe integrimi në sistemet e bazave të të dhënave dhe sistemet kontabilare të distriktit.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Qeveria e Kosovës
- Autoritetet qendrore - ministritë
- Autoritetet lokale - komunat.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.9 milion euro.	2014 – 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 30

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Masat financiare dhe ekonomike	**Kosovë**	**Projekt socioekonomik**

Objektivat:

Rëndësia e marrëdhënies mes zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike është evidente dhe theksohet në fushën e zhvillimit ekonomik. Thuhet se zhvillimi financiar është kyç për rritje të suksesshme ekonomike. Masat financiare dhe ekonomike që duhet të ndërmerren përfshijnë:

a) Diversifikimin e resurseve financiare, duke shfrytëzuar një gamë të gjerë të instrumenteve financiare

private e publike,
b) Kostot kthehen nga 'përdoruesit', nga instrumentet financiare publike dhe private (ngarkesat, çmimet, sigurimi, etj.),
c) Autoritetet mund të marrin kredi dhe të zhvlerësojnë asetet e tyre, të lejojnë shfrytëzim efikas të resurseve dhe zëvendësim të aseteve,
d) Rritjen e pjesëmarrjes së sektorit privat në menaxhimin e ujërave dhe burimeve natyrore, p.sh. përmes partneriteteve publike-private.

Intervenimi:

- T'iu ndihmohet kompanive, në veçanti ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në realizimin e eksporteve në tregjet globale, në krijimin e programeve eksportuese dhe në ndarjen e resurseve për biznese, në mënyrë që të mund t'i qasen me lehtësi përkrahjes që u nevojitet për të depërtuar në nivel global.
- Zbritja e kostove administrative për kompanitë eksportuese, për të zvogëluar riskun në ciklin financiar, duke shtuar gjasat që një projekt të arrijë tek përmbyllja financiare dhe/ose duke shtuar koston e kapitalit
- Siguria politike për tarifat stimuluese për burime të ripërtëritshme (tarifa *feed-in*)
- Garancitë kreditore për energji të pastër
- Menaxhimi fleksibil i politikave ekonomike dhe fiskale
- Stimulimi i investimeve private dhe atyre që promovojnë energjinë e ripërtëritshme dhe kursimet e energjisë, me qëllim të zhvillimit më të fuqishëm
- Përmes promovimit agresiv të përmirësohet konkurrueshmëria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë
- Rivitalizimi i ekonomive rajonale duke i shfrytëzuar asetet lokale dhe duke përshpejtuar ndërtimin e komuniteteve miqësore për banorët
- Promovimi i turizmit, bujqësisë, shtimi i vendeve të punës dhe përmirësimi i shpërndarjes së të ardhurave përmes masave tatimore dhe masave tjera
- Promovimi i modifikimit strukturor për të siguruar rritje vendore të orientuar nga kërkesa e të udhëhequr nga sektori privat
- Identifikimi i treguesve të performansës për të matur dhe përcaktuar prioritetet për menaxhimin e reagimeve mjedisore dhe sociale
- Identifikimi i treguesve relevantë socioekonomikë për të matur ndikimin në sektorët specifikë
- Identifikimi i treguesve të ndikimit socioekonomik për të matur dhe përcaktuar prioritetet për menaxhimin e reagimeve
- Matja e ndikimit socioekonomik që do të ndihmojë në të kuptuarit e nevojave, aspiratave, resurseve dhe masave stimuluese

Rezultatet/ndikimet:
Ekzistojnë teknika dhe mjete të ndryshme për të adresuar sfidat e matjes së ndikimit socioekonomik që do të mund t'u ndihmojë bizneseve, qeverisë dhe shoqërisë civile. Ndikimi/rezultati kryesor i implementimit të masave të propozuara financiare dhe ekonomike është sistemi financiar dhe ekonomia e stabilizuar.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Qeveria e Kosovës - Autoritetet qendrore - ministritë - Autoritetet lokale - komunat - Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministria e Financave, dhe - Donatorët aktivë në Kosovë.	
Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 1.7 milion euro.	**Periudha e investimit:** 2014 – 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 31		
Emri: **Përmirësime në menaxhimit të riskut**	**Lokacioni:** **Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt socioekonomik**
Objektivat: Sistemet e menaxhimit të riskut duhet të jenë më shumë sisteme të përshtatjes se sa statike. Institucionet financiare dhe ekonomike duhet të adresojnë varësinë e tepër të tyre nga rangimi kreditor, dhe t'i plotësojnë këto rangime me analiza të tyre, të cilat do duhej të azhurnohen kohë pas kohe përgjatë tërë periudhës së investimit. Përmirësimet në menaxhimin e rreziqeve përfshijnë: a) Perceptimin e rreziqeve nga gjykimet formale të ekspertëve dhe perceptimin e rreziqeve nga palët me interes, b) Përfshirjen e akterëve qeveritarë dhe joqeveritarë në vendimet mbi atë se çka përbën rrezik të pranueshëm, c) Vënien në dispozicion të mekanizmave për sigurim të korrave, d) Vënien në dispozicion të sigurimit të dëmtimit të vendbanimit dhe pronave.		
Intervenimi: • Zhvillimi i platformave, strukturat dhe komponentët e integruar për menaxhim më të avancuar të rreziqeve dhe menaxhim të gjelbër • Zhvillimi i kornizës për përmirësimin e menaxhimit të rreziqeve • Procedurat tipike të menaxhimit të rreziqeve, siç janë identifikimi, vlerësimi, reagimi, monitorimi dhe raportimi, të cilat duhet të realizohen me bashkërendim më të mirë, me më pak dyfishim të punëve, me efektivitet të shtuar dhe me kosto më të ulët. • Përfshirja e sistemeve për zgjerim të brendshëm të të dhënave mbi rreziqet dhe për ndarjen e të dhënave me agjencitë tjera. • Është me rëndësi të diskutohen të gjithë skenarët e rreziqeve dhe të identifikohet rreziqet specifik që do të mund ta destabilizonte krijimin dhe zhvillimin e mënyrave optimale për të reaguar ndaj tij.		
Rezultatet/ndikimet: Ndikimet socioekonomike janë ngushtë të ndërlidhura me suksesin e bizneseve, dhe ne duhet t'i integrojmë ato brenda menaxhimit të performansës së bizneseve.		

Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Qeveria e Kosovës - Autoritetet qendrore - ministritë - Autoritetet lokale - komunat - Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministria e Financave, dhe - Donatorët aktivë në Kosovë

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.6 milion euro.	2014 – 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 32		
Emri: **Sigurimi apo ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së palëve me interes**	**Lokacioni:** **Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt socioekonomik**
Objektivat: Sigurimi apo ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së palëve me interes, përfshirë: a) Dispozitat ligjore lidhur me qasjen në informata, pjesëmarrjen në vendimmarrje (p.sh. obligimet për konsultime para marrjes së vendimeve) dhe qasjes në gjykata, d) Strukturat bashkëpunuese përfshijnë akterët joqeveritarë (p.sh. OJQ-të mjedisore, grupet qytetare, grupet e përdoruesve apo sektori privat), c) Akterët joqeveritarë kontribuojnë në caktimin e agjendës, analizimin e problemeve, sajimin e zgjidhjeve dhe marrjen e vendimeve ('koproduksion'), d) Akterëve joqeveritarë u mundësohet apo u lejohet menaxhimi i një pjese të burimeve natyrore, p.sh. përmes shoqatës së përdoruesve të ujit.		
Intervenimi: • Sigurimi i teknikave të shumta dhe të pakufizuara për identifikimin dhe analizimin e palëve me interes • Shfrytëzimi i llojeve të ndryshme për komunikim dhe për zgjidhje të problemeve • Adresimi i shumë niveleve të politikëbërjes, përfshirë ndërvarësinë mes institucioneve dhe organizatave • Akomodimi i karakteristikave, interesave dhe komunikimeve të ndryshme. Të qenit i hapur për informata nga më shumë burime dhe të më shumë llojeve. • Pranimi se konflikti është i pashmangshëm dhe identifikimi i pamundësisë për të arritur deri tek një zgjidhje e plotë dhe përfundimtare. • Krijimi i kapaciteteve për tu përballë me turbulenca, trauma dhe çështje që do të rezultojnë nga ndikimi i ndryshimeve klimatike. • Të kuptohet se shumë probleme mund të gjenerohen nga i njëjti burim. • Të adresohen burimet e konfliktit dhe të adresohen mospajtimet e veçanta.		

• Të grumbullohen, këmbehen dhe komunikohen dijenia, storiet dhe botëkuptimet e pjesëmarrësve dhe të njëjtat të aplikohen në procese dhe dizajne institucionale.
Rezultatet/ndikimet: Qeverisja e mirë, promovimi i menduar mirë i demokratizimit dhe zhvillimi i vendimmarrjes së bazuar në informata, janë përfitimet perspektive që i sjell përfshirja e palëve me interes në politikëbërje. Kjo përfshirje konsiderohet se sjell përfitime për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Autoritetet qendrore - ministritë - Autoritetet lokale - komunat - Ministria e Zhvillimit Ekonomik - Ministria e Financave, dhe - Donatorët aktivë në Kosovë

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.6 milion euro.	2014 – 2016

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 33		
Emri: **Përmirësimi i bashkëpunimit ndërsektorial**	**Lokacioni:** **Kosovë**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt për ngritje të kapaciteteve**
Objektivat: Sot përballemi me mospërputhje të resurseve, mundësive dhe ekspertizës në organizata, prandaj bashkëpunimi ndërsektorial është duke u zhvilluar çdo herë e më shumë në tërë Evropën, me qëllim të adresimit të brengave të përbashkëta dhe gjetjes së metodave interesante të bashkëpunimit. Përderisa rolet dhe marrëdhënia mes autoriteteve publike, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë civile janë duke ndryshuar, akterët janë duke kërkuar mënyra të reja për të arritur synimet e tyre, duke diskutuar se si bashkëpunimet mes bizneseve, shoqërisë civile dhe qeverive mund të shfrytëzohen për të gjetur zgjidhje për sfidat e shumta me të cilat përballemi. Për këtë arsye, ne duhet të përmirësojmë bashkëpunimin ndërsektorial, përfshirë si në vijim: a) Autoritetet sektoriale të përfshijnë sektorët tjerë qeveritarë aktivisht (p.sh. bujqësi, natyrë, mjedis, turizëm, pylltari, shëndetësi, navigacion, planifikim hapësinor), b) Strukturat e bashkëpunimit të përfshijnë organe qeveritare nga sektorë të ndryshëm; në përgjithësi ka më shumë kontakte, c) Konfliktet të trajtohen me konstruktivitet, gjë që rezulton me marrëveshje përfshirëse për të cilat zotohen të gjitha palët (p.sh. konfliktet së paku zvogëlohen, apo zgjidhen, në mënyrë që të evitohen bllokimet e procesit vendimmarrës).		
Intervenimi: • Përshtaten modele për bashkëpunim ndërsektorial, duke grumbulluar sektorin publik, sektorin privat dhe ndërmarrjet shoqërore. Promovimi i modeleve të reja për bashkëpunim ndërsektorial për të kultivuar përfshirje sociale, kohezion dhe inovacion, me theks të posaçëm në fuqizimin e rolit dhe kapaciteteve të ndërmarrjeve shoqërore, me grupe primare të synuara si politikëbërësit, përfaqësuesit e		

bizneseve private, ndërmarrjet shoqërore, organizatat dhe iniciativat, publiku, dhe akterët tjerë relevantë. • Zhvillimi i instrumenteve të reja dhe metodave operative - integrimi i sistemeve teknike; akterët publik dhe privat, furnizimi i ujit dhe shërbimet sanitare, planifikimi i peizazhit, menaxhimi i mbeturinave, arkitektura, funksionet urbane, energjia, trafiku dhe transporti. • Përforcimi i pozitës strategjike dhe hulumtimeve dhe ofrimi i trajnimeve të mëtejme për ata që ofrojnë udhëzime • Garantimi i qasjes, disponueshmërisë dhe mjaftueshmërisë së udhëzimeve dhe shërbimeve këshillimore për të gjithë qytetarët, me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit dhe punës në rrjete rajonale ndërsektoriale. • Identifikimi dhe analizimi i praktikave të mira të modeleve efektive dhe inovative për bashkëpunim ndërsektorial dhe partneritet, veçanërisht duke u fokusuar në rolin dhe nevojat e ndërmarrjeve shoqërore. • Politikës zhvillimore i nevojitet bashkëpunim dhe rrjetëzim, ngritje e vetëdijes dhe informata mbi ekonominë sociale.
Rezultatet/ndikimet: Njerëzit presin që masat që ndërmerren nga qeveritë dhe administrata publike e tyre të jenë efektive dhe efikase, dhe duan që politikat dhe ligjet të jenë transparente dhe t'u përgjigjen nevojave të tyre. Ata gjithashtu kërkojnë të kenë më shumë informata mbi brengat ekonomike dhe ekologjike dhe kërkojnë të jenë më të përfshirë në formulimin dhe implementimin e politikave. Politikëbërësit dhe shërbyesit civilë duhet të kenë parasysh lidhjet e rëndësishme mes politikave të ndryshme publike dhe dimensioneve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre. Ndërkohë, zhvillimi i politikave dhe implementimi i tyre duhet të jenë të bazuara në marrëdhënie fleksibile mes qeverisë dhe akterëve përkatës, siç janë pronarët apo menaxherët e tokave, kompanitë private dhe organizatat e komunitetit.
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Qeveria e Kosovës - Autoritetet qendrore - ministritë - Autoritetet lokale - komunat, etj.

Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.8 milion euro.	**Periudha e investimit:** 2014 – 2025

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 34		
Emri: **Përmirësimi i bashkëpunimit mes niveleve të administratës**	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt për ngritje të kapaciteteve**
Objektivat: Marrëdhëniet mes autoriteteve qendrore dhe lokale funksionojnë në një numër nivelesh. Autoritetet qendrore dhe lokale duhet të punojnë së bashku përherë për të arritur synimet e përbashkëta. Prandaj, përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet niveleve të administratë është i domosdoshëm, duke përfshirë: a) Përfshirjen e autoriteteve të nivelit më të ulët në vendimmarrjen e autoriteteve më të larta,		

b) Strukturat e bashkëpunimit duhet të përfshijnë autoritete nga të gjitha nivelet e hierarkisë; më shumë kontakte në përgjithësi,
c) Konfliktet të trajtohen me konstruktivitet, gjë që rezulton me marrëveshje përfshirëse për të cilat zotohen të gjitha palët (p.sh. konfliktet së paku zvogëlohen, apo zgjidhen, në mënyrë që të evitohen bllokimet e procesit vendimmarrës).

Intervenimi:

- Programet e përbashkëta, trajnimet dhe ngritja e kapacitetet në/me të dyja nivelet.
- Metoda për planifikimin e orientuar nga objektivi - mjetet e menaxhimit që lehtëson planifikimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e projekteve të përbashkëta.
- Mekanizmi bashkërendues ndërmjet niveleve të ndryshme rezulton me rregullim të cilësisë
- Ndarja më efektive e përgjegjësive rregullative, dhe proceseve të tenderimit, vendimmarrjes dhe monitorimit
- Shtim i perspektivës së qeverisjes dhe menaxhimit të mirë të qeverisjes lokale
- Autoritetet qendrore japin përkrahje të plotë për autoritetet lokale në promovimin dhe zhvillimin e projekteve, në menaxhim, teknologji dhe financim/investim

Rezultatet/ndikimet:
Rezultat i këtij intervenimi do të jetë forcimi i marrëdhënies ekzistuese ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale dhe agjencive tjera, me qëllim të gjetjes së mënyrave më të mira për të punuar bashkë. Ndërkohë, konsiderohet si tejet e rëndësishme që t'i besohet qeverisjes lokale marrja e vendimeve dhe ofrimi i shërbimeve, këshillave dhe kryerja e hulumtimeve. Puna e përbashkët mund të jetë më efektive dhe t'iu shpërblehet më mirë palëve të përfshira.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Qeveria e Kosovës
- Autoritetet qendrore - ministritë
- Autoritetet lokale - komunat.

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.5 milion euro në vit.	2014 – 2025

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 35

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Përmirësimi i bashkëpunimit përtej kufijve administrativë	**Kosovë**	**Projekt infrastrukturor**

Objektivat:
Qëllimi kryesor është që të zvogëlohen efektet negative të kufijve administrativë, ndërsa që adresohen problemet e përbashkëta dhe shfrytëzohet potenciali i paprekur.
Përmirësimi i bashkëpunimit përtej kufijve administrativë, duke përfshirë:
a) Autoritetet më të ulëta të përfshihen në vendimmarrje nga nivelet më të larta,
b) Të ekzistojnë strukturat e bashkëpunimit ndërkombëtar/ndërkufitar (p.sh. komisionet e shtretërve të lumenjve); më shumë kontakte në përgjithësi,
c) Konfliktet të trajtohen me konstruktivitet, gjë që rezulton me marrëveshje përfshirëse për të cilat zotohen të gjitha palët (p.sh. konfliktet së paku zvogëlohen, apo zgjidhen, në mënyrë që të evitohen

bllokimet e procesit vendimmarrës)
Intervenimi: Procesi i bashkëpunimit avancohet përmes menaxhimit të përbashkët të programeve dhe projekteve, besimit dhe të kuptuarit e ndërsjellë. Ndarja e kufijve të përkufizuar dhe të qëndrueshëm minimizon parregullsitë ligjore. Përcaktimi i lokacioneve dhe korrigjimi i informatave publike për përshkrimet ligjore të distrikteve dhe hartat përkatëse të tyre.
Rezultatet/ndikimet:
Përgjegjësitë: Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë: - Qeveria e Kosovës - Autoritetet qendrore - ministritë - Autoritetet lokale - komunat, etj.

Kostoja e investimit: Kostoja e implementimit të intervenimit të lartpërmendur parashihet të jetë 0.5 milion euro.	**Periudha e investimit:** 2014 – 2015

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 36		
Emri: **Plani i menaxhimit dhe masat për rehabilitimin e hidrosistemit Ibër-Lepenc**	**Lokacioni:** **Liqeni i Gazivodës dhe Kanali i Ibër-Lepencit**	**Lloji i intervenimit:** **Projekt infrastrukturor dhe joinfrastrukturor**

Objektivat:

Liqeni artificial i Gazivodës dhe kanali bartës i ujit (akuedukti) paraqesin burimin më të rëndësishëm ujor të Kosovës. Uji nga liqeni i Gazivodës, i transportuar përmes kanalit të Ibër Lepencit, shfrytëzohet për qëllime të ndryshme nga konsumatorë të ndryshëm:

- Furnizimi me ujë të pijes: KRU Mitrovica merr ujin dhe planifikon t'i dyfishojë kapacitetet e veta të trajtimit për të përmbushur kërkesën në rritje (dy ITU janë në ndërtim e sipër), KRU Prishtina planifikon të ndërtojë një ITU të ri (ITU i ri është në fazën e dizajnimit, ndërsa implementimi i tij pritet të fillojë së shpejti).
- Energji: Gjenerim i rrymës (rreth 30MW) dhe për ftohjen e dy termocentraleve ekzistuese (Kosova A dhe B), ndërsa edhe termocentrali i ri i planifikuar 'Kosova e Re' do ta marrë ujin nga kanali i Ibër-Lepencit,
- Industri: Metalurgjiku i Ferronikelit merr ujin nga kanali i Ibër-Lepencit
- Ujitje: në tokat bujqësore të rajonit të Mitrovicës dhe Prishtinës.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij sistemi për furnizim të ujit, gjenerim të energjisë, industri dhe ujitje, do të sajohet një plan gjithëpërfshirës i rehabilitimit dhe menaxhimit të kanalit të Ibër-Lepencit, e me të cilin do të adresohet integriteti fizik dhe menaxhimi i kanalit të Ibër-Lepencit.

Vërejtje: Banka Botërore ka filluar implementimin e projektit me të cilin trajtohet hidrosistemi i Ibër-Lepencit.

Intervenimi:

Intervenimi do të përfshirjë masa strukturore dhe jostrukturore, siç janë:

i) Zhvillimi i planit operativ dhe të menaxhimit për kanalin e Ibër-Lepencit, dhe

ii) Zhvillimi i dizajnit dhe implementimi i masave rehabilituese për të siguruar integritetin strukturor të kanalit Ibër-Lepenci.

i) Plani operativ dhe i menaxhimit përfshin:

✓ Përcaktimin e prioriteteve të arsyeshme, kufizimin dhe ndarjen e ujit për çdo kategori konsumatorësh që merr ujë nga kanali i Ibër-Lepencit, duke shqyrtuar edhe kërkesën edhe ofertën.

✓ Menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të ujit, përfshirë politikat tarifore.

✓ Programin e zhvillimit të masave mbrojtëse për të adresuar nxjerrjen ilegale të ujit, derdhjen e ujërave të zeza dhe minimizimin e riskut të ndërlidhur.

✓ Zhvillimin e planeve për furnizim me ujë të konsumatorëve në rast të situatave emergjente, ndërlidhjen me elemente tjera kyçe infrastrukturore për të shtuar fleksibilitetin e furnizimit.

ii) Rehabilitimi i strukturës ekzistuese të kanalit për të përmirësuar efikasitetin e furnizimit të ujit

✓ Implementimi i masave rehabilituese për të ulur numrin e rrjedhjeve në kanal, çkyçjen e marrjes ilegale të ujit.

✓ Implementimi i masave mbrojtëse (ndërtimi i mureve) për të parandaluar rrjedhjen e ujit nga kanali.

✓ Rehabilitimi i kanalit Ibër-Lepenci për të siguruar integritetin strukturor të kanalit.

Rezultatet/ndikimet:

Implementimi i masave të mësipërme do të shpie tek:

i) Plani operativ dhe i menaxhimit për kanalin Ibër-Lepenc, dhe tek ndarja e ujit dhe përcaktimi i prioriteteve për kategori të konsumatorëve, duke adresuar skenarët e ndryshëm.

ii) Sigurimi i integritetit strukturor të kanalit Ibër-Lepenci,

iii) Minimizimi i cenueshmërisë që ndërlidhet me kontaminimin e ujit dhe marrjen ilegale.

iv) Përmirësimi i furnizimit dhe transportimit të ujit përmes kanalit.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:

- Hidrosistemi Ibër-Lepenci
- KRU-të e Mitrovicës dhe Prishtinës
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Financave dhe
- Agjencitë donatore

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e zhvillimit dhe implementimit të masave strukturore dhe jostrukturore parashihet të jetë 15 - 17 milionë euro.	2015 – 2018

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 37

Emri:	**Lokacioni:**	**Lloji i intervenimit:**
Dizajnimi dhe ndërtimi i një impianti për trajtim të ujërave acidike nga miniera e Novobërdës	**Novobërdë**	**Projekt infrastrukturor**

Objektivat:
Uji acidik i drenuar nga miniera e Novobërdës derdhet drejtpërdrejt në lumin Marevc. Cilësia e ujit nga kjo rrjedhë karakterizohet me pH të ulët (6.25), nivele të larta të joneve të sulfatit (163 mg/L), hekurit (62.5 mg/L), zinkut (22.1 mg/L) dhe manganit (17.9 mg/L). Metalet e rënda (që janë tejet toksik për shëndeti njerëzor), përfshirë As, Cd, Cu, Pb, Ni, Co dhe Cr janë të pranishme në përmasa të mëdha, duke i tejkaluar kufijtë mjedisorë të përcaktuar në Kosovë, BE apo standarde ndërkombëtarisht të pranueshme për ujë të rrjedhshëm.
Këto derdhje acidike kanë ndikim serioz negativ në cilësinë e lumit Marevc, edhe atë në një distancë të konsiderueshme në rrjedhën e poshtme nën minierë. Degradimi mjedisor bëhet edhe më i rëndë kur kemi parasysh se ky lum, cilësia e së cilit mbi pikën e derdhjes së ujit nga miniera karakterizohet me një habitat të shëndetshëm ujor dhe i plotëson të gjitha standardet më të rrepta mjedisore, ndikon në ujin e pijes dhe ujitjes në qytetet dhe popullatën që ndodhen në rrjedhën e poshtme të lumit, në komunat e Novobërdës dhe Kamenicës. Për më tepër, ndikimi i kontaminimit është ndërkufitar, pasi që lumi Marevc derdhet në lumin Morava e Binçes, i cili më pas derdhet në Danub.
Për këtë arsye, objektivi kryesor i këtij intervenimi/kësaj mase është që të trajtohen ujërat acidike nga miniera e Novobërdës dhe të ulet sasia e kontaminimit, për të arritur tek përmasat që nuk përbëjnë rrezik për mjedisin, habitatin ujor dhe shëndetin e popullatës që jeton nën vendin ku derdhet uji nga miniera.
Vërejtje: UNDP ka kryer studimin e fizibilitetit për trajtimin e ujërave acidike që drenohen nga miniera e Novobërdës.

Intervenimi:
Zhvillimi i dizajnit përfundimtar dhe ndërtimi i një impianti aktiv të trajtimit të ujërave acidike për Novobërdën, të përbërë nga rezervuari i trazimit dhe ajrosjes, bazeni i neutralizimit, sistematizimi dhe trashësia e llumit.

Rezultatet/ndikimet:
Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave acidike do duhej të rezultojë me zvogëlim të ngarkesës së kontaminimit dhe përmirësim të cilësisë së ujit dhe me më pak dëm për shëndetin njerëzor dhe degradimin e mjedisit në vendbanimet më në vijim të rrjedhës nën pikën e derdhjes nga miniera.

Përgjegjësitë:
Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij intervenimi janë:
- Ndërmarrja Trepça
- Komuna e Novobërdës
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe
- Ministria e financave

Kostoja e investimit:	**Periudha e investimit:**
Kostoja e zhvillimit të dizajnit dhe ndërtimit të impiantit të trajtimit parashihet të jetë 0.85 – 1.0 milion euro.	Afatshkurtër 2015 – 2016

Formulari i intervenimit sipas Strategjisë Nr. 38		
Emri: **Rikultivimi i mbetjeve industriale**	**Lokacioni:** **Parku industrial i Mitrovicës**	**Lloji i intervenimit:** **Infrastrukturor dhe**

dhe trajtimi i drenazhit acidik nga minierat	**Mbetjet e Stantërgut/Kelmendit Mbetjet e Zveçanit dhe mbeturinat metalurgjike**	**joinfrastrukturor**

Objektivat:

Mitrovica ndodhet në afërsi të Kompleksit të Minierës Trepça, i cili dikur ishte ndërmarrja më e rëndësishme industriale dhe e minierave në Kosovë. Minierat e Stantërgut ndodhen rreth 6km larg Mitrovicës, ndërsa Shkritorja e Pb-Zn e Zveçanit dhe Parku Industrial i Mitrovicës ndodhen në vetë periferinë e qytetit. Dekadat e tëra të mihjes dhe shkrirjes kanë prodhuar sasi të mëdha të mbeturinave industriale, edhe në formë të emetimeve të pjesëzave dhe gazrave nga tymtarët edhe në formë të vëllimeve të mëdha të baltës xeherore dhe mbetjeve tjera. Supozohet se rreth 50 milionë ton mbeturina toksike industriale janë të depozituara në afërsi apo përreth lokacioneve të lartpërmendura, në afërsi të vendbanimeve urbane dhe lumenjve (Sitnica dhe Ibër), gjë që përbën problem të madh mjedisor. Popullata e rajonit të Mitrovicës për disa dekada ka qenë e ekspozuar ndaj koncentrimeve tejet të larta të metaleve të rënda në ajër, ujë dhe tokë.

Për këtë arsye, objektivi i këtij intervenimi është të zbuten ndikimet negative të mbetjeve në mjedis dhe në shëndetin njerëzor.

Intervenimi:

Për të zbutur ndikimet negative të mbetjeve në mjedis në rajonin e Mitrovicës, ekziston nevoja për të zhvilluar dhe zbatuar masa rehabilituese të cilat përbëhen nga komponentë infrastrukturorë dhe joinfrastukturorë. Masat e implementimit janë të ndryshme, që nga zhvillimi i studimeve të fizibilitetit e deri tek rikultivimi i materialeve të mbeturinave industriale që përbëjnë rrezik ekstrem për shëndetin njerëzor dhe ekosistemet mjedisore nën lokacionet e kontaminuara. Intervenimet janë listuar në vijim:

- Hartimi i një studimi të fizibilitetit dhe një plani gjithëpërfshirës për ripërpunimin dhe/ose rehabilitimin e deponive të mbetjeve në Parkun Industrial të Mitrovicës dhe Stantërg/Kelmend dhe baltës xeherore metalurgjike të Zveçanit.
- Hartimi i një studimi të fizibilitetit për trajtimin e ujërave acidike minerare nga Tuneli i Parë para derdhjes së tyre në lumin Trepça, dhe për menaxhimin rrjedhjeve
- Implementimi i masave rehabilituese për mbetjet në Parkun Industrial të Mitrovicës, Stantërg/Kelmend dhe Zveçan.
- Ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave acidike nga minera që dalin nga Tuneli i Parë
- Zhvillimi i planit gjithëpërfshirës për përcaktimin e kontaminimit të ujërave nëntokësore dhe zhvillimin e masave për trajtim të ujërave nëntokësore në Parkun Industrial të Mitrovicës.
- Zhvillimi i masave për rehabilitimin e tokës bujqësore në zonat ku koncentrimi i metaleve të rënda përbën rrezik për shëndetin njerëzor.

Rezultatet/ndikimet:

Implementimi i masave të mësipërme do të zbutë degradimin mjedisor, do të pasqyrohet si përmirësim i shëndetit njerëzor në rajonin e Mitrovicës dhe më gjerë, pasi që këto ujëra nga lumi Ibër derdhen në Serbi, gjë që nënkupton efektet ndërkufitare të këtij kontaminimi.

Përgjegjësitë:

Partnerët me përgjegjësi kryesore për implementimin e këtij impianti trajtimit janë:

- Ndërmarrja Trepça
- Komunat e Mitrovicës dhe Zveçanit
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe
- Ministria e Financave
-

Kostoja e investimit: Kostoja e hartimit të studimeve të fizibilitetit dhe dizajnit kryesor për intervenimet e mësipërme dhe për realizimin e masave rehabilituese në godinat industriale dhe ndërtimin e impiantit të trajtimit parashihet të jetë 12.0 - 15.0 milionë euro.	**Periudha e investimit:** Intervenim afatgjatë 2015 – 2025

Shtojca 4: Planifikimi i investimeve dhe implementimi i Strategjisë

Pas ratifikimit të strategjisë, një nga sfidat kryesore do të jetë përgatitja për financim dhe implementim. Në kapitullin vijues jepet një pasqyrë e shkurtër e planifikimit të investimeve, financimit, përgatitjes së projekteve dhe implementimit të tyre.

Planifikimi i investimeve

Qëllimi i planit të investimit është që të paraqesë projektet që do të implementohen me qëllim të arritjes së objektivave; përbërjen; afatet kohore; oraret e disbursimit; të hyrat; ndikimet mjedisore dhe sociale; dhe çështjet ligjore dhe institucionale. Një plan i mirë i investimeve mund të joshë financierë dhe partnerë potencialë, dhe ndihmon në implementimin e mirëfilltë të projekteve. Gjatë përgatitjes së planit të investimeve mund të jetë e dobishme që tu përgjigjemi pyetjeve në vijim:

Cili është qëllimi i investimit? Objektivi i përgjithshëm i investimit, si dhe qëllimi i drejtpërdrejtë i tij, duhet të përshkruhen mirë. Qëllimi preferohet të lidhet me tregues specifikë të performansës, për të mundësuar monitorimin e ndikimeve të investimit. Investimet mund të kenë edhe ndikime sekondare, të cilat janë pozitive dhe ia vlen të formulohen.

A është dizajnuar investimi në mënyrë optimale? Një studim i fizibilitetit mund të jetë i domosdoshëm për shumicën e investimeve, ngase në të përshkruhen zgjidhjet alternative të ndryshme dhe ndikimi i tyre sa i përket fizibilitetit teknik; ndikimet mjedisore dhe sociale, rregullimin institucional, kërkesat ligjore dhe institucionale e madje edhe më shumë. Pasi që të jetë përzgjedhur alternativa e preferuar, shumë aspekte të detajuara të arsyeshmërisë duhet të shtjellohen dhe optimizohen, për shembull përmes dizajnit konceptual të të gjithë komponentëve të projektit, para përgatitjes së dizajneve të detajuara dhe dokumenteve të tenderimit.

Cili është kalendari kohor i investimeve? Në përgjithësi, intervenimi fizik kërkon tri lloje investimesh: (1) kostot përgatitore; (2) shpenzimet kapitale (CAPEX) dhe, pas përfundimit të punëve ndërtimore: (3) shpenzimet operative (OPEX). Në disa raste, investimet gjithashtu mund të ngërthejnë kosto të mbylljes pas përfundimit të fazës operative, për shembull në rast të deponive sanitare me jetëgjatësi të kufizuar. Është me rëndësi të bëhen vlerësime reale dhe të përcaktohen oraret kohore të secilës kategori të shpenzimeve.

Cilat janë të ardhurat e investimit? Nëse projekti do të gjeneronte të ardhura të drejtpërdrejta, siç janë pagesat për ujëra të zeza, është me rëndësi të kuptohet se deri në ç'masë janë të sigurta të ardhurat në fjalë, kur dhe si këto të ardhura do të gjenerohen dhe si të menaxhohet inkasimi i këtyre të ardhurave në mënyrë të qëndrueshme.

Cili është rreziku i investimit dhe rreziku financiar? Është me rëndësi të bëhet një vlerësim adekuat i rerzikut që ndërlidhet me investimin e paraparë. Rreziku mund të ndërlidhet me ngjarje të jashtme mjedisore të cilat mund të parandalojnë apo zvogëlojnë rezultatet e investimit; me rrezikun financiar apo ligjor të falimentimit apo tërheqjes së investitorëve kritikë; me ndërtimin, dhe me rrezikun që ndërlidhet me operacionet/të ardhurat. Është me rëndësi të kuptohen përmasat e rrezikut të tillë dhe ndikimin e tij, si dhe masat potenciale evituese dhe kostot e tyre.

Cila rrjedhë e parasë nevojitet? Dallimi mes shpenzimeve dhe të hyrave të një investimi me kalimin e kohës përcakton rrjedhën e parasë që nevojitet për të përgatitur, realizuar dhe zbatuar projektin. Shpenzime tipike mund të jenë: kostot e përgatitjes dhe AT; CAPEX; OPEX, tatimet, kamatat e kredive, shpagimi i kredive. Rrjedhat hyrëse të parave mund të ndërlidhen me të hyrat e projektit; me kreditë; me subvencionet; dhe me grantet. Rrjedha e parasë mund të gjenerohet nga burimet financiare vetanake dhe/ose përmes financierëve të jashtëm. Financat e jashtme mund të gjenerohen për shembull përmes buxheteve qeveritare; (bashkë)financimi nga sektori privat; fondet e IFN apo donatorëve; subvencionet apo grantet; apo kreditë komerciale. Në përgjithësi, kreditë komerciale kërkojnë plane financiare të qëndrueshme me të hyra të mjaftueshme dhe me nivel relativisht të ulët të riskut. Marrja parasysh e normave kamatore dhe inflacionit do të kontribuonte në optimizimin e mëtejmë dhe rregullimin e detajuar të rrjedhës së parave dhe planit të financimit.

Normat e brendshme të kthimit

Norma e brendshme e kthimit (IRR) e një investimi përkufizohet si normë e skontimit në bazë të së cilës vlera aktuale e kostove (rrjedha negative e parasë) të një investimi është e barabartë me neto vlerën aktuale të përfitimeve (rrjedha pozitive e parasë) të investimit. Kalkulimet e IRR zakonisht shfrytëzohen për të vlerësuar dëshirueshmëria e investimit të projektit. Sa më e lartë të jetë IRR, aq më i dëshirueshëm do të jetë projekti. Nëse supozojmë se të gjitha projektet kërkojnë të njëjtën shumë të investimit paraprak projekti me IRR më të lartë do të konsiderohej më i miri dhe do realizohej i pari.




Figura 1 - Norma pozitive e brendshme e kthimit

Figura 1 paraqet një shembull të një projekti që gjeneron normë të brendshme të kthimit prej 12.4%, gjë që pasqyrohet me faktin se pas një periudhe të caktuar kohore, të hyrat kumulative tejkalojnë shpenzimet kumulative. Në këtë rast, financimi i projektit kërkon 12,000 euro, gjë që përbën dallimin maksimal mes shpenzimeve kumulative dhe të hyrave pas vitit të dytë.




Figura 2 - Norma negative e brendshme e kthimit

Figura 2 paraqet një shembull të një projekti që gjeneron normë negative të brendshme të kthimit prej 6.5%, gjë që pasqyrohet me faktin se të hyrat kumulative nuk tejkalojnë shpenzimet kumulative gjatë periudhës së paraparë të projektit (në këtë rast 10 vite). Në këtë projekt financat e kërkuara (rrjedha negative e parasë) në fund të periudhës së projektit është 360,000 euro (në vitin e dhjetë), e përveç kësaj një vlerë prej 1,080,000 euro kërkohet për të mbuluar hendekun mes shpenzimeve kumulative dhe të hyrave prej vitit të katër (gjithsej 1,440,000 euro).

Shtojca 5: Pasqyrë e strategjisë sektoriale të Strategjisë

Strategjia sektoriale/plani/ligji	**Deklaratat e vizionit dhe misionit**
Plani Hapësinor i Kosovës 2010 - 2020 (MMPH)	Të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm social dhe ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, mundësi të edukimit për të gjithë dhe fuqi të kualifikuar të punës, një vend që respekton mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe kulturore të territorit të vet dhe të fqinjëve të vet, me një shoqëri të hapur që promovon diversitet dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të tjerëve.
Plani i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 2009 - 13 (MMPH)	Të japë kontribut të balancuar për mirëqenien ekonomike, mjedisore, shoqërore dhe kulturore në zona rurale dhe në Kosovë si tërësi, përmes partneriteteve efektive dhe fitimprurëse mes sektorit privat, qeverisë qendrore/lokale dhe komuniteteve lokale brenda kontekstit evropian.
Zhvillimi i Pyjeve 2010 - 2020	Të rritet kontributi i sektorit të pylltarisë për ekonominë kombëtare, përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve pyjore, duke marrë parasysh edhe rolin multifunksional të pylltarisë.
Strategjia dhe Plani Veprimit i Biodiversitetit 2011 - 2020	Mbrojtja (ruajtja) e biodiversitetit; zhvillimi i qëndrueshëm në bazë të përdorimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore; krijimi i të ardhurave dhe ndarja e përfitimeve nga përdorimi i biodiversitetit në mënyrë të barabartë
Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012 – 2025	Zhvillimi i resurseve minerale dhe zgjerimi dhe modernizimi i industrisë së përpunimit minerar, për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, mundësi të reja të punësimit dhe mirëqenie të shtuar për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sigurimi i të gjitha parakushteve ligjore dhe institucionale për shtim të shpejtë të investimeve në sektorin minerar, avancimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, shtimi i interesit të komunitetit dhe sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore.
Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011 – 2018	Sektori i ngrohjes do të plotësojë kërkesën për ngrohje të hapësirave të brendshme dhe ujit, duke marrë parasysh përdorimin e BRE, burimeve alternative të energjisë dhe pajimeve efiçiente, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit. Misioni i Strategjisë është që t'i kontribuojë zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të ngrohjes, në pajtim me standardet evropiane.
Strategjia Mjedisore e Kosovës (KES) 2011-2021	E drejta jonë është që të kërkojmë zhvillim në një mjedis të pastër dhe të sigurt. Ndërsa, përgjegjësi e jona është që të sigurohemi që ta ruajmë atë.
Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat në Kosovë	Të sigurojë zhvillim dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve ujore, të cilat janë të domosdoshme për shëndetin publik, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin shoqëroro-ekonomik të Kosovës; ndarje optimale të resurseve ujore; mbrojtje të resurseve ujore nga ndotja, keqpërdorimi apo përdorimi i tepërt.
Ligji Nr. 02 / l-79 për Detyrat Hidrometeorologjike	Ky ligj rregullon punët hidrometeorologjike dhe mënyrën e kryerjes së tyre.
Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetin Publik	Shëndetësia publike: disiplinë e pavarur që merret me identifikimin dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të bashkësisë nga të gjitha pikëpamjet shëndetësore, parandalimin e sëmundjeve, hulumtimin e etiologjisë së sëmundjeve, promovimin e shëndetit, rehabilitimin dhe ripërshtatjen e të

	hendikepuarve, edukimin shëndetësor dhe çështjet sociale.
Ligji Nr. 03/L-086 për ofruesit e shërbimeve të mbeturinave, ujit dhe kanalizimit	Ligji themelon Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) si rregullator i pavarur ekonomik për shërbime të ujit dhe ujërave të zeza në Kosovë. Roli i ZRRUM është që të sigurojë mosdiskriminim dhe ofrim të shërbimeve cilësore, efikase dhe të qëndrueshme, kundrejt një çmimi të drejtë dhe arsyeshëm për konsumatorët, duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik.
Ligji Nr. 02/L-9 për Ujitjen e Tokave Bujqësore	Qëllimi i këtij ligji është krijimi i infrastrukturës ligjore për krijimin dhe funksionimin e organeve që ofrojnë shërbime dhe për shfrytëzuesit e shërbimeve, si dhe organizimin autentik të tyre, me qëllim të krijimit të kushteve optimale për ujitjen e tokave bujqësore në Kosovë dhe mbrojtjen e tyre nga ujërat e tepërta, me qëllim të shtimit të rendimentit të produkteve bujqësore.
Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale	Ky ligj paraqet bazën ligjore për një sistem të qëndrueshëm të vetëqeverisjes lokale në Kosovë.
Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Natyra dhe trashëgimia kulturore janë interes i Republikës së Kosovës dhe duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë.
Ligji Nr. 03/L-124 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor	Qëllimi i këtij ligji është që të parandalojë dhe zbutë ndikimet negative të projekteve të propozuara publike dhe private, duke i kontribuar kësisoj ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit, mbrojtjes së shëndetit njerëzor dhe ngritjes së cilësisë së jetesës.
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit	Ky ligj do të harmonizojë zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore të mbrojtjes së mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.
Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturinat	Ky ligj rregullon menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhim mjedisor, të drejtat dhe obligimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyrën dhe kushtet e grumbullimit, transportit, trajtimit, përpunimit, ruajtjes dhe largimit përfundimtar, importit, eksportit dhe transitit të mbeturinave, monitorimit, sistemit të informimit dhe financimit të kësaj veprimtarie.
Ligji Nr. 04-L-174 për Planifikimin Hapësinor	Me qëllim të sigurimit të planifikimit dhe zhvillimit hapësinor kombëtar, arritja e balancit mes zhvillimit dhe ruajtjes së hapësirave të hapura dhe mbrojtjes së mjedisit, duke sjellë regjimet e planifikimit hapësinor të Kosovës në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare
Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Tjera.	Ky ligj rregullon mbrojtjen dhe shpëtimin e popullatës, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Shtojca 6: Procesi i zhvillimit të Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët dhe Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes

Procesi i përgatitjes ngërthente një seri tryezash të rrumbullakëta dhe punëtorish, në të cilat morën pjesë anëtarë të KNU, përfaqësuesit e ministrive kyçe dhe shoqërisë civile.

Procesi i LECRDS sipas udhëzuesit të UNDP		Hapat e ndërmarrë
Hapi 1	Zhvillimi i një procesi të planifikimit me shumë palë me interes	Krijimi i Grupit Punues Ndërministror për Ndryshime Klimatike (GPN) - mars 2013
Hapi 2	Përgatitja e profileve të ndryshimeve klimatike dhe skenarëve të cenueshmërisë	Studimi i fizibilitetit për sistemin e regjistrimit të gazrave serrë për Kosovën - 2012
Hapi 3	Identifikimi i opsioneve strategjike që rezultojnë me trajektore zhvillimore që janë më të rezistueshme ndaj klimës dhe kanë emetime më të ulëta	Tryeza e parë e rrumbullakët mbi Strategjinë e Zhvillimit me Emetime të Ulëta - shkurt 2013
Hapi 4	Identifikimi i politikave dhe opsioneve të financimit për të zbatuar veprimet prioritare për ndryshimet klimatike	Tryeza e dytë e rrumbullakët mbi Strategjinë e Zhvillimit me Emetime të Ulëta - qershor 2013 Punëtoria e MCA - shtator 2013
Hapi 5	Përgatitja e Udhërrëfyesit për Zhvillim me Emetime të Ulëta dhe të Rezistueshëm ndaj Ndryshimeve Klimatike	Tryeza e tretë e rrumbullakët mbi Strategjinë e Zhvillimit me Emetime të Ulëta - tetor 2013

Tryeza e rrumbullakët e parë për zhvillimin e CCFS u mbajt më 28 shkurt 2013 dhe kishte për qëllim paraqitjen e procesit të hartimit të strategjisë para akterëve kryesorë të këtij procesi, përcaktimin e fushave tematike kyçe që do adresoheshin nga strategjia dhe diskutimin e alternativave kryesore të përshtatjes apo lehtësuese të cilat do duhej marrë në konsideratë. Diskutimet u bazuan në konceptin fillestar të sajuar nga eksperti i UNDP-së.
Koncepti i dytë u bazua në idetë e akterëve të parashtruara gjatë tryezës së parë të rrumbullakët dhe shërbeu si bazë për tryezën e dytë të rrumbullakët që u mbajt më 26 qershor 2013. E njëjta u fokusua në vizionin dhe objektivat e përgjithshme dhe në përcaktimin e prioriteteve në listën e veprimeve të propozuara si fusha tematike gjatë punëtorisë së parë.
Pas tryezës së dytë të rrumbullakët, ekspertët vendorë përgatitën raportet e tyre sektoriale të cilat u paraqitën dhe diskutuan në punëtorinë e GPN, të mbajtur më 11 shtator. Pas kësaj, ekspertë ndërkombëtarë finalizuan kontributet e tyre të cilat u integruan në draft strategji.
Draft strategjia u diskutua në tryezën e tretë të rrumbullakët të mbajtur më 21 tetor, pas të cilës e njëjta u finalizua duke marrë parasysh komentet dhe konkluzionet e tryezës së rrumbullakët dhe iu paraqit qeverisë.

Shtojca 7: Grupi Punues Ndërministror (GPN) dhe ekipi këshillëdhënës përgjegjës për hartimin e CCFS

Strategjia për Ndryshimet Klimatike - lista e nëngrupeve punuese

a) **Nëngrupi për regjistrin e gazrave serrë** - i cili udhëhiqet nga Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit (AMMK)

- Riza Hajdari, udhëheqës i grupit, Agjencia Kosovare për Mbrojtje të Mjedisit (AMMK) /Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Mimoza Hyseni, anëtare AMMK/MMPH
- Abdullah Pirçe – anëtar, Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës (DMN)/MMPH
- Lulzim Korenica, anëtar, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
- Bedri Millaku, anëtar, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)
- Ramadan Mazrekaj, anëtar, Ministria e Infrastrukturës (MI)
- Fidaim Sahiti, anëtar, Departamenti i Ujërave/Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)
- Ibrahim Balaj, anëtar, Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/MMPH
- Vjosa Beqaj, anëtare, Ministria e Integrimeve Evropiane (MIE)
- Letafete Latifi, anëtare, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës/AMMK/MMPH
- Fisnik Sadikaj, anëtar, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPRZH)
- Bajram Kafexholli, anëtar, AMMK/MMPH
- Vebi Ejupi, anëtar, MMPH

b) **Nëngrupi për zvogëlimin e gazrave serrë** - i cili udhëhiqet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)

- Lulzim Korenica, udhëheqës i grupit, MZHE
- Nezakete Hakaj, anëtare, DMN/MMPH
- Abdullah Pirqe, anëtar, DMN/MMPH
- Azra Krasniqi, anëtare, MIE
- Ramadan Mazrekaj, anëtar, MI
- Bedri Millaku, anëtar, MTI
- Adriana Pllana, anëtare, AMMK/MMPH
- Letafete Latifi, anëtare, IH/AMMK/MMPH
- Fisnik Sadikaj, anëtar, MBPZHR
- Leonora Durmishi, anëtare, DU/MMPH
- Florije Kqiku, anëtar, MMPH

c) **Nëngrupi për përshtatje** - i cili udhëhiqet nga Departamenti për Mbrojtje të Natyrës (DMN) i MMPH

- Ismail Hetemaj, udhëheqës i grupit DMN/MMPH
- Zymer Mrasori, anëtar, DMN/MMPH
- Merita Mehmeti, anëtare, AMMK/MMPH
- Sami Behrami, anëtar, AMMK/MMPH
- Enver Tahiri, anëtar, DMN/MMPH
- Erëza Abrashi, anëtare, MIE

Konsulentët në vijim janë kontraktuar nga UNDP për të hartuar Strategjinë Kornizë për Ndryshimet Klimatike:

Konsulentë ndërkombëtarë/udhëheqës të ekipit:

- Dr. Patrick Huntjens (Holandë), autor udhëheqës i Strategjisë Kombëtare të Përshtatjes
- Jernej Stritih (Slloveni), autor udhëheqës i Strategjisë për Zhvillim me Emetim të Ulët

Konsulentë vendorë:

- Jehona Grapci (Kosovë), Koordinatore Kombëtare dhe Eksperte Institucionale dhe Socioekonomike
- Abedin Azizi (Kosovë), Ekspert i Resurseve Ujore, autori i kaptinave për resurset ujore

- Nysrete Doda-Gashi (Kosovë), Eksperte e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Planifikimit të Destinimit të Tokave, autore e kaptinave për bujqësi, pylltari, biodiversitet dhe planifikim të destinimit të tokave.
- Behxhet Shala, Ekspert i Gjenerimit të Energjisë Elektrike
- Mustafë Muhaxheri, Ekspert i Sektorit të Ndërtimit dhe Ngrohjes Qendrore
- Nol Dedaj, Ekspert i Sektorit të Transportit
- Halil Berisha, Ekspert i Sektorit të Industrisë

Shtojca 8: Akterët bilateralë

Personat në vijim kanë ofruar kontribute dhe komente gjatë zhvillimit të strategjisë:

- Daniela Zampini, Koordinatore për Zhvillim me Përfshirje, UNDP Kosovë
- Shqipe Deda-Gjurgjiali, Menaxhere e Portofolit të Mjedisit dhe Energjisë, UNDP Kosovë
- Daniela Carrington, Këshilltare për Politika të Ndryshimeve Klimatike, UNDP RBEC
- Zana Hoxha–Edip, Specialiste për Zvogëlimin e Rrezikut nga Katastrofat, UNDP Kosovë
- Muhamet Malsiu, Drejtor i Departamentit të Mjedisit, MMPH
- Gazmend Selimi, Menaxher për Bujqësi dhe Mjedis, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë
- Baton Begolli, Këshilltar për Politika Ujore, Sekretaria e Këshillit Ndërministror të Ujërave, Zyra e Kryeministrit
- Aleksandar Nikolovski, Kryekëshilltar Teknik, Ekipi i FAO në Kosovë
- Naser Krasniqi, Udhëheqës i Ekipit Kombëtar GCP/KOS/005/FIN, Ekipi i FAO në Kosovë
- Lura Rexhepi, Qendra Rajonale për Mjedis (REC), Kosovë
- Mustafë Gashi, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Kosovë
- Fadil Kodra, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), Kosovë
- Ardita Tahirukaj, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), Kosovë
- Ismail Hetemaj, Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit/Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Anna Kaplina, Analiste e Programit për Ndryshim Klimatik, UNDP
- Traute Koether, Komisioni Evropian, TAIEX
- Vanya Grigorova, Komisioni Evropian, TAIEX
- Detelina Petrova, Komisioni Evropian, TAIEX X
- Rositsa Karamfilova, Komisioni Evropian, TAIEX
- Hazir S. Çadraku, Udhëheqës i Divizionit për Politika Ujore, Departamenti i Ujërave, MMPH
- Merita Meksi, Koordinatore Rajonale për Programin e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike në Ballkanin Perëndimor/GIZ
- Redon Begolli, Zyrtar për Operacione, Banka Botërore
- Andre Jol, Udhëheqës i Grupit për Cenueshmëri dhe Përshtatje, Agjencia Mjedisore Evropiane (AEE)

Referencat

Komisioni Evropian, 2013, Udhëzimet për përgatitjen e përshtatjeve zhvillimore http://ec.europa.eu/clima/policies/adaptation/what/docs/swd_2013_134_en.pdf)

Hallegatte, S. 2009, Strategjitë për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike të pasigurta. *Global Environmental Change,* 19:240-247.

Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, 2007, Ndryshimet Klimatike: Ndikimi, Përshtatja dhe Cenueshmëria

Paneli Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike, 2013, Ndryshimet Klimatike 2013: Baza Shkencore Fizike. Kontributi i Grupit Punues I në Raportin e Pestë Vlerësues të PNNK - Ndryshimet në Vlerësimin Shkencor/Teknik Bazë (IPCC-XXVI/Doc.4)

Aleanca Ndërkombëtare e Universiteteve Hulumtuese (IARU), 2009, Ndryshimet klimatike: Rreziqet, Sfidat dhe Vendimet Globale. Raport përmbledhës i kongresit shkencor ndërkombëtar të IARU mbi ndryshimet klimatike që u mbajt në Kopenhagë më 10-12 mars 2009. Universiteti i Kompenhagës, Edicioni i Dytë, 2009.

OSBE, 2008, Çështje të Furnizimit me Ujë në Kosovë

Palmer, M. A., C. Liermann, C. Nilsson, M. Florke, J. Alcamo, P. S. Lake, dhe N. Bond., 2008, Ndryshimet klimatike dhe pellgjet e lumenjve në botë: paraqitja e opsioneve të menaxhimit. *Frontiers in Ecology and Environment,* 6:81-89.

UNDP/WMO, 2011, Vlerësimi i Nevojave të Përfituesve të IPA, Kosovë (sipas përkufizimit në Rezolutën 1244/99)

UN-HABITAT Kosovë, 2009, Identifikimi i Rreziqeve nga Katastrofat në Planifikim Hapësinor për qëllime të Zhvillimit të Qëndrueshëm: Rasti Studimor i Kosovës

WHO, WMO, 2012, Atlasi i shëndetit dhe klimës, ISBN: 978 92 4 156452 6

Banka Botërore, 2008, “Trendet Klimatike dhe Projeksionet në Evropën Juglindore", prezantim i Ndryshimeve Klimatike dhe Ujërave në Evropën Juglindore: Kuptimi i Ndikimeve dhe Planifikimit gjatë Përshtatjes, Tiranë, Shqipëri, 24-25 qershor 2008.

Raporti Botëror mbi Zhvillimin e Ujërave, 2009, Raporti i Tretë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Ujërave: Uji në një Botë në Ndryshim (WWDR-3), 2009, www.unesco.org